





association for  
the prevention  
of torture

# Monitorimi i Vendeve të Burgimit

---

një guidë praktike





association for  
the prevention  
of torture

# Monitorimi i Vendeve të Burgimit

---

një guidë praktike

# Monitorimi i Vendeve të Burgimit

## Guidë Praktike

### Vlerësime

Së pari, Shoqata e Parandalimit të Torturës (SHPT) do të donte të falenderontë Zyrën për Institucionet Demokratike dhe të Drejtave të Njeriut të OSBE/ODHIR që ranë dakord të na lejonin të publikonim këtë guidë si një rifreskim i publikimit tonë më të hershëm të përbashkët “Monitorimi i vendeve të burgimit: një guidë praktike për OJQ-të” (Gjenevë, Dhjetor 2002). Falenderojmë Zj. Annette Corbaz e cila shkroi guidën e mëparshme.

Drafti i këtij dokumenti u diskutua gjatë një takimi ekspertësh në Gjenevë më 20 tetor 2003 dhe do të donim të falenderonim ekspertët e mëposhtëm që morën pjesë në këtë takim: Z. Paul English (Reforma Penale Ndërkombëtare), Zj. Mary Murphy, anëtare e bordit të pavarur monitorues të burgjeve në Mbretërinë e Bashkuar dhe ish kërkuese shkencore e Amnesty International, Z. André Picot, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Z. Jean-Pierre Restellini, anëtar i Komisionit Europian për Parandalimin e Torturës (CPT), Zj. Margaret Sekaggya, Kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut të Ugandës dhe Z. Morris Tidball-Binz, Zyra për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut e Shërbimit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut. Komentet e tyre frutdhënëse në përpilimin e draftit ishin një kontribut thelbësor për versionin final të kësaj guide.

SHPT do të dëshironte gjithashtu të falenderonte personat dhe institucionet e mëposhtme:

“Instituto de estudios comparados en ciencias penales y sociales” të Argjentinës, Zj. Maria Noel Rodriguez, të Zyrës së Kombeve të Bashkuara të Komisionerit të Lartë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut Zyra e Kolumbisë, dhe Dr Andrew Coyle Drejtor i Qendrës Ndërkombëtare të Studimit të Burgjeve, për dobishmërinë e komenteve të tyre të shkruara për draftin e kësaj guide. Zj. Mary Murphy bëri një punë të mbrekullueshme lidhur me leximin dhe korrigjimin e versionit final.

Vlerësimi ynë shkon gjithashtu për Z. Theo van Boven, Raporter Special për Torturën i cili ra dakord të shkruante parathënien e këtij publikimi.

Së fundmi, kjo guidë nuk do të ishte publikuar pa mbështetjen bujare financiare të donatorëve tanë.

# SHËNIM I REDAKTORIT

Për më tepër se një çerek shekulli Shoqata për parandalimin e Torturës (SHPT) ka mbrojtur idenë e thjeshtë por të re të propozuar nga themeluesi i saj Jean-Jacques Gautier, që vizitat në vendet ku njerëzit janë të privuar nga liria ëshjtë një nga mënyrat më efektive për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit. SHPT vazhdon të promovojë këtë ide në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

SHPT ka qenë e përfshirë aktivisht në hartimin e instrumentave ndërkombëtarë bazuar në vizitat parandaluese në vendet e burgimit. Organizata ishte kështu në origjinë të Konventës Europiane për Parandalimin e Torturës (1987) sikurse dhe të Protokollit Opsional të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës, miratuar më 18 dhjetor 2002 (OPCAT). OPCAT është veçanërisht pioniere pasi është bazuar në plotësueshmërinë e vizitave parandaluese nga një organ ndërkombëtar dhe nga “një apo disa mekanizma parandalues kombëtar” që Palët e Shtetit duhet t’i ngrenë pas ratifikimit.

Kjo qasje “dy shtyllëshe” reflektohet tek SHPT e cila e ka inkurajuar për shumë vite monitorimin e vendeve të burgimit në nivel kombëtar. Është në këtë kontekst që SHPT ndërtoi në vitin 2000 një projekt të përbashkët me ODIHR për “Inkurajimin e OJF-ve kombëtare në monitorimin e vendeve të burgimit”. Ky projekt rezultoi në një publikim të përbashkët me titull “Monitorimi i vendeve të burgimit: një guidë praktike për OJF-të” botuar në dhjetor 2002 në anglisht dhe në shtator 2003 në rusisht. Guida e përbashkët u shkrua nga Annette Corbaz, konsulente e SHPT-së që ka më shumë se dhjetë vjet eksperiencë vizitash në vendet e burgimit me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.

Guida jonë e re është një adaptim i këtij versioni të mëparshëm, me qëllim përfshirjen e elementëve të OPCAT-it të sapo miratuar dhe zgjerimin e audiencës së synuar për çdo person apo organizëm që ka të drejtë të kryejë vizita në vendet e burgimit në nivel kombëtar. Guida do të publikohet në gjuhën angleze, franceze, portugeze, spanjolle dhe mundësisht në gjuhën ruse.

Ne shpresojmë që guida të jetë ndihmuese për të gjithë ata që janë të përfshirë në monitorimin e vendeve të burgimit, në përgatitjen e vizitës, kryerjen dhe ndjekjen e saj. Kjo përfundimisht do të kontribuonte në përmirësimin e kushteve të burgimit, dhe të parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit në botë.

Gjenevë, Shkurt 2004

ESTHER SCHAUFELBERGER BARBARA BERNATH  
*APT Programme Officer APT Programme Officer*  
*Visit Programme Europe Programme*

# PARATHËNIE

Tortura dhe keqtrajtimi i personave të privuar nga liria zakonisht ndodh në qendrat e burgimit që nuk janë të aksesueshme nga asnjë formë e mbikqyrjes publike. Ky është konteksti ideal për torturuesit që veprojnë pa u ndëshkuar.

Si Reporter Special i Kombeve të Bashkuara për Torturën, unë kam theksuar, sikurse dhe të dy paraardhësit e mi, se monitorimi i vendeve të burgimit nga organizma të përshtatshëm, të kualifikuar dhe të pavarur, është një nga mënyrat më efektive në luftën kundër praktikave të torturës dhe keqtrajtimit. Megjithatë, organizmat monitoruese duhet të jenë të përgatitura, të kualifikuara dhe të pajisura siç duhet për t'u marrë me një punë shumë të vështirë dhe shpesh në kushte të vështira. Për më tepër ata duhet të jenë në pozitë të bëjnë rekomandime që të merren seriozisht dhe të çojnë drejt përmirësimeve pozitive në trajtimin e personave të burgosur.

E mirëpres këtë guidë të Shoqatës së Parandalimit të Torturës pasi ajo siguron një mjet praktik për çdonjeri që synon të vizitojë vendet e burgimit me qëllim parandalimin e torturës dhe të keqtrajtimit. Guida jep këshilla se si të monitorohet në mënyrë që të përmirësohet efektiviteti dhe jep gjithashtu orjentime për çështje që kërkojnë vëmendje të veçantë sikundër është shërbimi mjekësor apo masat e mbrojtjes. Për më tepër, ajo shpjegon qartë gjithashtu tipet e ndryshme të mekanizmave monitorues dhe natyrës së tyre komplementare.

Manuali është gjithashtu në kohë pasi po del pikërisht përpara hyrjes në fuqi të Protokollit Opsional të miratuar së fundmi në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës. Organizmat parandalues të miratuar në Protokoll, sidomos në nivel kombëtar, do ta gjejnë këtë guidë si libër reference shumë ndihmues. Prandaj, unë sinjerisht shpresoj se guida do të inkurajonte shumë Shtete të firmosnin dhe ratifikonin Protokollin Opsional. Kjo inisiativë e re dhe e rëndësishme ndërkombëtare premtion të ketë një impakt real në ruajtjen e personave të burgosur nga tëmërrit i torturës dhe keqtrajtimit.

8 Mars 2004

PROFESOR THEO VAN BOVEN  
Reporter Special për Torturën i Kombeve të Bashkuara

# SHKURTIME TË PËRZGJEDHURA

ACHPR	Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popullit
APT	Association for the Prevention of Torture
BPP	Grupi I Parimeve për Mbrojtjen e të Gjithë Personave të Burgosur ose Burgosur Form paraburgimi ose burgimi
BPTD	Parimet Bazë për Trajtimin e të Burgosurve
CAT	Komitetit kundër Torturës
CPT	Komiteti European për Parandalimin e Torturës
ECPT	Konventa Europiane për Parandalimin e Torturës
EPR	Rregullat Europiane për Burgun
ICCPR	Marrëveshja Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Politike dhe Civile
ICPR	Marrëveshja Ndër-Amerikane për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Torturës
ICRC	Komitetit Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
NGO	Organizatat jo qeveritare
ODHIR	Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSCE
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
OPCAT	Protokolli Opsional i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës
OSCE	Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Europë
UN	Kombet e Bashkuara
UNCAT	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës

Shkurtime për standartet që përdoren vetëm në kapitullit IV janë dhënë në fillim të atij kapitulli

# TABELA E PËRMBAJTJES

Vlerësime .....	
Shënimi i Redaktorit .....	
Parathënie .....	
Shkurtime të përzgjedhura .....	
Tabela e përmbajtjes.....	
Hyrje .....	

## **Kapitulli I: Monitorimi i vëndeve të burgimit.....**

1. Mbrojtja e personave të privuar nga liria e tyre .....	
1.1 Privimi i lirisë.....	
1.2 Mbrojtja e personave të privuar nga liria .....	
2. Monitoimi i vëndeve të burgimit nëpërmjet vizitave.....	
2.1 Çfarë kuptojmë me monitorimin e vëndeve të burgimit?.....	
2.2 Rëndësia e monitorimit .....	
2.3 Vizitimi i vëndeve të burgimit —mjete kryesor për monitorimin .....	
3. Parimet bazë të monitorimit të vëndeve të burgimit .....	

## **Kapitulli II: Organet që monitorojnë vëndet e burgimit .....**

1. Vizitat në nivel kombëtar .....	
1.1 Inspektimet e brëndshme .....	
1.2 Inspektimet gjyqësore .....	
1.3 Monitorimi i jashtëm i pavarur .....	
2. Mekanizmat vizitues në nivel ndërkombëtar dhe rajonal .....	
3. Protokolli Opsional i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës.....	
3.1 Nën-komiteti i CAT .....	
3.2 Mekanizmat kombëtar parandalues sipas OPCAT .....	
3.2.1 Krijimi dhe përcaktimi i mekanizmave kombëtar parandalues.....	
3.2.2 Forma e mekanizmave kombëtar parandalues.....	
3.2.3 Mandati i mekanizmave kombëtar parandalues.....	
3.2.4 Garancitë për mekanizmat kombëtar parandalues .....	
3.2.5 Aksesi ndaj vëndeve ku ndodhen personat e privuar nga liria .....	
3.3 Ndjekje në vijimësi e vizitës sipas Protokollit Opsional.....	
3.3.1 Raportimi dhe rekomandimet .....	
3.3.2 Veprimet plotësuese parandaluese .....	
3.3.3 Kontakti i drejtëpërdrejtë me Nën-Komitetin.....	

- 4. Koordinimi midis organeve të ndryshme vizituese.....
- 4.1 Koordinimi midis organeve vëndase vizituese .....
- 4.2 Koordinimi midis organeve ndërkombëtare dhe kombëtare vizituese .....
- 4.3 Koordinimi midis organeve ndërkombëtare vizituese.....

**Kapitulli III: Si të monitorosh vëndet e burgimit .....**

- 1. Struktura e monitorimit .....
- 2 Krijimi i një programi monitorimi .....
- 2.1 Krijimi i një programi vizitash .....
- 2.2 Përzgjedhja e vëndeve.....
- 2.3 Kohëzgjatja e vizitave.....
- 2.4 Shpeshësia e vizitave .....
- 2.5 Grupi vizitues .....
- 2.5.1 Përbërja .....
- 2.5.2 Madhësia.....
- 2.5.3 Trajnimi .....
- 3. Përgatitja e vizitës.....
- 3.1 Puna përgatitore .....
- 3.2 Përcaktimi i objektivave të vizitës.....
- 4. Vizita në vetvete.....
- 4.1 Biseda fillestare me drejtorin e vëndit të burgimit.....
- 4.2 Konsultimi i regjistrave dhe dokumentave të tjera.....
- 4.3 Vizitimi i ambienteve të institucionit të burgimit.....
- 4.4 Intervistat me personat e privuar nga liria e tyre .....
- 4.4.1 Konsiderata të përgjithshme.....
- 4.4.2 Bisedat në grup.....
- 4.4.3 Bisedat private .....
- 4.4.4 Bisedat me stafin përgjegjës për personat e privuar nga liria .....
- 4.5 Biseda përfundimtare me drejtorin.....
- 5. Ndjekja në vijimësi e vizitës.....
- 5.1 Ndjekje e brendshme në vijimësi.....
- 5.2 Hartimit i raporteve të monitorimit mbi kushtet e burgimit.....
- 5.2.1 Hartimi i raportit mbi vizitën.....
- 5.2.2 Hartimi i raportit global.....
- 5.2.3 Shpërndarja e raporteve globale .....
- 5.3 Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve .....
- 5.4 Aktivitetet jashtë procesit të monitorimit .....



**Kapitulli IV: Cilat aspekte të burgimit duhen ekzaminuar.....**

Trajtimi .....

Tortura dhe keqtrajtimi .....

Izolimi .....

Mjetet e shtrëngimit.....

Përdorimi i forcës.....

Masat mbrojtëse .....

Regjistrat e burgimit .....

Informimi i të burgosurve .....

Inspektimi .....

Procedurat disiplinore .....

Procedurat ankimore .....

Veçimi i kategorive të të burgosurve .....

Kushtet materiale .....

Ushqimi.....

Ndriçimi dhe ajrosja .....

Ambientet sanitare.....

Higjena personale.....

Veshjet dhe shtrojet .....

Mbipopullimi dhe akomodimi .....

Regjimi dhe aktivitetet.....

Kontaktet me familjen dhe shokët.....

Kontakti me botën e jashtme .....

Arsimimi .....

Gjimastika përjashta.....

Aktivitete argëtuese dhe kulturore.....

Feja .....

Puna .....

Shërbimet mjekësore.....

Aksesi ndaj kujdesit shëndetësor.....

Stafi mjekësor.....

Kujdesi i vecantë shëndetësor për gratë dhe bebet.....

Kujdesi i vecantë shëndetësor për të burgosurit e sëmurë mendor.....

Personeli .....

Çështje të përgjithshme.....

Trajnimi i personelit.....

Arrestimi nga policia.....

Garancitë themelore.....

Regjistrat.....

Marrja në pyetje.....

Informimi .....

Kushtet materiale .....

Anekset.....

Aneksi 1: Lista .....

Aneksi 2: Shëmbull i shënimeve të brendshme mbi vizitat.....

Aneksi 3: Protokolli Opsional i Konvetës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës.....

Aneksi 4: List standartesh të rëndësishme.....

Aneksi 5: Lexime të mëtejshme.....

Aneksi 6: Adresa të dobishme.....

# HYRJE

*“Reporteri Special është i bindur se është e nevojshme të bëhet një transformim radikal i hipotezave në shoqërinë ndërkombëtare lidhur me natyrën e privimit të lirisë. Paradigma bazë, e marrë e mirëqenë për të paktën më shumë se një shekull, është se burgjet, komisaritet e policisë dhe të tjera si këto janë vende të mbyllura dhe sekrete, me veprimtari të fshehur nga vështrimi i publikut.(...)Ajo çfarë duhet është zëvendësimi i konceptit të paqartësisë me atë të transparencës. Hipoteza duhet të jetë një, ajo e aksesit të hapur në të gjitha vendet ku liria është e privuar.”*

**Sir Nigel Rodley**

Ish Reporter Special për Torturën i Kombeve të Bashkuara

3 korrik 2001, A/56/156, §35

## **PSE NJË GUIDË PËR MONITORIMIN E VENDEVE TË BURGIMIT?**

Transparenca dhe kontrolli i pavarur i administratës publike është pjesë e çdo sistemi të bazuar në parimet e demokracisë dhe të shtetit ligjor. Kjo është veçanërisht e vërtetë në rastin e monitorimit të forcës së shtetit për t'i privuar njerëzit nga liria. Monitorimi i trajtimit dhe kushteve të burgimit të personave të privuar nga liria nëpërmjet vizitave të rregullta dhe jo të njoftuara më parë, përbën një nga mënyrat më efektive për parandalimin e torturës dhe të keqtrajtimit.

Idea e monitorimit të jashtëm dhe të pavarur të vendeve të burgimit ka bërë një progress të konsiderueshëm gjatë viteve të fundit. Tashmë është pranuar gjerësisht se një nga mbrojtësit më të mirë kundër torturës dhe keqtrajtimit në vendet e burgimit është të qenët sa më shumë transparent dhe dhënia e aksesit të rregullt anëtarëve të publikut me reputacion. Ky evolucion pozitiv reflektohet në miratimin më 18 dhjetor 2001 të Protokollit Opsional të Konventës Kundër Torturës të Kombeve të Bashkuara (OPCAT), objektivi i të cilit është “të ndërtojë një sistem për vizita të rregullta nga organe të pavarura kombëtare dhe ndërkombëtare në vendet ku njerëzit janë të privuar nga liria, me qëllim që të parandalohet tortura dhe trajtimet apo ndëshkimet e tjera mizore, çnjerëzore dhe degraduese”.

Sipas OPCAT, obligimi kryesor për parandalimin e torturës qëndron në nivel vendor, pasi Palëve Shtetërore do t'ju duhet të “ngrenë, përcaktojnë dhe ruajnë një apo disa mekanizma parandalues kombëtarë”. Është e nevojshme që ose të ndërtohen mekanizma të rinj ose mekanizmat egzistues të përshtaten në linjë me kriteret e OPCAT-it. Ky zhvillim nuk duhet të përjashtojë apo të dëmtojë format e tjera të monitorimit në nivel vendor. Në këtë kontekst, kjo guidë praktike synon të shërbejë si mjet i dobishëm për promovimin e vizitave efektive parandaluese nga çdo grup monitorues apo organizëm në nivel kombëtar.

## **AUDIENCA E SYNUAR**

Kjo guidë i adresohet çdo personi apo organi që ka të drejtë të monitorojë dhe të kryejë vizita në vendet e burgimit në nivel kombëtar. Sikurse përmendet më lartë, përdoruesit e parë do të jenë anëtarët e mekanizmave të ngritur apo përcaktuar si “mekanizma parandalues kombëtarë” sipas OPCAT-it.

Megjithatë, guida nuk është e limituar vetëm për këto organizma por ka një përdorim më të gjërë si një mjet për persona apo institucione të tjera që kanë të drejtë të monitorojnë vendet e burgimit në vendet e tyre. I adresohet organizmave që tashmë e kanë fituar aksesin për në vendet e burgimit nëpërmjet mandatit të tyre apo marrëveshjeve të veçanta.

Përveç mekanizmave vizitues vendorë, guida është gjithashtu një mjet i dobishëm për organizmat që janë përgjithësisht të interesuara në çështjet që lidhen me privimin e lirisë si organizatat joqeveritare kombëtare dhe ndërkombëtare, organizatat rajonale dhe ndërkombëtare si dhe zyrat e tyre në terren.

Si përfundim, synimi ynë për informacionin që jepet në guidë është të jetë i dobishëm gjithashtu edhe për autoritetet përgjegjëse dhe personelin që punon në vendet e burgimit, pasi janë pikërisht ata që ju duhet të bashkëpunojnë me organizmat monitoruese.

## **Objektivat e Guidës**

Objektivi i përgjithshëm i guidës është të promovojë organizmat vizitues vendorë efektivë, të ndërtuar rishtaz apo ata ekzistues, duke rritur profesionalizmin e tyre e kështu impaktin e tyre në parandalimin e torturës dhe përmirësimin e kushteve të burgimit.

### **Objektivat Specifikë janë:**

- Të japë këshilla dhe rekomandime konkrete për metodologjinë e vizitave sipas shkallëve të ndryshme (përgatitja, zhvillimi dhe ndjekja).
- Të promovojë bashkëpunimin midis organizmave të ndryshëm vizitues vendorë sikurse dhe midis organizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë.
- Të prezantojë në mënyrë praktike, tematike standartet e ndryshme ndërkombëtare lidhur me monitorimin e vendeve të burgimit.
- Të japë informacion lidhur me përmbajtjen e OPCAT që për herë të parë në një traktat ndërkombëtar për të drejtat e njeriut specifikon kritere të qarta dhe garanton pavarësi dhe funksionim efektiv të “mekanizmave kombëtarë parandalues”.
- Duke bërë këtë, të ndihmojë të mos ndërtohen mekanizma parandalues në kundërshtim me parimet e OPCAT.

Guida nuk është ndërtuar sipas ndonjë mekanizmi specifik apo ndonjë vendi a rajoni në veçanti. Ajo synon të jetë e vlefshme për një publik të gjerë universal.

### **Qëllimi i guidës**

Guida synon të merret me monitorimin e çdo vendi ku personat janë të privuar nga liria e tyre. Në praktike, megjithatë, ajo fokusohet kryesisht tek burgjet dhe në një mënyrë pak më të limituar tek komisariatet e policisë. Monitorimi i vendeve të veçanta si institucionet psikiatrike, qendrat e burgimit për të rinjtë apo të huajt, kërkon një qasje specifike, megjithëse disa koncepte të përgjithshme janë të përshtatshme.

Kategori të veçanta të burgosurish vulnerabël si gratë, fëmijët, minoritetet apo migrantët e huaj, nuk janë konsideruar në kapituj të veçantë por janë përfshirë në të gjithë guidën kudo ku është e mundur.

Guida është strukturuar si vijon: Kapitulli i parë përmban një prezantim të përgjithshëm mbi rëndësinë e monitorimit të kushteve të burgimit. Kapitulli i dytë paraqet shkurtimisht mekanizmat ekzistues vendorë dhe ndërkombëtarë dhe i bën referenca të veçanta veçorive të mekanizmave parandalues kombëtarë sikurse kërkohet nga OPCAT. Kapitulli i tretë ka një natyrë më tepër operacionale dhe përshkruan si të bëhet një vizitë, duke filluar nga përgatitja e deri tek ndjekja. Kapitulli i fundit paraqet, temë pas teme, aspektet e burgimit që duhet të konsiderohen gjatë një vizite dhe komenton dispozitat korresponduese të standarteve ndërkombëtare.

### **Përcaktimi i termave kyçe:**

#### **Monitorimi i vendeve të burgimit**

Monitorimi i vendeve të burgimit përshkruan procesin e shqyrtimit të rregullt, nëpërmjet vizitave në vend, të të gjithë aspekteve të burgimit. Shqyrtimi përfshin të gjitha apo disa kategori të dhëna të të burgosurve (shiko më poshtë) që mbahen në një apo më shumë vende burgimi.

Monitorimi përfshin transmetimin e rezultateve të shqyrtimit gojor apo të shkruar sikurse dhe rekomandimet tek autoritetet përkatëse dhe aktorët e tjerë të përfshirë në mbrojtje të personave të privuar nga liria e tyre në nivel kombëtar apo ndërkombëtar. Ajo gjithashtu përfshin ndjekjen lidhur zbatimin e rekomandimeve të transmetuar autoriteteve.

#### **I burgosur**

Termi “i burgosur” përdoret në mënyra të ndryshme në vende të ndryshme e madje edhe në dokumenta të ndryshëm ndërkombëtarë. Ndonjëherë, termi lidhet vetëm me personat që janë në stadin

para daljes në gjyq apo në burgim administrativ dhe jo me personat e dënuar. Në këtë guidë termi ‘i burgosur’ është përdorur në kuptimin e vet më të gjërë të mundshëm dhe mbulon çdo person të privuar nga liria personale si rezultat i arrestimit, burgimit administrative, në stadin para daljes në gjyq apo i dënuar dhe i mbajtur në një vend burgimi (shiko më poshtë)

#### **Vendi i burgimit**

Termi “vendi i burgimit” përdoret këtu gjithashtu në një kuptim të gjërë. Ai mbulon çdo vend ku një person është i privuar nga liria: burgjet, komisariatet e policisë, qendrat për të huajt apo për azilkerkuesit, qendrat për të rinjte, shtëpitë e kujdesit social, institucionet psikiatrike, burgjet apo qelitë për personelin ushtarak dhe çdo vend tjetër ku njerëzit mund të jenë të privuar nga liria e tyre.

#### **Organizmat vizitues vendorë**

Ky term i referohet gjithë mundësive në nivel vendor (kombëtar, lokal apo komunitet) nga të cilët lloje të ndryshëm organizmash të pavarur (institucione kombëtare për të drejtat e njeriut, zyra e avokatit të Popullit, OJFte kombëtare, komitetet e qytetarëve dhe grupe të tjera të shoqërisë civile) monitorojnë vendet e burgimit.

#### **Mekanizmat Parandalues Kombëtarë**

Ky term i referohet specifikisht mekanizmave të përcaktuara nga Shteti si “mekanizëm parandalues kombëtar” sipas OPCAT-it.

#### **Vizita**

Termi “vizitë” në kuptim të gjërë mbulon jo vetëm vizitat aktuale në vendet e burgimit por gjithashtu përgatitjen e vizitës dhe ndjekjen e saj. Ky term mbulon vizitat në një vend tërësisht burgimi sikurse dhe vizitat e fokusuara tek të burgosur të veçantë apo një problem, temë apo incident në veçanti.

# KAPITULLI I

## Monitorimi i vendeve të burgimit në kontekst

### 1. MBROJTJA E PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA E TYRE

#### 1.1 Privimi i lirisë

E drejta e të qenit i lirë dhe liria e lëvizjes është një nga të drejtat themelore të njeriut. Megjithatë, kjo nuk është absolute. Shteti e ka mundësinë të privojë njerëzit nga liria e tyre nëpërmjet arrestimit apo burgimit ku arsyet për privimin e lirisë dhe procedurat që ndiqen janë qartësisht të mbështetura në ligj. Arrestimet apo burgimet arbitrare janë të ndaluara sipas të drejtës ndërkombëtare.

Privim i lirisë do të thotë vendosja e një personi në një ambient privat apo publik nga ku ky person nuk lejohet të largohet me dëshirën e tij, me urdhër të një autoriteti gjyqësor, administrative apo tjetër.

#### Shembuj të privimit të lirisë:

- Arrestimi
- Nën arrest përpara akuzës (mbajtur nën arrest nga policia)
- Nën arrest pas akuzës dhe para daljes në gjyq (burgim në pritje të masës së arrestit)
- Burgim (vuajtje dënimi pas dhënies së vendimit final)
- Burgim administrativ
- Burgim i të rinjve
- Mbikqyrje në psikiatri
- Burgim si një ndëshkim disiplinor në ushtri

Standartet ndërkombëtare e inkurajojnë Shtetin të vendosë limite në privimin e lirisë. Burgimi në pritje të masës së arrestit nuk duhet të përdoret sistematikisht por “si një mjet i shpresës së fundit të ndjekjes penale, me respektimin e duhur të investigimit të kundërvajtjes së pretenduar dhe mbrojtjes së shoqërisë dhe viktimës”. Standartet promovojnë mos përdorimin e gjëndjes nën arrest por të një burgimi me masa alternative siç është shërbimi komunitar.

Standartet ndërkombëtare e inkurajojnë shtetin që në veçanti të shmangë burgimin e të rinjve, përfshirë edhe ata në pritje të gjykimit.

Burgimi i humbet individëve të drejtën e lëvizjes. Ata duhet të vazhdojnë të gëzojnë të drejtat e tyre të tjera njerëzore. Në veçanti, ata duhet të trajtohen në mënyrë që të respektohet dinjiteti i tyre si qenie njerëzore.

#### 1.2 Mbrojtja e personave të privuar nga liria

Njerëzit e privuar nga liria e tyre janë vulnerabël dhe veçanërisht të rrezikuar nga dhunimi i të drejtave të njeriut. Siguria dhe mirëqenia e tyre janë përgjegjësi e autoriteteve të burgimit të cilët duhet të garantojnë që kushtet e burgimit të respektojnë të drejtat e njeriut dhe dinjitetin njerëzor. Monitorimi i kushteve të burgimit megjithatë, përbën një pjesë integrale të sistemit për mbrojtjen e personave të privuar nga liria e tyre. Një element thelbësor brenda sistemit të monitorimit janë vizitat e rregullta, të pa-lajmëruara në vendet e burgimit nga organizma të pavarur, ndjekur nga raportet dhe rekomandimet drejtuar autoriteteve si dhe ndjekja sistematike e zbatimit të këtyre rekomandimeve. Çdo Shtet që është i interesuar të sigurojë që të drejtat e njeriut respektohen në këtë fushë duhet të posedojë apo ndërtojë një sistem të këtij lloji.

Ekspierienca ka treguar se një sistem efektiv i mbrojtjes kombëtare për ata që janë të privuar

nga liria e tyre duhet të përfshijë si më poshtë:

**1 një kuadër ligjor kombëtar** që ka integruar standartet e mbrojtjes sipas të drejtës ndërkombëtare: dmth, miratimin e ligjeve dhe rregulloreve korresponduese të cilat i përcaktojnë kuadrin politik dhe direktivat qeverisëse.

**2 zbatim efektiv** i këtij kuadri ligjor në ruajtje të ligjit dhe rendit, në praktikën ligjore, në organizimin dhe trajtimin e personave të privuar nga liria e tyre. Kjo përfshin:

- një vullnet politik të deklaruar qartë dhe gjerësisht për zbatimin e kuadrit ligjor.
- trajnimin e burimeve njerëzore sipas kodeve të etikës profesionale.
- burimet financiare dhe materiale

**3. monitorimi i zbatimit efektive të kuadrit ligjor nga:**

- shërbimet ndërkombëtare të inspektimit ;
- kontrolli gjyqësor i gjyqtarëve dhe prokurorëve ;
- avokatët dhe Shoqatat e avokatëve ;
- institucionet për të drejtat e njeriut dhe të ombudsmanit ;
- organizma të pavarur vendore ;
- organizata jo-qeveritare ;
- mekanizmat ndërkombëtarë ;

E parë në tërësi, ky monitorim ndihmon në krijimin e një panorame të punës së kryer nga organet e shtetit. Mund të propozohen masa në nivel praktik dhe ligjor. Praktikrat e mira mund të identifikohen dhe të mbështeten.

## **2. MONITORIMI I VENDEVE TË BURGIMIT NËPËRMJET VIZITAVE**

### **2.1 Çfarë kuptohet me monitorim të vendeve të burgimit?**

Monitorimi përshkruan procesin e **shqyrtimit të rregullt të të gjitha aspekteve të burgimit**. Shqyrtimi përfshin të gjitha kategoritë e dhëna të personave të privuar nga liria e tyre në një apo shumë vende burgimi.

Të gjitha aspektet e burgimit janë të ndërvarura dhe duhet të shqyrtohen në lidhje me njëra tjetrën (shiko kapitullin IV):

- masat ligjore dhe administrative të vendosura dhe të aplikuara brenda vendeve të
- burgimit me qëllim mbrojtjen e personave, garantimin e të drejtës së tyre të jetës dhe të integritetit fizik dhe psikologjik;
- kushtet e jetesës gjatë burgimit;
- regjimi në burgim ( aktivitete, kontakte me botën e jashtme);
- aksesin ndaj kujdesit shëndetësor;
- organizimin dhe menaxhimin e të burgosurve dhe personelit sikurse dhe marrëdhëniet midis të burgosurve dhe autoriteteve të parabuurgimit.

Monitorimi përfshin transmetimin gojor apo me shkrim të rezultateve të shqyrtimit tek autoritetet e interesuara dhe në disa raste, tek të tjerë aktorë të përfshirë në mbrojtjen e personave të privuar nga liria e tyre, në nivele kombëtare apo ndërkombëtare sikundër dhe tek media. Monitorimi përfshin gjithashtu ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të transmetuara autoriteteve.

### **2.2 Rëndësia e Monitorimit**

Monitorimi i kushteve të burgimit është absolutisht i nevojshëm për arsye të ndryshme:

- Privimi i një personi nga liria e tij është një veprim serioz shtrëngues i Shtetit që rrezikon drejt një trashëgimie abuzimi të të drejtave të njeriut.
- Njëpërmjet humbjes së lirisë, personat e burgosur vijnë e bëhen pothuajse tërësisht të varur nga

autoritetet dhe zyrtarët publik që të garantojnë mbrojtjen e tyre, të drejtat dhe mjetet e jetesës së tyre.

- Mundësitë e personave të privuar nga liria për të ndikuar në fatin e tyre janë të limituara ose nuk ekzistojnë fare.
- Vendet e burgimit sipas përkufizimit janë të mbyllura dhe i mbajnë këta të burgosur larg nga vështrimi i shoqërisë.

Në çdo kohë dhe në të gjitha vendodhjet, **personat e privuar nga liria e tyre janë vulnerabël dhe në rrezik** për t'u keqtrajtuar apo edhe torturuar. Kjo do të thotë që ata duhet të kenë një mbrojtje të mire nëpërmjet monitorimit të kushteve të tyre të burgimit.

Duhet vënë re se, fakti që mekanizmat monitorues janë të integruar në sistemin e përhershëm të mbrojtjes së personave të privuar nga liria e tyre, nuk do të thotë domosdoshmërisht se ka probleme serioze në vendet e burgimit apo mungesë të madhe besimi tek oficerët në detyrë.

Është më shumë një çështje subjektivizmi ekzistenca e një të çare të madhe në marrëdhënien e pushtetit që kane burgosësit ndaj të burgosur në vëzhgimin e jashtëm të organeve të autorizuar të ndërhyjnë në rastin e abuzimit me këtë pushtet. **Këta mekanizma kontrolli promovojnë të drejtat e njeriut, ndihmojnë në limitimin e rrezikut për keqtrajtim** dhe rregullojnë çdo marrje mase të tepruar ndaj atyre që u është privuar liria.

Ata kontribuojnë gjithashtu në transparencën dhe përgjegjshmërinë e vendeve të privimit të lirisë, duke rritur kështu legjitimitetin e menaxhimit të këtyre vendeve si dhe **besimin e publikut tek institucionet**.

### 2.3 Vizitat në vendet e burgimit - mjeti kryesor i monitorimit

Vendet e burgimit monitorohen kryesisht nëpërmjet vizitave në vendet ku personat janë burgosur. Këto vizita kanë funksione të ndryshme:

- **funksion parandalues:** Fakti ithjeshtë se dikush nga jashtë hynë rregullisht në një vend burgimi, kontribuon në vetvete në mbrojtje të personave që mbahen atje.
- **mbrojtje e drejtpërdrejtë:** Vizitat bëjnë të mundur reagimin e menjëhershëm ndaj problemeve që prekin të burgosurit dhe që nuk janë trajtuar nga zyrtarët përgjegjës.
- **dokumentacioni:** Gjatë vizitave mund të ekzaminohen aspekte të ndryshme të burgimit dhe të bëhet një vlerësim i saktë i tyre; informacioni u mbledhur krijon një bazë për një gjykim apo dokumentim të tij apo për justifikimin e propozimit të ndonjë mase korrektuese.
- Vizitat japin gjithashtu mundësi të dokumentohen aspekte specifike të burgimit të cilat mund të trajtohen në një studim tematik.
- **bazë për dialog me autoritetet e burgimit:** Vizitat bëjnë të mundur krijimin e një dialogu të drejtpërdrejtë me autoritetet apo zyrtarët përgjegjës të ambjenteve të burgimit. Ky dialog, për aq sa është krijuar mbi respektin reciprok, çon drejt zhvillimit të një marrëdhënie pune konstruktive ku mund të dalin edhe këndvështrimet e zyrtarëve për kushtet e punës së tyre apo ndonjë problem që ata mund të kenë identifikuar.
- Për më tepër, duhet vënë në dukje se për personat e privuar nga liria është e rëndësishme të kenë kontakte të drejtpërdrejta me personat jashtë të interesuar për kushtet e tyre pasi kjo përbën një formë mbrojtjeje apo dhe mbështetje morale.

<sup>3</sup> Informacioni për kushtet e burgimit i mbledhur jashtë vendeve të burgimit, mund të përdoret gjithashtu si bazë për ndërhyrje kur këto vendet janë të paaksesueshme. Megjithatë, vlefshmëria dhe legjitimiteti i këtyre ndërhyrjeve mund të kontestohet më lehtë se sa i atyre që vijojnë nga vizitat.

## 3. PARIMET BAZË TË MONITORIMIT TË VENDEVE TË BURGIMIT

Monitorimi i vendeve të burgimit nëpërmjet vizitave është një detyrë delikate dhe sensitive. Për arsye etike dhe efëçence, kryerja e këtyre vizitave duhet të ketë parasysh dhe të respektojë një numër parimesh themelore.

Parimet e mëposhtme janë marrë kryesisht nga tetëmbëdhjetë parimet themelore të monitorimit, të identifikuar në Manualin e Kombeve të Bashkuara të Trajnimit mbi Monitorimin e të Drejtave të

Njeriut. Ato miratohen, kur është e nevojshme, me qëllim që të merren në konsideratë të veçantat e monitorimit të vendeve të burgimit.

Mekanizmat duhet të zhvillojnë strategjitë e rekrutimit, praktikat e punës dhe trajnimet që ruajnë këto cilësi themelore.

### **1. Mos dëmto**

Të burgosurit janë veçanërisht vulnerabël dhe siguria e tyre duhet patur në mendje nga vizitorët të cilët nuk duhet të bëjnë asnjë veprim apo marrin ndonjë masë që mund të dëmtonte ndonjë individ apo grup individësh. Në veçanti, në rastet e pretendimeve për torturë dhe keqtrajtim, parimi i konfidencialitetit, sigurisë dhe ndjeshmërisë duhet të mbahet parasysh. Vizita të keq përgatitura apo keq planifikuara apo vizitat që nuk kryhen duke respektuar metodologjinë apo parimet bazë të mëposhtme, aktualisht bëjnë më shumë keq se sa mirë.

4 Kapitulli V, (pp. 87-93) i Manualit të Kombeve të Bashkuara të Trajnimit mbi Monitorimin e të Drejtave të Njeriut, vëllimi nr.7, Trajnimi Profesional, Zyra e komisionerit të lartë për të Drejtat e Njeriut, Kombet e Bashkuara, Neë York, Gjenevë, 2001.

### **2. Përdor gjykim të mirë**

Monitoruesit duhet të jenë në dijeni për standartet dhe rregullat kundrejt të cilave ata kryejnë monitorimin e tyre. Megjithatë, pavarësisht nga numri i tyre, përkatësia dhe preçizioni, rregullat nuk mund të zëvendësojnë gjykimin e mirë personal dhe gjykimin e shëndosh. Prandaj, monitoruesit duhet të kenë dhe të përdorin gjykimin e mirë në të gjitha rrethanat.

### **3. Respekto autoritetet dhe stafin përgjegjës**

Nëse nuk janë vendosur bazat minimale të respektit reciprok midis stafit dhe skuadrës vizituese, puna në vendet e burgimit mund të rrezikohet. Vizitorët duhet të respektojnë gjithmonë funksionin e autoriteteve dhe të përpiqen të njohin nivelet dhe përgjegjësitë e hierarkisë në mënyrë që të adresojnë problemin e duhur në nivelin përkatës. Ndërsa është e qartë që mund të ndeshet një individ i stafit me sjellje të papërshtatshme, shumë probleme burojnë jo nga individët por nga sistemi i papërshtatshëm lidhur me privimin e lirisë që ushqen sjelljen e papërshtatshme. Vizitorët duhet gjithashtu të kenë parasysh faktin që stafi punonjës në vendet e paaraburgimit kryen një punë të vështirë, shpesh të nënvlerësuar nga shoqëria dhe në shumë vende edhe të paguar pak.

### **4. Respekto personat e privuar nga liria**

çfarëdoqoftë arsyeja e privimit të lirisë, të burgosurit duhet të trajtohen me respekt dhe mirësjellje. Vizitori duhet të bëjë prezantimin e tij/saj.

### **5. Të jesh i besueshëm**

Vizitorët duhet t'ju shpjegojnë qartë të burgosurve apo stafit punonjës, objektivat dhe kufizimet e punës së tyre monitoruese dhe të sillen në përputhje me to. Ata nuk duhet të bëjnë premtime që nuk janë në gjendje t'i mbajnë dhe të mos ndërmarrin veprime që nuk mund t'i ndjekin dot

### **6. Respekto konfidencialitetin**

Respekti për konfidencialitetin e informacionit që është marrë në intervistat private është thelbësore. Vizitorët nuk duhet të bëjnë asnjë parashtrim duke përdorur emrin e ndonjë të burgosuri pa marrë pëlqimin e tij. Vizitorët duhet të sigurohen që i burgosuri të kuptojë plotësisht përfitimet sikurse dhe rreziqet e mundshme apo konsekuencat negative të ndonjë veprimi të bërë në emër të tyre. Vizitorët, mjekët dhe përkthyesit janë të detyruar të respektojnë konfidencialitetin.

### **7. Respekto sigurinë**

Siguria i referohet sigurisë personale të vizitorëve, sigurisë të të burgosurve të cilët janë në kontakt me ta dhe sigurisë së vendit të burgimit. Është e rëndësishme të respektohen rregullat e brendshme të vendit që vizitohet dhe të kërkohet këshillë apo leje speciale nga personat në detyrë. Autoritetet shpesh



nxjerrin arsye sigurie për të mos lejuar vizita në vende të veçanta ose vendosin kushte për intervista me të burgosur specifik. Është përfundimisht përgjegjësia e grupit vizitues të vendosin nëse duan dhe si të ndjekin këtë këshillë.

Vizitorët duhet të mos prezantojnë apo heqin një objekt pa marrë më parë aprovimin nga autoritetet. Ata duhet ta tregojnë identitetin e tyre nëpërmjet bexhit apo nje tjetër shenje dalluese. Lidhur me sigurinë e personave të burgosur që do të vizitohen, vizitorët duhet të kenë parasysh që të përdorin informacionin në atë mënyrë që të mos venë në rrezik asnjë individ. Vizitorët duhet të bëjnë vizita të përsëritura dhe të takojnë përsëri shumicën e të burgosurve që kanë takuar më parë e kështu të sigurohen që ata nuk kanë patur ndëshkime.

### **8. Të jesh konsistent, këmbëngulës dhe i duruar**

Legjitimiteti i mekanizmit vizitues ndërtohet kryesisht si rezultat i përkatësisë, këmbënguljes dhe konsistencës në punë. Monitorimi i vendeve të burgimit kërkon efikasitet, rregullsi dhe vazhdimësi në punën e vet. Kjo nënkupton vizita të rregullta në të njëjtin vend dhe marrjen e evidencave të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të mirë bazuara dhe të bëhen rekomandimet. Është thelbësore qenia këmbëngulës gjithashtu edhe në ndjekjen e aktiviteteve.

### **9. Të jesh i saktë dhe preçiz**

Gjatë vizitës në vend, është e rëndësishme të mblidhet informacioni i saktë në mënyrë që të bëhen raporte të mirë-dokumentuara dhe rekomandime përkatëse.

### **10. Të jesh i ndjeshëm**

Veçanërisht kur intervistohen të burgosurit, vizitorët duhet të jenë të ndjeshëm ndaj situatës, gjendjes shpirtërore dhe nevojave të individit sikurse dhe ndaj domosdoshmërisë për të bërë hapat e duhura drejt sigurisë së tij. Në rastet e pretendimit për torturë apo keqtrajtim, vizitorët duhet të jenë në dijeni të problemeve të ritraumatizimit (shiko kapotullin IV: tortura dhe keq trajtimi).

### **11. Të jesh objektiv**

Vizitorët duhet të përpiqen të regjistrojnë fakte aktuale dhe të merren si me stafin edhe të burgosurin në atë mënyrë që të mos jetë e ngjyrosur nga ndjenja apo opinionet paragjyquese.

### **12. Sillu me integritet**

Vizitorët duhet ti trajtojnë me respekt të gjithë të burgosurit, autoritetet dhe stafin punonjës si dhe shokët e tyre vizitorë. Ata nuk duhet të jenë të motivuar nga interesat vetjakë dhe duhet të jenë të ndershëm në mënyrë skrupuloze. Në çfarëdo që ata bëjnë duhet të veprojnë në përputhje me standartet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të cilat janë mandatuar ti mbështesin.

### **13. Të jesh i dukshëm**

Brenda vendit të burgimit, vizitorët duhet të sigurohen që stafi dhe të burgosurit janë në dijeni të metodologjisë dhe mandatit të grupit vizitues. Ata duhet të mbajnë bexhin apo një mjet tjetër identifikimi. Jashtë vendit të burgimit, puna e mekanizmit vizitues duhet të bëhet publike nëpërmjet raporteve të shkruara dhe përdorimit të kujdesshëm të medias (shiko kapitullin III, seksioni 5, ndjekje e vizitës).

### **Lexim i mëtejshëm**

Kombet e Bashkuara, Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, *Trajnimi Profesional vëllimi 7, Manual Trajnimi mbi Monitorimin e të Drejtave të Njeriut*, në York, Gjenevë, 2001.

Fondacioni për të Drejtat e Njeriut të Helsinkit, *Monitorimi i të Drejtave të Njeriut*, Varshavë, 2001.

# KAPITULLI II

## Organet e monitorimit të vendeve të burgimit

Për një kohë të gjatë monitorimi në nivel kombëtar ishte i bazuar vetëm tek inspektimet e kryera nga organet administrative të brendshme. Por domosdoshmëria për një vëzhgim më të gjerë publik të vendeve të privimit të lirisë, bëhej gjithnjë e më shumë e nevojshme dhe lindën format e tjera të monitorimit kombëtar totalisht të pavarura nga autoritetet e burgimit. Paralelisht, u zhvillua idea e kontrollit ndërkombëtar dhe monitorimi i vendeve të burgimit nga organet ndërkombëtare u bë ngadalë ngadalë realitet.

Me miratimin e kohëve të fundit të OPCAT, bazuar në vizitat parandaluese në burgim nga mekanizmat vizitues kombëtarë dhe ndërkombëtarë, një hap i mëtejshëm u bë drejt ndërtimit të një sistemi global të forcimit reciprok të mekanizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Është gjithashtu e rëndësishme të vihet në dukje se me miratimin e OPCAT, për herë të parë në një instrument ndërkombëtar janë paraqitur kritere dhe garanci për funksionimin efektiv të mekanizmave vizitues kombëtarë.

Seksioni 1 dhe 2 i këtij kapitulli jep një pamje të përgjithshme të llojeve të mekanizmave ekzistues në nivel vendor dhe ndërkombëtar. Seksioni 3 paraqet mekanizmat vizitues të parashikuara në OPCAT, duke patur si referencë të veçantë mekanizmat parandalues kombëtarë. Në fund, seksioni 4 merret me çështjen e bashkëpunimit të domosdoshëm midis organeve vizituese vendore dhe me organet vizituese ndërkombëtare.

### 1. VIZITAT NË NIVEL KOMBËTAR

Monitorimi i kushteve të burgimit është mbi të gjitha përgjegjësi e autoriteteve kombëtare përgjegjëse për personat e privuar nga liria e tyre.

“Në mënyrë që të mbikëqyret zbatimi korrekt i ligjeve dhe rregulloreve përkatëse, vëndet e burgimit duhet të vizitohen rregullisht nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë, të caktuar dhe të varur nga një autoritet kompetent i ndryshëm nga autoriteti përgjegjës për administrimin e vëndit të burgimit ose burgimit. *Parimi 29, paragrafi 1, i Grupit të Parimeve të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave të Paraburgosur ose të Burgosur.*

Shumica e Shteteve kanë krijuar mekanizmat e tyre të inspektimit të brendshëm, të cilat janë nganjëherë të plotësuara nga kontrolli gjyqësor. Megjithatë, ato kanë qenë të ngadalta në zhvillimin e mekanizmave të jashtëm monitories, të pavarur.

#### 1.1 Inspektimet e brëndshme

Shumica e Shteteve kanë krijuar për inspektimet e brëndshme, një institucion qeveritare që është përgjegjës të kryej vizita në vëndet e privimit të lirisë, si pjesë e funksionimit normale të burokracive. Roli i një organi administrative të tillë është zakonisht i kufizuar në kotrollin e përputhshmërisë së personelit dhe procedurave me standartet kombëtare, direktivat administrative dhe rregulloret. Krallë herë ky organ trajton çështje më të gjëra si ajo e dinjitetit dhe të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria. Është kështu e mundur që ndërkohë që procedurat e inspektimit të brendshëm ndiqen plotësisht, kushtet e burgimit vazhdojnë të jenë në mospërputhje me standartet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kjo është një arsye pse monitorimi i brëndshëm nuk është i mjaftueshëm në vetvete dhe duhet të plotësohet nga monitorimi i jashtëm i pavarur.

#### 1.2 Inspektimet gjyqësore

Si pjesë e mandatit të tyre, gjykatësit dhe prokurorët publik janë shpesh përgjegjës për të kryer

vizita të rregullta në vëndet e burgimit dhe për të inspektuar vëndet e burgimit. Në disa vënde, ka një “gjykatës mbikëqyrës” i cili mund të vizitojë burgjet e kriminelëve të dënuar dhe të vendosi mbi çështje që lidhen me ekzekutimin e dënimit. Inspektimet gjyqësore variojnë për sa i përket shpeshtësisë dhe cilësisë. Ato mund të jenë efektive kur gjykatësi mund të marri vendime detyruese në lidhje me kushtet e burgut.

### 1.3 Monitorimi i jashtëm i pavarur

Në vitet e fundit, pranimi se vëndet e burgimit duhet të jenë transparente dhe të kontrollueshme ka çuar në krijimin e mekanizmave monitorues të pavarur vëndas. Me kalimin e kohës këta janë bërë më professional dhe kanë rritur influencën e tyre. Këto mekanizma të jashtëm mund të jenë të llojeve të ndryshme: institucione zyrtare të krijuara nga Parlamenti, organe të varura nga një Ministri specifike ose grupe sociale civile ose një miks i këtyre.

Mekanizmat e jashtëm të krijuar nga Parlamenti janë: **Zyrat e Avokatit të Popullit dhe Insitucionet kombëtare** të të drejtave të njeriut. Mandati i tyre i zakonshëm për të monitoruar dhe promovuar respektimin e të drejtave të njeriut e kombinuar me pushtetin e tyre për të ekzaminuar ankesat individuale, shpesh përfshin mundësinë e vizitimit dhe monitorimit të vëndeve të burgimit. Megjithatë, thellësia dhe shpeshtësia e vizitave mund të variojë. Për më tepër, vizitimi i vëndeve të burgimit shpesh kryhet për të verifikuar pretendimet specifike dhe për të hetuar ankesat individuale më shumë sesa për të ekzaminuar dhe vlerësuar kushte e burgimit me qëllim parandalimin e problemeve në të ardhmen. Një karakteristikë avantazhuese e Avokatit të Popullit dhe institucioneve kombëtar të të drejtave të njeriut është se ata zakonisht raportojnë publikisht në Parlament dhe rekomandimet e tyre janë parë, fal statusit zyrtar të tyre, si të besueshme.

Në disa shtete, janë krijuar **organe monitoruese të vecanta** të varura nga një Ministri specifike. Këto organe kanë zakonisht një mandate të dyfishtë, të kontrollojnë kushtet e burgimit në vëndet që janë nën kontrollin e Ministrisë dhe të këshillojnë Ministrinë mbi përmirësimet e nevojshme. Këto organe mund të përbëhen nga zyrtarë, nga përfaqësues të NGO, nga anëtar të pavarur të shoqërisë civile, ose nga një kombinim i këtyre. Këto organe, zakonisht, nxjerrin rekomandime jodetyruese. Ndonjëherë këto rekomandime publikohen në formën e raporteve.

Së fundi, në disa shtete, **NGO-t kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organizatat e shoqërisë civile** kanë bërë të mundur të marrin autorizim për të monitoruar rregullisht vëndet e burgimit. Monitorimi nga shoqëria civile karakterizohet zakonisht nga një shkallë e madhe pavarësie nga autoritetet dhe nga publiciteti që i bëhet konstatimeve dhe raporteve, që shpesh është pikërisht për arsye të kësaj pavarësie dhe perceptimit se kjo pavarësi i bënë konstatimet më të sinqerta. Megjithatë, bazat ligjore për monitorimin mund të jenë shpesh të dobëta, bazuar në një marrëveshje të shkruar me ministrinë e ndryshme ose madje me ministrin si individe, e cila i lë monitoruesit të varur nga vullneti politik i autoriteteve. Në disa vënde, mungesa e fondeve madje dhe për shpenzimet e udhëtimit mund ta bëjë detyrën e monitorimit konsekuent pothuajse të pamundur për grupe të tillë të pavarura.

## 2. Mekanizmat vizitues në nivel ndërkombëtar dhe rajonal

Praktika e organeve ndërkombëtare që kryejnë vizita në vendet e burgimit është zhvilluar relativisht vonë. ICRC ka qënë e para që morri një mandate të tillë, në kohën e konflikteve të armatosura, për të vizituar të burgosurit e luftës. Më vonë mandate u shtri mbi të drejtën e iniciativës, duke e lejuar atë që me miratimin e qeverisë përkatëse dhe gjatë problemeve dhe tensioneve të brendshme, të vizitonte të burgosurit. Rekomandimet e ICRC-s mund të prekin edhe të burgosurit sipas ligjit-zakonor (common-law).

Shumica e mekanizmave ndërkombëtar ekzistues të autorizuar për të vizituar vëndet e burgimit, funksionojnë kryesisht në një mënyrë reaguese, dhe kryejnë vizita në vend me të marrë informacionin për një torturë ose keqtrajtimi (për shembull, Reporteri Special i Kombeve të Bashkuara, CAT). Pak prej tyre kanë mandatin të kryejnë vizita të rregullta ( për shembull, Reporteri Special për burgjet dhe kushtet e burgimit në Afrikë). Këto mekanizma mund të kryejnë vetëm vizita në vend me autorizimin e shtetit përkatës.

Dy organizma ndërkombëtarë punojnë mbi baza radikalisht të ndryshme. Komiteti European për

Parandalimin e Torturës (CPT) ka qenë organi i parë i krijuar në vitin 1987 specifikisht për të kryer vizita parandaluese në vëndet e burgimit. Me ratifikimin e Konventës, Shtetet Anëtare pranuan që CPT të kryente vizita në çdo kohë dhe në çdo vend ku ndodheshin personat e privuar nga liria e tyre. Nën-Komiteti i Komitetit kundër Torturës, që do të krijohet sipas OPCAT, do të kryej gjithashtu vizita në vëndet ku ndodhen personat e privuar nga liria e tyre, pavarësisht faktit nëse ka pasur ndonjë ankesë dhe pa autorizim paraprak nga Shteti anëtar përkatës.

**TABLE 1: Mekanizmat vizitues ndërkombëtar dhe rajonal**

Lloji	Karakteristikat ligjore bazë
<i>Mekanizmat ndërkombëtar</i>	
<b>Procedura Tematike e Kombeve të Bashkuara</b> • Reporterit Special mbi Torturën dhe Trajtimi apo Ndëshkimit Mizor, Jo Human ose Degradues; • Reporterit Special mbi Ekzekutimet e Jashtë Ligjeshme ose Arbitrare; • Grupi i Punës për Zhdukjen e Detyruar dhe të Pavullnetshme; • Grupi i Punës për Burgimin Arbitrar	Rezolutat e Komisionit të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Njeriut • Miratim paraprak nga Shteti përkatës; • Vizita rastësore në vëndet e burgimit në mënyrë që të vlerësohet bazuar në mandatin e tyre, situata në vend; • Rekomandimet e nxjerra mbi bazën e informacionit të transmetuar Reporterit dhe të verifikuara, ose në vijim të vizitave të kryera në shtetin përkatës; • Rekomandimet pa karakter detyrues për Shtetet; • Raportet publike të prezantuara në sesionin e Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut.
<b>Komiteti kundër Torturës</b>	Neni 20 i Konventës së Kombeve të Bashkuara (1984) • Mund të vizitohen vetëm Shtetet Anëtare të Konventës; • Vizitat kryen vetëm në rastet e “torturës sistematike”; • Autorizim nga Shteti përkatës; • Procedurë konfidenciale.
<b>Nën-Komiteti i Komitetit kundër Torturës</b>	Protokoll opsional i Konventës kundër torturës (OPCAT) (2002) • Vizitat kryen në Shtetet Anëtare të Protokollit; • Do të vendoset me qëllim kryerjen e vizitave parandaluese; • Pranimi i vizitave pa miratim paraprak pas ratifikimit ose anëtarësimit në OPCAT; • Vizita periodike parandaluese; mundësia e një vizite pasuese; • Akses i palimituar në çdo vend ku ndodhen persona të privuar nga liria e tyre; • Raporte konfidenciale; mundësia që Shteti të autorizojë publikimin ose që komitetit ti bëjë publike në rastet kur nuk ka pasur bashkëpunim; • Raport Vjetor drejtuar CAT; • Kontakt direct me mekanizmat kombëtar parandalues.

**TABLE 1: Mekanizmat vizitues ndërkombëtar dhe rajonal (vazhdimi)**

Lloji	Karakteristikat ligjore bazë
<i>Mekanizmat ndërkombëtar</i>	
<b>Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq</b>	Mbi bazën e Konventës së Gjenevës (1949) për situatat e konfliktit; Mbi bazën e një marrëveshjeje me Shtetin për situatat e tjera. • Monitorimi i kushteve të burgimit me objektiv personat e arrestuar dhe të burgosur në lidhje me një situatë konfliktit ose mosmarrëveshjeje të brendshme. Në situata të caktuara, monitorimi shtrihet mbi kategoritë e tjera të personave të privuar nga liria e tyre; • Në situatën e një konflikti ndërkombëtar, Shtetet Anëtare të konfliktit janë të detyruara të autorizojnë vizitimin e të burgosurve ushtarak dhe të civilëve shtetas të forcës së huaj të përfshirë në konflikt; • Në situata të tjera, vizitat janë subjekt i miratimit paraprak nga autoritetet; • Vizita permanente dhe të rregullta gjatë një situatë konflikti ose mosmarrëveshjeje ose pasojave direkte të saj; aktivitete lehtësuese ose rehabilituese me miratimin e autoriteteve; • Ndihme për të rivendosur lidhjet familjare • Procedurë dhe raporte konfidenciale.
<i>Mekanizmat Rajonal</i>	
<b>Komisioni Ndër-Amerikan mbi të Drejtat e Njeriut</b>	Konventa Amerikane mbi të Drejtat e Njeriut (1978) Deklarata Amerikane e të Drejtave dhe Detyrave të Njeriut (1948)7 • Vizita në vend, përfshirë vëndet e burgimit, në shtetet Anëtare të Konventës ose Deklaratës; • Çdo vizitë negociohet me shtetin përkatës; • Raporte publike mbi situatën në vend.
<b>Reporterit Special mbi Burgjet dhe Kushtet e Burgimit në Afrikë</b>	Në vijim të Deklaratës Kampala, të vendosur nga një Rezolutë e Komisionit Afrikan mbi të Drejtat e Njeriut (1996) • Vizitat kryen ndaj Shteteve Anëtare të Kartës Afrikane të të Drejtave të Njeriut; • Vizitat kryen vetëm pas miratimit nga shteti përkatës; • Vlerësim i përgjithshëm i kushteve të burgimit dhe trajtimit; • Raportet publikohen pas integritimit të komenteve dhe vërejtjeve të autoriteteve të shtetit përkatës.

Lloji	Karakteristikat ligjore bazë
	<i>Mekanizmat Rajonal</i>
<b>Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës (CPT)</b>	Konventa Europiane për Parandalimin e Torturës (1987) • Vizitat kryen në Shtetet Anëtare të Konventës; • Është krijuar me qëllim kryerjen e vizitave parandaluese; • Akses i palimituar: në çdo moment e në çdo vend ku ndodhen persona të privuar nga liria e tyre; • Vizita periodike dhe të rastit (“sipas rrethanave”); • Raporte teorikisht konfidenciale por publikimi i tyre është bërë rregull.

### 3. Protokollin Opsional i Konventës kundër Torturës

Protokollin Opsional i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës (OPCAT) trajton vizitat në vendet e burgimit nga mekanizmat kombëtar e ndërkombëtar:

“Objektivi i Protokollit është të vendosi një sistem vizitash të rregullta që kryen nga organe të pavarura kombëtare dhe ndërkombëtare, në vendet ku ndodhen persona të privuar nga liria e tyre, me qëllim që të parandalohet tortura dhe trajtimi ose ndëshkimi mizor, jo human ose degradues” (Neni 1 OPCAT).

#### 3.1 Nën-Komiteti i CAT

Protokollin parashikon krijimin e një Nën-Komiteti të varur nga Komiteti kundër Torturës (Nën-Komiteti). Ky organ do të përbëhet nga 10 anëtar të pavarur, të propozuar dhe të zgjedhur nga Shtetet Anëtare të Protokollit<sup>8</sup>, me eksperiencë profesionale dhe që përfaqësojnë rajonet dhe sistemet e ndryshme ligjore të botës. Në punën e tij, Nën-Komiteti, duhet të udhëhiqet nga parimet e “konfidencialitetit, paanshmërisë, jo-përzgjedhjes dhe objektiviteti” (Neni 2).

Mandati i Nën-Komiteti është të kryej vizita në vendet ku ndodhen personat e privuar nga liria e tyre; ai mund të ketë akses jo vetëm në burgje ose rajonet e policisë por gjithashtu, për shembull, në çdo qëndër për azil kërkuesit, kampet ushtarake, qendrat për të rinjtë, spitalet psikiatrike dhe zonat tranzit të aeroporteve ndërkombëtare<sup>9</sup>.

Nën-Komiteti mund të kryej vetëm “vizita të rregullta” dhe duhet të krijojë një program dhe të informojë shtetet anëtare. Për më tepër, ai mund të kryej vizita të shkurtra pasuese pas një vizite të rregullt.

<sup>8</sup> Ky numër do të arrijë 25 pas ratifikimit të 50.

<sup>9</sup> Lloji i vëndit është i njëjtë si për mekanizmat kombëtar vizitues (shiko më poshtë).

#### Mandati dhe kompetencat në lidhje me vizitat:

- Akses ndaj çdo informacioni që ka lidhje me numrin e personave të privuar nga liria e tyre, me trajtimin e tyre dhe kushtet e burgimit;
- Akses ndaj çdo vendi burgimi dhe ambientet e tij. Në raste përjashtimore, është e mundur për një shtet të shtyjë përkohësisht aksesin tek një vend për arsye urgjente siç është mbrojtja e sigurisë kombëtare, siguria publike, katastrofat kombëtare ose trazirat serioze në vëndin që do vizitohet;
- Mundësia për të kryer intervista private;
- Liria për të zgjedhur vëndin që do vizitohet dhe personat që do intervistohen;
- Për më tepër, ka një dispozitë që parashikon mbrojtjen e personave që kontaktojnë me Nën-Komitetin ose me mekanizmat kombëtar parandalues, nga çdo sanksion/ shpagim. (neni 15).

Pas vizitës, Nën-Komiteti harton një raport konfidencial i cili përmban rekomandime, dhe ja transmeton atë Shteteve Anëtare, dhe në qoftë se është e nevojshme, edhe mekanizmave kombëtar parandalues. Raporti është konfidencial por shtetet mund të autorizojnë publikimin e tij.

Rekomandimet nuk janë detyruese por shtetet kanë detyrimin ti ekzaminojnë dhe të dialogojnë rreth masave zbatuese. OPCAT parashikon gjithashtu krijimin e një fondi vullnetar për mbështetjen e zbatimit të rekomandimeve.

Në se Shtetet refuzojnë të bashkëpunojnë, atëherë Nën-Komiteti mund ti propozojë Komitetit të Kombeve të Bashkuara kundër Torturës të bëjë një deklaratë publike ose të publikojë raportin.

### **3.2 Mekanizmat kombëtar parandalues sipas OPCAT**

Standartet dhe kriteret e përcaktuara në OPCAT janë të një rëndësie të veçantë për mekanizmat vizitues vëndas të cilat mund të përcaktohen si “mekanizma kombëtar parandalues”. Ato janë me interes edhe për organe të tjera vizituese vendase, duke qenë se ato përfaqësojnë “gjendjen e artit” në reflektimin ndërkombëtar mbi garancitë e nevojshme për të siguruar që mekanizmat vizitues vëndas të jenë efektive.

#### **3.2.1 Krijimi ose përcaktimi i mekanizmave kombëtar parandalues**

Shtetet Anëtare kanë detyrimin të “ruajnë, përcaktojnë ose krijojnë (...) një ose disa mekanizma kombëtar të pavarur për parandalimin e torturës në nivel vëndas” (Neni 17)<sup>10</sup>. Në përputhje me këtë nen, disa Shteteve do tu duhet të krijojnë një organ të ri ndërkohë të tjerëve që mund të kenë tashmë një mekanizëm të tillë do tu duhet të shikojnë nëse ai i përmbush të gjitha kërkesat sipas Protokollit Opsional.

Në mënyrë që të ndihmojë Shtetet Anëtare të krijojnë mekanizma kombëtar efektiv, Nën-Komitetit mund të sigurojë asistencë dhe këshillim. Për këtë qëllim, Nën-Komitetit ka mandatin të këshillojë Shtetet Anëtare mbi krijimin e mekanizmave kombëtar. Nën-Komitetit gjithashtu mund t’u ofrojë mekanizmave kombëtar parandalues, asistencë dhe trajnim.

Kur një shtet përcakton që një organ ekzistues do të veprojë si “mekanizëm kombëtar parandalues” në kuadër të OPCAT, ai duhet të vlerësojë nëse ky organ i përmbush kriteret e përcaktuara në Protokollin Opsional, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me pavarësinë funksionale. Nën-Komitetit do të jetë gjithashtu në gjëndje të kontrollojë funksionimin efektiv të mekanizmit kombëtar parandalues. Ai mund ti bëjë rekomandime Shtetit Anëtar me qëllim forcimin e kapacitetit të tij për të parandaluar torturën dhe keqtrajtimin.

10 Shtetet Anëtare janë të detyruara të kenë mekanizma kombëtar parandalues brënda 1 viti nga hyrja në fuqi e OPCAT ose në qoftë se ai ka hyrë në fuqi, nga ratifikimi i OPCAT. Megjithatë Shtetet mund të bëjnë një deklaratë në momentin e ratifikimit, bazuar në nenin 24, për të shtyrë përkohësisht detyrimin e tyre për të krijuar mekanizma kombëtar për një periudhë maksimale prej 5 vjetësh.

Duhet theksuar gjithashtu se përcaktimi ose krijimi i mekanizmave kombëtar parandalues nuk duhet të përdoret nga Shtetet për të ndërprerë vizitat që kryen nga organe të tjera vëndase, në vecanti nga organizatat jo qeveritare. Aktivitetet monitoruese nga subjekte të ndryshme duhe të konsiderohet si plotësuese në parandalimin e torturës.

#### **3.2.2 Forma e mekanizmave kombëtarë parandalues**

OPCAT nuk parashikon ndonjë formë të veçantë për mekanizmat kombëtar parandalues. Kështu që Shtetet Anëtare kanë fleksibilitetin të zgjedhin llojin e organit që është më i përshtatshëm sipas kontekstit të vendit përkatës. Një mekanizëm kombëtar parandalues mund të jetë një institucion kombëtar i të drejtave të njeriut, një Avokat Popullit, një komision parlamentar, një NGO, ose çdo organ i specializuar, i krijuar specifikisht për të monitoruar vëndet e burgimit.

Shtetet Anëtare mund të vendosin të kenë disa mekanizma kombëtar parandalues për shkak të strukturës së shtetit (për shembull, federatë) ose bazuar në një ndarje tematike. Kur një Shtet vendos të ketë disa mekanizma kombëtar parandalues, qofshin rajonal ose tematik, është e këshillueshme që të gjëndet një mënyrë për të arritur bashkëpunimin midis tyre, për shembull duke patur një organ koordinues në nivel kombëtar i cili të punojë për të harmonizuar kontributin e secilit prej organeve vizituese.

### 3.2.3 Mandati i mekanizmave kombëtarë parandalues

Efekti parandalues i vizitave në vëndet e burgimit varet nga rregullshmëria e vizitave dhe ndjekja e asaj që vijon pas tyre. Për këtë, mekanizmat kombëtar parandalues janë të mandatuar të ndjekin vizita të rregullta në vëndet ku ndodhen persona të privuar nga liria e tyre dhe për të bërë rekomandime.

#### Qëllimi i mandatit (Neni 19)

Mekanizmat kombëtar parandalues duhet të jepet të paktën pushtet:

- Për të ekzaminuar rregullisht trajtimin e personave të privuar nga liria e tyre, në vëndet e burgimit;
- Për të bërë rekomandime autoritetit përkatës me qëllim përmirësimin e trajtimit;
- Për të paraqitur propozime dhe vërejtje mbi draftet ekzistuese të legjislacionit.

#### Përkufizimi i vëndeve të burgimit

Vëndet ku personat janë të privuar nga liria e tyre përkufizohen gjërësisht në OPCAT dhe përfshijnë:

- Rajonet e Policisë
- Rajonet e forcave të sigurisë
- Qëndrat para-gjyqësore
- Burgjet e arrestit
- Burgjet për personat e dënuar
- Qëndrat për të rinjtë
- Qëndrat e imigrimit
- Zonat tranzite në aeroportet ndërkombëtare
- Qëndrat për azil kërkuesit
- Institucionet psikiatrike
- Vëndet e burgimit administrativ
- Çdo vend tjetër ku personat janë të privuar nga liria e tyre

### 3.2.4 Garancitë për mekanizmat kombëtar parandalues

OPCAT përcakton garanci dhe kritere specifike për mekanizmat kombëtar parandalues në mënyrë që të sigurojë që ata të jenë të lirë nga çdo ndërhyrje nga ana e Shtetit. Këto dispozita janë të ndërvarura dhe duhet të konsiderohen sëbashku në mënyrë që të sigurohet pavarësia e këtyre organeve.

Si një burim udhëzues, OPCAT kërkon që Shtetet Anëtare të konsiderojnë sic duhet “Parimet që lidhen me statusin dhe funksionimin e institucioneve kombëtare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut” (Parimet e Parisit)<sup>11</sup>.

#### Garancitë dhe kriteret për mekanizmat kombëtar parandalues (Neni 18)

Në përputhje me Nenin 18 të OPCAT, mekanizmave kombëtar parandalues duhet tu sigurohen garancitë e mëposhtme:

- Pavarësi funksionale
- Aftësitë dhe njohuritë profesionale të kërkuara
- Burime të mjaftueshme

#### Pavarësia funksionale

Pavarësia e mekanizmave kombëtar parandaluese është thelbësore për të siguruar efektivitetin e këtyre organeve në parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimin. Praktikisht kjo do të thotë që mekanizmat kombëtar parandalues duhet të jenë në gjëndje të veprojnë në mënyrë të pavarur nga autoritetet shtetërore. Është gjithashtu thelbësore që mekanizmat kombëtar parandalues të perceptohen si të pavarur nga autoritetet shtetërore.

<sup>11</sup> Këto parime janë miratuar në Tetor të 1991 në Paris gjatë një mbledhjeje ndërkombëtare të thirrur nga Qendra e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Komisioni për të Drejtat e Njeriut nënshkroi rekomandimin në Mars të 1992.

## **Pavarësia funksionale e mekanizmave kombëtar mund të arrihet duke patur:**

### **■ Baza të pavarura themelimi**

Në mënyrë që të krijohen mbi baza të forta ligjore dhe të mund të sigurohet vazhdimësia e tyre ndër vite, duhet që themelimi i mekanizmave kombëtar parandalues të parashikohet në Kushtetutë ose në një akt Parlamentar.

### **■ Aftësi për të hartuar rregullat dhe procedurat e tyre**

Rregullat e procedurës nuk duhet të jenë të hapura për modifikim nga autoritetet e jashtme;

### **■ Ndarje nga autoritetet ekzekutive dhe gjyqësore**

Në mënyrë që të garantohet efektiviteti dhe pavarësia e perceptuar, duhet që mekanizmat kombëtar parandalues të mos jenë të varur formalisht nga një Ministri ose organ gjyqësor.

### **■ Një procedurë të pavarur dhe transparente për caktimin në detyrë**

Procedura e caktimit në detyrë duhet përcaktojë mënyrë dhe kriteret e caktimit në detyrë si dhe kohëzgjatjen e detyrës, çdo privilegj dhe imunitet, shkarkimin nga puna dhe procedurat apeluese. Parimet e Parisit specifikojnë se “Në mënyrë që të sigurohet një mandate stabël për anëtarët e institucionit, pa të cilin nuk mund të ketë një pavarësi reale, caktimi i tyre në punë duhet të bëhet me një akt zyrtar i cili të përcaktojë kohëzgjatjen specifike të mandatit. (...)”, Parimi 3. Procedura e caktimit në detyrë duhet të përfshijë konsultimin me shoqërinë civile.

### **■ Pavarësi financiare**

Autonomia financiare është një kriter thelbësor dhe përfshin konceptin e financimit të përshtatshëm (shiko më poshtë) dhe aftësinë për të përcaktuar dhe propozuar buxhetin në mënyrë të pavarur.

### **■ Praktika transparente pune dhe raportim publik**

Nëpërmjet raportimit publik mbi punën dhe funksionimin e tyre, mekanizmat kombëtar përforcojnë pavarësinë e tyre dhe për më tepër shikohen si të pavarura.

### **■ Ekspertizë dhe njohuri të përshtatshme**

Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që anëtarët ekspert të kenë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme profesionale në lidhje me të drejtat e njeriut dhe çështjeve që lidhen me privimin e lirisë. OPCAT këshillon gjithashtu që të kërkohet një balancë gjinore dhe përfaqësim i përshtatshëm i minoriteteve në përbërjen e mekanizmave kombëtar parandalues.<sup>12</sup>

### **■ Përbërjen e duhur**

Mekanizmat që kryejnë vizita në vëndet e burgimit është më e përshtatshme të kenë një përbërje të shumëllojshme, e cila të përfshijë:

- Juristë
- Infermiere
- Doktorë, përshtirë mjekë ligjor
- Psikiatër dhe psikolog
- Përfaqësues të tjerë nga shoqëria civile dhe NGO-t
- Specialist në çështjet e të drejtave të njeriut, ligjit humanitar, sistemit ndëshkimor dhe policisë

<sup>12</sup> Dispozita është në linjë me Parimet e Parisit, të cilat theksojnë se institucionet kombëtare duhet të krijohen në mënyrë të tillë që të kenë një përbërje të shumëllojshme.

### **Burime të mjaftueshme**

Autonomia financiare është një kriter thelbësor, pa të cilin mekanizmat kombëtar parandalues nuk do të ishin në gjëndje të gëzonin pavarësi në vendimarrje. Mekanizmat kombëtar parandalues duhet të kenë mundësi financiare dhe të jenë të pavarur në kryerjen e funksioneve të tyre bazë. Parimet e Parisit theksojnë nevojën për financim të përshtatshëm të këtyre mekanizmave “në mënyrë që ato të mund të kenë stafin dhe ambientet e tyre dhe të jenë të pavarur nga qeveria si dhe të mos jenë subjekt i kontrollit financiar”. (Parimi 2)



### **3.2.5 Aksesit tek vëndet ku personat privohen nga liria e tyre**

Sipas OPCAT, mekanizmat kombëtar parandalues duhet të lejohen të kenë akses tek vëndet ku personat privohen nga liria e tyre. Në mënyrë që mekanizmat kombëtar të funksionojnë në mënyrë efektive duhet të sigurohen disa garanci.

#### **Mekanizmat kombëtarë duhet t'u lejohet (Neni 20):**

- Aksesit tek të gjitha vendet e burgimit sipas zgjedhjes së tyre;
- Aksesit ndaj çdo informacioni që ka lidhje me numrin e personave të privuar nga liria e tyre;
- Aksesit ndaj çdo informacioni që ka lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria e tyre dhe me kushtet e burgimit;
- Kryerja e intervistave private me personat e privuar nga liria e tyre, me pëlqimin e këtyre të fundit dhe pa dëshmitarë, dhe me çdo person të zgjedhur prej tyre. Autoritetet duhet gjithashtu të garantojnë që personat që kontaktojnë me grupin vizitues të mos jenë subjekt i presioneve, kërcënimeve ose keqtrajtimit si masë ndëshkimore

#### **Është e rekomandueshme që mekanizmat kombëtarë parandalues të lejohen:**

Të kryejnë vizita në cdo kohë, pa njoftim paraprak të autoritetit përkatës. Në cdo rast, në të gjitha rrethanat, aksesit duhet të sigurohet sa më shpejtë të jetë e mundur.

## **3.3 Ndjekja e vizitave sipas Protokollit Opsional**

### **3.3.1 Raportimi dhe rekomandimet**

Mekanizmat kombëtar parandalues duhet të pregatisin një raport vjetor të cilin Shtetet Anëtare të OPCAT janë të detyruara ta publikojnë. Përmbajtja e çdo raporti vjetor ka si qëllim të nxjerrë në pah përfundimet e çdo mekanizmi kombëtar parandalues por asgjë nuk e ndalon përfshirjen në këtë raport të shumicës së informacionit që përmbajnë raportet e vizitave. Në çdo rast raporti vjetor duhet të përmendi rekomandimet e bëra ndaj autoriteteve. Shtetet Anëtare nuk janë të detyruara por mund të japin miratimin e tyre për të publikuar të gjitha raportet e vizitave të kryera nga një mekanizëm kombëtar parandalues.

Mekanizmi kombëtar parandalues mund t'ia përcjell raportin Nën-komitetit përkatës të Komveve të Bashkuara, dhe nëqoftë se është e nevojshme, mund ta bëjë këtë gjë në mënyrë konfidenciale.

Mekanizmat kombëtar parandalues duhet ta trajtojë informacionin konfidencial si të privilegjuar dhe nuk mund të publikojë të dhëna personale pa miratimin e shprehur të personit të interesuar.

### **3.3.2 Veprimet parandaluese plotësuese**

Mekanizmat kombëtar parandalues mund të plotësojnë vizitat dhe rekomandimet e tyre me veprime të tjera që kanë si qëllim parandalimin e keqtrajtimit dhe përmirësimin e kushteve të personave të privuar nga liria e tyre, të tillë si:

- Organizimi i seminareve trajnuese për personelin përgjegjës për personat e privuar nga liria e tyre;
- Organizimi i aktiviteteve publike që rrisin ndërgjegjësimin;
- Paraqitja e propozimeve dhe vërejtjeve në lidhje me legjislacionin ekzistues ose draftet e tij (në përputhje me nenin 19 c).

### **3.3.3 Kontakt të drejtëpërdrejtë me Nën-komitetin**

Siç është përmendur dhe më sipër, OPCAT përmban një risi e cila i referohet plotësisht të ndërsjellë që i bëjnë njëra-tjetrës përpjekjet kombëtare dhe ato ndërkombëtare, me qëllim parandalimin e torturës. OPCAT kërkon që mekanizmat kombëtar parandalues të kenë kontakt me Nën-Komitetin. Për më tepër, Shtetet Anëtare kanë detyrimin të inkurajojnë dhe lehtësojnë këto kontakte.

Organet kombëtare dhe ndërkombëtare mund shkëmbejnë informacion në lidhje me metodat dhe strategjitë për parandalimin e torturës. Për këtë qëllim, Nën-Komiteti dhe mekanizmat kombëtar

parandalues mund të takohen dhe të shkëmbejnë informacion dhe në qoftë se është e nevojshme kjo gjë mund të bëhet edhe në mënyrë konfidenciale. Mekanizmat kombëtar parandalues mund të shkëmbejnë dhe të përcjellin raportet e tyre dhe çdo informacion tjetër mekanizmit ndërkombëtar.

Nën-komiteti do të jetë gjithashtu në gjëndje të ofrojë trajnim dhe asistencë teknike me qëllim rritjen e kapacitetit të mekanizmave kombëtar parandalues. Nën-komiteti mund ti këshillojë dhe asistojë ato në vlerësimin e metodave të nevojshme për të përmirësuar mbrojtjen e personave të privuar nga liria e tyre.

#### **4. Koordinimi midis organeve të ndryshme vizituese**

Ekzistenca e disa mekanizmave vizitues në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar lë të kuptohet se do të duhet të vendoset një koordinim i mirë midis të gjitha organeve në mënyrë që të shmanget konfuzioni dhe të arrihet impakt optimal.

##### **4.1 Koordinimi midis organeve vizituese vëndase**

Në situatën kur në një shtet ka disa organe vizituese vëndase (për shembull NGO-t kombëtare dhe një Avokat Populli) është vecanërisht e rëndësishme që ato të vendosin një mënyrë për koordinimin e aktiviteteve të tyre monitoruese. Shkalla e bashkëpunimit mund të variojë: shkëmbim informacioni në lidhje me aktivitetet monitoruese, veprime plotësuese të ndërsjellta, bashkëpunim në çështje specifike, ose edhe partneritet.

Ky koordinim mbetet thelbësor edhe kur një ose disa nga këto organe vëndase janë përcaktuar si “mekanizëm kombëtar parandalues” sipas OPCAT. Qëllimi i OPCAT nuk është të uli numrin e organeve monitoruese por të rrisi efektivitetin e tyre.

Koordinimi do të rrisë efijencën e programit monitorues dhe do ta bëjë atë më efektiv në sytë e autoriteteve.

Koordinimi duhet kërkuar gjithashtu me zyrat e oranzatave ndërkombëtare (Zyrat e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Organizata për Sigurinë dhe Kooperimin në Europë) Koordinimi duhet të kërkohet edhe me ICRC. Edhe pse teknikisht është një organizatë ndërkombëtare, në shtetet ku ajo është prezente, metodat e saj të punës në fushën e burgimit ngjajnë me shumë me ato të organeve vizituese vëndase sesa me ato ndërkombëtare.

##### **4.2 Koordinimi ndërmjet organeve vizituese vëndase dhe atyre ndërkombëtare**

Siç është parë dhe më sipër, OPCAT thekson kontaktin e drejtëpërdrejtë midis “mekanizmave kombëtar parandalues” dhe Nën-Komitetit. Kjo gjë është thelbësore për të siguruar plotësimin e ndërsjellt të përjekjeve të këtyre organeve. Nërkohë që OPCAT parashikon vetëm kontakt të drejtëpërdrejtë ndërmjet mekanizmave kombëtar parandalues dhe Nën-Komitetit, aktiviteti i organeve vëndase do të kishte mundësi të ishte më efektiv nëse ata do ti jepnin informacion dhe do ti paraqisnin raporte Nën-Komitetit.

Informacioni dhe raportet e organeve vizituese vëndase mund ti paraqiten edhe organeve të tjera përkatëse të Kombeve të Bashkuara si dhe mekanizmave rajonal të të drejtave të njeriut, si më poshtë:

#### **Organet e Kombeve të Bashkuara**

##### **Procedura speciale sipas Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut**

- Reporteri Special për Torturën
- Reporteri Special për Pavarësinë e Gjyqësorit
- Reporteri Special për Ekzekutimet e Jashtligjshme
- Reporteri Special për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut
- Grupi i Punës për Burgimin Arbitrar

##### **Organet e parashikuara në Traktatin të Kombeve të Bashkuara**

- Komiteti për të Drejtat e Njeriut
- Komiteti kundër Torturës
- Komiteti për të Drejtat e Fëmijës

- Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave
- Organe të tjera tematike (për shembull, Komiteti për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial)

#### **Agjensitë e Specializuara të Kombeve të Bashkuara**

- Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (vecanërisht programe për mbrojtjen e refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vëndit)
- Programi i Kombeve të Bashkuara për zhvillim (kryesisht programe për reformën gjyqësore)
- UNICEF (kryesisht programe për gratë dhe fëmijët në burgim)

#### **Organizatrat rajonale**

*Në Shtetet Amerikane:*

- Komisioni Ndër-Amerikan për të Drejtat e Njeriut

*Në Afrikë:*

- Komisioni Afrikan për të Drejtat e Njeriut (në vecanti Reporterit i tij për Burgjet dhe Kushtet e Burgimit në Afrikë)

*Në Europë:*

- Këshilli i Europës (në vecanti Komiteti European për Parandalimin e Torturës (CPT))
- Zyra e OSCE për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR)

#### **4.3 Koordinimi ndërmjet organeve vizituese ndërkombëtare**

Organet vizituese ndërkombëtare janë ndonjëherë të detyruara të respektojnë rregulla strikte konfidencialiteti të cilat mund të kufizojnë mundësitë e koordinimit. Megjithatë ato duhet të konsultohen.

Në OPCAT, koordinimi ndërmjet Nën-Komitetit dhe mekanizmave ekzistues vizitues rajonal parashikohet në nenin 31, i cili i inkurajon ata të “konsultohen dhe bashkëpunojnë me qëllimin për të shmangur duplikimin”.

Komiteti European për Parandalimin e Torturës (CPT) i bëri një propozim shteteve anëtare të OPCAT dhe ECPT për të rënë dakort “që raportet e vizitave të përgatitura nga CPT në lidhje me shtetet e tyre dhe përgjigjet përkatëse të tyre, ti përcillen sistematikisht Nën-komitetit në mënyrë konfidenciale. Në këtë mënyrë konsultimi mund të bëhet nën dritën e të gjitha fakteve përkatëse”.<sup>1,3</sup>

Në ato vënde ku raportet bëhen publike, ky është rasti i raporteve të Komisionit Ndër-Amerikan për të Drejtat e Njeriut dhe Reporterit Special për Burgjet dhe Kushtet e Burgimit në Afrikë, konsultimi dhe bashkëpunimi me Nën-Komitetin është më i lehtë.

OPCAT specifikon gjithashtu se “dispozitat e Protokollit nuk duhet të prekin detyrimet e Shteteve Anëtare që rredhin nga katër Konventat e Gjenevës dhe as mundësinë që ka çdo shtet Anëtar për të autorizuar ICRC-në të vizitojë vëndet e burgimit në rastet e pambuluara nga ligji ndërkombëtar humanitar.” Nën-komiteti që do krijohet dhe ICRC-ja do tu duhet të gjejnë mënyra për të vendosur kontakt midis tyre, sic po ndodh tashmë në Europë midis CPT-s dhe ICRC-s.

#### **Për të lexuar më tepër**

Shoqata për Parandalimin e Torturës, Vizitimi i Vëndeve të Burgimit: *Praktika dhe Leksione të disa Institucioneve të përzgjedhura vëndase, raport semnari*, Gjenevë, 2004.

Shoqata për Parandalimin e Torturës, *Impakti i Vizitave të Jashtme në Rajonet e policisë për Parandalimin e Torturës dhe Keqtrajtimit*, Studim, Gjenevë, 1999.

Shoqata për Parandalimin e Torturës, *Procedura Standarte Veprimi të Mekanizmave Ndërkombëtar që kryejnë Vizita në Vëndet e Burgimit, raport seminari*, Gjenevë, 1997.

#### **Për OPCAT**

Shoqata për Parandalimin e Torturës, *Protokolli Opsional i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Mizor, Jo Human ose Degradues: Një Manual Parandalues*, Gjenevë, 2004.

Shoqata për Parandalimin e Torturës, *Impelmentimi i Protokollit Opsional të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës, Krijimi dhe Përcaktimi i Mekanizmave Kombëtar Parandalues* Gjenevë, Prill 2003.

13 Raporti i 13 i përgjithshëm mbi aktivitetin e CPT-s, për periudhën 1 Janar 2002 deri 31 Korrik 2003, CPT/Inf (2003)35, §22

#### **Për CPT**

Malcolm D. Evans, Rod Morgan, *Parandalimi i Torturës –Një studim i Konvetës Europiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Johuman ose Degradues*, Clarendon Press, Oxford, 1998.

Malcolm D. Evans, Rod Morgan, *Lufta kundër Torturës në Europë*, Publikim i Këshillit të Europës, 2001.

Seritë e APT-s për Parandalimin e Torturës në Europë (në Frengjisht dhe Anglisht).

Broshurë nr. 3 – Barbara Bernath, *Historia e CPT-s, Mandati, Përbërja*, Gjenevë, Dhjetor 1999.

Broshurë nr. 4 – Ursula Kriebaum, *CPT Modus Operandi*, Gjenevë, Maj 2002.

APT/Këshilli i Europës, *Një vizitë nga CPT –Për çfarë është e gjitha? 15 pyetje dhe përgjigje për policinë*, Maj 1999.

#### **Për ICRC**

Komitetit Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, *Të privuar nga liria*, Gjenevë, 2002.

## **FAZAT E VIZITËS**

KUR?

PREGATITJA E VIZITËS (seksionet 2 & 3)

VIZITA (seksioni 4)

NDJEKJA E ASAJ QË VIJON PAS VIZITËS (seksioni 5)

ÇFARË?

- Mbledhja e informacionit të disponueshëm
- Përcaktimi i objektivave të vizitës
- Organizimi i grupit vizitues
- Bisedë fillestare me drejtorin e burgut
- Vizitimi i ambienteve
- Konsultimi me regjistrat
- Intervista private me të burgosurit
- Bisedime me nëpunësit e tjerë të burgut
- Bisedë përfundimtare me drejtorin e burgut
- Shënime mbi vizitën
- Raport mbi vizitën
- Vizitë pasuese
- Raport global
- Aktivitete pasuese
- Raport vjetor

# KAPITULLI III

## Si të monitorosh vëndet e burgimit

### 1. Sistemi i monitorimit

Monitorimi i kushteve të burgimit përfshin kontrollin që këto kushte ti korrespondojnë standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe që personat e privuar nga liria e tyre trajtohen me respektin që kërkon dinjiteti dhe vlerat e tyre si qenie njerëzore. Pjesa më e madhe e standarteve të përgjithshme që lidhen me privimin e lirisë gjënden në instrumentat ndërkombëtar përkatës (shiko kapitullin IV) dhe në legjislacionin kombëtar.

Parimet Bazë të kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve përbëjnë pjesën më të madhe të standarteve të përgjithshme për privimin e lirisë. Ato zbatohen për çdo person të privuar nga liria kudo që ai të mbahet, dhe sigurojnë një referencë thelbësore për organet vizituese:

#### Parimet bazë për Trajtimin e të Burgosurve

*Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në rezolutën e saj 45/111 të 14 Dhjetorit 1990*

- 1 Të gjithë të burgosurit duhet të trajtohen me respektin që kërkon dinjiteti dhe vlerat e tyre si qenie njerëzore.
- 2 Nuk duhet të ketë asnjë diskriminim mbi bazën e racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, besimit bindjeve politike ose opinionëve, origjinës kombëtare ose sociale, pronës, ditëlindjes ose ndonjë statusi tjetër.
- 3 Është e dëshirueshme që të respektohen besimet fetare dhe kulturore të grupeve të cilave i përkasin të burgosurit, kurdoherë që kushtet e vendit e kërkojnë në gjë të tillë.
- 4 Përgjegjësia e burgjeve për mbikëqyrjen e të burgosurve dhe për mbrojtjen e shoqërisë nga krimet duhet të jetë në përputhje me objektivat e tjera sociale të shtetit dhe përgjegjësinë themelore të tij për të promovuar mirëqenien dhe zhvillimin e anëtarëve të shoqërisë.
- 5 Me përjashtim të atyre kufizimeve që janë të nevojshme për vet natyrën e burgosjes, të gjithë të burgosurit duhet të gëzojnë të drejtat dh liritë themelore të njeriut të përcaktuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të njeriut, dhe kur shteti është anëtar, dhe në Marrëveshjen Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Marrëveshjen Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, në Protokollin Opsional si dhe në marrëveshjet e tjera të Kombeve të Bashkuara.
- 6 Të gjithë të burgosurit duhet të kenë të drejtën të marrin pjesë në aktivitetet kulturore dhe edukative që kanë si qëllim zhvillimin e plotë të personalitetit njerëzor.
- 7 Përpjekjet për heqjen e ndëshkimit me izolim ose kufizimin e përdorimit të tij duhet të inkurajohen.
- 8 Kushtet duhet të jenë të tillë që ti mundësojnë të burgosurve punësim me pagesë në mënyrë që ata ta kenë më të lehtë integrimin në tregun e punës në vend dhe të mund të kontribuojnë në financat e tyre dhe ato të familjes së tyre.
- 9 Të burgosurit duhet të kenë akses tek shërbimi shëndetësor i disponueshëm në vend pa u diskriminuar për shkak të situatës së tyre ligjore.
- 10 Me pjesëmarrjen dhe ndihmën e komunitetit dhe institucioneve shoqërore dhe duke marrë parasysh interesat e viktimës, duhet të krijohen kushte të favorshme për riintegrimin në shoqëri, në kushte sa më të mira të mundshme të ish të bugosurve.
- 11 Parimet e mësipërme duhet të aplikohen në mënyrë të paanshme.

Monitorimi bazohet në një process me katër hapa:

- a) dokumentimi objektiv dhe profesional të kushteve të burgimit
- b) analizimi i përputhshmërisë së tyre me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare
- c) formulimi i rekomandimeve
- d) ndjekja e zbatimit të rekomandimeve.

#### a) Dokumentimi objektiv dhe profesional të kushteve të burgimit

Organi vizitues përcakton, në mënyrë sa më shteruese të mundshme, punët e shtetit për sa i përket kushteve të burgimit- i.e. praktikën- duke përmbledhur:

- Pikëpamjen e autoriteteve, stafit dhe profesionistëve të tjerë që kujdesen për personat e privuar nga liria e tyre;
- Pikëpamjen e personave të privuar nga liria e tyre ;
- Pikëpamjen e burimeve të tjera të disponueshme (avokatët, familjarët e të burgosurve, shoqatat, NGO-t);
- Çfarë kanë parë anëtarët e grupit vizitues në vëndin e burgimit.

Është e rëndësishme që përpara transmetimit të ankesave tek autoriteti më i lartë dhe përpara përgatitjes së draftit të konkluzioneve të tyre, anëtarët e grupit vizitues duhet të marrin në konsideratë të gjitha këto burime informacioni. Kjo është thelbësore në qoftë se organi duhet të bëjë një analizë gjithëpërfshirëse të kushteve të burgimit dhe të përgatisi rekomandime kuptimplote. Megjithatë, pretendimet për keqtrajtime ose torturë duhet ti transmetohen autoriteteve menjëherë, dhe në një nivel që të mos rrezikohet personi ose personat që kanë ngritur pretendimin. (shiko Kapitullin IV, Tortura dhe Keqtrajtimi)

#### b) Përputhshmëria me standartet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare

Në hapin e dytë, mekanizmat vizitues analizojnë nëse kushtet e burgimit janë në përputhje me standartet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare.

Mekanizmi vizitues nuk duhet të limitohet vetëm në konstatimin nëse aspektet e ekzaminuara janë në përputhje apo jo me standartet (për shëmbull, çfarë praktike është, krahasuar me atë që ajo duhet të jetë) por duhet të përpiqet të shpjegojë, të paktën pjesërisht, shkakun e çdo devijimi nga standartet.

Mospërputhje vijnë zakonisht për shkak të kombinimit të disa faktorëve si përshembull:

- Legjislacioni kombëtar nuk i korrespondon standarteve ndërkombëtare;
- Standartet nuk aplikohen ose aplikohen pjesërisht, sepse për shembull;
- ato nuk janë zhvilluar në thelb mjaftueshëm për të siguruar një system të vërtetë për punën e stafit përgjegjës për personat e privuar nga liria e tyre;
- trajnimi i stafit nuk është eficient për sa i përket disa aspekteve të punës së tij ose kultura e tij profesionale nuk është në përputhje me standartet;
- burimet njerëzore ose materiale të disponueshme nuk lejojnë aplikimin e standarteve.

#### c) Formulimi i rekomandimeve

Analizat e mësipërme mund të përdoren për të formuluar më shumë rekomandime thelbësore dhe pragmatiste sesa thjeshtë të përsërisin standartet.

Vec kësaj, të kuptosh problemet dhe shkakun e tyre do të thotë që gjithashtu mund:

- Të identifikohen zonat e ndjeshme ose problemet kryesore;
- Të integrohet faktori kohë tek rekomandimet (i.e., çfarë mund të arrihet në një kohë të shkurtër, mesatare ose të gjatë);
- Të propozohen zgjidhje origjinale për disa probleme;
- Të kontribuohet në zhvillimin e standarteve.

#### d) Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve

Qëllimi përfundimtar i monitorimit të vëndeve të burgimit është të inkurajojë autoritetet të përmirësojnë trajtimin e të burgosurve dhe kushtet e burgimit. Vizitimi i vëndeve të burgimit dhe raportimi janë vetëm mjetet për të arritur qëllimin. Për rrjedhojë ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të bëra është hapi më i rëndësishëm në procesin e monitorimit. Kur bëhen përmirësime ato duhet të mirëprehen. Kur nuk merret asnjë masë, mekanizmi vizitues duhet të kërkojë mënyra të tjera presioni për të nxitur zbatimin.

## 2. Krijimi i një programi monitorimi

### 2.1 Krijimi i një programi vizitash

Programi i vizitave duhet të përmbajë pikat e mëposhtme:

- Një listë të vendeve ku mbahen kategoritë e personave të privuar nga liria e tyre, të cilët janë objekti i vizitave të organeve vizituese vëndase;
- Në qoftë se vizitat duhet të njoftohen ose jo;
- Radhën sipas të cilës do të vizitohen vëndet; kohëzgjatjen e planifikuar për secilën vizitë;
- Shpeshësinë e përsëritjes së vizitave.

### 2.2 Përzgjedhja e vendeve

Sipas situatës, organi vizitues do të vendosi në qoftë se do të kryejë vizita të rregullta në të gjitha vëndet e burgimit apo vetëm në disa prej tyre.

Në përzgjedhjen e vendeve për tu vizituar mund të aplikohen kritere të ndryshme, të vecuara nga njëra tjetra ose të kombinuara me njëra tjetrën, si më poshtë:

**Rreziku potencial ose ekzistues, ndaj të cilit janë të ekspozuar personat e privuar nga liria e tyre:**

- Vëndet e burgimit ku personat merren në pyetje;
- Të burgosurit vecanërisht vulnerabël si gratë, të rinjtë, të huajt dhe minoritetet;
- Vëndet në zonat, qytetet dhe distriktet me rrezik të lartë;

**Informacioni i disponueshëm:**

Numri i ankesave (si mungesa e ankesave ashtu dhe numri i madh i tyre mund të jetë shenjë se ka probleme) numri i personave të burgosur, kapaciteti i vëndit të burgimit dhe niveli i mbipopullimit; Informacioni i siguruar nga burime të tjera si organet e tjera vizituese kombëtare ose ndërkombëtare.

**Shëmbull:**

- Vëndet që konsiderohen se përfaqësojnë më mirë situatën në vënd;
- Vëndet që nuk vizitohen shpesh (shpesh janë ato që ndodhen më largë qendrave urbane);
- Përzgjedhje e kryqëzuar e cila mbulon kategori të ndryshme njerëzish ose vëndesh burgimi

### 2.3 Kohëzgjatja e vizitave

Vizitat duhe të zgjasin aq sa është e nevojshme për të bërë një punë profesionale. Ato duhet të zgjasin aq sa grupi vizitues të jetë në gjëndje të bisedojë me përgjegjësit, vartësit e tyre dhe përfaqësuesit tipik të personave që mbahen në atë vënd dhe të ekzaminojë ambientet dhe kushtet e jetesës.

Kohëzgjatja e vizitës duhet gjithashtu të reflektojë faktin se vizitat mund të përcajjnë ose frenojnë punën e stafit përgjegjës për personat e privuar nga liria e tyre. Është pra e rëndësishme të vendoset një balancë midis nevojës për monitorim eficient dhe kufizimeve të zakonshme për mënyrën sesi këto vënde funksionojnë.

Kohëzgjatja e vizitave mund të vlerësohet bazuar në faktorët e më poshtëm:

- Madhësia e grupit vizitues;
- Sa shumë dihet për vëndin që do vizitohet: - A e ka vizituar mekanizmi më parë vëndin?
- A ka informacion nga palë të treta, i cili të ndihmojë në vlerësimin e kohës së nevojshme për vizitën?
- Madhësia e vëndit të burgimit dhe numri i personave që mbahen aty;
- Lloji i vëndit të burgimit; -regjimi i sigurisë që aplikohet (sa më e madhe siguria, aq më shumë kohë duhet për të lëvizuar nëpër ambientet e burgimit);
- A mbahen në të njëjtin vënd kategori të ndryshme personash të privuar nga liria e tyre, të cilët

trajtohen nën regjime të ndryshme burgimi? Kjo mund të thotë që do të jetë e nevojshme më shumë kohë për të ekzaminuar kushtet e ndryshme të burgimit;

- Stafit dhe kushtet e institucionit;
- Gjuha që flihet nga të burgosurit dhe nevoja e mundshme për përkthim;
- Puna e nevojshme për përpilimin e të dhënave, e cila duhet të realizohet sa më shpejtë të jetë e mundur në fund të vizitës;
- Koha e udhëtimit nga një vënd burgimi në një tjetër.

## 2.4 Shpeshtësia e vizitave

Eksperienca tregon se vizitat do të jenë më efektive për sa i përket parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit dhe promovimit të përmirësimit, në qoftë se ato zhvillohen rregullisht. Sesa shpesh është e nevojshme që të vizitohet një vend, varet nga disa faktorë.

Shpeshtësia e vizitave mund të përcaktohet në varësi të:

- Llojit të vëndit të burgimit;
- Vëndet e arrestit parajyqësor si rajonet e policisë duhet zakonisht të vizitohen më shpesh sesa vëndet e burgimit pasi:
  - aty bëhet marrja në pyetje;
  - kontaktet e të arrestuarit me botën e jashtë janë të limituara;
  - ka një qarkullim të shpeshtë të të arrestuarve;
- Rreziqeve – të njohura ose të prezumuara- ndaj të cilave janë të ekspozuar personat e privuar nga liria ose çdo problemi tjetër të konstatuar që ka të bëjë me mbrojtjen e tyre;
- Balancës që duhet të vendoset ndërmjet nevojave të organit vizitues dhe nevojave të personelit përgjegjës për të kryer punën e tyre. Shpesh vizitat rutinë të përsëritura mund të jenë kundërproduktive në qoftë se ato përcajnë punën e stafit pa ndonjë arsye të vlefshme.

Shpeshtësia e vizitave gjithashtu varet gjërësisht nga rëndesa e problemeve të hasura në lidhje me mbrojtjen e të burgosurve. Në rastet kur mekanizmi vizitues i trëmbet raprezaljeve që mund të kryen kundër të burgosurve që bisedojnë me të, është e rëndësishme të kryhet një vizitë pasuese pa vonesë dhe të vizitohen të njëjtët të burgosur si më parë.

## 2.5 Grupi vizitues

### 2.5.1 Përbërja

Për të monitoruar kushtet e burgimit janë të nevojshme disa aftësi profesionale në vecanti në fushën e ligjit dhe shëndetit publik. Grupi vizitues duhet, idealisht, të përmbajë të paktën një njeri me njohuri ligjore dhe një njeri me njohuri mjekësore, e preferueshme është një doktor. Prezenca e një doktori në grup është vecanërisht e rëndësishme kur ka probleme torture ose keqtrajtimi. Gjithashtu ajo lehtëson kontaktin me personelin mjekësor të vëndit, i cili mund të ndaj eksperiencat e tij ndërkohë që respekton konfidencialitetin mjekësor.

Profesionist të tjerë mund të jenë të dobishëm- për shembull, psikologët, inxhinierët, mësuesit.

Përveç aftësive profesionale, aftësitë personale janë thelbësore, në vecanti aftësia për të bashkëvepruar me njerëzit në mënyrë të ndjeshme e cila respekton dinjitetin njerëzor.

Eksperienca ka treguar se është një avantazh i fortë të kesh një balancë **meshkujsh dhe femrash** anëtar të grupit vizitues. Në shumicën e kulturave, burrat dhe gratë kanë mundësi të ndryshme për të vendosur marrëdhënie të bazuara në besim me të burgosurit dhe stafin. Të burgosurit dhe stafit preferojnë të bisedojnë me një burrë ose një grua në varësi të çështjeve konkrete. Në një kontekst ku dominon kultura mashkullore, të burgosurit mund ti trëmben më pak prishjes së imazhit përara një vizitoreje femër. Balanca gjinore në grup rrit mundësinë për të patur një imazh më të plotë të kushteve të burgimit.

Në vëndet e burgimit ku mbahen persona që i përkasin grupeve të ndryshme etnike ose rajonale, është avantazh i fortë për grupet e vizitimit të reflektojnë këto grupe në përbërjen e grupit të tyre. Aftësitë gjuhësore përbëjnë një pikë tjetër që duhet të merret në konsideratë.



### 2.5.2 Madhësia

Madhësia e grupit vizitues varet nga një disa faktorë si për shembull:

- Objektivat e vizitës;
- Sa shumë dihet për vëndin dhe problemet e tij;
- Madhësia e ndërtesës dhe numri i personave që mbahen aty;
- Çdo kufizim që është vendosur nga autoriteti u burgut.

Numri ideal i anëtarëve për një grup vizitues është ndërmjet 2 dhe 8 personave.

### 2.5.3 Trajnimi

Monitorimi i vëndeve të burgimit është një detyrë e vështirë dhe sensitive. Është pra vecanërisht e rëndësishme që anëtarët e mekanizmit vizitues të kenë një trajnim të përshtatshme të një natyre teorike dhe praktike. Trajnimi duhet të vazhdojë përgjatë gjithë kohëzgjatjes në detyrë.

**Trajnimi teorik duhet të përfshijë të paktën sa më poshtë:**

- Parimet bazë të monitorimit, në vecanti konfidencialitetin dhe nevojshmërinë për të patur parasysh sigurinë e të burgosurve;
- Sistemin ligjor, në vecanti standartet ndërkombëtare përkatëse, ligjet kombëtare dhe rregulloret;
- Çështje dhe probleme kyçe që lidhen me privimin e lirisë.

**Trajnimi praktik duhet të përfshijë të paktën sa më poshtë:**

- Metodologjinë e vizitave;
- Si të drejtosh një intervistë private me personat e privuar nga liria e tyre;
- Sjelljen që duhet patur për tu adoptuar me autoritetet, stafin dhe të burgosurit;
- Rregullat bazë të sigurisë që duhen respektuar gjatë vizitës;
- Hartimin e raportit;
- Mekanizmat për bashkëpunimin dhe komunikimin brenda vet mekanizmit.

## 3. Prgatitja e vizitës

### 3.1 Puna përgatitore

Që vizita të zhvillohet në kushtet më të mira të mundshme ajo duhet të përgatitet mirë paraprakisht. Mekanizmi vizitues duhet të ketë në dispozicion kohën e nevojshme për:

**Përmbledhjen e informacionit në dispozicion, rreth vëndit që do vizitohet:**

- Një përmbledhje e informacionit të marrë gjatë vizitave më të hershme ose nga burime të tjera (organe të tjera vizituese, NGO-t, media, të burgosurit e liruar, familjarët e të burgosurve, avokatët, shoqatat e bamirësisë, vullnetarët që punojnë në vëndet e burgimit, etj.);
- Autoritetet drejtëpërdrejtë përgjegjëse dhe autoritetet më të larta;
- Kapaciteti i vëndit, numri dhe statusi i të burgosurve;
- Çdo prolem të njohur ose të pretenduar.

Bazuar në informacionin e mësipërm, mund të hartohet një listë problemesh.

**Përcaktimin e objektivave specifike të vizitës:**

- Një vlerësim i përgjithshëm i kushteve të burgimit;
- Një vizitë pasuese për të kontrolluar aspektet specifike të burgimit, rastet individuale ose zbatimin e rekomandimeve të mëparshme;
- Të tjera.

**Organizimin e punës së grupit vizitues:**

- Të përgatitet një formular, pyetësor ose listë 14 mbi kushte e burgimit si mënyrë për të garantuar standartizimin e mbledhjes së informacionit;

- Të identifikohet një person për të drejtuar grupin dhe për të qenë përgjegjës për koordinimin e vizitës;
- Të sigurohet që të gjithë anëtarët e grupit të kenë të njëjtin informacion mbi vendin që do vizitohet, objektivat dhe format e vizitës;
- Të ndahen detyra të ndryshme ndërmjet anëtarëve të grupit sipas aftësive të tyre, natyrës dhe madhësisë së vendit që do vizitohet dhe kohëzgjatjes së planifikuar të vizitës.

#### **Planifikimin e çdo kontakti paraprak të nevojshme, me vendin e burgimit**

- Njoftimin e vizitës; grupi vizitues duhet të jetë në gjëndje të kryej vizita të panjoftuara paraprakisht por ai mund të vendosi të njoftojë për një vizitë të vecantë për arsye praktike (për shembull, distanca, madhësia e vendit).
- Praqitjen e justifikimit ose kërkesës për autorizim për të future brenda materiale (per shembull kamera, pajisje regjistrimi) të cilat zakonisht janë të ndaluara.

14 Shiko aneksin 1 për një shëmbull të një liste të tillë.

#### **Planifikimin e çdo kontakti që duhet vendosur jashtë vëndit të burgimit:**

- Autoritetet politike dhe administrative;
- Autoritetet gjyqësore;
- Shërbimet shtetërore që punojnë me vëndet e burgimit për shembull: shërbimet mjekësore, sociale, arsimore;
- Çdo subjekt tjetër që punon me vëndet e burgimit;
- Të tjera.

### **3.2 Përcaktimi i objektivave të vizitës**

Nuk është e arsyeshme ose e mundur që grupi vizitues të ekzaminojë sistematikisht të gjitha aspektet e burgimit gjatë çdo vizite. Duhet të bëhet një analizë e informacionit të mbledhur gjatë përgatitjes për vizitën, në vecanti e prioritetëve sic janë përcaktuar nga të burgosurit, ish të burgosurit dhe burimet e tjera të besueshme, në mënyrë që të ndihmohet përcaktimi i objektivave dhe prioritetëve të vizitës.

Në qoftë se janë planifikuar disa vizita në të njëjtin vend, pragrami i vizitave mund të përcaktojë objektiva të ndryshme për çdo vizitë. Gjatë vizitës së parë për shembull grupi mund të përqëndrohet tek gjëndja e infrastrukturës materiale: ndërtesat, qelitë, ambientet e përbashkëta. Menjëherë pas kësaj sugjerohet që vizitorët ti kushtojnë vëmendje të kujdesshme aspekteve të mëposhtme:

- Sistemeve ankimore brënda vendeve të burgimit;
- Menaxhimit të ndëshkimeve disiplinore;
- Kontaktit me botën e jashtme;
- Kujdesit mjekësor;
- Marrëdhënies midis stafit/ drejtuesve dhe të burgosurve.

Kapitulli IV i kësaj guide siguron informacion mbi këto aspekte kryesore të burgimit dhe udhëheqje për mekanizmat vizitues në lidhje me çfarë duhet të kërkojnë gjatë vizitës. Një përmbledhje e shkurtër e çështjeve përkatëse gjëndet në listën e Aneksit 1.

## **4. Vizita në vetvete**

### **4.1 Bisedim fillestar me drejtorin e vëndit të burgimit**

Vizita e parë në vëndin e burgimit duhet të fillojë me një bisedë ndërmjet grupit vizitues dhe personit përgjegjës ose zëvëndisit të tij. Kjo bisedë, e cila është hapi i parë në vendosjen e një dialogu me autoritetet, shërben për të:

- Prezantuar mekanizmin vizitues dhe anëtarët e grupit vizitues;
- Shpjeguar kuptimin dhe objektivat e vizitës;

- Shpjeguar metodat e punës që përdoren, në vecanti nevojën absolute për të biseduar privatisht me personat e privuar nga liria e tyre dhe, në qoftë se është e mundur, me anëtarët e stafit që kujdesen për ta;
- Shpjeguar përdorimin që do të bëhet informacionit të mbledhur;
- Siguruar personin përgjegjës në vënd, në lidhje me sjelljen e anëtarëve të grupit gjatë vizitës (për respektimin e rregullave dhe rregulloreve të sigurisë);
- Shpjeguar se si vizita do të shtrihet dhe sa kohë do të zgjasi ajo;
- Kërkuar informacion rreth vendit të burgimit, përfshirë këtu informacion nëse ka grupe të burgosurish me nevoja të vecanta (për shembull të burgosur shurdh, të burgosur me paaftësi të tjera) dhe nëse ka pasur ndonjë ndryshim ose ngjarje të rëndësishme që nga vizita e fundit;
- Kërkuar opinionin e personit përgjegjës në lidhje me: -kushtet e burgimit dhe personat nën përgjegjësinë e tij, -ndonjë aspekt problematik të këtyre kushteve dhe shkaqet e tyre-propozimet e tij për përmirësime
- Caktuar takimin për të biseduar mbi rezultatin e vizitës.

Me kryerjen e disa vizitave në të njëjtin vend duke mos hasur asnjë vështirësi serioze ose duke mos identifikuar asnjë problem të vecantë në lidhje me kushtet e burgimit, biseda fillestare mund të limitohen në aspektet formale ose relative të saj.

#### **4.2 Konsultimi i regjistrave dhe dokumentave të tjera**

Në këtë seksion, regjistrat kanë vetëm kuptimin e burimeve të informacionit rreth personave të privuar nga liria e tyre dhe kushteve të tyre të jetesës. Konsultimi i regjistrave në fillim të vizitës mund të jetë i dobishme vecanërisht në se vizita do të zgjasi disa ditë. Informacioni i mbledhur nga regjistrat mund të verifikohet, në qoftë se është e nevojshme, gjatë vizitës.

Në varësi të llojit të vëndit të burgimit, mund të ketë disa regjistra të ndryshëm. Ata më të rëndësishmit për rastin tonë mund të ndahen në tre kategori

##### **Regjistrat për personat e privuar nga liria e tyre:**

- Regjistrat sipas kategorive të të burgosurve;
- Regjistrat e hyrjeve dhe daljeve;
- Regjistrat e masave disiplinore;
- Regjistrat mjekësor 15;
- Të tjera.

##### **Regjistrat e furnizimit me materiale për personat e privuar nga liria e tyre:**

- Regjistrat për ushqimin, higjenën, veshjet, mbulesat, etc;
- Regjistrat për ilaçet dhe materialet mjekësore;
- Regjistrat për materialet mësimore, sportive dhe argëtuese
- Të tjera.

##### **Regjistrat e ngjarjeve të jetës së përditshme në ambientet e burgimit:**

- Regjistrat për përdorimin e forcës ose armëve të zjarrit;
- Regjistrat për regjimin e : vakteve, punës, ushtrimeve, aktiviteteve mësimore etj;
- Regjistrat e incidenteve.

Tre regjistrat e fundit mund të jenë vecanërisht të rëndësishëm për rindërtimin e ngjarjeve dhe përcaktimin e përgjegjësisë në rastet e sjelljeve abusive ndaj të burgosurve. Megjithatë, autoritetet shpesh refuzojnë të lejojnë vizitorët të konsultohen me këto regjistra.

Vizitorët duhet gjithashtu të kërkojnë të konsultohen me dokumenta të tjera të cilat janë të rëndësishme për të kuptuar më mirë funksionimin e vëndit përkatës:

- Rregullat e brëndshme,
- Listën e stafit,
- Programin e punës së stafit.

15 Për shkak të rregullit për konfidencialitetin mjekësor, kontrolli i dosjeve personale mjekësore mund të bëhet nga një anëtar i grupit vizitues i cili është praktikues i kualifikuar i mjekësisë.

### 4.3 Vizitimi i ambienteve të ndërtesës së burgimit

Gjatë vizitës së parë në një vend burgimi, është vecanërisht e rëndësishme të vizitohen të gjitha ambientet e ndërtesës të cilat përdoren nga, dhe për të burgosurit. Të gjithë anëtarët e grupit duhet të bëjnë një xhiro të shkurtër dhe të përgjithshme të të gjithë ndërtesës, të shoqëruar nga personi përgjegjës për vendin e burgimit ose nga një nëpunës i aftë të sigurojë informacion të dobishëm rreth ambienteve dhe funksionimit të shërbimeve. Pas xhiros së përgjithshme, ose në vizitat pasuese, grupi mund të ndahet në grupe më të vogla, secili përgjegjës për zonën e tij.

#### Vizitimi i godinës bënë të mundur që:

- Të krijohet një ide rreth godinës dhe mënyrës së organizimit të saj. Rëndësia e kësaj pike nuk duhet anashkaluar. Arkitektura e vendit të burgimit dhe organizimi i sigurisë fizike (gardhet, muret kufizuese, etj) kanë një influencë të drejtëpërdrejtë në jetën e përditshme të të burgosurve;
- Të lokalizohen ambientet ku jetojnë të burgosurve (qelitë, fjetoret, oborret, mensat, zonat e studimit dhe argëtimit, hapësirat dhe fushat sportive, vëndet e punës, dhomat e vizitave, etj) si dhe shërbimet e ndryshme;
- Të krijohet një impression i parë rreth atmosferës dhe gjëndjes në vend.

Ndërsa të gjitha ambientet duhet të vizitohen, disa prej tyre duhet të kenë prioritet absolut pasi ato shërbejnë për të matur nivelin e respektit që i akordohet të burgosurve. Këto ambiente janë:

- vëndet ku të burgosurit priten dhe trajtohen në momentin e mbërritjes;
- qelitë e izolimit dhe qelitë e masave disiplinore;
- ambientet sanitare;
- qelitë dhe fjetoret. Grupi vizitues mund të pyesi të burgosurit se cilin vend ata e konsiderojnë si vendin më të keq, në mënyrë që ta vizitojë atë. Grupi vizitues duhet të jetë i ndërgjegjshëm se disa qeli ose zona mund të mbahen të fshehura. Grupi duhet të kontrollojë në mënyrë të ndërthurur informacionet që disponon, gjatë bisedave private. Është e dobishme që grupi të konsultohet me të burgosurit ose vizitorët e mëparshëm.

Ambientet që i rezervohen stafit duhet gjithashtu të vizitohen, me përjashtim të rastit kur një gjë e tillë është jashtë objektit të vizitës.

### 4.4 Intervistat me personat e privuar nga liria e tyre

#### 4.4.1 Konsiderata të përgjithshme

Komunikimi me personat e privuar nga liria **përbënë bazën e procesit të dokumentimit të kushteve të burgimit**. Kjo është një detyrë shumë delikate dhe sensitive.

Në fillim të çdo bisede, në grup ose private, anëtarët e grupit vizitues duhet të përpiqen të fitojnë **besimin** e të burgosurve dhe duhet të prezantojnë vetveten dhe mekanizmin e tyre vizitues. Ata duhet të shpjegojnë në mënyrë të qartë arsyen e vizitës së tyre, çfarë mund të bëjnë dhe çfarë jo dhe natyrën konfidenciale të bisedës së tyre.

Përdorimi i një table ose pyetësori gjatë bisedave në grup dhe atyre individuale është një mjet shumë i dobishëm për të siguruar që të gjithë elementet e rëndësishëm të merren në konsideratë (shiko listën në Aneksin 1). Megjithatë vizitorët duhet gjithashtu të lënë hapësira gjatë intervistave në mënyrë që të burgosurit të ndihen rehat dhe të shprehin mendimet e tyre në mënyrë spontane. Në qoftë se përdoret në mënyrë tepër statike, pyetësori rrezikon të kontribuojë në krijimin e disa modeleve të marrjes në pyetje. Kjo duhet të shmanget me çdo mjet.

Është e rëndësishme për vizituesit të shprehin vetveten në mënyrë të qartë, të thjeshtë dhe të kuptueshme. Komentet ose pyetjet nuk duhet të formulohen në mënyrë që ato të kufizojnë ose influencojnë personin që do përgjigjet. Vizitorët nuk duhet të përdorin pyetje tendencioze.

Në varësi të gjuhës që flasin të burgosurit, mund të jetë e nevojshme që grupi vizitues të shoqërohet nga një përkthyes. Grupi vizitues duhet të tregohet i kujdesshëm kur përkthyesit përfshihen në bisedë dhe duhet të shmangin përdorimin e personave që ndodhen në vend, të burgosurve të tjerë ose të anëtarëve të familjes, në vend të përkthyesve profesionist, me përjashtim të rastit kur një gjë e tillë është absolutisht e domosdoshme. Përkthyesi duhet të ketë parasysh detyrimin për të respektuar konfidencialitetin. Vënia paraprakisht në dispozicion të përkthyesit e një fjalori me terma të vecantë, do të përmirësonte punën e tij.

Përbërja **gjinore** e grupit vizitues është vecanërisht e rëndësishme për intervistat private. Në rastet e pretendimeve për përdhunim, abuzim seksual ose forma të tjera dhune, viktimat, meshkuj ose femra, mund të preferojnë të zgjedhin gjininë e bashkëbiseduesit të tyre (shiko Kapitullin IV, Tortura dhe keqtrajtimi).

Në rastet më të shumta, vizituesit duhet të zgjedhin një numër të caktuar personash me të cilët do të bisedojnë. Të përzgjedhurit duhet të përfaqësojnë sa më shumë të jetë e mundur kategoritë e ndryshme të të burgosurve në vëndin konkret.

Vizitorët duhet të kujdesen që të mos bisedojnë vetëm me ata individë që kërkojnë kontaktin me ta ose që propozohen nga stafi.

Bisedat e rastësore me të burgosurit dhe stafin duhet të shikohen si një element i rëndësishëm në ndërtimin e një marrëdhënie besimi dhe mbledhjen e informacionit.

#### **4.4.2 Bisedat në grup**

Bisedat në grup e lejojnë grupin vizitues të jetë në kontakt me më shumë të burgosur, por njëkohësisht ato kanë tendencën të përjashtojnë mundësinë e trajtimit të problemeve më sensitive.

Bisedat në grup janë të dobishme për të identifikuar problemet komune, për evidentimin e drejtuesve jozyrtar, për të kuptuar gjëndjen shpirtërore dhe kulturën e të burgosurve dhe për të përcaktuar personat që do intervistohen më vete.

Kohëzgjatja e bisedave në grup duhet të përcaktohet paraprakisht. Është një ide e mirë që diskutimi të fillohet me një pyetje të hapur. Deklaratat e personave prezent mund të tregojnë se çfarë ata konsiderojnë si probleme kryesore (ose ato që ata nuk guxojnë ti përmendin).

Në vizitat pasuese, biseda duhet të orjentohej më shumë, me qëllim që të mblidhet informacion rreth çështjeve që janë identifikuar si shqetësuese. Aty ku informacioni është kontradiktore ose i dyshimtë, ai mund të rikontrollohet gjatë bisedave private, nëpërmjet vërejtjet empirike të vet vizitorit dhe nëpërmjet konsultimit me burime të tjera.

#### **4.4.3 Bisedat private**

Një bisedë private është mbi të gjitha një takim me një person që jeton në kushte jonormale (jashtë standartit të shoqërisë së jashtme), i privuar nga liria e tij. Personi ka një histori të vecantë jete e cila nuk mund të limitohet vetëm tek arsyet e burgimit të tij. Ky fakt i dukshëm shpesh anashkalohet nga sjelljet përgjithësuere si të personelit ashtu dhe nganjëherë të subjekteve të jashtme.

**Përzgjedhja e vëndit** ku do të bëhet biseda është thelbësore, pasi ajo do të influencojë sjelljen e personit të privuar nga liria. Çdo vënd i cili mund të barazojë në sytë e të burgosurit, vizitorin me personelin, (për shembull zyrat e administratës) duhet të shmanget. Grupi vizitues nuk duhet të ndihet i detyruar të zhvillojë intervistën në një vëndin e caktuar nga autoritetet. Ambientet ku jetojnë të burgosurit (qelia, fjetorja, dhoma e vizitave, oborri, libraria janë të gjitha vende të mundshme. Vizitorët duhet të përpiqen të identifikojnë vëndin që duket të jetë më i sigurti i mundshëm, nga përgjuesit. Opinioni i personit që do intervistohet duhet të merret në konsideratë.

Në rajonet e policisë mundësia e përzgjedhjes së vëndit mund të jetë më e kufizuar.

Bisedat private nuk duhet të dëgjohen nga nëpunësit, ndërkohë që nuk është gjithmonë e mundur që ato të zhvillohen larg syve të tyre.

#### **Elementet e sigurisë**

Kufizimet e propozuara nga stafi për arsye të sigurisë personale të vizitorëve duhe të merren në

konideratë me kujdes, por gjithësesi mbetet në përgjegjësinë e grupit vizitues të vendosi nëse do i ndjekin ato ose jo. Mekanizmi duhet të bjeri paraprakisht dakort me autoritetet, për kushtet e tij.

#### **Zhvillimi i intervistës**

Në bisedë mund të marrin pjesë një ose dy vizitorë, njëri prej tyre të drejtojë diskutimin dhe tjetri të mbajë shënime. Ndërkohë që kjo mund të jetë mbyltese për personin e privuar nga liria, ajo ka avantazhin që i mundëson personit që drejton bisedën të përqëndrohet më mirë, megjithatë kjo gjë duhet të sqarohet me personin e burgosur.

Është e rëndësishme të fitohet besimi i të burgosurit. Në fillim të intervistës, vizitorët duhet të prezantojnë vetveten, të shpjegojnë qartë arsyet e prezencës së tyre, çfarë mund të bëjnë dhe çfarë jo dhe natyrën konfidenciale të intervistës.

Vizitorët duhet të jenë të përgatitur të ruajnë qetësinë. Për një sërë arsyesh – eksperiencës ose gjëndja emocionale, privimi i lirisë për një kohë të gjatë që con në humbjen e sensit të kohës, humbjet e memories, fiksimit, etj- mënyra e të shprehurit të personave të privuar nga liria mund të jetë e ngatërruar.

Bisedat private duhet të menaxhohen në një mënyrë të tillë që të merret informacioni i nevojshëm, të respektohen nevojat e të burgosurit dhe të përdoret sa më mirë koha në dispozicion.

Është e rëndësishme të vendoset një balancë ndërmjet:

- nevojave të vizitorit për të mbledhur informacionin e nevojshëm për të vlerësuar kushtet e burgimit dhe nevojave të të burgosurve për të shprehur shqetësimet e tyre. Çdo mënyrë që i ngjan marrjes në pyetje duhet të shmangët me çdo kusht;
- ndjeshmërisë ndaj personit dhe distancës emocionale të nevojshme për kryerjen e bisedës. Pika e ekuilibrit varet gjithashtu nga gjëndja emocionale e personit të privuar nga liria;
- kohës që i kushtohet nevojës së personit për të komunikuar dhe kohës që i kushtohet nevojës së vizitorit për të mbledhur informacion, në varësi të kohëzgjatjes së intervistës të përlogaritur paraprakisht.

**Intervistimi i një personi që pretendon se është torturuar**, është një proces tepër delikat. Intervistimi i një personi të tillë që ndodhet në burgim kërkon kujdes të veçantë. Literatura e shkëlqyer që ekziston për këtë çështje, të cilës mund ti referohen anëtarët e grupit vizitues dhe e cila mund të përdoret për trajnim, është si më poshtë:

Giffard, Camille, *Manual mbi Raportimin e Torturës – Si të dokumentosh dhe si ti përgjigjesh pretendimeve për torturë, brenda sistemit ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut*, Qendra për të Drejtat e Njeriut, Universiteti i Essex, Mbretëria e Bashkuar, 2000, Pjesa II – Dokumentimi i pretendimeve, pp. 29-51;

Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Seri Trajnimi Profesional nr. 8, Protokollit i Stambollit, Manual mbi Hetimin Efektiv dhe Dokumentimin e Torturës dhe Trajtimi ose Ndëshkimit Mizor, Jo human ose Degradues, New York, Gjenevë, 2001, Kapitulli IV- Konsiderata të përgjithshme për intervistat.

Shiko Aneksin për sesi të gjesh këto publikime dhe gjuhët në të cilat ato janë të disponueshme.

#### **4.4.4 Bisedimet me stafin përgjegjës për personat e privuar nga liria**

Stafi mund të ndahet zakonisht në dy kategori: ata që janë thjeshtë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe ata që kryejnë shërbimet ndaj të burgosurve- ushqimi, kujdesi mjekësor ose social, arsimimi, puna etj. Bisedat me të dytët zhvillohen si pjesë e ekzaminimit të kushteve të burgimit.

Bisedat me personelin mbikëqyrës janë zakonisht të vështira për tu realizuar për shkaqe që burojnë nga struktura organizative dhe natyra e punës së tyre.

Personeli mbikëqyrës, megjithatë, është një element i rëndësishëm në jetën e përditshme të personave të privuar nga liria e tyre, dhe për rredhje është e rëndësishme të organizohen bisedime me ta gjatë të cilave grupi vizitues duhet të shpjegojë mandatin e tij dhe arsyet e punës së tij, ti përgjigjet pyetjeve të tyre dhe të dëgjojë pikëpamjet e tyre. Kjo përbën një bazë të mirë për punën e mëtejshme të mekanizmit.

Vizitorët mund të organizojnë gjithashtu bisedime private me anëtarët e stafit, larg dëgjimit dhe shikimit të pjesës tjetër të personelit, në qoftë se ata kërkojnë një gjë të tillë.

#### **4.5 Biseda e fundit me drejtorin**

Është e rëndësishme që vizita të mbyllet formalisht me një bisedë me drejtuesin e institucionit. Kjo bisedë e fundit duhet të përgatitet, dhe i gjithë grupi vizitues duhet të mblidhet paraprakisht në mënyrë që të ndajë informacionin e mbledhur dhe të diskutojë mbi pikat kyce që duhen transmetuar.

Është e rëndësishme të vendoset një dialog konstruktiv me personat përgjegjës për vëndin që vizitohet, në mënyrë që ata të jenë informuar me përpikmëri mbi rezultatet e vizitës. Qëllimi i vizitës së fundit është të transmetohet një përmbledhje e fakteve të konstatuara dhe problemeve specifike të identifikuara. Rastet urgjente, në vecanti ato që kanë lidhje me parandalimin e torturës ose formave të tjera të keqtrajtimit, duhet të bëhen të ditura menjëherë. Në rastet e konstatimit të abuzimeve të rënda, mekanizmi vizitues duhet të drejtohet drejtëpërdrejtë autoriteteve më të larta në hierarki, në mënyrë që të shmanget rreziku i raprezaljeve ndaj personave që kanë siguruar informacionin. Kjo strategji duhet të përdoret vetëm në rastet serioze, për të shmangur prishjen e panevojshme të marrëdhënieve të punës me personin përgjegjës.

Kur nuk janë hasur probleme specifike, biseda e fundit me drejtorin mund të jetë më shumë e një natyre formale.

### **5. Ndjekja në vijimësi e vizitës**

**Vizita nuk është një qëllim në vetvete: Ajo është thjeshtë fillimi i një procesi i cili ka si qëllim të përmirësimit trajtimin dhe kushtet e burgimit të personave të privuar nga liria e tyre.** Faza që pason vizitën është pra po aq e rëndësishme sa vizita vet, në mos më hsumë. Vizitat duhet të pasohen nga raporte që i adresohen autoriteteve përgjegjëse, dhe përmbajnë rekomandime për përmirësimin e situatës. Zbatimi i këtyre rekomandimeve duhet gjithashtu të monitorohet.

#### **5.1 Ndjekja e brendshme në vijimësi**

Mekanizmi vizitues duhet të jetë në gjëndje të identifikojë pika referimi ose tregues të cilët ti mundësojnë ndjekjen e zhvillimit në kohë të kushteve të burgimit në vëndet që ai viziton rregullisht. Kjo do të thotë që informacioni i mbledhur nga grupi vizitues duhet të analizohet, të organizohet dhe të regjistrohet në mënyrë të tillë që të mund të përdoret në mënyrë sa më efçente të mundshme kur të jetë nevoja. Informacioni që as analizohet as regjistrohet është informacion i humbur.

Është e rekomandueshme që grupi vizitues të mbajë shënime të brendshme, mbi vizitën sipas një forme standarte (shiko Aneksin 2). Këto shënime përbëjnë një gjurmë të shkruar të vizitës dhe kontribuojnë në memorien institucionale të organit vizitues. Ato janë thelbësore për përgatitjen e vizitës së ardhshme.

#### **Këto shënime të brendshme mund të përfshijnë:**

- Informacion të përgjithshëm rreth vëndit dhe natyrës së vizitës;
- Të dhëna në lidhje me institucionin;
- Informacione kyce të përftuara gjatë vizitës: problemet kryesore të identifikuara, veprimet e ndërmarra, pikat që duhen verifikuar në vizitën e ardhshme.
- Mekanizmi vizitues mund gjithashtu të kontrollojë dhe plotësojë informacionin e përftuar gjatë vizitave duke u konsultuar me:
  - Autoritetet më të larta;
  - Shërbimet shtetërore të ndryshme nga ato përgjegjëse për vëndin e burgimit ( për shembull, Ministria e Shëndetit);
  - Subjekte të tjera si avokatët, ose organizatat e shoqërisë civile që punojnë në ose me vëndet e burgimit;
  - Raportet e mekanizmave të tjerë vizitues;
  - Familjarët e personave të privuar nga liria ose të burgosurit e liruar;
  - Të burgosurit e transferuar në një vend tjetër burgimi.

## **5.2 Hartimi i raporteve mbi monitorimin e kushteve të burgimit**

Raportet janë mundësisht mjete më të rëndësishme që kanë në dispozicion një organi vizitues për mbrojtjen e të burgosurve dhe përmirësimin e situatës së tyre. Tekstet e ligjore ose marrëveshjet që sigurojnë bazën për mekanizmat vizitues, zakonisht parashikojnë shprehimisht të drejtën e organit vizitues për të bërë raporte dhe rekomandime, si dhe detyrimin e autoriteteve të burgimit për të marrë ato në konsideratë dhe për të hyrë në dialog.

Mund të ketë disa lloje raportesh, me objekte të ndryshme, të cilat kanë si objektiv bashkëbisedues të ndryshëm. Organi vizitues duhet të përcaktojë strategjinë e tij në lidhje me raportimin dhe ndjekjen. Një organ vizitues mund të vendosi të raportojë për çdo vizitë ose të paraqesë një raport të përgjithshëm që bazohet në një seri vizitash. Ai mund të vendosi gjithashtu të paraqesë një raport të përgjithshëm vjetor.

### **5.2.1 Hartimi i raporteve mbi vizitat**

Mekanizmi vizitues duhet të informojë rregullisht autoritetet e burgimit mbi rezultatet e vlerësimit të tij ndaj vëndeve të burgimit. Është shumë e rekomandueshme që informacioni të përcillet në formën e një raporti të shkruar. Trasmetimi oral i informacionit duhet të kufizohet tek kontakti periodik që mekanizmi do të përpiqet të vendosi dhe të mbajë me autoritetet përkatëse.

Raporti mbi vizitën e kryer në një vend, duhet të prezantojë faktet dhe problemet kryesore që kanë lindur nga vizita, si dhe çdo element të rëndësishëm që ka dalë në pah nga biseda përfundimtare me drejtorin. Këto raporte vizitash mund të jenë relativisht të shkurtra dhe duhet të përcillen brenda pak kohe nga kryerja e vizitës. Ato duhet të adresohen drejtëpërdrejtë autoriteteve përgjegjëse për vëndin e vizituar, duke qenë se ata kanë përgjegjësinë të gjejnë zgjidhje dhe të zbatojnë rekomandimet. Kjo gjë përforcon dialogun me autoritetet duke siguruar reagim formal dhe të shkruar prej tyre.

Mekanizmi vizitues mund të jetë i idesë që jo çdo vizitë individuale duhet të jetë objekt i një raporti të shkruar drejtuar autoriteteve. Në këtë rast raportet do të adresohen autoriteteve sipas rasteve, në varësi të vlerësimit të grupit ndaj rëndësisë së problemit të hasur.

### **Raporti mbi vizitën duhet të përmbajë një informacion të caktuar të përgjithshëm:**

- Përbërjen e grupit vizitues dhe datën e orën e vizitës;
- Objektivat e arritura, të vizitës;
- Si është mbledhur dhe kontrolluar informacioni.

### **Prezantimi i kushteve të burgimit:**

Raporti duhet të prezantojë qartësisht shqetësimet kryesore bazuar në çështjet e mëposhtme, të listuara në Kapitullin IV:

- Trajtimi
- Masat mbrojtëse
- Kushtet materiale
- Regjimi dhe aktivitetet
- Shërbimet mjekësore
- Personeli

Nuk është e nevojshme të preken detaje të atyre aspekteve të kushteve të burgimit të cilat janë të përshtatshme, megjithëse është e rekomandueshme që dhe aspektet positive të përmenden.

Çështjet problematike duhet të radhiten me prioritet:

Theksi duhet të vendoset tek problemet më serioze të cilat sjellin probleme të tjera; Kur raportohet tortura, keqtrajtimi ose çdo situatë tjetër në të cilën vizitori nuk ka qenë dëshmitar, duhet të tregohet kujdes me mënyrë sesi shprehet informacioni. Terminologjia që përdoret duhet të bëjë të qartë diferencën midis asaj që “është” me atë që “pretendohet të jetë” ose që “raportohet të jetë”. Objektivi është ti kërkohet autoriteteve të hetojnë dhe të reagojnë. Organi vizitues duhet gjithashtu të jetë absolutisht i sigurt që të dhënat personale të të burgosurve të përmenden vetëm me miratimin e tyre të shprehur dhe që përmbajtja e raportit të mos vërë në rrezik individët që janë kontaktuar.



## **Rekomandimet**

Është e rëndësishme që rekomandimet ti adresohen autoritetit të duhur. Në raportin mbi vizitën, rekomandimet duhet ti adresohen drejtëpërdrejtë zyrtarëve përgjegjës për vëndin e burgimit, të cilët kanë autoritetin të bëjnë ndryshime dhe të zbatojnë rekomandimet. Në qoftë se shkak i problemit nuk është në kompetencë të drejtorit më të madh, atëherë problemi duhet të prezantohet tek një nivel tjetër dhe më një raport tjetër.

Rekomandimet ose masat korrigjuese të propozuara duhet të përfshijnë faktorin kohë: ato që mund të zbatohen për një periudhë kohe të shkurtër, mesatare ose të gjatë. Këto afate duhet të jenë realiste dhe duhet të fillojnë nga momenti i prezanimit të problemit.

### **5.2.2 Hartimi i një raporti global**

Përveç ose në vend të raporteve mbi vizitat, organi vizitues mund të vendosi të hartojë një raport analitik, një raport vjetor ose të dyja.

#### **Raporti analitik**

Mekanizmi vizitues mund të vendosi të hartojë raporte bazuar në një numër vizitas të kryera brënda një periudhe kohe. Një strategji e tillë i mundëson mekanizmit vizitues të krijojë një ide më gjithëpërfshirëse dhe analitike të problemeve që kanë dalë në pah gjatë monitorimit. Një trajtim më tematik mund të përdoret për tu fokusuar në një grup të kufizuar problemesh.

Analizimi i vizitave të kryera në disa vënde të ndryshme ndihmon në identifikimin e problemeve ose shkeljeve tipike. Kjo mënyrë mund të hedhi dritë mbi një spektër të tërë shkaqesh që sjellin problemet në vëndet e burgimit. Rekomandimet atëherë mund ti drejtohen subjekteve të ndryshme që duhet të ndërhyjnë për trajtimin e këtyrë shkaqeve të cilat mund të derivojnë nga jashtë burgut ose Ministrisë (për shembull, legjislacioni, politika e dënimit, kushtet e trajnimit të stafit).

Raportet analitike mund të jenë plotësuese të raporteve mbi vizitat, mbi të cilat bazohen.

#### **Raporti vjetor**

Mekanizmi vizitues mund të vendosi të hartojë një raport vjetor mbi aktivitetin e tij monitories.

Përmbajtja e raportit vjetor mund të varrojë nga një organ vëndas tek tjetri. Raportet vjetore mund të jenë në formën e përmbledhjes së raporteve mbi vizitat e kryera dhe të prezantojnë në detaje faktet e konstatuara në vëndet e ndryshme të vizituara dhe rekomandimet e bëra. Raportet mund të jenë më analitike dhe të theksojnë problemet kryesore të identifikuar gjatë vitit. Raportet vjetore mund të fokusohen tek një ose tek një numër i kufizuar problemesh tematike kryesore dhe të propozojë rekomandimet përkatëse.

Sipas OPCAT, mekanizmat kombëtar parandalues duhet të hartojnë një raport vjetor dhe Shtetet Anëtare duhet ta publikojnë dhe ta shpërndajnë atë. Është në dorë të mekanizmit kombëtar të vendosi nëse raporti vjetor do të përmbajë vetëm informacion të përgjithshëm mbi aktivitetin e tij monitorues apo do të përfshijë në të edhe raportet mbi vizitat e kryera dhe rekomandimet përkatëse.

### **5.2.3 Shpërndarja e raporteve globale**

Raportet globale nuk duhet ti adresohen vetëm autoriteteve. Është e rëndësishme që si raportet vjetore ashtu dhe ato analitike të vihen në dispozicion të publikut, përfshirë këtu subjektet e tjera që mund të kenë influencë në mbështjetjen dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, si deputetët dhe organizatat e shoqërisë civile.

Në varësi të strategjisë komunikuese të organit monitories, raportet ose përmbledhjet mund ti përcillen edhe medias.

Duhet theksuar se këto raporte mund ti dërgohen në të ardhmen, në konfidencialitet ose pa ndonjë kufizim, Nën-komitetit që do të krijohet sipas OPCAT. Raportet do të jenë një burim i dobishëm informacioni për organe të tjera ndërkombëtare, në vecanti për organet rajonale si CPT, Komisioni Ndër-Amerikan mbi të drejtat e Njeriut dhe Reporterin special për Burgjet dhe Kushtet e Burgimit në Afrikë, si dhe për CAT kur ekzaminohet raporti i Shtetit, për Reporterin Special për Torturën, etj (Shiko Kapitullin II, pika 4: Koordinimi).

### 5.3 Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve

Me dorëzimin e raporteve mbi vizitat e kryera ose të raporteve globale, tek subjektet e tjera, është e rëndësishme të monitorohet nga afër reagimi i tyre.

Autoritetet kanë detyrën të reagojnë ndaj raportit, për rrjedhojë atyre duhet tu jepet kohë e arsyeshme për tu pozicionuar në lidhje me kritikën ose rekomandimet e bëra. Autoritetet duhet të hyjnë në dialog me mekanizmin vizitues për rekomandimet dhe zbatimin e tyre.

Përgjigjet specifike dhe reagimet e përgjithshme të autoriteteve do e ndihmojnë organin vizitues vendas të përshtasi programin e tij të vizitës. Vizitorët mund të kontrollojnë gjatë vizitave pasuese nëse përgjigjet zyrtare i korrespondojnë situatës në vend dhe nëse është ndërmarrë ndonjë masë ose veprim.

Në rastet kur pas marrjes së raportit, autoritetet shfaqin mosdashje për të marrë në konsideratë raportin dhe rekomandimet dhe për të ndërmarrë ndonjë veprim, organi vizitues duhet të vazhdojë punën e tij monitoruese. Ai duhet të konsiderojë strategji të tjera për të ushtruar presion mbi autoritetet, si për shëmbull ti drejtohet deputetëve, shoqërisë civile, medias dhe organizatave ndërkombëtare.

### 5.4 Aktiviteti jashtë procesit të monitorimit

Gjatë vizitës në vëndet e burgimit grupi vizitues haset me probleme dhe nevoja të ndryshme. Vizitorët marrin shumë kërkesa si për shëmbull për ndihmë ligjore dhe humanitare, ose për kontakt me anëtarët e familjes. Është e rëndësishme që organi vizitues të diskutojë dhe të adoptojë një politikë të qartë mbi mënyrën sesi ti përgjigjet kërkesave në mënyrë që të mos krijojë shpresa të kota. Është përgjegjësi e autoritetit të burgimit që të sigurojë që nevojat e njerëzve nën kujdesin e tyre të përmbushen. Detyra primare e mekanizmit vizitues zakonisht është të ekzaminojë se në çfarë mase bëhet një gjë e tillë, të ngrejë çdo problem dhe të bëjë rekomandime për përmirësim.

Megjithatë, disa mekanizma vizitues vendas që përballen me nevoja dhe kufizime të veçanta në vëndin e tyre, shkojnë përtej detyrës strikte të monitorimit dhe raportimit. Disa përforcojnë vërejtjet e tyre duke siguruar ndihmë ligjore për rastet individuale, të tjerë sigurojnë ndihmë humanitare dhe zhvillojnë aktivitete trajnuese për personelin si dhe për të burgosurit.

Në disa shtete, përfshirja e organeve vizituese në ndjekjen e rekomandimeve shtrihet deri në pjesëmarrjen e tyre në procedurat e rishikimit të legjislacionit kombëtar. OPCAT parashikon shprehimisht se mekanizmat parandalues kombëtar duhet të kenë mandatin për të “bërë propozime dhe vërejtje në lidhje me aktet ekzistuese ligjore ose projektaktet” (neni 19 c).

Disa mekanizma vizitues vendas, në veçanti institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, kanë pushtet “pothuajse gjuqësor”. Ato jo vetëm që marrin ankesa por gjithashtu hetojnë mbi to dhe i çojnë çështjet përpara gjykatës. Disa organe vizituese mund të urdhërojnë lirin e të burgosurve dhe/ose dëmshpërblimin e atyre që u janë shkelur të drejtat.

#### Për lexim të mëtejshme

Kombet e Bashkuara, Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, *Seri për Trajnimin Profesional nr.7, Manual Trajnimi për Monitorimin e të Drejtave të Njeriut*, New York, Gjenevë, 2001. (Kapitulli IX: Vizitimi i personave të burgosur)

Giffard, Camille, *Manual për Raportimin e Torturës – Si të dokumentosh dhe ti përgjigjesh pretendimeve për torturë brenda sistemit ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut*, Qendra për të Drejtat e Njeriut, Universiteti i Essex, Mbretëria e Bashkuar, 2000.

Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, *Seri për Trajnimin Profesional nr. 8, Protokollin e Stambollit, Manual mbi Hetimin Efektiv dhe Dokumentimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Mizor, Jo Human ose Degradues*, New York, Gjenevë, 2001.

APT/OSCE-ODIHR, *Monitormi i vëndeve të burgimit: një guidë praktike për NGO-t*, Gjenevë, 2002.

TRAJTIMI  
MASAT MBROJTËSE  
KUSHTET MATERIALE  
REGJIMI DHE AKTIVITETET  
SHËRBIMET MJEKËSORE  
STAFI I BURGU

## ÇËSHJET QË DUHEN EKZAMINUAR

- Tortura dhe Keqtrajtimi
- Izolimi
- Mjetet kufizuese
- Përdorimi i forcës
- Inspektimi
- Procedurat ankimore
- Procedurat disiplinore
- Regjistrat e burgimit
- Ndarja e kategorive të të burgosurve
- Ushqimi
- Ndriçimi dhe ajrimi
- Higjena Personale
- Ambientet sanitare
- Veshja, shtresat dhe mbulesat
- Mbipopullimi dhe akomodimi
- Kontaktet me familjen dhe shoqërinë
- Kontaktet me botën e jashtme
- Ushtrimet përjashta
- Arsimimi
- Aktivitetet argëtuese
- Feja
- Puna
- Aksesi tek kujdesi mjekësor
- Kujdes i veçantë shëndetësor për gratë dhe fëmijët
- Kujdes i veçantë shëndetësor për të burgosurit me sëmundje mendore
- Sëmundjet e transmetueshme
- Staf i mjekësor
- Të përgjithshme
- Trajnimi i personelit

# KAPITULLI IV

## Çfarë aspektesh të burgimit duhen ekzaminuar

TRAJTIMI MASAT MBROJTËSE KUSHTET MATERIALE REGJIMI DHE AKTIVITETET

SHËRBIMET MJEKËSORE PERSONELI NDALIMI NGA POLICIA

### Lista e shkurtimeve të standarteve:

ACHPR	Karta Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popullit – Miratuar nga Organizata e Unitetit Afrikan në 27 Qershor 1981
ACPR	Karta Afrikane për të Drejtat e të Burgosurve – Drafti është miratuar nga Konferenca e pestë e Kryetarëve të Shteteve të Afrikës Qëndrore, Lindore dhe Jugore për Shërbimet Korrigjuese (CESCA), të mbledhur në Ēind-hoek, Namibia, 4 deri 7 Shtator 2001 <sup>16</sup>
BPP	Grupi I Parimeve për Mbrojtjen e të Gjithë Personave të Burgosur ose Burgosur – Miratuar me Rezolutën 43/173 datë 9 Dhjetorit 1988, të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara
BPTD	Parimet Bazë për Trajtimin e të Burgosurve- miratuar me Rezolutën 45/111 datë 14 Dhjetorit 1990, të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara
CPT GR2	Raporti i Dytë i Përgjithshëm mbi Aktivitetin e CPT-s I cili mbulon periudhën 1 Janar deri 31 Dhjetor 1991; CPT/Inf (92)3, 13 Prill 1992
CPT GR3	Raporti i Tretë i Përgjithshëm mbi Aktivitetin e CPT-s I cili mbulon periudhën 1 Janar deri 31 Dhjetor 1992; CPT/Inf (93) 12, 4 Qershor 1993
CPT GR10	Raporti i Dhjetë i Përgjithshëm mbi Aktivitetin e CPT-s I cili mbulon periudhën 1 Janar deri 31 Dhjetor 1999, CPT/Inf (2000) 13, 18 Gusht 2000
CPT GR11	Raporti i Njëmbëdhjetë i Përgjithshëm mbi Aktivitetin e CPT-s I cili mbulon periudhën 1 Janar deri 31 Dhjetor 2000, CPT/Inf (2001)16, 3 Shtator 2001
CPT GR12	Raporti i Dymbëdhjetë i Përgjithshëm mbi Aktivitetin e CPT-s I cili mbulon periudhën 1 Janar deri 31 Dhjetor 2001, CPT/Inf (2002) 15, 3 Shtator 2002
EPR	Rregullat Europiane për Burgun; Rekomandimi R(87)3, miratuar nga Këshilli I Komitetit Europian të Ministrave në datë 12 Shkurt 1987
GC	Komentet e Përgjithshme të Komitetit për të Drejtat e Njeriut mbi zbatimin e dispozitave të ICCPR
ICCPR	Marrëveshja Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Politike dhe Civile, 1966
ICPRT	Marrëveshja Ndër-Amerikane për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Torturës – Miratuar nga Organizata e Shteteve Amerikane në 28 Shkurt 1987.
IDRCPLD R(89)12	Deklarata Draft Ndër-Amerikane që Udhëheq të Drejtat dhe Kujdesin ndaj Personave të Privuar nga Liria <sup>17</sup> Rekomandim I Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për Arsimimin në Burg (miratuar nga Këshilli I Komitetit Europian të Ministrave në 13 Tetor 1989)
R(98) 7	Rekomandim I Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për aspektet etike dhe organizative të kujdesit ndaj shëndetit në burg (miratuar nga Komitetit I Ministrave në 8 Prill 1998).
RIG	Direktiva dhe Masa për Ndalimin dhe Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Ndëshkimit Mizor, Johuman ose Degradues në Afrikë (Direktivat e Ishullit Robben), 2002.
RPJDL	Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve të Privuar nga Liria e tyre, 1990.
SMR	Rregullat për Standartet Minimale të Trajtimin të të Burgosurve, miratuar nga ECOSOC në rezolutën e tij 633C (XXIV) të datës 31 Korrik 1957 dhe 2076 (LXII) të datës 13 Maj 1977.

Ky kapitull prezanton elemente të ndryshme që mund të ekzaminohen gjatë vizitave. Ai ka si synimin të sigurojë një mjet praktik që jep akses të shpejtë tek standartet ndërkombëtare për kushtet e burgimit dhe guidë në lidhje me çfarë të kërkohet në praktikë. Këtu theksohen disa fusha që mund të prezantojnë vështirësi të vecanta për mekanizmin vizitues si dhe disa strategji për tu përballur me to. “Pikat e referimit” që janë dhënë në fund të çdo nën-seksioni nuk janë ezauruese, dhe është parashikuar që mekanizmat vizitues të zhvillojnë listën e tyre bazuar në nevojat përkatëse të sistemit të cilit i përkasin.

16 Ky Kapitull është një draft i përgatitur nga CESCA.

17 Kjo Deklaratë është një draft i përgatitur nga Penal Reform International dhe i sponsorizuar nga qeveria e Costa Rican

## 1. TRAJTIMI

Respekti për dinjitetin e të burgosurve si qenie njerëzore duhet të jetë vlera themelore etike për personat përgjegjës për ta dhe që punojnë në vendet e burgimit si dhe për organet vizituese të ngarkuara me mbikëqytjen e tyre. Ky parim bazë është parashikuar shprehimisht në nenin 10 të marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike (ICCPR): “Të gjithë personat e privuar nga liria e tyre duhet të trajtohen me humanitet dhe me respekt për dinjitetin e tyre si qenie njerëzore”<sup>18</sup>

Mbi të gjitha, tortura dhe trajtimi johuman ose degradues janë absolutisht të ndaluara dhe nuk mund të justifikohen në asnjë rrethanë.

Disa masa mund të përbëjnë torturë ose keqtrajtim në qoftë se përdoren në mënyrë të papërshtatshme. Kjo i referohet veçanërisht izolimit, mjeteve të tjera kufizuese dhe përdorimit të forcës. Kjo është arsyeja pse përdorimi i këtyre masave duhet të shoqërohet me një sër garancish dhe organi vizitues duhet ti kushtojë vëmendje të veçantë mënyrës sesi këto masa administrohen.

### Trajtimi

- Tortura dhe keqtrajtimi
- Izolimi
- Mjetet kufizuese
- Përdorimi i forcës

18 Shiko gjithashtu, Parimin 1 të Parimeve Bazë të Burgimit dhe Parimin 1 të Grupit të Parimeve.

## TORTURA DHE KEQTRAJTIMI

### Standartet

“Asnjë person i burgosur ose i burgosur nuk duhet të jetë subjekt i torturës ose trajtimit apo ndëshkimit mizor, johuman ose degradues. Asnjë rrethanë nuk mund të përdoret si justifikim për torturën ose trajtimin apo ndëshkimin mizor, johuman ose degradues” *BPP, Parimi 6*

“Asnjë person nuk duhet të jetë subjekt i torturës ose trajtimit apo ndëshkimit mizor, johuman ose degradues. Në vecanti, asnjë person nuk duhet të jetë subjekt i eksperimenteve mjekësore ose shkencore, pa miratimin e tij të pandikuar.” *ICCPR, Neni 7*

“Asnjë person nuk duhet të jetë subjekt i torturës ose trajtimit apo ndëshkimit mizor, johuman ose degradues. Të gjithë personat e privuar nga liria e tyre duhet të trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre si qenie njerëzore”. *Neni 5, Konventa Amerikane mbi të Drejtat e Njeriut, 1978*

“Asnjë person nuk duhet të jetë subjekt i torturës ose trajtimit apo ndëshkimit mizor, johuman ose degradues.” *Neni 3 i Konventa Europiane mbi të Drejtat e Njeriut, 1950*

“Çdo individ duhet të ketë të drejtën që ti respektohet dinjiteti si qenie njerëzore dhe ti njihet statusi i tij ligjor. Çdo formë shfrytëzimi dhe degradimi i njeriut vecanërisht skllavëria, tregtia e skllavërive, tortura, trajtimi dhe ndëshkimi mizor, johuman ose degradues duhet të jenë të ndaluara.” *Neni 5, ACHPR*

“Për qëllimet e kësaj Konvente, termi “torturë” ka kuptimin e një akti që shkakton qëllimisht dhimbje ose vuajtje të rënda, fizike ose mendore, tek një person me qëllimin për të marrë prej tij ose një personi të tretë informacione personale ose rrëfime, për ta ndëshkuar për një akt të kryer ose që dyshohet të jetë kryer prej tij ose një personi të tretë, për ta trëmbur ose për ta detyruar atë ose një person të tretë ose për çdo arsye që bazohet në çfarëdo lloj diskriminimi, kur një dhimbje ose vuajtje e tillë shkaktohet nga ose me iniciativën ose miratimin ose dijeninë e një zyrtari publik ose të një personi që ka kompetenca zyrtare. Ky term nuk përfshin dhimbjen ose vuajtjen që lind nga sanksionet ligjore.” *Neni 1 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimi ose Ndëshkimit Mizor, Johuman ose Degradues (UNCAT), 1984*

“Për qëllimet e kësaj Konvente, tortura duhet të kuptohet si një akt i qëllimshëm që shkakton dhimbje ose vuajtje, fizike ose mendore, ndaj një personi, për qëllimet e një hetimi penal, si mjet friksimi, ndëshkimi individual, si masë parandaluese, si dënim ose për çdo qëllim tjetër. Torturë është edhe përdorimi i metodave që kanë si qëllim të zhdukin personalitetin e viktimës ose të ulin aftësitë e tij fizike ose mendore, edhe në qoftë se ato nuk shkaktojnë dhimbje fizike ose mendore.

Koncepti i torturës nuk duhet të përfshijë dhimbjen ose vuajtjen, mendore ose fizike, që është e qënësishme ose vetëm pasojë e masave ligjore, me kusht që këto masa të mos përfshijnë kryerjen e akteve ose përdorimin e metodave të cilave i referohemi në këtë nen.” *Neni 2, ICPRT.*

“Çdo Shtet Anëtar duhet të ndërmarrë veprime për parandalimin brenda territorit nën juridiksionin e tij, të akteve të tjera të trajtimit ose ndëshkimit mizor, johuman ose degradues të cilat nuk arrijnë në nivelin e torturës sipas përcaktimit në nenin 1, kur akte të tillë kryen nga ose me iniciativën, miratimin ose dijeninë e një zyrtari publik ose personi që ka kompetenca zyrtare. (...)” *Neni 16 UNCAT*

“Ndëshkimet trupore, ndëshkimet që konsistojnë në futjen e personit në një qeli të errët dhe çdo ndëshkim tjetër mizor, johuman ose degradues duhet të jenë plotësisht të ndaluara si dëshkime për shkelje disiplinore.” *SMR, Rregulli 31*

### **Të rinjtë**

“Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që

a) Asnjë fëmijë të mos jetë subjekt i torturës ose trajtimit apo ndëshkimit mizor, johuman ose degradues (...)” *Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës Neni 37*

### **Komente**

Të burgosurit janë më të rrezikuar nga tortura gjatë fazave të para të burgimit të tyre, vecanërisht gjatë marrjes në pyetje dhe hetimit. Edhe nëse mandati i një organi vizitues të vecantë nuk përfshin policinë ose arrestin paragyqësor, ata duhet të takohen dhe të flasën me të burgosurit të cilët kanë ardhur rishtaz nga një arrest i tillë dhe të vëzhgojnë nëse ata kanë pasur mundësinë të dokumentojnë shqetësimet dhe gjëndjen e tyre fizike dhe i kanë bërë ato objekt të ankimit zyrtar, kur ka qenë e nevojshme.

Tortura është një nga fushat më të vështira për të përballura nga vizitorët, e cila kërkon protokolle të kujdesshme, përgatitje dhe trajnim. Intervistimi i personave që janë torturuar është një detyrë jashtëzakonisht delikate.

Tortura mund të jetë e vështirë për tu provuar, vecanërisht kur ka kaluar kohë. Vizitorët duhet të sigurohen që të jenë informuar mirë mbi praktikat vëndase, përfshirë këtu mënyrat për mbulimin e shkeljeve dhe metodat përgjithësisht të zbuluara. Ata duhet gjithashtu të jenë të informuar mbi masat administrative që aplikohen në vend për parandalimin e torturës.

Vizitorët duhet të kenë parasysh se ato që do vijojnë, janë konsideruar në nivelin e torturës ose trajtimit mizor, johuman ose degradues nga jurisprudencë e organeve ndërkombëtare:

- Kushtet e burgimit, të vetme ose të kombinuara me elemente të tjera
- Izolimi (Shiko në këtë Kapitull seksionin “Izolimi”)
- Mohimi i trajtimit të përshtatshëm mjekësor
- Privimi ndijor

### **Ndalimi absolut i torturës**

Tortura është absolutisht e ndaluar sipas ligjit ndërkombëtar dhe nuk mund të justifikohet në asnjë rrethanë. Mbrojtja ndaj torturës është një e drejtë e patjetërsueshme, ndaj të cilës nuk lejohet asnjë devijim pavarësisht arsyes, qoftë kjo emergjenca publike, siguria e shtetit ose ndonjë gjë tjetër. Tortura dhe keqtrajtimi janë gjithashtu të ndaluara nga ligji ndërkombëtar zakonor.

### **Format e torturës dhe keqtrajtimit**

Përkufizimi i torturës sipas CAT përmban tre elemente thelbësore:

- Shkaktimin e dhimbjes ose vuajtjes së rëndë mendore ose fizike

- Kryet me miratimin ose dijeninë e autoriteteve shtetërore
- Kryet për një qëllim specifik, si për shembull, për të marr informacion, për të ndëshkuar ose për të frikësuar.

Tortura mund të jetë si mendore ashtu edhe fizike dhe mund të marr formë të ndryshme si për shembull: goditjet elektrike, goditjet në shputën e këmbës, varja pezull në pozicione të dhimbshme, rrahja, përdhunimi, asfiksioni, djegia me cigare, privimi nga ushqimi, gjumi dhe komunikimi, friksioni, tallja, ekzekutimi...

Abuzimi seksual është një metodë e paaftësisë fizike dhe psikologjike.

Grupet vizituese duhet të jenë të ndërgjegjshme për faktin se ekzistojnë praktika që nuk përfshihen në përkufizimin klasik të torturës, të cilat janë të vështira për tu evidentuar dhe me kalimin e kohës mund të shkatërrojnë balancën psikologjike të personave të privuar nga liria e tyre. Këto praktika janë edhe më të dëmshmet pasi viktimat e burgosura mund të jenë mësuar aq shumë me to sa nuk janë në pozitën të identifikojnë dhe të raportojnë në një mënyrë të qartë. Faktet mund të përçohen nëpërmjet një deklaratë të përgjithshme, Më poshtë gjenden disa shembuj të këtyre praktikave:

- Injorimi sistematik i një kërkesë deri sa ajo të përsëritet disa herë;
- Të folurit me personat e privuar nga liria e tyre, sikur ata të ishin fëmijë të vegjël;
- Të mos parit kurrë në sy;
- Hyrja në qelitë e të burgosurve papritmas dhe pa arsye;
- Krijimi i një klime dyshimi midis të burgosurve;
- Autorizimi i të burgosurve për të shmangur rregulloren sot dhe ndëshkimi i tyre të nesërmen, etj.

### **Dhuna ndërmjet të burgosurve**

Vizitorët duhet të kenë parasysh se detyra e stafit për tu kujdesur për të burgosurit përfshin përgjegjësinë e tyre për të mbrojtur të burgosurit nga njëri tjetri. Aktet e dhunës të kryera nga të burgosurit nuk duhet të injorohen – për shembull: gjuajtja dhe plagosja, përdhunimi dhe sjelljet e tjera sadiste. Kjo lloj dhune shpesh nuk raportohet nga viktimat nga frika e ndëshkimit. Ajo mund të tolerohet nga stafi i cili e konsideron se kjo është puna e vet të burgosurve dhe për rrjedhojë preferon të merret me dicka tjetër sesa të bëjë armiq midis atyre të burgosurve që janë më të prirurit për të shkaktuar probleme.

Vizitorët duhet të krijojnë një atmosferë dhe kushte të tillë, në të cilat të burgosurit më të dobët të ndiejnë se mund të afrohen atyre për shqetësimet që kanë.

Vizitorët duhet të jenë të ndërgjegjshëm për mundësitë që ka stafi për të kufizuar dhunën ndërmjet të burgosurve dhe të monitorojnë se deri në çfarë mase këto mundësi përdoren:

- Ndarja e kategorive të ndryshme të të burgosurve;
- Zgjedhja e kujdeseshme e të burgosurve që ndajnë të njëjtat qeli;
- Një sistemi ankimi konfidencial dhe me lehtësi akses;
- Numër i mjaftueshëm personeli të trajnuar;
- Shmangia e përdorimit të të burgosurve në role kontrolli dhe disiplinimi;
- Politika të qarta dhe të mirë publikuara “kundër ngacmimeve”.

### **Trajtimi i pretendimeve për torturë**

Gjatë intervistave private, anëtarët e organit vizitues mund të marrin pretendime për torturë. Ato mund të referohen trajtimeve të pësura përpara mbërritjes në vendin aktual të burgimit. Siç është e kuptueshme, të burgosurit që ndodhen në vendin ku po ndodh ose ka ndodhur tortura, janë më pak të prirur të ngrijnë pretendimet e tyre nga frika e ndëshkimit. Pretendimet i referohen incidenteve individuale si abuzimi nga një roje, ose një ngjarje specifike si ajo e një trazire ose ndëshkimi disiplinor. Vizitori duhet të mos harrojë që kushtet e përgjithshme në institucion mund të përbëjnë në vetvete torturë.

Një person që ka qenë subjekt i torturës ose keqtrajtimit, e ka zakonisht të vështirë të flasi për këtë eksperiencë ekstremisht poshtëruese. Mbledhja e informacionit rreth keqtrajtimit është një detyrë

veçanërisht delikate për vizitorët. Vizitorët duhet të kenë trajnim të veçantë për trajtimin e pretendimeve për torturë, në mënyrë që të kuptojnë sesa larg mund të shkojnë me pyetjet e tyre ose kur është e nevojshme ndërhyrja e një specialisti. Është veçanërisht e vështirë të vendoset një balancë ndërmjet marrjes së informacionit të nevojshëm për të kërkuar korrigjimin e situatës dhe shmangies së ritraumatizimit të mundshëm.

**Për mbrojtjen e të burgosurve, është thelbësore që të pyesësh në qoftë se dhe sesi mund të përdorësh pretendimin e ngritur (nëse mund të përmendësh të dhëna personale, nëse duhet të përdorësh informacionin vetëm në një mënyrë të përgjithshme ose të mos e përdorësh fare atë).**

Është e rëndësishme për personelin mjekësor të jetë në gjëndje të dokumentojë pretendimet sa më shpejtë të jetë e mundur nëpërmjet një ekzaminimi mjekësor i cili të evidentojë si shënjat fizike ashtu dhe ato psikologjike.

Për një informacion më të detajuar rreth intervistimit të viktimave të torturës si dhe rreth mbledhjes së të dhënave mjekësore, shiko:

- Camille Giffard, *Manuali për Raportimin e Torturës – Si të dokumentosh dhe të reagosh ndaj pretendimeve për torturë brenda sistemit ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut*, Qendra e të Drejtave të Njeriut, Universiteti i Essex, Mbretëria e Bashkuar, 2000. Pjesa II – Dokumentimi i pretendimeve, f. 29 deri 51;
- Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Seri për Trajnim Profesional nr. 8; *Protokolli i Stambollit, Manual për hetimin efektiv dhe dokumentimin e torturës dhe trajtimin apo ndëshkimit mizor, johuman ose degradues*, New York, Gjenevë, 2001. Kapitulli-Konsiderata të përgjithshme për intervistat.

Nuk është roli i vizitorit të vendosi nëse trajtimi i pretenduar përbënë torturë. Pretendimet për torturë ose keqtrajtim duhet ti transmetohen autoriteteve përgjegjëse për hetimin (administrativ ose penal), duke marr masat e sipërpërmendura në lidhje me prezantimet që bëhen në emër të individëve dhe duke ndjekur një procedurë e cila të mos vërë në rrezik personin që ka lidhje me pretendimin. Barra e provës, e cila është përgjegjësia për të provuar nëse pretendimi është i vërtetë apo jo nëpërmjet një hetimi të përshtatshëm, i përket autoriteteve përgjegjëse dhe jo viktimës së pretenduar.

**Informacioni që vizitorët mund të mbledhin në rastet e pretendimeve për keqtrajtim është:**

- Identiteti i plotë i personit;
- Datën kur dhe vendin ku pretendimi është ngritur;
- Autoritetet e burgimit ;
- Datën dhe vendin e keqtrajtimit;
- Autoritetet përgjegjëse për keqtrajtimin;
- Rrethanat e keqtrajtimit;
- Dëshmitarët e akti;
- Përshkrim i detajuar i keqtrajtimit (çfarë, si, për sa kohë, sa shpesh, nga kush), efektin e menjëhershëm dhe të mëvonshëm që pati keqtrajtimi ndaj të burgosurit, ndonjë shënjë të dukshme;
- Certifikata mjekësore dhe ndonjë provë tjetër si fotografi.

**Në qoftë se grupi vizitues përfshin personelin mjekësor ata mund të dokumentojnë:**

- Shënjat fizike;
- Shënjat psikologjike;
- Nevojën për trajtim mjekësor.

**Veprimet pasuese që u ndërmorrën ose që do ndërmerren:**

- Kush është informuar mbi pretendimin dhe çfarë rezultati ka sjellë?
- Është e mundur të bëhet një ankim administrativ ose penal?



- A e ka autorizuar personi transmetimin e pretendimit të tij?
- A ka pasur ndonjë reagim zyrtar ndaj incidentit (përfshirë mos reagimin ose reagimin ekuivalent me mosreagimin)?
- Kur ka pasur një ankim, cilat kanë qenë pasojat (për autorin, për viktimën)?
- Vërejtjet personale të vizitorëve

## **Izolimi**

### **Standartet**

“Përpjekjet për mosaplikimin e izolimit si ndëshkim, ose kufizimi e përdorimit të tij duhet të ndërmerren dhe të inkurajohen.” *Parimi 7, BPTP*

“Izolimi i zgjatur i të paraburgosurve ose të burgosurve mund të përbëjë torturë”, *GC nr. 20/44 në nenin 7 ICCPR*

“CPT i kushton vëmendje të vecantë të burgosurve që mbahen për çfarëdo lloj arsye (për qëllime disiplinore, për shkak të rrezikshmërisë së tyre ose sjelljes së tyre problematike, se është në interes të hetimit penal, me kërkesën e tyre) në kushtet e izolimit.

Parimi i proporcionalitetit kërkon një balancë ndërmjet kërkesave të çështjes dhe aplikimit të regjimit të izolimit, i cili është një hap që mund të ketë pasoja shumë të dëmshme për personin e prekur. Izolimi në disa raste mund të përbëjë trajtim jo human dhe degradues; në çdo rast të gjitha format e izolimit duhet të jenë sa më të shkurtra të jetë e mundur.

Në rastin e një regjimi të tillë i cili është imponuar ose kërkuar, një masë themelore mbrojtëse është që kurdoherë që një burgosur ose një nëpunës i burgut që vepron për llogari të të burgosurit, kërkon një mjek, ky i fundit duhet të thërritet pa vonesë në mënyrë që të bëjë një ekzaminim mjekësor të të burgosurit. Rezultati i një ekzaminimi të tillë, përfshirë vlerësimin e gjëndjes fizike dhe mendore të të burgosurit si dhe të pasojave të parashikueshme të izolimit të vazhduar, duhet të bëhet i ditur në formën e një deklarate të shkruar e cila i përcillet autoriteteve kompetente.” *CPT, GR2, § 56*

Shiko gjithashtu *IDRCPDL, neni 48*.

### **Komente**

Grupi vizitues duhet ti kushtojë vëmendje të vecantë mbajtjes së të burgosurve, për çfarë do lloj arsye, në regjimin e izolimit (asnjë kontakt me të burgosurit e tjerë, kontakt i kufizuar ose i ndaluar me botën e jashtme).

Vendosja e një qenieje njerëzore në izolim është një sanksion serioz i cili në qoftë se aplikohet për një kohë të zgjatur ose në mënyrë të përsëritur mund të përbëjë trajtim johuman ose degradues ose madje torturë. Ai mund ta bëjë të burgosurin më vulnerabël ndaj një trajtimi të tillë. Për rrjedhojë, izolimi duhet të jetë masë përjashtimore dhe me kohëzgjatje të kufizuar; ajo duhet të jetë sa më e shkurtër të jetë e mundur. Izolimi duhet të shoqërohet me një sër garancish, si sistemet për rishikim dhe ankim. Grupet vizituese mund të përfshihen në kontrollimin e shtrirjes që kanë këto sisteme në sigurimin e mbrojtjes së përshtatshme për të burgosurit.

Izolimi ndonjëherë mund të jetë e nevojshme të përdoret si masë mbrojtëse. Në këtë rast, regjimi i të burgosurit duhet të jetë më pak kufizues se ai që aplikohet për një të burgosur i cili është vendosur në izolim si ndëshkim disiplinore. Çdo sistem rishikimi duhet të veprojë edhe për këta të burgosur.

Të rinjtë nuk duhet të mbahen asnjëherë në izolim.

### **Izolimi nuk duhet:**

- Të jetë pa afat
- Të jetë i zgjatur
- Të jetë i përsëritur

### **Pikat e referimit**

- Cila është kohëzgjatja maksimale e lejueshme për izolimin?

- Në çfarë date është vendosur izolimi?
- Kush vendos për aplikimin e izolimit?
- Për çfarë arsyes mund të aplikohet izolimi?
- Çfarë sistemesh rishikimi dhe ankimi ekzistojnë në vendin konkret?
- A i lejohet personit në izolim të kryejë të paktën 1 orë në ditë, çdo ditë, ushtrime përjashta?
- Çfarë regjimi aplikohet për personat në izolim?
- A kryhet ndonjë ekzaminim mjekësor përpara izolimit dhe a fokusohet ky ekzaminim mbi mirëqënien e të burgosurit?
- Sa shpesh kryhet një ekzaminim i tillë gjatë izolimit?
- A ka i burgosuri në izolim akses tek një doctor sa herë që e kërkon?
- Kush ka akses tek i burgosuri i izoluar dhe si regjistrohet një gjë e tillë?
- A ka ndonjë provë se izolimi po aplikohet në mënyrë disproporcionale ndaj ndonjë pakice?

## Mjetet kufizuese

### Standartet

“Mjetet kufizuese si prangat, zinxhirët dhe këmishat e forcës, nuk duhet kurrë të aplikohen si ndëshkim. Për më tepër, zinxhirët ose hekurat nuk duhet të përdoren si mjete kufizimi. Mjetet e tjera kufizuese nuk duhet të përdoren përveç se në kushtet e më poshtme:

(a) si masë paraprake kundër arratisjes gjatë transferimit, me kusht që ato të hiqen kur i burgosuri të dali përpara një autoriteti gjyqësor ose administrative;

(b) për arsye mjekësore nën urdhrin e një mjeku;

(c) me urdhër të drejtorit, në qoftë se metodat e tjera të kontrollit dështojnë, në mënyrë që të parandalohet që i burgosuri të dëmtojë veten ose të tjerët ose të dëmtojë pronën; në kushte të tillë drejtori duhet të njoftojë menjëherë mjekun dhe të raportojë tek autoriteti më i lartë administrativ.”  
*SMR, Rregulli 33*

“Mënyrat e përdorimit të instrumentave kufizuese duhet të vendosen nga administrata qendrore e burgut. Këto instrumenta nuk duhet të aplikohen për një kohë më të gjatë sesa është e nevojshme.”  
*SMR Rregulli 34*

“Mënyrat e përdorimit të instrumentave kufizuese të autorizuara sipas paragrafit më sipër duhet të vendosen me ligj ose rregullore. Këto instrumenta nuk duhet të aplikohen për një kohë më të gjatë sesa është e nevojshme.” *SMR Rregulli 40*

“Në ato raste të rralla kur është e nevojshme aplikimi i instrumentave të kufizimit fizik, i burgosuri duhet të mbahet nën mbikëqyrje konstante dhe të përshtatshme. Për më tepër, instrumentat kufizuese duhet të hiqen në rastin më të parë të mundshëm; ato nuk duhet të aplikohen asnjëherë ose aplikimi i tyre të zgjatet, si një ndëshkim. Si përfundim, duhet të regjistrohet çdo përdorim force kundër të burgosurve.” *CPT, GR 2, §53*

Shiko gjithashtu *ACPR, A-5; IDRCPL, neni 46 dhe EPR, Rregulli 39.*

### Të rinjtë

“Përdorimi i instrumentave kufizues dhe forcës për çfarë do lloj arsye duhet të jetë e ndaluar, me përjashtim të rasteve të parashikuara në rregullin 64 më poshtë.” *RPJDL, 63*

“Instrumentat kufizuese dhe forca mund të përdoren vetëm në raste përjashtimore, kur çdo metodë tjetër kontrolli është ezauruar dhe ka dështuar dhe vetëm sic është autorizuar dhe specifikuar saktësisht nga ligji dhe rregullorja. Ato nuk duhet të shkaktojnë poshtërim ose degradim dhe duhet të përdoren në mënyrë të kufizuar dhe për një kohë sa më të shkurtër të mundshme. Këto instrumenta mund të përdoren me urdhër të drejtorit të administratës, për të parandaluar të rinjtë të dëmtojnë vetveten, të tjerët ose ti shkaktojnë prishje serioze të pronës. Në raste të tillë drejtori duhet të njoftojë mjekun dhe personelin përkatës dhe të raportojë tek autoriteti më i lartë administrativ.” *RPJDL, 64*

## Komente

Disa mjete kufizuese janë absolutisht të ndaluara.

Të gjitha mjetet kufizuese të lejuara duhet të përdoren vetëm në raste përjashtimore. Ato nuk duhet të përdoren asnjëherë si ndëshkime disiplinore. Për më tepër, ato duhet të shoqërohen nga një sërë garancishë:

- Të burgosurit duhet të jenë të kufizuar për periudhën më të shkurtër të nevojshme;
- Përdorimi i mjeteve kufizuese ose forcës duhet të regjistrohet në një regjistër;
- Drejtori duhet të informohet menjëherë.

Roli i mjekut në përdorimin e mjeteve shtrënguese është vecanërisht delikat. SMR-ja dhe rregullat e tjera parashikojnë se doktori mund të japi këshillat e tij për aplikimin e disa masave për arsye mjekësore. Sic është bërë e qartë nga komentet e CPT-së, në rastet e përdorimit të kufizimeve i burgosuri ka të drejtën të ekzaminohet menjëherë nga një mjek. Kjo nuk duhet të interpretohet në asnjë rrethanë se i kërkohet mjekut të vërtetojë "përshtatshmërinë për ndëshkim". Një rol i tillë për një mjek është i ndaluar nga standartet ndërkombëtare dhe është në kundërshtim me etikën profesionale të mjekut (shiko gjithashtu seksionin: Shërbimet Mjekësore)

Do të jetë e papërputhshme me rolin e grupit vizitues në sigurimin e respektimit të dinjitetit njerëzor në vendin e burgimit, në qoftëse ai kryen intervista ndërkohë që të burgosurit janë nën masa kufizuese.

## Pika referimi

- Në cilat raste është i autorizuar përdorimi i mjeteve kufizuese?
- Sa shesh përdoren?
- A regjistrohen të gjitha rastet në regjistër?
- A kanë akses tek një doktor, personat e trajtuar në këtë mënyrë?
- Për sa kohë aplikohen mjetet kufizuese?
- A ka të dhëna se mjetet kufizuese përdoren në mënyrë joproportionale ndaj pakicave?

## Përdorimi i forcës

### Standartet

"1. Nëpunësit e institucionit nuk duhet të përdorin forcën në marrëdhënie me të burgosurit, për vec se për vetë mbrojtje ose kur tentohet arratisja ose në rastet e rezistencës fizike aktive ose passive ndaj nju urdhri të bazuar në ligj ose rregullore.

Nëpunësit që përdorin forcën nuk duhet ta përdorin atë më shumë se sec nevojitet dhe duhet të raportojnë menjëherë tek drejtorit ose institucioni.

1 Nëpunësit e burgut duhet të kenë trajnim të vecantë fizik në mënyrë që ata të jenë në gjendje të kontrollojnë të burgosurit agresiv.

2 Përveç se në rrethana të vecanta, stafi që merret drejtë përdrejtë me të burgosurit nuk duhet të jetë i armatosur. Për më tepër, stafi nuk duhet në asnjë rrethanë, të jetë i pajisur me armë në qoftë se nuk është trajnuar për përdorimin e tyre. (...)" *SMR, Rregulli 54 (shiko gjithashtu EPR Rregulli 63)*

"Nëpunësit e zbatimit të ligjit mund të përdorin forcën vetëm kur është e domosdoshme dhe në masën e kërkuar për përmbushjen e detyrave të tyre." *Kodi i sjelljes për nëpunësit e zbatimit të ligjit, Neni 3*

"Nëpunësit e zbatimit të ligjit nuk duhet të përdorin armë zjarri kundër personave për vec se për vetmbrojtje ose mbrojtjen e të tjerëve nga një kërcënim eminent për vdekje ose plagosje të rëndë, për të parandaluar kryerjen e një krimi serioz që rrezikon jetën, për të arrestuar një person që përbënë rrezik dhe që i bënë rezistencë autoritetit, ose për të ndaluar arratisjen e tij dhe vetëm kur mjetet më pak ekstreme nuk janë të mjaftueshme për të arritur këto objektiva. Në çdo rast, përdorimi qëllimisht vjekjeprurës i forcës mund të lejohet vetëm kur është e domosdoshme për të mbrojtur jetën". *Parimet Bazë të Kombeve të Bashkuara për Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Nëpunësit e Zbatimit të Ligjit, Parimi 9*

“Nëpunësit e zbatimit të ligjit, në marrëdhënien e tyre me personat nën mbikëqyrje ose burgim, nuk duhet të përdorin forcën përveç se kur është e domosdoshme për të mbajtur sigurinë dhe rendin Brenda institucionit ose kur siguria personale është në rrezik.” *Parimet Bazë të Kombeve të Bashkuara për Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Nëpunësit e Zbatimit të Ligjit, Parimi 15*

“Nëpunësit e zbatimit të ligjit, në marrëdhënien e tyre me personat nën arrest ose burgim, nuk duhet të përdorin armë zjarri përveç se për vetë mbrojtje ose mbrojtjen e të tjerëve ndaj një rreziku të menjëhershëm për vdekje ose plagosje të rëndë, ose kur është domosdoshmërisht e nevojshme për të parandaluar arratisjen e një personi nën arrest ose burgim i cili shfaq rreziqet e përmendura në parimin 9”, *Përdorimi i Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Nëpunësit e Zbatimit të Ligjit, Parimi 16*

“Personelit të burgut mund t’i duhet, me raste, të përdori forcën për të kontrolluar të burgosurit e dhunshëm dhe përjashtimisht mund edhe të ketë nevojë të përdori mjete të shtrëngimit fizik. Këto janë qartësisht situata me rrezik të lartë dhe duke qenë se të burgosurit mund të keqtrajtohen, ka nevojë për masa mbrojtëse të vecanta.

Një i burgosur ndaj të cilit është përdorur çfarëdo lloj force duhet të ketë të drejtën të ekzaminohet menjëherë dhe në qoftë se është e nevojshme, të trajtohet nga një mjek. Ky ekzaminim duhet të kryhet largë veshëve dhe në mënyrë të preferueshme edhe larg syve të stafit jo mjekësor, dhe rezultatet e ekzaminimit (përfshirë çdo deklaratë të bërë nga i burgosuri dhe konkluzionet e doktorit) duhet të regjistrohen formalisht dhe të jenë të disponueshme për të burgosurin. (...). Si përfundim, duhet të regjistrohet çdo rast i përdorimit të forcës ndaj të burgosurve.” *CPT, GR 2, §53*

#### **Të rinjtë**

“Mbajtja dhe përdorimi i armëve nga personeli në ambientet e burgimit të të rinjve, duhet të jetë e ndaluar” *RPJDL, 65*

#### **Komente**

Grupi vizitues duhet të ekzaminojë nëse përdorimi i forcës është një reagim përjashtimor apo është një rregull.

Ata duhet të konsiderojnë nëse parimi i nevojshmërisë dhe proporcionalitetit zbatohet apo jo.

Ata duhet të shohin nëse instruksionet dhe kufizimet e përdorimit të forcës janë përfshirë në rregulloret e burgut dhe janë të aksesueshme për të burgosurit dhe ëfarë trajnimi u bëhet stafit për teknikat e kontrollit dhe kufizimit në mënyrë që ata të mund të mbajnë kontrollin pa dëmtuar veten ose të burgosurit.

Si parim i përgjithshëm, staf i që është në kontakt të drejtëpërdrejtë me të burgosurit nuk duhet të mbaj armë zjarri. Në qoftë se ata mbajnë armë si shkop gome, kjo nuk duhet të bëhet me mburrje dhe në një mënyrë provokuese.

Çdo incident që përfshin përdorimin e forcës ose të armëve të zjarrit duhet ti raportohet me shkrim drejtorit, të regjistrohet në një regjistër zyrtar dhe të hetohet.

#### **Pika referimi**

- A mban staf i armë?
- Cilët prej stafit lejohen të mbajnë armë zjarri, sipas rregulloreve lokale?
- Sa shpesh incidentet përfshijnë përdorimin e forcës (sipas të burgosurve, drejtorit, regjistrat dhe burimeve të tjera)?
- A ka ndonjë të dhënë mbi përdorimin e forcës në mënyrë joproporcionale në lidhje me pakicat?

#### **Për lexim të mëtejshëm**

Amnesty International, *Të luftosh torturën: një manual për veprim*, Londër, 2003. (Kapitulli 5.5: Kushtet e burgimit; Disiplina dhe siguria f. 127-132

Camille Giffard, *Manual për Raportimin e Torturës, Si të dokumentosh dhe të reagosh ndaj pretendimeve për torturë brenda sistemit ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut*, Qendra për të Drejtat e Njeriut, Universiteti i Essex, Mbretëria e Bashkuar, 2000.

Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, *Seri për Trajnim Profesional nr. 8, Protokollit i Stambollit, Manual për hetimin efektiv dhe dokumentimin e torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit mizor, johuman ose degradues*, Neë York, Gjenevë, 2001.

Penal Reform International, *Si ti bësh standartet të funksionojnë, një manual ndërkombëtar mbi praktikën e mira në burg*. Londër, 2001, f.42-51.

Andreë Coyle, *Afrimi i të drejtave të njeriut me administrimin e burgut. Manual për stafin e burgut*. Qendra Ndërkombëtare për studimin e burgjeve, 2003, f. 69-81.

UN OHCHR, *HTë drejtat e njeriut dhe burgjet – Një manual mbi trajnimin e nëpunësve të burgut rreth të drejtave të njeriut.*, Gjenevë, 2003. (Seksioni 2: e drejta e integritetit fizik dhe moral, f. 2133)

## 2. MASAT MBROJTËSE

Qëllimi i këtij seksioni është të ekzaminojë llojet e ndryshme të masave që mbrojnë të drejtat dhe dinjitetin e të burgosurve ndërkohë që bëjnë të mundur që sistemet penale të funksionojnë qetësisht. Pra, ndërkohë që është thelbësore që të ruhet rendi në burg, disiplina mund të vendoset vetëm në bazë të rregullave dhe procedurave të qarta dhe të përcaktuara. Sanksionet disiplinore duhet të shoqërohen me garanci dhe duhet t'u sigurohet të burgosurve mundësia për t'u ankuar në mënyrë të thjeshtë dhe efektive dhe pa rrezikun e ndëshkimit, tek autoritet brënda dhe jashtë insitucionit. Mekanizmat e pavarur të inspektimit luajnë gjithashtu një rol në monitorimin e respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria e tyre.

Së fundmi, ka dhe masa të tjera që ndihmojnë të garantohet që insitucioni të drejtohet në një mënyrë jo-arbitrarë dhe/ ose që të monitorohet mënyra sesi ai drejtohet, për shembull: veçimi i kategorive të ndryshme të të burgosurve, mbajtja e regjistrave, dhe informimi i njerëzve rreth mënyrës sesi insitucioni funksionon.

### Masat mbrojtëse:

- Regjistrat;
- Informimi i personave të privuar nga liria ;
- Inspektimi;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat ankimore;
- Veçimi i kategorive të të burgosurve.

### Regjistrat e burgimit

#### Standartet

“1. Duhet të regjistrohen:

- (a) Arsyet e arrestit;
- (b) Koha e arrestit dhe e transportimit të personit të arrestuar tek vendi i burgimit si dhe e paraqitjes së tij përpara një autoriteti gjyqësor ose autoriteti tjetër;
- (c) Identiteti i nëpunësit të zbatimit të ligjit të përfshirë në rastin konkret;
- (d) Informacioni i saktë rreth vendit të burgimit.

2. Këto të dhëna duhet ti komunikohen të burgosurit ose avokatit të tij në qoftë se ka një tillë, në formën e kërkuar nga ligji.” *BPP, Parimi 12*

“1. Në çdo vënd ku ka persona të burgosur duhet të mbahet një regjistër me faqe të numëruara në të cilin të mbahet informacioni i mëposhtëm për çdo të burgosur:

- (a) Informacion mbi identitetin e tij;
- (b) Arsyet e burgimit dhe autoritetin përkatës që e ka urdhëruar atë ;
- (c) Ditën dhe orën e futjes dhe lirimit të tij nga burgu.

2. Asnjë person nuk duhet të futet në një institucion pa një urdhër të vlefshëm burgimi, të dhënat e të cilit duhet të jenë hedhur paraprakisht në regjistër.” *SMR, Rregulli 7*

“1. Asnjë person nuk duhet të futet në një institucion pa një urdhër të vlefshëm burgimi.

2. Të dhënat thelbësore të burgimit duhet të regjistrohen menjëherë.” *EPR, Rregulli 7*

“Për të garantuar mbrojtjen efektive të personave të burgosur, duhet të parashikohet që të burgosurit të mbahen në vende zyrtarisht të njohura si vende burgimi, dhe emrat e tyre dhe të vendeve të burgimit së bashku me emrat e personave përgjegjës për burgimin e tyre, të mbahen në një regjistër i cili të jetë i disponueshëm dhe i aksesueshëm nga personat e interesuar, përfshirë familjarët dhe shokët.” *GC 20, para. 11.*

Shtetet duhet

“Të sigurojnë që të dhënë gjithëpërfshirëse të personave të privuar nga liria e tyre të mbahen të shkruara në çdo vend burgimi, në mënyrë që të jepen detaje mbi datën, orën, vendin dhe arsyet e çdo burgimi.” *RIG, dispozita 30*

Shiko gjithashtu *IDRCPDL, neni 18.*

### **Komente**

Regjistrimi zyrtar është një masë thelbësore mbrojtëse. Ajo është gjithashtu një element i rëndësishëm për garantimin e transparencës së autoriteteve dhe mbrojtjes së të burgosurve.

Regjistrat që janë me interes të veçantë për grupet vizituese janë ato që mbajnë të dhëna për lëvizjen e të burgosurve brenda dhe jashtë vendeve të burgimit; përdorimin e forcës dhe masave disiplinore.

Duhet të regjistrohen të dhënat si më poshtë:

- Identiteti i personit të burgosur;
- Arsyet ligjore të heqjes së lirisë;
- Koha e arrestit;
- Koha kur personi i arrestuar ka mbërritur në vendin e burgimit;
- Koha kur është nxjerrë (për shembull, në kuadër të hetimit ose gjatë seancës gjyqësore ) dhe është kthyer në vendin e burgimit;
- Gjëndja fizike e të burgosurit në nisje dhe mbërritje;
- Koha kur ai/ajo u paraqit për herë të parë përpara një autoriteti gjyqësor ose autoriteti tjetër;
- Identiteti i personave përgjegjës për aplikimin e ligjeve përkatëse;
- Informacioni i saktë mbi vendin e burgimit ku mbahet personi (lokalizimi i shpejtë i të gjithë personave të privuar nga liria e tyre duhet të jetë i mundshëm).

Duhet të ketë një regjistër ku të regjistrohen sistematikisht incidentet (përdorimi i forcës, masat disiplinore,...).

Në disa kontekste një nga objektivat e qarta të një programi vizitash është mbrojtja nga zhdukja. Në këto raste ndjekja e informacionit nëpër regjistra është thelbësore. Për këtë, ajo që do të pasojë vizitën është verifikimi i informacionit mbi transferimet në vende të tjera burgimi ose lirimet. Ky verifikim mund të ndodh gjatë vizitave pasuese në vende të tjera burgimi ose nëpërmjet kontaktit me familjarët e të burgosurve ose të liruarve.

### **Disa pika referimi**

- A regjistrohen hyrjet dhe daljet në mënyrë rigorozë?
- A shënohen të gjitha incidentet e rëndësishme në një regjistër?
- Si përdoret informacioni i shënuar në regjistra?

A ka një regjistër ku shënohen datat kur të burgosurit duhet të lirohen?

## **Informimi i të burgosurve**

### **Standarte**

“Çdo person duhet që në momentin e arrestit dhe në fillimin e paraburgimit ose burgimit, t’i sigurohet nga autoritetit përgjegjës për arrestimin, paraburgimin ose burgimin e tij, informacion dhe një shpjegim mbi të drejtat e tij dhe mënyrën se si mund t’i përdorë ato.” *BPP; Parimi 13*

“1. Çdo i burgosur kur hyn në burg duhet t’i sigurohet informacion i shkruar mbi rregulloren që zbatohet për trajtimin e të burgosurve të kategorisë së tij, kërkesat disiplinore të institucionit, metodat e autorizuara për të kërkuar informacion dhe mënyrën e ankimit, dhe çdo çështje tjetër që është e nevojshme për të mundësuar që ai të kuptojë si të drejtat ashtu dhe detyrimet e tij dhe të përshtasi veten me jetën në institucion,

2. Në qoftë se një i burgosur është analfabet, informacioni i sipërpërmendur duhet t’i sigurohet gojarisht.” *SRM, Rregulli 35;*

“Shteti duhet të sigurojë që të gjithë personat e burgosur të informohen menjëherë mbi arsyet e burgimit të tyre” *RIG, dispozita 25*

Shiko gjithashtu *ACPR, A-9 and IDRCPLD, neni 53.*

### **Komente**

Grupi vizitues duhet të ekzaminojë se sa informohen të burgosurit mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre; përshtatshmërinë e metodave të transmetimit të këtij informacioni; dhe sesa e kuptojnë dhe sa akses kanë të burgosurit për këtë informacion.

Të burgosurit mund të jenë konfuz dhe vulnerabël kur ata mbërrijnë për herë të parë në vendin e burgimit. Në mënyrën e transmetimit të informacionit duhet të merret parasysh kjo gjë.

Mekanizmat vizitues duhet të kontrollojnë nëse familjarët e të burgosurve kanë akses tek informacioni mbi funksionimin e institucionit, në vecantë për sa i përket vizitave, korrespondencës, dhe kontaktit telefonik.

### **Pika referimi**

- Çfarë informacioni marrin personat e privuar nga liria, në momentin kur mbërrijnë në vendin e burgimit?
- Në çfarë forme e marrin këtë informacion?
- A është gjuha që përdoret e kuptueshme (dhe në rastet e shtetasve të huaj, a ka ndonjë dispozitë të vecantë që të sigurojë informimin e tyre?) dhe a merren në konsideratë rastet e analfabetizmit?
- A janë rregulloret e brendshme publike dhe të lehta për tu konsultuar?
- A i përgjigjet përmbajtja e tyre frymës së standarteteve për trajtimin e personave të privuar nga liria e tyre?
- A janë ato të formuluar në mënyrë të qartë?

## **INSPEKTIMI**

### **Standartet**

“1. Në mënyrë që të mbikëqyri zbatimin e përpiktë të ligjeve dhe rregulloreve përkatëse, vendet e burgimit duhet të vizitohen rregullisht nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë, të caktuar nga autoriteti kompetent i ndryshëm nga autoriteti drejtëpërdrejtë përgjegjës për administrimin e vendit të burgimit ose paraburgimit.

2. Një person i burgosur ose i paraburgosur duhet të ketë të drejtën të komunikojë lirisht dhe në konfidencialitet të plotë me personat që vizitojnë vendin e burgimit ose paraburgimit në përputhje me paragrafin 1 të këtij parimi, në kushte të arsyeshme të cilat garandojnë sigurinë dhe rendin në vend.” *BPP, Parimi 29*

“Institucionet ndëshkimore duhet ti nënshtrohen inspektimit të rregullt nga inspektorë të

kualifikuar dhe me eksperiencë, të caktuar nga autoriteti kompetent. Detyra e tyre duhet të jetë, në vecanti, të sigurojnë që këto institucione të administrohen në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe me qëllimin për të arritur objektivat e shërbimeve ndëshkimore dhe korrektuese.” *SMR, Rregulli 55*

“Procedurat efektive ankimore dhe inspektuese janë masa themelore mbrojtëse kundër keqtrajtimit në burgje. Të burgosurit duhet të kenë rrugë ankimore të mundshme si brenda ashtu dhe jashtë kontekstit të sistemit të burgut, përfshirë mundësinë për të patur akses konfidencial tek një autoritet i përshtatshëm. CPT i kushton rëndësi të vecantë vizitave të rregullta në çdo institucion burgu, të kryera nga një organ i pavarur i cili ka kompetenca të dëgjojë ankesat e të burgosurve dhe të inspektojë ambientet e institucionit. Këto organe mund të luajnë një rol të rëndësishëm në nxjerrjen në pah të diferencave që lindin ndërmjet administratës së burgut dhe një të burgosuri oe të burgosurve në përgjithësi.” *CPT, GR 2, §54 Shiko gjithashtu ACPR, A-16 dhe IDRCPLD, neni 9 dhe neni 10 para. 1.*

### **Komente**

Siç u pa në Kapitullin I, ka nevojë për një serë sistemesh të brendshme dhe të jashtme inspektimi për të mbrojtur të drejtat e personave të privuar nga liria e tyre. Ju, si një mekanizëm vizitues, përbëni një prej këtyre sistemeve.

Të burgosurit duhet të jenë në gjëndje të komunikojnë lirisht dhe në konfidencë me mekanizmat e inspektimit.

Mekanizmat vizitues duhet të monitorojnë se në ç’masë reagojnë vendet e burgimit ndaj vërejtjeve dhe rekomandimeve të këtyre organeve.

### **Pika referimi**

- A ka ndonjë mekanizëm të brendshëm inspektimi?
- Cila është përbërja e tij?
- Sa të shpeshta janë inspektimet?
- A kanë akses konfidencial tek ky organ, personat e privuar nga liria?
- A mundet ky organ të marri dhe të ekzaminojë ankesa?
- Kush ka akses tek raportet? A bëhen raportet publike?
- Cilat janë rezultatet e inspektimeve?

## **Procedurat disiplinore**

### **Standartet**

“1. Mënyrat e sjelljes së të paraburgosurve ose të burgosurve që përbëjnë shkelje disiplinore gjatë paraburgimit ose burgimit, përkrahimi dhe kohëzgjatja e ndëshkimeve disiplinore që mund të aplikohen dhe autoritetet kompetente për imponimin e këtyre ndëshkimeve duhet të parashikohen me ligj ose me rregullore dhe të publikohen.

2. Një person i paraburgosur ose i burgosur duhet të ketë të drejtën të dëgjohej përpara se të merren masat disiplinore. Ai duhet të ketë të drejtën të drejtohet autoriteteve më të larta për rishikim.” *BPP, Parimi 30*

“Disiplina dhe rregulli duhet të mbahen me vendosmëri, por jo me më shumë kufizime sec është e nevojshme për të patur një jetë në komunitet të sigurt dhe të mirë administruar.” *SMR, Rregulli 27*

“Të mëposhtmet duhet të përcaktohen gjithmonë nga ligji ose rregullorja e autoritetit administrative kompetent:

- (a) Sjelljet që përbënë shkelje disiplinore;
- (b) Llojet dhe kohëzgjatja e ndëshkimeve që mund të aplikohen;
- (c) Autoriteti kompetent që mund të imponojë këto ndëshkime.” *SMR, Rregulli 29*

“Ndëshkimi trupor, ndëshkimi duke e future personin në një qeli të errët dhe të gjitha ndëshkimet mizore, johumane ose degraduese duhet të jenë plotësisht të ndaluara si ndëshkime për shkelje.” *SMR, Rregulli 31 (shiko gjithashtu Rregullin 28, 30).*



“Është gjithmonë në interes si të të burgosurve dhe të stafit të burgut që të vendosen zyrtarisht dhe të aplikohen në praktikë procedura të qarta disiplinore; çdo zonë gri në këtë fushë mbartë rrezikun që të ndodhin zhvillime jo zyrtare (dhe të pakontrolluara) të procedurave. Procedurat disiplinore duhet ti sigurojnë të burgosurve të drejtën për tu dëgjuar në lidhje me shkeljen e pretenduar dhe të drejtën e ankimit tek autoriteti më i lartë në lidhje me sanksionin e imponuar.

Shpesh ekzistojnë edhe procedura të tjera paralelisht me procedurën zyrtare disiplinore, sipas të cilave një i burgosur mund të ndahet nga të burgosurit të tjerë, pa vullnetin e tij, për arsye disiplinore ose sigurie (për shembull kur është në interes të ruajtjes së rendit në institucion). Këto procedura duhet të shoqërohen me masa mbrojtëse efektive. I burgosuri duhet të informohet mbi arsyet e masës së marrë ndaj ti, përveç se kur kërkesat e sigurisë kërkojnë të kundërtën, ti jepet mundësia të prezantojë pikëpamjet e tij mbi çështjen dhe të ketë mundësinë të kundërshtojë masën e marrë përpara një autoriteti të përshtatshëm.” *CPT, GR 2, §55*

Shiko gjithashtu *ACPR A-3, A-6, A-12, dhe IDRCPLD neni 47 para. 1 dhe neni 49.*

### **Komente**

Mekanizmat vizitues duhet të ekzaminonjë nëse sistemi i ndëshkimitë është i formalizuar në një grup rregullash të qarta të cilat i janë përcjellë tek dhe janë kuptuar nga stafi dhe të burgosurit; dhe nëse lista e të gjitha akteve që përbëjnë shkelje disiplinore është e publikuar. Mekanizmat duhet të konsiderojnë nëse rregullat janë të qarta jo vetëm për atë që përbënë shkelje por edhe për ndëshkimin që pason; nivelin hierarkik që mund të vendosi sanksionin disiplinor dhe procedurën sipas të cilës personi i ndëshkuar mund të dëgjohet për pikëpamjet e tij dhe të ankimohet.

Mekanizmi mund të interesohet mbi mënyrën sesi rregullat përcillen dhe ku ato bëhen publike.

Mekanizmi duhet gjithashtu të interesohet për natyrën e rregullave disiplinore (a janë ato të bazuara në parimin e proporcionalitetit ndërmjet nevojës për rregull dhe organizim të qetë dhe nevojës për të respektuar dinjitetin e individëve).

Natyra e procedurës duhet të jetë një temë e rëndësishme për shqyrtim. Procedura duhet të parashikojë garancitë e një procesi të drejtë.

Mekanizmi vizitues duhet të ketë parasysh që sanksionet disiplinore kthehen në keqtrajtim në qoftë se janë jo proporcionale me shkeljen e kryer, në qoftë se janë arbitrare ose në qoftë se janë një burim irritimi ose vuajtje e pajustificueshme.

Mekanizmat duhet të kërkojnë për ndonjë tendencë për të zhvilluar disiplinën ndaj një hierarkie joformale të burgosurish. Kjo është e ndaluar.

### **Pika referimi**

- Çfarë sjelljesh dhe veprimesh janë objekt sanksioni ?
- Kush i cakton sanksionet dhe në çfarë bazash (raport i shkruar/gojor)?
- A ka mundësi personi të mbrojtë vetveten?
- A është personi i informuar mbi akuzat që i bëhen?
- Cila është natyra dhe kohëzgjatja e sanksioneve që aplikohen?
- Si funksionon mekanizmi i apelit?
- A ka rezultuar ndonjë apel në favour të personit të burgosur?
- Sa janë të ndëshkuarit në një periudhë kohe të caktuar, krahasuar me numrin total të personave të privuar nga liria e tyre?
- A ka ndonjë të dhënë se ndëshkimet ose ndëshkime të vecanta aplikohen në mënyrë joproporcionale ndaj pakicave?
- A ka ndonjë të dhënë se të burgosurit janë të përfshirë në aplikimin e masave disiplinore?

### **Procedurat ankimore**

#### **Standartet**

“1. Një person i paraburgosur ose i burgosur ose avokati i tij duhet të ketë të drejtën të bëjë një

kërkesë ose një ankesë në lidhje me trajtimin e tij, në veçanti në rastet e torturës ose trajtimi mizor, johuman ose degradues, tek autoritetet përgjegjëse për administrimin e vëndit të burgimit dhe tek autoritetet më të larta dhe kur është e nevojshme tek autoritetet kompetente për rishikimin dhe korrigjimin e situatës.

1 Në ato raste ku as i paraburgosuri ose i burgosur dhe as avokati i tij nuk ka mundësinë të ushtrojë të drejtat e tij sipas paragrafit 1 të këtij parimi, një anëtar i familjes së të paraburgosurit ose të burgosurit ose çdo person tjetër i cili ka dijeni mbi çështjen, mund të ushtrojë këto të drejta.

2 Në qoftë se kërkohet nga paditësi, duhet të ruhet konfidencialiteti për sa i përket kërkesës ose ankimit.

3 Çdo kërkesë ose ankim duhet të trajtohet sic duhet dhe duhet të ketë një përgjigje pa vonesë. Në se kërkesa ose ankimi refuzohet ose nuk i jepet një përgjigje në kohë, paditësi duhet të ketë të drejtën të sjelli çështjen përpara një autoriteti gjyqësor ose një autoriteti tjetër. As i paraburgosuri ose i burgosuri dhe as ndonjë paditës tjetër sipas paragrafit 1 të këtij parimi nuk duhet të paragjykohe se ka bërë një kërkesë apo një ankim.”*BPP, Parimi 33*

“1. Çdo i burgosur duhet të ketë mundësinë që çdo ditë të javës të mund të bëjë kërkesa ose ankime tek drejtori I institucionit ose tek nëpunësi i autorizuar për ta përfaqësuar atë

1 Duhet të jetë e mundur ti bëhen kërkesa ose ankime inspektorit të burgut gjatë inspektimit të tij. I burgosuri duhet të ketë mundësinë të bisedojë me inspektorin ose me çdo nëpunës tjetër inspektimi pa prezencën e drejtorit ose ndonjë anëtar tjetërtë stafit.

2 Çdo i burgosur duhet të lejohet të bëjë një kërkesë ose ankim pa kufizime për sa i përket përmbajtjes por në formën e duhur, drejtuar administratës qendrore të burgut, autoritetit gjyqësor ose ndonjë autoritetit tjetër kompetent.

3 Çdo kërkesë ose ankim duhet të trajtohet sic duhet dhe ti jepet një përgjigje pa vonesë, me përjashtim të rastit kur është në mënyrë të dukshme pavlerë ose i pabazuar.” *SMR, Rregulli 36*

Shiko gjithashtu *ACPR, A-7-a), b) dhe c), IDRCPL, nenin 50 para 1 dhe nenin 54.*

## **Komente**

Mekanizmi vizitues duhet të ekzaminojë nëse të burgosurit janë njohur me mjetet e diskutimit dhe kundërshtimit të aspekteve të jetës së tyre në burgim. Forma dhe përmbajtja e procedurës së ankimit ose mungesa e tyre mund të jetë një indikator i rëndësishëm i nivelit të respektit që i sigurohet të burgosurve.

Sa nivele ankimi janë të disponueshme? Niveli i parë mund të drejtohet drejtëpërdrejtë drejtorit të institucionit. A e ka mundësinë I burgosuri të bëjë ankimim të pakufizuar dhe konfidencial tek një instancë më e lartë?

Mekanizmi duhet të ekzaminojë nëse të burgosurit kanë akses të pakufizuar tek ndonjë autoritet i jashtëm, i pavarur nga sistemi i burgut.

## **Mekanizmi vizitues duhet të monitorojë sistemin e ankimit.**

- A është procedura në përputhje me standartet e drejtësisë dhe paanësisë?
- Sa i aksesueshëm është për të burgosurit?
- A respektohet konfidencialiteti?
- A është procedura transparente ?
- A sillen në mënyrë objektive dhe të paanshme ata që merren me ankesat?
- A është sistemi i përshtatshëm për nevojat e të burgosurve dhe situatën? (fleksibiliteti)
- A merr paditësi një përgjigje në lidhje me substancën e ankesës së tij, në kohën e duhur (eficenca)
- A mbahen, analizohen dhe veprohet në përputhje me statistikën mbi përgjigjet e dhëna ndaj ankesave?

Mekanizmat e ankimit duhet të ekzaminohen të lidhura me inspektimin, pasi organet e inspektimit duhet të kenë mundësinë të marrin dhe ekzaminojnë ankesat (shiko seksionin: Inspektimi).

## Pika referimi

- Çfarë rrugësh ankimimi kanë personat e privuar nga liria e tyre?
- Cila është natyra e ankimimit – administrative/gjyqësore?
- Cila është procedura e ankimimit – tek cili dhe si?
- A është procedura lehtësisht e aksesueshme nga çdo person i privuar nga liria e tij (përfshirë shtetasit e huaj dhe analfabetët ose gjysëm-analfabetët)?
- A ka mundësi një i jashtëm të bëjë ankim në administratën e burgut, në emër të të burgosurit?
- A ka mundësi një i jashtëm të bëjë ankim në administratën përgjegjëse për mbikëqyrjen, në emër të të burgosurit?
- Cili është afati për administrimin e ankesave?
- Sa ankesa janë bërë gjatë gjashtë muajve të shkuar (krahasuar me numrin mesata të personave që gjenden në vendin konkret)?
- Cila është natyra e ankesave?
- Cili është rezultati më i zakonshëm i ankimimit?
- Sa ankimime kanë përfunduar në favor të paditësit?
- A ka pretendime për hakmarrje për shkak të ngritjes së një ankesë?

## Veçimi i kategorive të të burgosurve

### Standartet

“2. (a) Personat e akuzuar duhet, në rrethana përjashtimore, të jenë të ndarë nga personat e dënuar dhe duhet të jenë subjekt i një trajtimi të veçantë të përshtatshëm për statusin e tyre si persona të padënuar;

(b) Të rinjët e akuzuar duhet të veçohen nga të rriturit dhe të gjykohen sa më shpejtë të jetë e mundur.” *ICCPR, Neni 10.2*

“Neni 10, paragrafi 2 (a), parashikon për veçimin e personave të akuzuar nga ata të dënuar. Një veçim i tillë kërkohet me qëllim që të theksohet status i personave të padënuar të cilët gëzojnë të drejtën e prezumimit të pafajshëm sic parashikohet në nenin 14, paragrafi 2.” *GC 21, para. 9.*

“Kategoritë e ndryshme të të burgosurve duhet të mbahen në institucione të ndryshme ose në pjesë të ndryshme të një insitucioni, në varës të seksit, moshës, të dhënave kriminale, arsyeve ligjore të burgosjes dhe nevojshmërive të trajtimit të tyre. Kështu:

- (a) Meshkujt dhe femrat duhet të mbahen të ndarë në insitucione të vecanta; në një institucion ku mbahen si femrat ashtu dhe meshkujt ambientet në dispozicion të grave duhet të jenë plotësisht të veçuara;
- (b) Të burgosurit e pagjykuar duhet të mbahen të ndarë nga të burgosurit e dënuar;
- (c) Personat e burgosur për borxhe dhe të burgosurit e tjerë civil duhet të mbahen të ndarë nga personat e burgosur për krime penale;
- (d) Të burgosurit e rinj duhet të mbahen të ndarë nga të rriturit.” *SMR, Rregulli 8.*

“1. Në ndarjen e personave në institucione ose regjime të ndryshme duhet të merret parasysh situata e tyre ligjore e gjyqësore (të burgosur të pagjykuar ose të dënuar, shkelës për herë të parë apo përsëritës, dënime të shkurtra apo të gjata) kërkesat e vecanta të trajtimit të tyre, nevojat e tyre mjekësore, seksi dhe mosha e tyre.

1 Meshkujt dhe femrat duhet parimisht të mbahen të ndarë nga njëri-tjetri, megjithatë ata mund të marrin pjesë së bashku në aktivitete të organizuara si pjesë e një programi trajtimi.

2 Parimisht, personat e pagjykuar duhet të mbahen të ndarë nga personat e dënuar me përjashtim të rastit kur ata bien dakort të akomodohen ose të përfshihen bashkarisht në aktivitete përfituese për ta.

3 Të burgosurit e rinj duhet të mbahen në kushte të cilat ti mbrojnë sa më shumë të jetë e mundur nga influencat dëmtuese dhe të cilat të marrin parasysh nevojat e vecanta të moshës së tyre.” *EPR, Rregulli 11*

“Parimisht, gratë e privuara nga liria e tyre duhe të mbahen në ambiente të ndara fizikisht nga ato të

burrave që gjenden në të njëjtin institucion. E thënë kjo, disa shtete kanë filluar të mendojnë për çiftet (që privohen bashkarisht nga liria e tyre) në mënyrë që ata të akomodohen bashkë dhe/ ose për një farë përzjerje gjinore në burgje. CPT i mirëpret idetë e tillëa progressive me kusht që të burgosurit e interesuar të bien dakortë të marrin pjesë, dhe ata të përzgjidhen me kujdes dhe të mbikëqyren në mënyrë të përshtatshme.” *CPT, GR10, §24*

Shiko gjithashtu: *SMR Rregulli 85; EPR Rregullat 12 dhe 13 dhe ACPR, B-1-b) dhe IDRCPL, neni 16.*

### **Të rinjtë**

“Sipas nenit 10, paragrafi 3, shkelësit e rinjë duhet të mbahen të ndarë nga të rriturit dhe duhet tu sigurohet trajtim i përshtatshëm për moshën e tyre dhe statusin e tyre ligjor, për sa i përket kushteve të burgimit.”. *GC 20 para 13.*

“Në të gjitha vëndet e burgimit të rinjtë duhet të ndahen nga të burgosurit, përveçse kur janë pjestar të të njejtës familje. Nën kushte të kontrolluara, të rinjtë mund të mbahen sëbashku me të rritur të përzgjedhur me kujdes për të ndjekur programe të veçanta që kanë treguar se janë përfituese për të rinjtë.” *RPJDL, Rreulli 29.*

### **Komente**

Parimi që udhëheq veçimin e të burgosurve është mbrojtja si dhe njohja e nevojave specifike ose statusit të kategorive të ndryshme. Të burgosurit nuk duhet të veçohen për arsye të ndryshme nga ato që udhëhiqen nga ky parim.

Të burgosurit normalisht vecohen sipas:

- Seksit dhe moshës: burrat nga gratë dhe të miturit nga të rriturit;
- Situatës gjyqësore soe ligjore: të akuzuar ose të dënuar.

Mekanizmi vizitues duhet të ekzaminojë kushtet e burgimit nga pikëpamja e mbrojtjes dhe nevojave të veçanta. Veçimi duhet të bazohet në një vlerësim objektiv të rrezikut që i kanoset të burgosurit. Të burgosurit duhet të kenë mundësinë të kërkojnë veçimin kur ekzistojnë probleme të vërteta sigurie. Disa të burgosur mund të kenë nevojë të vecohen për shkak të kërkcënimeve specifike që i drejtohen sigurisë së tyre nga të burgosurit e tjerë, për shembull për shkak të origjinës së tyre etnike, besimeve fetare, orjentimeve seksuale. Mekanizmi duhet të jetë i ndërgjegjshëm se veçimi mund të ketë një impact disavantazhues mbi kategori të ndryshme të burgosurish. Për shembull, duke qenë se gratë dhe të rinjtë përbëjnë një pakicë në popullsinë e burgjeve, veçimi I tyre në ambiente të ndara shpesh rezulton në privimin e tyre nga kontakti me familjen dhe shoqërinë. Të burgosurit që presin gjykimin, edhe pse prezumohen të pafajshëm, shpesh mbahen në kushte më të këqia dhe me më pak akses në botën e jashtme sesa të burgosurit e dënuar.

Nuk ka një justifikim mjekësor për veçimin e të burgosurve vetëm për shkak se ata janë me SID.

Mekanizmat vizitues duhet të marrin në konsideratë nëse nevojat e veçanta të personave të paaftë ose të personave të vjetër në moshë respektohen duke i mbajtur ata në të njëjtin vend me të burgosurit e tjerë me aftësi të plota.

Mekanizmat duhet të mos harrojnë mbrojtjen e të burgosurve gjatë transportimit të tyre.

Të miturit e privuar nga liria e tyre duhet të mbahen në struktura dhe kushte që janë të përshtatshme për nevojat e tyre.

### **Pikat e referimit**

- A mbahen të miturit efektivisht të veçuar nga të rriturit, gjatë gjithë orëve të ditës?
- Në vëndet e burgimit ku mbahen kategori të ndryshme personash:
- A janë gratë efektivisht të veçuara nga meshkujt, 24 orë në ditë?
- A janë ato kryesisht nën përgjegjësinë e stafit femëror?
- A u sigurohet grupeve të të burgosurve që kualifikohen si vulnerabël, akomodim i vecantë, kur ka arsye reale për tu shqetësuar për sigurinë e tyre?
- Kur ka ambiente burgimi të përbashkëta:

- Kush e cakton akomodimin dhe mbi çfarë bazash?
- A mund të kërkojnë të burgosurit të ndërrojnë vëndin e akomodimit?
- Në qoftë se po, mbi çfarë bazash?
- Si e parandalon dhe e kontrollon stafi rrezikun ndaj abuzimit, në vecanti abuzimin seksual të kryer ndaj të burgosurve të të njëjtit seks?
- A ka ndonjë të dhënë se grupet në pakicë veçohen për arsye të ndryshme nga ato të sigurisë?

### **Për lexim të mëtejshme**

PRI, *Si ti bësh standartet të funksionojnë*, Londër 2001. (Seksioni II Procesi dhe ankimet, f. 29-54; Seksioni VIII, Inspektimet, f. 167-174)

UN HCHR, *Të drejtat e njeriut dhe burgjet*, Gjenevë 2003 (Seksioni 5 Si ti bësh burgjet vende të sigurta, f. 72-75)

Andrew Coyle, *Afrimi i të drejtave të njeriut me menaxhimin e burgut*, 2003. (Kapitulli 6: Procedurat disiplinore dhe ndëshkimet, f.75-82; Kapitulli 9 Kërkesat dhe ankesat f.105-110, Kapitulli 10: Procedurat e inspektimi, f.111-116)

AI, *Të luftosh torturën*, Londër 2003. (Kapitulli 5 Kushtet e burgimit, f. 133; 139-143)

### **3. KUSHTET MATERIALE**

Mekanizmat vizitues ka shumë mundësi t'ia kushtojnë pjesën më të madhe të kohës ekzaminimit të kushteve materiale të burgimit.

Duke privuar një person nga liria e tij autoritetet marrin përgjegjësinë ti plotësojnë atij personi nevojat jetësore. Privimi i lirisë në vetvete ka njëkarakter ndëshkues. Shteti nuk ka asnjë autoritet të përkeqësorë situatën me kushte të varfra burgimi që nuk janë në përputhje me standartet që shteti ka marrë përsipër të respektojë.

Kushte të përshtatshme jetese në vëndet e burgimit janë thelbësore për ruajtjen e dinjitetit njerëzor të personit të burgosur. Hapësira për të jetuar, ushqimi, higjena janë faktorë që kontribuojnë në respektimin e dinjitetit dhe mirëqenies së të burgosurit.

Vizitorët duhet të ekzaminonjë kushtet e përgjithshme të vendit të burgimit; furnizimi me energji, furnizimi me ujë, menaxhimi i mbeturinave dhe pastrimi janë të gjitha elemente të rëndësishëm për dinjitetin njerëzor.

Vizitorët nuk duhet të harrojnë që kushtet e jetes së të burgosurve janë gjithashtu kushtet e punës së stafit.

Ndër kushtet e burgimit, problemi i mbipopullimit është një nga më të rëndësishmit, pasi ai ka një influencë negative mbi të gjitha aspektet e tjera të burgimit dhe mbi klimën e përgjithshme në institucion. Kur mbi popullimi arrin ca nivele ose kur kombinohet me faktorë të tjerë negative, ai mund të përbëjë trajtim johuman ose degradues.

### **Kushtet materiale**

- Ushqimi
- Ndriçimi dhe ajrosja
- Higjena personale
- Ambientet sanitare
- Veshja dhe shtrojet
- Mbiipopullimi dhe akomodimi

### **Ushqimi**

#### **Standartet**

“1. Çdo të burgosuri duhet ti sigurohet nga administrata, në orare të zakonshme, ushqim me vlera ushqyese të përshtatshme për shëndetin dhe fuqinë, cilësisht të shëndetshëm dhe të përgatitur dhe të shërbyer mirë.

2. Uji duhet të jetë i disponueshëm për çdo të burgosur kurdoherë që atij i nevojitet.” *SMR, Rregulli 20*

“1. Nëpunësi mjek duhet të kontrollojë dhe këshillojë drejtor mbi:

(a) sasinë, cilësinë, përgatitjen dhe shërbimin e ushqimit” *SMR, Rregulli 26*

“1. Në përputhje me standartet e vendosura nga autoritetet shëndetësore, administrata duhet ti sigurojë të burgosurve në orare normale, ushqim të përgatitur dhe të serveritur në mënyrë të përshtatshme i cili të jetë në përputhje në cilësi dhe sasi me standartet dietike dhe të higjenes dhe i përshtatshëm për moshën, shëndetin dhe natyrën e tyre të punës dhe për aq sa është e mundur në përputhje me kërkesat fetare dhe kulturore.

2. Uji duhet të jetë i disponueshëm për të gjithë të burgosurit.” *EPR, Rregulli 25*

Shiko gjithashtu *ACPR, A-11 dhe IDRCDDL, neni 32*.

### **Të rinjtë**

“Pakësimi i ushqimit ose kufizimi ose mohimi i kontaktit me familjen duhet të jetë e ndaluar për çfarë do lloj arsye.”. *RPJDL, Rregulli 67*.

### **Komente**

Mekanizmat vizitues duhet të zhvillojnë një metodologji që i lejon ato të kontrollojnë rregullisht nëse dieta e të burgosurve është e mjaftueshme për sa i përket sasisë, cilësisë dhe shumëllojshmërisë në mënyrë që personat e privuar nga liria e tyre të jenë të shëndetshëm dhe mos t’i nënshtrohen kushteve mjekësore që shoqërojnë keq ushqimin. Të burgosurit duhet të kenë në dispozicion ujë gjatë gjithë kohës.

Në disa shtete ushqimi mund ose duhet të plotësohet me ushqime nga familja. Në këto raste, mekanizmi duhet të monitorojë situatën e atyre që jetojnë pa mbështjetjen e personave të jashtëm, në vecanti nëse burgu i identifikon këta individë dhe i plotëson atyre nevoja të veçanta.

Mekanizmat duhet ti sigurojë vëmendje higjenes dhe çështjeve të tjera që lidhen me dinjitetin e të burgosurve, si për shëmbull koha në të cilë serviret ushqimi, ora kur lejohet të konsumohet ushqimi dhe mënyra sesi ai shërbehet.

### **Pika referimi**

- Çfarë standartesh ekzistojnë në lidhje me sasinë, cilësinë, dhe shumëllojshmërinë e ushqimit? Kush vendos për menynë? A luan rregullisht një rol personeli mjekësor ?
- Cili është buxheti vjetor për ushqimin (dhe shuma e lejueshme për çdo të burgosur, në ditë)?
- Kur është koha e ngrënies? A janë intervalet midis vakteve të përshtatshme?
- A serviren të burgosurit me respekt? A ka ndonjë diskriminim negative në mënyrën e shpërndarjes së ushqimit, dhe shpërndarjen e të burgosurve në mence?
- A kanë të burgosurit akses tek ushqimi dhe uji jashtë orarit të vakteve?
- Çfarë lloj uji është i disponueshëm? A është ai i pastër dhe i disponueshëm gjatë gjithë vitit?
- A ka dieta të veçanta për të sëmurët, të vjetrit, dhe fëmijët e shoqëruar nga nënat e tyre?
- A respektohen kufizimet në ushqim për arsye besimi?
- A e pasqyron ushqimi përbërjen etnike të të burgosurve?
- A ka një mence ose një dyqan ku të burgosurit mund të blejnë ushqim, dhe në çfarë kushtet mund ta bëjnë një gjë të tillë? Kush vendos për rezervat?
- Cilat janë rregullat dhe praktikatat për familjet që sjellin ushqim?
- Cilat janë kushtet në guzhinën ku përgatitet ushqimi? A inspektohen ato rregullisht?

## **NDRIÇIMI DHE AJROSJA**

### **Standartet**

“Në të gjitha vëndet ku të burgosurve u kërkohet të jetojnë dhe punojnë:

(a) dritaret duhet të jenë mjaftueshmërisht të mëdhaja për ti mundësuar të burgosurve të

lexojnë dhe punojnë me dritë natyrale, dhe të lejojnë futjen e ajrit të freskët pavarësisht ka apo jo ajrosje artificiale;

(b) Drita artificiale duhet të jetë e mjaftueshme që të burgosurit të lexojnë dhe punojnë pa dëmtuar sytë.” *SMR, Rregulli 11* (shiko gjithashtu *EPR Rregullin 16*)

“1.Nëpunësi mjek duhet të kontrollojë dhe këshillojë rregullisht drejtorin mbi:

(c) Kushtet sanitare, të ngrohjes, ndricimit dhe ajrosjes, në institucion.” *SMR, Rregulli 26*

“ CPT ndeshet shpesh me mjete si grila, listela, pjata metalike, të vendosura në dritaret e qelive të cilat i privojnë të burgosurit nga drita natyrale dhe ajri i freskët. Ato janë një element vecanërisht e zakonshëm në ambientet e të burgosurve paragjyqësor. CPT pranon plotësisht se masa të vecanta sigurie të disenjuara për të parandaluar rrezikun e veprimeve të fshehta dhe/ose aktivitetit kriminal mund të aplikohen për disa të burgosur. Megjithatë imponimi i masave të kësaj natyre duhet të jetë përjashtim dhe jo rregull. Kjo nënkupton që autoritetet përkatëse duhet të ekzaminonin rastin e çdo të burgosuri në mënyrë që të sigurohen nëse masat e vecanta të sigurisë justifikohen në rastin konkret. Për më tepër, edhe kur masa të tillë janë të nevojshme, ato nuk duhet asnjëherë të përfshijnë privimin e të burgosurve nga drita natyrale dhe ajri i pastër. Këto të fundit janë elementet bazë të jetës dhe çdo i burgosur të drejtën të gëzojë ato; gjithashtu, mungesa e këtyre elementeve gjeneron kushte të favorshme për përhapjen e sëmundjeve dhe në vecanti të turbekulozit.

CPT njih se sigurimi i kushteve të përshtatshme jetësore në institucionet ndëshkimore mund të jetë shumë e kushtueshme dhe përmirësimet janë penguar në shumë shtetet nga mungesa e fondeve. Megjithatë heqja e pengesave nga dritaret e ambienteve të të burgosurve nuk duhet të kërkojë investim të konsiderueshëm dhe në të njëjtën kohë, do të jetë me goxha benefit për të interesuarit.” *CPT, GR 11, §30*

### **Komente**

Mekanizmat vizitues do tu duhet të monitorojnë sesa akses kanë të burgosurit tek drita natyrale, ajri i pastër dhe temperaturat e përshtatshme, në të gjitha rastet nëpërmjet vërejtjeve të tyre ose duke marrë në pyetje të burgosurit dhe stafin.

Vizitorët duhet të konsiderojnë ajrosjen në përputhje me madhësinë dhe hapësirën e qelisë dhe shkallën e dëndësisë së saj. Dritaret nuk duhet të jenë të bllokuara dhe duhet të jetë e mundur të hapen ventilatorët. Të burgosurit duhet të jenë në gjëndje të ndezin dhe të fikin dritat vet, brenda në qeli.

Standartet bazë që aplikohen ndaj akomodimit normal në vendet e burgimit duhet gjithashtu të aplikohen edhe në qelitë e ndëshkimit.

### **Pika e referimit**

- A është ajrosja e mjaftueshme në qeli?
- A është temperatura në qeli e përshtatshme?
- Cilat janë përmasat e dritares? A mund të hapet ajo?
- A mundet i burgosuri të rregullojë vet ndricimin, ventilimin dhe ngrohjen?
- Si sigurohet ngrohja dhe a është sistemi i ngrohjes i sigurt?
- A është drita e mjaftueshme për të lexuar?

### **Ambientet sanitare**

#### **Standartet**

“Instalimet sanitare duhet të jenë të përshtatshme për të mundësuar çdo të burgosur të plotësojë nevojat e tij natyrore në pastërti dhe në mënyrën e duhur.” *SMR, Rregulli 12* (shiko gjithashtu *EPR, Rregulli 17*)

“Akses i gatshëm në tualet dhe mbajtja e standarteve të mira të higjenes janë elemente thelbësore të ambientit njerëzor.

Në këtë drejtim CPT-s i duhet të deklarojë që asaj nuk i pëlqejnë praktikat e hasura në disa shtete ku të burgosurit kryenin nevojat e tyre personale në kova, brenda qelisë së tyre (këto kova nxirreshin

jashtë në momente të caktuara). Ose duhet të vendosen tualete në ambientin e qelisë (e preferueshme është që të vendosen në një aneks të qelisë) ose të krijohet mundësia që të burgosurit të mund të dalin nga qelitet për të përdorur tualetet përjashta, pa vonesë dhe në çdo kohë (përfshirë gjatë natës).”

*CPT, GR 2, §49 Shiko gjithashtu IDRCPLD, neni 31.*

### **Komente**

Mekanizmat vizitues duhet të vizitojnë ambientet sanitare për të kontrolluar nëse ato janë të përdorshme, sigurojnë privatësinë e duhur dhe mbahen në kushte higjenike. Ata duhet të kërkojnë të flasim me të burgosurit për ti pyetur nëse ka kufizime të paarsyeshme ndaj aksesit të tyre tek këto ambiente sanitare.

Kur tualetet janë brenda qelive, vizitorët duhet të kontrollojnë nëse ato janë të ndara me një murë ose ndarje. Në qoftë se në tualete nuk qarkullon uji, vizitorët duhet të kontrollojnë sesa shpesh zbrazen enët mbajtëse.

Kur tualetet janë të vendosura jashtë qelive, vizitorët duhet të kontrollojnë nëse mundësohet aksesit tek ato pa vonesë.

Vizitorët duhet të konsiderojnë nëse sigurohet një nivel i përshtatshëm mirëmbajtjeje nga autoritetet e burgimit.

### **Pika referimi**

- Cili është raporti i numrit të tualeteve krahasuar me numrin e të burgosurve dhe ai I përgjigjet ky raport standarteve minimale?
- A kanë të gjithë të burgosurit akses në tualet në kushtet e duhura dhe në privatësi ?
- Në qoftë se nuk ka tualete brenda ambienteve të burgimit:
  - Sa gjëtë duhet të presi personi përpara se ti mundësohet përdorimi i tualeteve që ndodhen përjashta?
  - Si munden personat që ndodhen brenda të kryejnë nevojat e tyre personale gjatë natës?
- duke i thënë personelit mbikëqyrës?;
- duke përdorur kovat me kapak?
- Sa të pastra dhe higjenik janë ambientet sanitare? Cilat janë masat për mbajtjen e tyre në kushte të pastra dhe të përdorshme?
- A ka ndonjë të dhënë për diskrimin negativ ndaj grupeve në pakicë për sa i përket aksesit në ambientet sanitare ?

## **Higjena persoanel**

### **Standartet**

“Ambiente të përshtatshme për larje dhe dush duhet të sigurohen në mënyrë që çdo i burgosur të ketë mundësinë dhe ti kërkohej të lahet ose të bëj një dush, në një temperaturë të përshtatshme për klimën, aq shesh sa është e nevojshme për higjenën në përgjithësi sipas stinës dhe rajonit gjeografik, por të paktën një herë në javë kur klima është e butë.” *SMR, Rregulli 13*

“Të burgosurit duhet tu kërkohej të rrinë të pastër dhe për këtë qëllim atyre duhet tu sigurohet uji dhe artikujt e nevojshëm për qenë të pastër.” *SMR, Rregulli 15*

“Në mënyrë që të burgosurit të kenë një pamje të mirë në përputhje me vet-respektin, duhet tu sigurohen ambiente për kujdesin ndaj flokëve dhe mjekrës, dhe burrat duhet të kenë mundësinë të rruhen rregullisht.” *SMR, Rregulli 16*

“Të burgosurit duhet të kenë aksesin e duhur në ambientet e larjes dhe dushit. Është gjithashtu e dëshirueshme që uji të jetë i disponueshëm brenda qelive.” *CPT, RG 2, §49*

“Nevojat e veçanta higjenike të grave duhet të trajtohen në mënyrën e duhur. Aksesit në ambientet sanitare dhe të larjes, vëndet për hedhjen e mbeturinave si dhe sigurimi i artikujve higjenik si peshqirët sanitar dhe tamponët, janë të një rëndësie të veçantë. Mos sigurimi i këtyre elementeve bazë mund të përbëjë në vetvete trajtim degradues.” *CPT, GR 10, §31*

Shiko gjithashtu *ACPR A-11 dhe IDRCPLD neni 31.*



## Komente

Mbajtja e higjenës trupore është çështje shëndeti dhe respekti ndaj të tjerëve dhe vetvetes. Higjena personale mund të lidhet edhe me praktikat fetare që duhet të respektohen. Aksesit në ambientet sanitare si dhe tek dushet dhe vëndet e larjes është thelbësor si një mënyrë për të ulur përhapjen e mundshme të sëmundjeve midis të burgosurve dhe stafit. Kjo bëhet vecanërisht e rëndësishme kur të burgosurit janë mbajtur për një periudhë të gjatë kohe në një ambient të mbipopulluar.

Higjena personale dhe higjena në vëndet e burgimit duhet gjithashtu të shikohet nga pikëpamja e trajtimit që u bëhet të burgosurve nga autoritetet e burgimit. Kushte e këqia higjenike janë poshtëruese dhe degraduese.

Autoritetet e burgimit duhet të sigurojnë artikujt e nevojshëm që personat të mbajnë higjenën e tyre trupore.

Është e rëndësishme që organizimi i vëndit të mos jetë poshtëruer për të burgosurit, për shembull të mos ti detyrojë ata të bëjnë dush në publik.

Gratë duhet të marrin rregullisht dhe në mënyrën që respekton sensin e tyre të intimitetit, artikujt higjenik të zakonshëm dhe të nevojshëm për menstruacionet. Në qoftë se ato shoqërohen nga fëmijë të vegjël, atyre duhet tu sigurohen artikuj shtesë të përshtatshëm për fëmijët.

Shpeshësia e bërjes së dushit duhet të caktohet duke marrë parasysh klimën dhe nvelin e aktivitetit të personave të privuar nga liria e tyre.

## Pika referimi

- A kanë përherë mundësi për tu larë, të burgosurit?
- Sa shpesh kanë personat (që punojnë dhe nuk punojnë) akses në ambientet e larjes?
- A janë ambientet e larjes të mjaftueshme në numër?
- A janë ato në gjëndje të rregullt dhe të pastër?
- Çfarë artikujsh të higjenës shpërndahen nga autoritetet dhe sa shpesh?
- A respektohen nevojat fetare dhe kulturore?
- A ka ndonjë të dhënë për diskriminim negative ndaj grupeve në pakicë për sa i përket aksesit në vëndet e larjes?
- A plotësohen nevojat e grave me menstruacione?

## Veshja dhe shtresat

### Standartet

“1. Kur vëndi i fjetjes është në qeli ose dhoma individuale, çdo i burgosur duhet të ketë qelinë ose dhomën e tij. Në qoftë se për arsye të vecanta, si përshëmbull për arsye të mbipopullimit, lind nevoja për administratën qëndore të burgut të bëjë një përjashtim nga ky rregull, nuk është e preferueshme të vendosen dy të burgosur në një qeli ose dhomë.

2. Në rastin kur pëdoren fjetore, aty duhet të vendosen të burgosur të zgjedhur me kujdesë sit ë përshtatshëm për të qëndruar sëbashku. Në këtë rast duhet të ketë mbikëqyrje të rregullt gjatë natës, në përputhje me natyrën e institucionit.” *SMR, Rregulli 9*

“Mbi popullimi është një problem i një rëndësie të drejtëpërdrejtë për mandatin e CPT-s. Të gjitha shërbimet dhe aktivitetet brenda një burgu do të preken në qoftë se numri I të burgosurve është më i madh se kapacitetit i tij, dhe cilësia e përgjithshme e jetës në institucion do të ulet, mbase edhe në mënyrë të konsiderueshme. Për më tepër, niveli i mbipopullimit në një burg ose në një pjesë të veçantë të tij mund të përbëjë në vetvete trajtim johuman ose degradues nga një pikëpamje fizike.” *CPT, GR 2, §46*

“Fenomeni i mbipopullimit të burgjeve vazhdon të dëmtojë sistemet ndëshkimore anë e mbanë Europës dhe pengon seriozisht përpjekjet për përmirësimin e kushteve të burgimit. Efektet negative të burgjeve të mbipopulluara janë nxjerrë në pah në Raportet e Përgjithshme të mëparshme. Duke qenë se fusha e veprimit të CPT-s është shtrirë anë e mbanë kontinentit European, Komiteti ka hasur nivele të larta burgimi dhe mbipopullim të madh në burgje. Fakti që shteti fut në burg shumë qytetarë nuk mund të shpjegohet bindshëm e ndarë nga shkalla e lartë e krimeve;

Në kushte të tilla, investimi i shumave të parave në institucionin e burgut nuk do të sjelli zgjidhje. Në vend të kësaj është e nevojshme të rishikohet ligji dhe praktikat ekzistuese në lidhje me burgimin gjatë gjykimit dhe dënimeve jo me burg të mundshme. Kjo është zgjidhja e propozuar në Rekomandimin e Komitetit të Ministrave N° R (99) 22 në lidhje me mbi popullimin e burgjeve dhe inflacionin e popullimit në burgje. CPT shpreson shumë që parimet e përcaktuara në këtë material të rëndësishëm të zbatohen nga Shtetet Anëtare; zbatimi i këtij rekomandimi duhet të monitorohet nga afër prej Këshillit të Europës.” *CPT, GR 11, §28*

“1. Të burgosurit duhet të vendosen në qeli individuale gjatë natës përveç rasteve kur konsiderohet me avantazh ndarja e qelisë me të burgosur të tjerë.

2. Kur qelia ndahet, aty duhet të vendosen të burgosur të përshtatshëm për tu shoqëruar me njëri tjetrin. Në këtë rast duhet të ketë mbikëqyrje gjatë natës, në përputhje me natyrën institucionit.” *EPR, Rregulli 14*

“Në një numër shtetesh të vizituara nga CPT, vecanërisht në Europën qendrore dhe linore; qelitë me disa të burgosur shesh kanë kapacitet të madh dhe kanë të gjitha pajisjet e nevojshme për të plotësuar nevojat ditore të të burgosurve, si për shëmbull për të fjetur, për të jetuar si dhe për të kryer nevojat sanitare. CPT i kundërshton edhe parimisht këto komodime në burgjet e mbyllura dhe këto kundërshtime përforcohen kur, sic ndodh shpesh, fjetoret janë të tillë që I mbajnë të burgosurit nën kushte ekstremisht të ngushta dhe ndëshkuese. Ska dyshim që faktorë të ndryshëm- përfshirë ato të natyrës kulturore- mund ta bëjnë të preferueshme në disa shtete organizimin e akomodimit të të burgosurve në qeli të përbashkta se sa në qeli individuale. Megjithatë, ka shumë pak për të thënë në favour të – dhe ka shumë për të thënë kundër- organizimit të akomodimit në mënyrë të tillë ku dhjetra të burgosur jetojnë dhe flenë sëbashku në të njëjtën fjetore.

Fjetoret me kapacitet të madh nënkuptojnë detyrimisht mungesën e privatësisë të të burgosurve në jetën e tyre të përditshme. Për më tepër, rreziku i frikësimit dhe dhunës është i lartë. Këto akomodime janë të prirura të ushqejnë zhvillimin e nënkulturës e kriminelëve dhe të lehtësojnë mbajtjen e kohezionit të organizatave kriminale. Ato mund ta bëjnë ekstremisht të vështirë për të mos thënë të pamundur, kontrollin për stafin; më specifikisht, në rastet e trazirave në burg, ndërhyrjet nga jashtë që përfshijnë përdorimin e forcës së konsiderueshme janë të vështira për tu shmangur. Me një akomodim të tillë, ndarja e duhur e të burgosurve e cila mund të shfaqë një rrezik rast pas rasti dhe ka nevojë për vlerësim, bëhet gjithashtu një punë e pamundur. Të gjitha këto probleme rëndohen kur numri I të burgosurve shkon përtej nivelit të arsyeshëm të popullimit; për më tepër, në një situatë të tillë ngarkesa në përdorimin e lavamanëve dhe banjove si dhe ajrosja e pamjaftueshme për aq shumë njerëz zakonisht con në kushte të mjerueshme.

CPT duhet të theksojë se përdorimi I qelive të vogla individuale në vend të fjetoreve me kapacitet të madh, duhet të shoqërohet me masa që të sigurojnë që të burgosurit të harxhojnë një pjesë të mirë të ditës të angazhuar në aktivitete të natyrave të ndryshme jashtë qelive të tyre.” *CPT, GR 11, §29*

“Të gjitha ambientet që përdoren nga ose për të burgosurit duhet të mbahen gjithmonë të pastra. Në përgjithësi janë të burgosurit vet që kujdesen për mirëmbajtjen e ambienteve të tyre. Në këto kushte atyre duhet tu sigurohen mjetet dhe produktet e nevojshme për kryerjen e kësaj detyre.” *Rek. 99 Komitetit i Ministrave*

Shiko gjithashtu *ACPR, A-11 dhe IDRCPLD, neni.11 paragrafet 1 dhe 2, dhe neni 31.*

## **Komente**

Në shumë kontekste, mbipopullimi në ambientet e burgimit është një problem madhor dhe një burim e një sër problemesh sekondare serioze në fushën e trajtimit, shëndetit, sigurisë dhe rehabilitimit. Duke folur në përgjithësi, standartet ndërkombëtare nuk specifikojnë hapësirën minimale për çdo të burgosur. Gjatë viteve të fundit CPT ka filluar të lëvizë në këtë drejtim. Ajo rekomandon që një qeli e vetme nuk duhet të jetë më pak se 7m<sup>2</sup>. Për qelitë me shumë të burgosur, CPT ka përcaktuar se përmasat e tyre duhet të jenë: 10m<sup>2</sup> për dy të burgosur, 21m<sup>2</sup> për 5 të burgosur, 35m<sup>2</sup> për 7 të burgosur dhe 60m<sup>2</sup> për 12 të burgosur.

Mekanizmat vizitues kanë nevojë të dinë kapacitetin maksimal zyrtar të ambienteve të ndryshme të

burgut dhe bazën mbi të cilën këto hapësira janë përlllogaritur. Zakonisht kjo bazë është marrëdhënia midis sipërfaqes së ambientit dhe numrit të personave që e zënë atë. Megjithatë vizitorët nuk duhet të mbështeten në formula matematikore; do të ketë gjithmonë elementë të tjerë të rëndësishëm si për shëmbull sasia e kohës që kalohet në ambientin përkatës gjatë 24 orëve, dhe struktura e vecantë e vëndit të burgimit. Çdo I burgosur duhet të ketë të paktën një krevat të vecantë.

Grupi vizitues duhet t'i drejtojë vërejtje dhe rekomandimet e tij në lidhje me mbipopullimin tek një numër autoritetesh të ndryshme të cilat janë në pozitën për të marrë masat e nevojshme. Rekomandimet për të përmirësuar situatën do të varen nga konteksti. Rekomandimi mund të jetë që hapësira e papërdorur në një burg të vecantë mund të përshtatet për të lehtësuar ambientet e mbipopulluara. Mekanizmat vizitues mund të propozojnë reforma ligjore ose gjyqësore dhe të promovojnë alternativat e burgimit. Organet vizituese duhet të jenë të ndërgjegjshme se ndërtimi I vëndeve të tjera të burgimit është rrallë herë një zgjidhje.

Standartet ndërkombëtare rekomandojnë akomodimin individual në krahasim me akomodimin kolektiv. Në kontekstin e disa kulturave mund të ekzistojë preferenca midis të burgosurve për tu akomoduar në një dhomë të përbashkët me përmasa të përshtatshme. Akomodimi kolektiv duhet të jetë i kufizuar për sa i përket numrit të personave që e ndajnë atë dhe është e rëndësishme që personat që ndajnë qelinë të përzgjidhen, në mënyrë që të kufizohet rreziku I abuzimit ndërmjet të burgosurve.

Vizitorët duhet ti kushtojnë vëmendje pastërtisë së qelive të të burgosurve.

#### **Pika referimi**

- A janë qelitë të përshtatshme për sa i përket: - metrave katror për person? –sasisë së orëve që personat kalojnë në qelitë e tyre (sasinë e orëve që kalojnë të mbyllur në qeli gjatë 24 orëve) ? –ventilimit dhe sasis së ajrit që qarkullon kur qelitë janë të mbyllura? – kohëzgjatjen e planifikuar të burgimit? A kanë të gjithë të burgosurit krevatin e tyre personal?
- A mireëmbahen rregullisht qelitë dhe a vihen në dispozicion materiale për pastrimin e tyre?
- Në qelitë e përbashkëta: Cila është përbërja e personave që ndajnë të njëjtën dhomë dhe cilat janë kriteret e përzgjedhjes së tyre?
- A ndahet hapësira në qelitë e përbashkëta, në mënyrë të drejtë dhe jodiskriminuese?
- Në rastet e mbipopullimit: A ka hapësira jashtë qelive dhe fjetoreve të cilat janë të papërdorshme dhe mund të adaptohen?

#### **Për lexime të mëtejshme**

PRI, *Si ti bësh standartet të funksionojnë*, Londër 2001. (Seksioni III Kushtet fizike – Nevojat bazë, f.55-68)

UN HCHR, *Të drejtat e njeriut dhe burgjet*, Gjenevë 2003. (Seksioni 3: E drejta për një standart të përshtatshëm jetese, f.34-45)

AI, *Të luftosh torturën*, Londër 2003. (*Kapitulli 5 Kushtet e burgimit*, f. 120-122)

## **4. REGJIMI DHE AKTIVITETET**

Përgjegjësitë e autoriteteve të burgimit shkojnë përtej sigurimit të një ambienti fizik të përshtatshëm. Autoritetet duhet të inkurajojnë zhvillimin personal të të burgosurve dhe të lehtësojnë riintegrimin në shoqëri pas lirit. Kjo është në interes si të burgosurve ashtu dhe të shoqërisë si një e tërë. Vizitat familjare, arsimimi, trajnimi profesional dhe puna dhe aktivitetet argëtuese duhet të konsiderohen nga kjo perspektivë. Këto aktivitete nuk janë favore por të drejta për të gjithë të burgosurit.

Si përfaqësues të shoqërisë civile dhe zakonisht të komunitetit lokal, vërejtjet, rekomandimet dhe madje edhe suporti në praktikë i mekanizmave vizitues mund të jetë me një vlerë të veçantë për autoritetet në përmbushjen e kësaj detyre sfiduese.

Është thelbësore për mirëqenien fizike dhe mendore të atyre që janë subjekt i të gjitha formave të privimit të lirisë, përfshirë këtu të burgosurit që merren në pyetje dhe ata që janë nën burgim paragjyqësor, që ata të kalojnë kohë jashtë qelive të tyre dhe të përfshihen në aktivitetet të qëllimshme të natyrave të ndryshme.

Mekanizmat vizitues mund të kontrollojnë nëse sigurimi i një regjimi të përshtatshëm shikohet si një qëllim i rëndësishëm nga autoritetet e burgut. Vizitorët duhet të sigurohen se janë marrë masat e duhura për vizitat familjare, aksesin për arsimim, trajnim profesional dhe punë (e fundit nuk duhet të jetë e detyrueshme për të burgosurit e padënuar).

Është e rëndësishme të konsiderohet nëse aktivitetet që sigurohen në vendin e burgimit janë të rëndësishme për botën e jashtme, për shembull nëse trajnimi profesional dhe puna i korrespondojnë nevojave të tregut të jashtëm të punës dhe nëse standartet e arsimimit janë ekuivalente me ato jashtë mureve të burgut.

### **Regjimi dhe aktivitetet**

- Kontakti me familjen dhe shoqërinë
- Kontakti me botën e jashtme
- Arsimimi
- Gjimnastika përjashta
- Aktivitetet argëtuese
- Feja
- Puna

### **Kontaktet me familjen dhe shoqërinë**

#### **Standartet**

“Pavarësisht përjashtimeve të parashikuara nga parimi 16, paragrafi 4, dhe nga parimi 18, paragrafi 3, komunikimi i të paraburgosurit ose të burgosurit me botën e jashtme dhe në vecanti me familjen ose avokatin e tij, nuk duhet të mohohet për më shumë se disa ditë.” *BPP, Parimi 15*

“Një person i paraburgosur ose i burgosur duhet të ketë të drejtën të vizitohet nga dhe të mbaj korrespondencë me anëtarët e familjes së tij dhe duhet ti jepen mundësit e duhura për të komunikuar me botën e jashtme, në kushte të arsyeshme dhe me kufizimet e parashikuara nga ligji ose rregulloret.” *BPP, Parimi 19*

“Të burgosurit duhet të lejohen të komunikojnë, nën mbikëqyrjen e nevojshme, me familjen dhe shokët e tyre, në intervale të rregullta, nëpërmjet korrespondencës dhe vizitave.” *SMR, Rregulli 37*

“Të burgosurit e pagjykuar duhet të lejohen të informojnë menjëherë familjen për burgimin e tyre dhe duhet tu krijohen të gjitha lehtësitë e arsyeshme për të komunikuar me familjen dhe shokët e tyre dhe për të patur vizita prej tyre, duke qenë subjekt i mbikëqyrjes dhe kufizimeve që janë në interes të administrimit të drejtësisë, sigurisë dhe rendit në institucion.” *SMR, Rregulli 92*

“Është gjithashtu shumë e rëndësishme për të burgosurit të mbajnë kontakte të mira me botën e jashtme. Mbi të gjitha, një i burgosur duhet të ketë të gjitha mjetet për mbrojtjen e marrëdhënieve të tij me familjen dhe shokët e ngushtë. Parimi udhëheqës duhet të jetë promovimi i kontaktit me botën e jashtme; çdo kufizim i këtyre kontakteve duhet të bëhet ekskluzivisht për arsye të sigurie.

CPT dëshiron të theksojë në këtë kontekst nevojën për pak fleksibilitet në lidhje me aplikimin e rregullave për vizitat dhe kontaktet telefonike të të burgosurve familjartë e të cilëve jetojnë largë (gjë që I bënë vizitat e rregullta të pamundura). Për shembull, këtyre të burgosur mund tu lejohet të mbledhin kohën e vizitave dhe/ose tu ofrohet një mundësi më e përmirësuar për kontakte telefonike me familjarët e tyre.” *CPT, GR 2, § 51*

“Shetet duhet:

Të sigurojnë që të gjithë personat e privuar nga liria e tyre të kenë (...) të drejtën të vizitohen nga dhe të kenë korrespondencë me anëtarët e familjes.” *RIG, dispozita 31.*

Shiko gjithashtu *CDD, A-8-b), B-1-f) dhe B-3-b) dhe IDRCPL, neni 36 para. 1 dhe 2 dhe neni 38*

#### **Të rinjtë**

“Të rinjtë duhet të lejohen të komunikojnë me familjarët, shokët e tyre dhe persona të tjerë ose përfaqësues të organizatave të jashtme, të largohen nga ambientet e burgimit për të vizituar shtëpinë

dhe familjen e tyre dhe të kenë leje të veçantë për tu larguar nga ambientet e burgimit për arsimim, trajnim profesional ose çdo arsye tjetër të rëndësishme(...).” *RPJDL, Rregulli 59.*

“Sipas nenit 10, paragrafi 3, shkelësve të rinjë duhet (...) tu sigurohet trajtim i përshtatshëm për moshën e tyre dhe statusin e tyre ligjor për sa i përket kushteve të burgimit (...), si për shëmbull duhet tu sigurohet kontakt me të afërmit, me qëllim për të ndihmuar riformimin dhe rehabilitimin e tyre.” *GC 21 para. 13.*

Shiko gjithashtu *RPJDL 60, 61 dhe 62 dhe IDRCPDL neni 39.*

## **Komente**

Mekanizmat vizitues duhet të jenë të ndërgjegjshëm që kushtet e aksesit tek familja janë shumë të rëndësishme. Shumica e të burgosurve do të kthehet një ditë lirisë. Nëse ata lejohen dhe inkurajohen të mbajnë sa më shumë lidhje me familjarët dhe shokët e tyre, kjo do të lehtësojë riintegrimin e tyre pasi të lirohen.

Vizitorët duhet të monitorojnë nëse mbahet një balancë e shëndetshme midis nevojës për siguri dhe humanitetit. Kontakti me familjen dhe shokët nuk duhet të jetë një privilegj për disa të burgosur por një e dretë për të gjithë. Të burgosurit nuk duhet të privohen nga vizitat dhe komunikimi si masë disiplinore. Kontrollat dhe kontrollat trupore duhet të kryhen sic duhen, me respekt dhe takt. Të drejtat e anëtarëve të familjes dhe shokëve janë gjithashtu me interes për mekanizmat vizitues.

Vizitat janë mënyra më e mirë për mbajtjen e lidhjeve. Mekanizmat vizitues duhet të monitorojë kushtet në të cilat zhvillohen vizitat, pasi ky është një standart matës për respektin që i akordohet të burgosurve dhe familjarëve të tyre nga autoriteti i burgut. Vizitat private ose familjare të cilat zhvillohen në dhoma të vecanta duke mundësuar më shumë intimitet duhet të inkurajohen. Kjo duhet të shtrihet dhe më tej duke siguruar vizita intime (bashkëshortore) me partnerin. Në mënyrë që të lehtësohen vizitat e rregullta me familjen, të burgosurit duhet të mbahen në vendin e duhur të burgimit I cili gjëndet sa më afër shtëpisë së tyre.

Grupi vizitues duhet të kontrollojë me të burgosurit nëse kushtet për komunikimin me telefon janë të përshtatshme (veçanërisht për shtetasit e huaj) dhe nëse të burgosurit marrin postën të paprekur dhe në kohë. Mekanizmat vizitues duhet të jenë në dijeni të llojit të sistemit të censurimit ose monitorimit që ekziston në vendin përkatës dhe nëse ky system është proporcional me rreziqet potenciale që prezanton individi konkret. Situata e të burgosurve të huaj kërkon vëmendje të përqëndruar. Mekanizmat vizitues duhet të monitorojnë se çfarë suporti është i disponueshëm për zgjidhjen e problemeve të vecanta që hasen për sa i përket kontaktit me familjen dhe shokët, aranzhimeve të lirimit dhe kthimit në shtetin vëndas.

Të rinjtë dhe gratë kërkojnë gjithashtu vëmendje të vecantë nga mekanizmat vizitues. Statusi delikat i të rinjve e bënë veçanërisht të rëndësishme për riintegrimin e tyre mbajtjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve të tyre me familjarët dhe në vecanti me prindërit. Gratë në shumë kultura kanë përgjegjësinë për kujdesin ndaj fëmijës, dhe burgimi i një nëne prek fëmijët e saj. Mekanizmat vizitues duhet të monitorojnë sfarë masash speciale zbatohen për të asistuar familjet e grave dhe të rinjve të burgosur, për shkak të distancës më të madhe që ata normalisht duhet të përshkojnë për të bërë vizitën (vëndet ku mbahen gratë dhe të rinjtë janë më të pakta në numër dhe ka më shumë mundësi që të jenë të vendosura larg shtëpive të tyre)

Mekanizmat vizitues duhet të kontrollojnë se çfarë masash merr burgu për të rivendosur kontaktin për të burgosurit që kanë humbur lidhjet me familjen e tyre për shkak të konflikteve të armatosura ose fatekeqësive natyrore. Burgu duhet të lidhet me Agjensinë Qëndrore të Gjurmimit ICRC, direct ose nëpërmjet Kryqit të Kuq Kombëtar ose Shoqërisë së Kuqe në Britje.

## **Pika referimi**

### **Vizitat**

- Sa shpesh janë vizitat nga personat e jashtëm të autorizuar?
- Sa zgjatën këto vizita?

- A ka kufizime në vizita për kategori të caktuara të burgosurish?
- Në qoftë se po, mbi çfarë bazash vendosen këto kufizime?
- Si priten familjarët në vendin e burgimit?
- Çfarë informacioni sigurohet për ti mundësuar familjes të kontaktojë dhe vizitojë një anëtar të familjes të burgosur?
- A ka ndonjë kusht të veçantë për kontaktin me fëmijët?
- A siguron burgju ose një agjensi e jashtëm një ndërtesë ku familjarët të presin?
- Cilat janë kushtet materiale të vizitave?
- Cili është niveli i mbikëqyrjes së vizitave?
- A bënë burgju ndonjë arranzhim alternativ për të burgosurit që nuk kanë kurrë vizita nga jashtë?
- A ka arranzhime të vecanta për kontaktin me familjen për shtetasit e huaj (në veçanti për sa i përket telefonatave)?

### **Korrespondenca**

- A është posta objekt i censurës?
- Në qoftë se po, cilat janë kriteret për censurimin dhe a u bëhen këto kriteret të ditura stafit dhe personave të privuar nga liria e tyre?
- Cilat janë kushtet për marrjen e pakove? Sa shpesh mund të merren pakot?

### **Telefonatat**

- A ka ndonjë mundësi për të burgosurit që të bëjnë telefonata?
- Sa shpesh? Cili është sistemi i pagesës?
- A është akses i vizitave, korrespondenca dhe telefonatat i shpërndarë në mënyrë të drejtë, transparente dhe jodiskriminuese?

### **Kontakti me botën e jashtme**

#### **Standartet**

“1. Një person i paraburgosur ose i burgosur duhet të mund të komunikojë dhe të konsultohet me një avokat.

1 Një personi të paraburgosur ose të burgosur duhet ti jepet koha e përshtatshme dhe ambiente për tu konsultuar me avokatin e tij.

2 E drejta e një të paraburgosuri ose të burgosuri për tu vizituar, për tu këshilluar dhe për të komunikuar pa vonesë ose censurë dhe në konfidencë të plotë me avokatin e tij nuk mund të pezullohet ose kufizohet me përjashtim të rasteve përjashtimore të parashikuara nga ligji ose rregulloret, dhe kur konsiderohet e domosdoshme nganjë autoritet gjyqësor ose i një natyre tjetër me qëllim për të ruajtur sigurinë dhe rendin.

3 Intervistat midis një personi të paraburgosur ose të burgosur dhe avokatit të tij mund të vëzhgohen por jo të dëgjohen nga nëpunësit e zbatimit të ligjit.” *BPP, Parimi 18* (shiko gjithashtu *SMR Rregulli 93*)

“Të burgosurit duhet të mbahen rregullisht të informuar rreth lajmeve më të rëndësishme duke lexuar gazetatat, botimet periodike ose publikimet e vecanta institucionale, duke dëgjuar trasmetimet pa kabëll, nëpërmjet leksioneve ose nëpërmjet mënyrave të ngjashme të autorizuara ose kontrolluara nga administrata.” *SMR, Rregulli 39*

#### **Të rinjtë**

“Duhet të sigurohet me çdo mjet që të rinjtë të komunikojnë me botën e jashtme, pasi kjo është pjesë e të drejtës së tyre për trajtim të drejtë dhe njerëzor dhe është thelbësore për përgatitjen e tyre për tu kthyer në shoqëri.” *RPJDL, Rregulli 59*

#### **Të huajt**

“1. Të burgosurit që janë shtetas të huaj duhet tu krijohen lehtësi për të komunikuar me përfaqësuesit diplomatik dhe konsullor të shtetit të tyre.

2. Të burgosurve që janë shtetas të shteteve pa përfaqësues diplomatik ose konsullor në vendin përkatës dhe personave pa shtetësi duhet tu sigurohen lehtësi të njëjta për të komunikuar me përfaqësuesit diplomatik të shtetit që mbrojnë interesat e tyre ose të çdo autoriteti kombëtar ose ndërkombëtar detyra e të cilit është të mbrojë këta persona.” *SMR, Rregulli 38.*

“Me qëllim lehtësimin e funksioneve avokatore në lidhje me shtetasit e vendit dërgues:

- (a) nëpunësit konsullor duhet të jenë të lirë të komunikojë me shtetasit e vendit dërgues dhe të ketë akses tek ata. Shtetasit e vendit dërgues duhet të kenë të njëjtën liri për të komunikuar dhe për të patur akses tek nëpunësit konsullor të shtetit dërgues;
- (b) në qoftë se kërkohet një gjë e tillë, autoritetet kompetente të shtetit pritës duhet të njoftojnë pa vonesë zyrën konsullore të shtetit dërgues në qoftë se një shtetas i atij shteti është arrestuar ose burgosur ose është burgosur në pritje të gjyqit ose është ndaluar në ndonjë mënyrë tjetër. Çdo komunikim i personit të arrestuar, të burgosur, të burgosur ose të ndaluar drejtuar zyrës konsullore duhet të përcillet nga autoritetet përkatëse, pa vonesë. Autoritetet përkatëse duhet të informojnë pa vonesë personin e interesuar rreth të drejtave të tij sipas nënparagrafit të më poshtëm:
- (c) nëpunësit konsullor duhet të kenë të drejtën të vizitojnë shtetasit e shtetit dërgues të cilët janë ndaluar, arrestuar, burgosur për të biseduar me të për të arranzhuar përfaqësimin e tij ligjor. Ata duhet të kenë gjithashtu të drejtën për të vizituar çdo shtetas të shtetit dërgues të ndaluar, arrestuar ose të burgosur në vijim të një vendimi gjyqësor. Pavarësisht kësaj nëpunësit konsullor nuk duhet të ndërmarrin veprime për llogari të shtetasit të burgosur, arrestuar ose ndaluar në qoftë se ai e ka kundërshtuar shprehimisht një veprim të tillë.

E drejta e referuar në paragrafin 1 të këtij neni duhet të ushtrohet në përputhje me ligjet dhe rregulloret e shtetit pritës, me kusht që këto ligje dhe rregullore të mundësojnë efekt të plotë qëllimeve për të cilat janë parashikuar këto të drejta.” *Konventa e Vienës për Marrëdhëniet Konsullore, Neni 36.*

### **Komente**

Mekanizmat vizitues duhet të flasin me të burgosurit rreth çdo vështirësie që ata mund të kenë për të kontaktuar me personat e lejuar. Komunikimi me avokatin në konfidencë dhe pa ndërhyrje, është i një rëndësie të vecantë për të gjithë të burgosurit. Të burgosurit duhet të jenë gjithashtu në gjëndje të kenë kontakte me përfaqësues fetar sipas zgjedhjes së tyre (shiko seksionin: Feja)

Të burgosurit e huaj duhet të kenë të drejtën të kenë kontakt me përfaqësuesit diplomatik të shtetit të tyre ose në qoftëse nuk ka përfaqësues të tillë diplomatik, me përfaqësuesit e shtetit ose organizatës që i përfaqëson ose i mbrojnë ata. Në qoftë se një shtetas i huaj nuk dëshiron të njoftojë trupat diplomatike të vendit të tij kjo dëshirë duhet respektuar. Personat që deklarojnë statusin e refugjatit kanë të drejtën të vizitohen nga një përfaqësues i zyrës së Komisionierit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët.

Kontakti me botën e jashtme nënkupton gjithashtu se të burgosurit mund të jenë në kontakt me zhvillimet e shoqërisë së tyre. Mekanizmat vizitues duhet të monitorojnë nëse të burgosurit, në vaçanti ata të burgosur për një kohë të gjatë, të kenë akses tek media, përfshirë gazetatat, revistat, radion dhe televizionin.

Mekanizmat vizitues duhet të jenë të ndërgjegjshëm për të drejtat e të burgosurve sipas ligjit kombëtar në lidhje me votën dhe të kontrollojnë nëse ata mund ta ushtrojnë këtë të drejtë në praktikë.

### **Pika referimi**

Akcesi tek avokati

- A kanë mundësi të burgosurit për të komunikuar lirisht dhe në konfidencë me avokatin e tyre?
- Në çfarë kushtesh zhvillohen vizitat me avokatin?
- Kontakti i shtetasve të huaj me botën e jashtme
- A kanë të gjithë shtetasit e huaj kontakt me përfaqësuesit diplomatik të shtetit të tyre?
- Çfarë i ka ndodhur atyre që kanë refuzuar kontaktin?
- Çfarë ndodh në qoftë se përfaqësitë diplomatike nuk i përgjigjen kërkesave të të burgosurve të shteteve të tyre (vecanërisht e rëndësishme në rastet e humbjes ose skadimit të dokumentave kombëtare)?

- Aksesit tek informacioni i jashtëm
- Çfarë aksesit kanë personat e privuar nga liria tek media (gazetat, televizioni)?
- A ka ndonjë kufizim dhe cilat janë kriteret?
- A i siguron burgut të burgosurve akses tek radio ose televizioni apo lehtëson një akses të tillë?
- A sigurojnë autoritete furnizimin me gazeta, revista ose botime të tjera periodike, pa pagesë? Nëse jo, a kanë mundësi të burgosurit ti blejnë ose ti marrin ato?

## Arsimimi

### Standartet

“1. Duhet të merren masa për arsimimin e mëtijshëm të të gjithë të burgosurve të aftë për të përfutur prej tij, përfshirë mësimdhënien fetare në vendet ku kjo është e mundur. Arsimimi I të burgosurve analfabet dhe të rinj duhet të jetë e detyrueshme dhe duhet ti kushtohet vëmendje e vecantë nga administrata.

2. Arsimimi i të burgosurve duhet të jetë i integruar me sistemin arsimor të shtetit në mënyrë që pas lirimt të burgosurit të mund të vazhdojnë arsimimin e tyre pa vështirësi.” *SMR, Rregulli 77*

“Të gjithë të burgosurit duhet të kenë të drejtën të marrin pjesë në aktivitete kulturore dhe arsimore që synojnë zhvillimin e plotë të personalitetit njerëzor.” *BPTD, Parimi 6*

“Çdo institucion duhet të ketë një program arsimor për të siguruar mundësinë të gjithë të burgosurve për të ndjekur të paktën disa prej nevojave dhe aspiratave të tyre. Këto programe duhet të kenë si objektive të tyre përmirësimin e perspektivës për një rifutje të sukseshme në shoqëri, e moralit dhe sjelljes së të burgosurve dhe vetrespektit të tyre.” *EPR, Rregulli 77*

“Arsimimi duhet të konsiderohet si një aktivitet që ka të njëjtin status dhe shpërblimin bazë si puna, me kusht që të zhvillohet gjatë orareve normale të punës dhe të jetë pjesë e një programi të autorizuar për trajtimin individual.” *EPR, Rregulli 78*

“Të gjithë të burgosurit duhet të kenë akses tek arsimimi, i cili përfytyrohet të konsistojë në zhvillimin e temave në klasë, edukimin profesional, aktivitetet argëtuese dhe kulturore, ushtrimet fizike dhe sportive, edukimin social dhe librarinë.” *R(89)12, §1*

“h) Kurdoherë që është e mundur, të burgosurit duhet të lejohen të marrin pjesë në arsimimin jashtë burgut;

i) Kur arsimimi duhet të zhvillohet brenda burgut, komuniteti i jashtëm duhet të përfshihet sa më shumë të jetë e mundur.” *Rezoluta 1990/20 e Këshillit Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara për arsimimin në burgje.*

Shiko gjithashtu: Teksti i komplet i rekomandimit *R(89)12, §1 dhe rezolutën e ECOSOC 1990/20; SMR, Rregulli 82; EPR Rregulli 79 deri 82, si dhe rekomandimi I UNESCO për arsimimin në burgje.*

### Burgimi para-gjykimt

“Një program aktivitetesh i kënaqshëm (puna, arsimimi, sporti, etj) është me rëndësi thelbësore për mirëqënien e të burgosurve. Kjo është e vërtetë për të gjitha institucionet, si për të burgosurit e dënuar ashtu dhe për ata që janë në pritje të gjykimt. CPT ka vërejtur se aktivitetet në vendet e burgimit janë shumë të limituara. Organizimi i regjimit të aktiviteteve në këto vende – të cilat kanë qarkullim të shpeshtë të të burgosurve- nuk është një çështje e hapur. Është e qartë që nuk mund të kërkohen programe për trajtime individuale të natyrës që mund të aspirohen në institucionet e të burgosurve të dënuar. Megjithatë, të burgosurit nuk mund të lihen të brengosen për javë të tëra, mundësisht muaj, të mbyllur në qelitë e tyre, dhe kjo pa marrë parasysh sesa të mira janë kushtet materiale në qeli. CPT konsideron se të burgosurit në vendet e burgimit duhet të jenë në gjëndje të kalojnë një pjesë të mirë të ditë (8 orë ose më shumë) jashtë qelive të tyre, të angazhuar në aktivitete të natyrave të ndryshme. Sigurisht, regjimet në institucionet e të burgosurve të dënuar duhet të jenë akoma më shumë të favorshme.” *CPT, GR 2, §47*

### Gratë

“Gratë e privuara nga liria e tyre duhet të gëzojnë akses ndaj veprimtarive kuptimplotë (puna,



trajnimi, arsimimi, sporti, etj) në pozita të barabarta me homologët e tyre meshkuj. Delegacionet e CPT shumë shpesh vërejnë se grave të burgosura u ofrohen aktivitete që konsiderohen “si më të përshtatshme” për to (si qepjet dhe punimet me dore) ndërkohë që të burgosurve meshkuj u ofrohen trajnime me natyrë më profesionale. Sipas pikëpamjes së CPT-s, një sjellje kaq diskriminuese mund të shërbejë vetëm për të përforcuar stereotipin e dalë nga moda të rolit shoqëror të gruas. Për më tepër, në varësi të rrethanave, ti mohosh grave akses të barabartë ndaj aktiviteteve mund të cilësohet si trajtim degradues.” *CPT GR 10, § 25*

Shiko gjithashtu *ACPR, A-14-a) dhe IDRCPLD, neni 35*.

### **Të rinjtë**

“Çdo i ri në moshë për të ndjekur shkollimin e detyrueshëm ka të drejtën për të ndjekur arsimin e përshtatshëm sipas nevojave dhe aftësive të tij dhe të projektuar për ta përgatitur atë për tu kthyer në shoqëri. Një arsimim I tillë duhet të sigurohet jashtë ambienteve të burgut në shkollat publike kudo që është e mundur dhe, në çdo rast, nga mësues të kualifikuar dhe nëpërmjet programeve të integruara me sistemin arsimor në qytet, në mënyrë që pas lirim të tyre, të rinjtë të mund të vazhdojnë arsimimin e tyre pa vështirësi (...).” *RPJDL, Rregulli 38*.

“Të rinjtë në moshë më të madhe se sa për të ndjekur shkollimin e detyrueshëm të cilët dëshirojnë të arsimohen, duhet të lejohen dhe inkurajohen për të bërë një gjë të tillë, dhe duhet bërë çdo përpjekje për t’i siguruar atyre akses të përshtatshëm ndaj programeve arsimore.” *RPJDL, Rregulli 39*.

### **Komente**

Mekanizmat vizitues do tu duhet të kontrollojnë se çfarë arsimimi sigurohet dhe mënyrën sesi përcaktohet përparësia në sistemin e burgut.

Arsimimi është një element i rëndësishëm në përgatitjen e të burgosurve për riintegrimin e tyre në shoqëri dhe për të stimuluar zhvillimin personal të të burgosurve. Ai gjithashtu mund ti përgjigjet nevojave specifike të popullsisë së burgut, si për shëmbull mësimit të gjuhës vëndase ose mësimit të shkrimit, këndimit dhe numërimit.

Standartet ndërkombëtare e përcaktojnë arsimimin si një element të arritjeve integruese për programin e rehabilitimit individual që përgatit të burgosurit për lirin e tyre, në përputhje me nevojat dhe potencialet e tyre.

Nga pikëpamja e riintegrimin në shoqëri dhe kontaktit me botën e jashtme, është një avantazh i madh në qoftë se veprimtaritë arsimore sigurohen nga anëtarët e komunitetit (për shëmbull nga shkollat ose kolegjet lokale, nga mësuesit e shkollave lokale). Këto veprimtari mund të zhvillohen edhe në komunitet. Kualifikimet e marra duhet të njihen në botën e jashtme.

Arsimimi duhet të shpërblehet njësoj si puna.

### **Pika referimi**

- Çfarë lloj arsimimi ofrohet?
- Sa është përqindja e të burgosurve që marrin pjesë në veprimtaritë arsimore?
- A mundet që të burgosurit që duan një gjë të tillë, të kenë akses ndaj veprimtarive arsimore?
- Çfarë statistikash mbahen në lidhje me aksesin ndaj arsimimit dhe arritjet e tij?
- A është arsimimi I disponueshëm, në përputhje me qëllimet e tij? A janë veprimtaritë të përshtatshme për nevojat individuale dhe nevojat e kategorive të vecanta të të burgosurve (për shëmbull për shtetasit e huaj)?
- A shpërblehet arsimimi?
- A realizohet mësimdhënia dhe trajnimi nga mësues ose trajnues të jashtëm?
- Çfarë kushtesh aplikohen për aksesin e të burgosurve në library?
- A ka në librari punime të cilat janë në një gjuhë të ndryshme nga ajo që flasin të burgosurit?
- A kanë gratë akses ndaj arsimimit me cilësi të njëjtë dhe sipas të njëjtave kushteve sit ë burgosurit meshkuj?
- A krahasohen mundësitë për arsimim të të burgosurve me ato të disponueshme në botën e jashtme?
- A sigurohet aksesin ndaj arsimimit në një mënyrë të drejtë dhe diskriminuese?

## Gjinnastika përjashta

### Standartet

“1.Çdo i burgosur i cili nuk merret me punë përjashta duhet të kryej të paktën një orë në ditë gjinnastikë, në ajër të pastër, në qoftë se moti e lejon.

2.Të burgosurit e rinj dhe të tjerët me moshë dhe fizik të përshtatshëm, duhet të kenë trajnim fizik dhe clodhës gjatë periudhës së gjinnastikës. Për këtë qëllim duhet të sigurohen pajisjet e nevojshme.”  
*SMR, Rregulli 21*

“Çdo i burgosur që nuk është i angazhuar me punë përjashta, duhet ti lejohet të paktën një orë në ditë të eci ose të bëjë gjinnastikë në ajër të pastër, dhe për aq sa është e mundur i mbrojtur nga koha me shi.” *EPR, Rregulli 86*

“Referim i veçantë duhet t’i bëhet gjinnastikës përjashta. Kërkesa që të burgosurit të lejohen të paktën një orë në ditë të bëjnë gjinnastikë në ajër të pastër është pranuar gjerësisht si një element themelore (është e preferueshme që të jetë pjesë e një programi aktiviteteve, shumë më të madh). CPT dëshiron të theksojë që të gjithë të burgosurit pa përjashtim (përfshirë ata që janë të izoluar si ndëshkim) duhet ti ofrohet mundësia për të bërë gjinnastikë përjashta çdo ditë. Është gjithashtu e pakundërshtueshme që ambientet e gjinnastikës përjashta duhet të jenë me hapësirë të arsyeshme dhe kurdoherë që është e mundur të ofrojnë mbrojtje nga koha me shi.” *CPT, GR 2, §48*

Shiko gjithashtu *ACPR, A-11 dhe IDRCPLD, neni 33*.

### Të rinjtë

“Çdo i ri duhet të ketë të drejtën të ketë kohë për gjinnastikë në ajër të pastër, nëse moti e lejon, gjatë të cilës duhet të sigurohet normalisht stërvitje fizike dhe clodhëse. Hapësirë dhe pajisje të përshtatshme duhet të sigurohen për kryerjen e këtyre aktiviteteve. (...)”*RPJDL, Rregulli 47*.

### Komente

Mekanizmat vizitues do të duhet të flasin me të burgosurit dhe stafin për të kontrolluar që të paktën një orë në ditë sigurohet rregullisht aktivitet fizik për të gjithë të burgosurit pa përjashtim. Megjithatë, koha e kaluar jashtë qelisë ose fjetores nuk duhet të kufizohet vetëm në këtë periudhë, veçanërisht nëse burgimi zgjat më shumë se disa ditë.

Gjatë gjinnastikës të burgosurit duhet të kenë akses në zona relativisht të mëdhaja dhe mundësisht të kenë mundësi të shikojnë pemë e bimësi. Oborret e vogla me mure- nuk mund të konsiderohen se përmbushin detyrimin për të krijuar mundësinë për tu ushtruar në ajër të pastër.

Mekanizmat vizitues duhet të vërejnë mënyrën sesi zhvillohet gjinnastika përjashta, të vizitojnë vendet të parashikuara për këtë qëllim dhe të vërejnë se çfarë aktiviteteve janë në dispozicion të të burgosurve gjatë kohës së gjinnastikës.

### Pika referimi

- A respektohet rregulli sipas të cilit duhet të sigurohet një orë ushtrime fizike në ajër të pastër për të gjithë të burgosurit?
- Cilat janë përmasat dhe natyra e ambientit të ushtrohen të burgosurit?
- Gjatë kohës së dedikuar ushtrimeve përjashta. Çfarë aktiviteteve mund të kryejnë të burgosurit (sport, ecje?)
- Sa është koha që kalohet jashtë qelisë?
- Kur koha që kalohet jashtë qelisë ose fjetores është e kufizuar, çfarë arsyes jep stafi për këtë kufizim:
  - një regjim burgimi ekstremisht shtypës,
  - një infrastrukturë sigurimi e dështuar,
  - personel të pamjaftueshëm,
  - arkitektura dhe hapësira e disponueshme,
  - kufizime afatshkurtra për shkak të ngjarjeve të veçanta,
  - të tjera.

## Argëtimi dhe aktivitetet kulturore

### Standartet

“Aktivitetet shplohëse dhe kulturore duhet të sigurohen në çdo institucion për të mirën e shëndetit mendor dhe fizik të të burgosurve.” *SMR, Rregulli 78* (shiko gjithashtu Rregullin 82)

“Një person i paraburgosur ose i burgosur duhet të ketë të drejtën të ketë brenda limiteve të burimeve të disponueshme, një sasi të arsyeshme materialesh edukative, kulturore dhe informative, duke qenë subjekt i kushteve të arsyeshme që ruajnë rendin dhe sigurinë në vendin e burgimit dhe burgimit.” *BPP, Parimi 28*

“Çdo institucion duhet të ketë një librari që të përdoret nga të gjithë kategoritë e të burgosurve, e cila të ketë si libra argëtues ashtu dhe udhëzues, dhe të burgosurit duhet të inkurajohen ta përdorin atë.” *SMR, Rregulli 40*

“Regjimi i burgut duhet të njohi rëndësinë që kanë ndaj shëndetit fizik dhe mendor aktivitetet e organizuara sic duhet për të siguruar clodhje dhe mbajtjen në formë të trupit.” *EPR, Rregulli 83*

“Për këtë, programe për edukimin fizik, sportin dhe aktivitete të tjera clodhëse duhet të organizohen brenda kuadrit dhe objektivave të regjimit trajtues dhe trajnues. Për këtë qëllim duhet të sigurohen ambientet dhe pajisjet e nevojshme.” *EPR, Rregulli 84*

Shiko gjithashtu *EPR, Rregulli 85 dhe ACPR, A-11*.

### Të rinjtë

“Projektimi i ambienteve të burgimit për të rinjtë dhe duhet të jetë në përputhje me qëllimin rehabilitues të trajtimit të tyre, dhe nevojave të të rinjve për privatësi, për tu shoqëruar me shokët dhe për të marrë pjesë në aktivitete sportive, ushtrime fizike dhe aktivitete argëtuese (...).” *RPJDL, Rregulli 32*

“Çdo i ri duhet të ketë kohë shtesë për aktivitete argëtuese, çdo ditë. Pjesë e kësaj kohe duhet të dedikohet, në qoftë se të rinjtë dëshirojnë një gjë të tillë, zhvillimit të aftësive artistike dhe zanateve. Ambientet e burgimit duhet të sigurojnë që të rinjtë të jenë fizikisht të aftë për të marrë pjesë në programet e mundshme të edukimit fizik. Edukimi dhe terapia mjekësore fizike duhet të sigurohet nën mbikëqyrjen e mjekut, ndaj të rinjve që kanë nevojë për të.” *RPJDL, Rregulli 47*.

### Komente

Si dhe në shoqëri në përgjithësi, personat që ndodhen në burgë kanë nevojë për aktivitete argëtuese. Sporti në vecanti mund të kontribuojë në mirëqenien e të burgosurve, pasi ai i mundëson atyre të harxhojnë energji fizike. Ai gjithashtu mund të promovojë marrëdhënien e mirë ndërmjet të burgosurve me njëri – tjetrin dhe me stafin. Mekanizmat vizitues duhet të monitorojnë përpjekjet e autoriteteve për të siguruar një gamë aktivitetesh për të kënaqur të burgosurit. Është e rëndësishme të njohësh se çfarë aktivitetesh janë të disponueshme dhe nëse ato përdoren për të mirën e të burgosurve.

### Pika referimi

- Çfarë aktivitetesh sportive janë të disponueshme për të burgosurit, sa shpesh dhe për sa kohë?
- Çfarë aktivitetesh të tjera, përfshirë aktivitetet kulturore, janë të disponueshme ?
- Në qoftë se gama e aktiviteteve dhe koha në dispozicion të tyre është e kufizuar, cilat janë arsyet që jepen për këtë kufizim dhe çfarë kuptoni ju se janë arsyet ?
- A ka një librari në vendin e burgimit ? Cilat janë kushtet e aksesit? A janë librat të disponueshëm në gjuhët e huaja që flasin të burgosurit?
- A ka ndonjë dhomë ose hapësirë që i dedikohet aktiviteteve argëtuese? Çfarë lloja aktivitetesh argëtuese janë të disponueshme?
- A është aksesin ndaj aktiviteteve të disponueshëm në mënyrë të barabarëtë për të gjithë dhe a e gëzojnë këtë akses të gjithë në mënyrë të drejtë, transparente dhe jodiskriminuese?

## Feja

### Standartet

“1. Në qoftë se institucioni ka një numër të mjaftueshëm të burgosurish të të njëjtit besim fetar, duhet të caktohet dhe miratohet një përfaqësues i atij besimi fetar. Nëse numri i të burgosurve e justifikon dhe kushtet e lejojnë, mund të mundësohet që ky përfaqësues të jetë me kohë të plotë.

1 Përfaqësuesi i caktuar dhe aprovuar sipas paragrafit 1, duhet të lejohet të kryej shërbesat e zakonshme dhe të kryej vizita private me të burgosurit e besimit të tij..

2 Aksesi tek një përfaqësues fetar nuk duhet ti refuzohet asnjë të burgosuri. Nga ana tjetër, në qoftë se ndonjë i burgosur kundërshton vizitën e një përfaqësuesi fetar, qëndrimi i tij duhet të respektohet plotësisht.” *SMR, Rregulli 41*

“Për aq sa është e praktikueshme, çdo I burgosur duhet të lejohet të kënaqi nevojat e jetës së tij fetare duke marrë pjesë në shërbesat që kryhen në institucion dhe të posedojë librat fetar.” *SMR, Rregulli 42*

“Megjithatë është e dëshirueshme të respektohet besimet fetare dhe normat kulturore të grupeve që u përkasin të burgosurit, kurdoherë që një gjë të tillë e kërkojnë kushtet rajonale.” *BPTD, Parimi 3*

“Për aq sa është e praktikueshme, çdo I burgosur duhet të lejohet të kënaqi nevojat e jetës së tij fetare , shpirtërore dhe morale duke ndjekur shërbesat ose takimet që zhvillohen në institucion dhe të posedojë librat dhe literaturën e nevojshme.” *EPR, Rregulli 46* (Shiko gjithashtu *EPR, Rregulli 47*)

Shiko gjithashtu *ACPR A-11 dhe IDRCPLD neni 43*.

### Komente

Liria e besimit fetar është një e drejtë themelore njerëzore, dhe të burgosurit duhet të kenë mundësinë e ushtrimit të saj, përfshirë këtu të drejtën kolektive për të marrë pjesë në shërbesat fetare. Megjithatë kjo nuk është një detyrim. Të burgosurit që nuk kanë ndonjë besim fetar dhe nuk dëshirojnë të praktikojnë ndonjë fe nuk duhet të detyrohen ta bëjnë një gjë të tillë ose të trajtohen në mënyrë diskriminuese.

Mekanizmat vizitues duhet të sigurohen që e drejta e kultit të mos kufizohet tek njerëzit që i përkasin besimit fetar të shimicës ose të shtetit dhe që të drejtat e grupeve në pakicë të mos harrohen.

Të burgosurit duhet të jenë në gjëndje të marrin vizita nga përfaqësuesit fetar dhe ky kontakt duhet të privat dhe të paktën të mos dëgjohet nga stafi i burgut.

### Pika referimi

- Cilat janë kriteret për caktimin e një përfaqësuesi fetar në vendin e burgimit (për shembull, një numër minimal besimtarësh)?
- Çfarë besimesh përfaqësohen nga pastorët e zgjedhur ose shërbesat e organizuara ? A i korrespondojnë ato besimeve fetare që praktikohen nga të burgosurit ?
- A u imponohen të burgosurve ndonjë kusht në mënyrë që ata të kenë akses tek përfaqësuesit fetar ?
- Ku, kur dhe sa shpesh kryhen shërbesat ? A janë kushtet e përshtatshme në vend për të lejuar pjesëmarrjen e të gjithë atyre që dëshirojnë? Sa është numri mesatar i pjesëmarrësve?
- A bëhen arranjime për ti mundësuar të burgosurve të ndjekin praktikat fetare në lidhje me ushqimin, veshjen, higjienën dhe lutjet private?

## Puna

### Standartet

“Duhet të krijohen kushte të cilat ti mundësojnë të burgosurve të kenë punësim kuptimplotë me pagesë i cili t’i lehtësojë atyre riintegrimin në tregun e punës dhe t’i lejojë atyre të kontribuojnë në financat e tyre dhe ato të familjes së tyre.” *BPTP, Parimi 8*

“1. Puna në burg nuk duhet të shkaktojë vuajtje.

- 1 Të gjithë të burgosurve të dënuar duhet ti kërkohet të punojnë në përputhje me aftësitë e tyre fizike dhe mendore sic është përcaktuar nga nëpunësi mjek.
- 2 Puna që u sigurohet të burgosurve duhet të jetë e një natyre të dobishme dhe e mjaftueshme për mbajtjen e të burgosurve aktiv përgjatë një orari normal pune.
- 3 Për atë që është e mundur, puna duhet të jetë e tillë që të ruaj ose të rrisi aftësitë e të burgosurve për të fituar jetesën në një mënyrë të ndershme, pas lirimimit.
- 4 Trajnim profesional duhet ti sigurohet të burgosurve që janë të aftë të përfitojnë prej tij dhe vecanërisht të burgosurve të rinj.
- 5 Brenda kufizimeve të pajtueshme me natyrën profesionale që kërkohet dhe me kërkesat e administratës së institucionit dhe disiplinës, të burgosurit duhet të jenë në gjëndje të përzgjedhin llojin e punës që dëshirojnë të kryejnë.” *SMR, Rregulli 71*

“Asnjë personi nuk duhet ti kërkohet të kryejë punë të detyruar.” *ICCPR, Neni 8.3 (a)*.

“1. Organizimi dhe metodat e punës në institucion duhet ti ngjasojnë sa më shumë të jetë e mundur punës jashtë institucionit, me qëllim për ti përgatitur të burgosurit për kushtet e jetës normale në punë.

2. Interesi i të burgosurve dhe trajnimi i tyre profesional nuk duhet të nënrenditet pas qëllimit për përfitim financiar nga një ndërrmartjen në institucion.” *SMR, Rregulli 72*

“1. Maksimumi i orëve ditore dhe javore të punës për të burgosurit duhet të caktohet nga ligji ose rregullorja administrative, duke marrë parasysh rregullat rajonale ose zakonore që zbatohen për punësimin e punotorëve të lirë.

2. Orët e punës të caktuara duhet të lejojnë një ditë në javë pushim dhe kohë të mjaftueshme për arsimim dhe aktivitete të tjera të kërkura si pjesë e trajtimit dhe rehabilitimit të të burgosurve.” *SMR, Rregulli 75*

“1. Duhet të ketë një sistem për shpërblimin e përshtatshëm të punës së të burgosurve.

2. Sipas sistemit, të burgosurit duhet të lejohen të shpenzojnë një pjesë të të ardhurave të tyre për artikuj të aprovuar për përdorim personal dhe për të dërguar një pjesë të të ardhurave të tyre familjes.

Sistemi duhet të sigurojë gjithashtu që një pjesë e të ardhurave të lihen mënjane nga administrata në mënyrë që ato shërbejnë si fond kursimesh të cilat i dorezohen të burgosurit në momentin e lirimimit.” *SMR, Rregulli 76*

Shiko gjithashtu *SMR, Rregullat 73, 74, ACPR, A-15 dhe IDRCPLD, neni 34 para. 1*.

### **Të rinjtë**

“Sipas nenit 10, paragrafi 3, shkelësve të rinj (...) duhet ti sigurohet trajtim i përshtatshëm për moshën dhe statusin e tyre për sa i përket kushteve të burgimit, si për shëmbull orë më të shkurtra pune (...), me qëllim refomimin dhe rehabilitimin e mëtejshëm të tyre.” *GC 21, para. 13*

“Duke patur parasysh natyrën profesionale që kërkohet dhe kërkesat e administratës së institucionit, të rinjtë duhet të jenë në gjëndje të zgjedhin llojin e punës që ata dëshirojnë.” *RPJDL, Rregulli 43*.

“Kurdoherë që është e mundur, të rinjtë duhet tu sigurohen mundësi për të kryer punë me pagesë, nëse është e mundur, në komunitet, si plotësim ndaj trajnimit profesional që u sigurohet në mënyrë që të rriten mundësitë e gjetjes së një punësimi të përshtatshëm kur ata të kthehen në komunitet. Lloji i punës duhet të jetë i tillë që të sigurojë trajnim të përshtatshëm nga o cili ata të përfitojnë pasi të lirohen nga burgu. Organizimi dhe metodat e punës që ofrohet në ambientet e burgut duhet ti ngjajnë sa më shumë të jetë e mundur atyre të punës që kryhet në komunitet, në mënyrë që të rinjtë të përgatiten për kushtet normale të punësimit.” *RPJDL, Rregulli 45*

### **Komente**

Mekanizmat vizitues duhet të sigurohen që prioriteti për administratën e burgut është trajnimi dhe shfrytëzimi i forcës punëtore në burg për të nxjerrë përfitime. Standartet që lidhen me punën e të burgosurve kanë si qëllim të garantojnë për çdo të burgosur mundësinë për të qenë i angazhuar në aktivitete kuptimplote me pagesë, pa qenë, nga ana tjetër, i shfrytëzuar si forcë punëtore e lirë.

Puna e rregullt dhe kuptimplote është parë si një element thelbësor në përgatitjen e të burgosurve për riintegrimin e tyre në shoqëri dhe punësimin e tyre jashtë burgut. Me qëllim riintegrimin, të

burgorurit duhet të kenë mundësi të përfitojnë aftësi të cilat do të rrisin shanset për të gjetur një punë të ligjshme në të ardhmen. Trajnimi për përfundimin e aftësive profesionale të përshtatshme për tregun e jashtëm të punës luan një rol madhor në këtë drejtim.

Të burgosurit e dënuar mund të detyrohen të punojnë, por vetëm nën disa kushte të caktuara. Puna e detyruar dhe e forcuar është e ndaluar, por jo çdo punë e detyruar e kryer nga të burgosurit I përket kësaj kategorie. Në disa shtete, puna e rëndë vazhdon të aplikohet si një ndëshkim I caktuar nga gjykata, gjë që është në kundërshtim me Konventën e ILO-s për Punën e Detyruar.

Personat në burgim nuk mund të detyrohen të punojnë por ata duhet të kenë mundësinë të punojnë nëse e dëshirojnë një gjë të tillë.

Vetëm ata të burgosur që janë të aftë të punojnë, duhet ta bëjnë një gjë të tillë. Në rastet kur sëmundjeve nga puna, një doctor duhet të ekzaminojë të burgosurin dhe nëse është e nevojshme duhet të lëshohet një certifikatë për të siguruar që I burgosuri të mos humbasi rrogën.

Të burgosurave femra duhet tu sigurohet akses I njëjtë ndaj mundësive për punë që mund ti sigurojnë atyre fitime për të përballuar jetën pas liritimit dhe jo të kufizohen për shkak të kryerjes së aktiviteteve si qepja dhe punimet e dorës.

### **Kushtet më të rëndësishme janë:**

- Puna nuk duhet të ketë karakter ndëshkues;
- Puna duhet të jetë me pagesë (në disa shtete të burgosurit marrin një ulje të dënimit për çdo ditë pune të kryer)
- Orët e punës nuk duhet të kalojnë ato që normalisht aplikohen në jetën përjashta burgut.
- Standartet kombëtare për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë duhet të aplikohen.

### **Pika referimi**

- Cilat janë mundësitë për punë benda vëndit të burgimit dhe si janë ato krahasuar me punën e disponueshme në botën e jashtme?
- A ka mundësi të punohet jashtë vëndit të burgimit (vecanërisht për të rinjtë dhe për ata që për pak kohë lirohen nga burgu) ?
- Nëse nuk ka punë të mjaftueshme për të gjithë të burgosurit, si bëhet përzgjedhja e atyre që punojnë ? A është procesi i shpërndarjes së punës i drejtë, transparent dhe jodiskriminues ?
- Çfarë lloj trajnimi profesional ofrohet?
- A është puna vullnetare?
- Cilat janë kushtet e punës dhe si janë ato krahasuar me kushtet e punës në botën e jashtme?
- A mbrohen të drejtat e atyre që punojnë jashtë vëndit të burgimit?
- A ndahen fitimet nga puna midis personit të privuar nga liria, autoritetit të burgut dhe shtetit? Nëse po, si ndahen ato dhe a janë kriteret transparente?
- Çfarë mundësish ka i burgosuri për të harxhuar dhe kursyer të ardhurat?

### **Për lexime të mëtejshme**

Andrew Coyle, *Afrimi i të drejtave të njeriut me administrimin e burgut*, 2003. (Kapitulli 7 aktivitetet konstruktive dhe riintegrimi social; Kapitulli 8: Kontaktet me botën e jashtme, f.83-104)

PRI, *Si ti bësh të funksionojnë standartet*, Londër 2001. (Seksioni V- Kontakti i të burgosurve me botën e jashtme, f.101-115; Seksioni VI – Programet për të burgosurit, f. 7-149)

UN HCHR, *Të drejtat e njeriut dhe burgjet*, Gjenevë 2003. (Seksioni 6: Përdorimi më i mirë i burgjeve; Seksioni 7: Kontakti i të burgosurit me botën e jashtme, f.76-102)

Peter Sutton, (ed.) *Arsimimi bazë në burgje: Raporti final*, Kombet e Bashkuara/ UNESCO Instituti për Arsimimin (UIE) publikim i përbashkët.

## 5. SHËRBIMI MJEKËSOR

Shëndeti fizik dhe mendor i të burgosurve është vecanërisht i rëndësishëm, pasi burgimi i privon ata nga mundësia për tu kujdesur vet për shëndetin e tyre, dhe mund të ketë në vetvete një efekt negative ndaj shëndetit fizik dhe mendor të të burgosurve. Autoriteti i burgut mban përgjegjësinë për të siguruar që të burgosurit të kenë shëndet të mirë, kushte të shëndetshme jetese dhe pune, dhe kujdes mjekësor të duhur. Kujdesi që sigurohet në burg duhet të jetë ekuivalent me atë që është i disponueshëm jashtë vëndit të burgimit.

Pëlqimi dhe konfidencialiteti janë çështje që duhet të jenë vecanërisht në vëmendje të mekanizmit vizitues. Një marrëdhënie e bazuar në besim është thelbësore midis pacientit dhe mjekut. Rregullat ndërkombëtare specifikojnë që një person i burgosur nuk mund të jetë subjekt i eksperimenteve mjekësore që mund të prekin integritetin e tij fizik ose mendor.

Mekanizmat vizitues duhet të jenë të ndërgjegjshëm për problemet kyce të shëndetit me të cilat përballen të burgosurit në qytetin ose rajonin e tyre. Ato mund të përfshijnë Tuberkulozin, Sidën, dhe abuzimin me substancat. Programe të vecanta duhet tu sigurohen të sëmurëve.

### Shërbimet mjekësore

- Aksesit tek kujdesi shëndetësor
- Kujdes shëndetësor i veçantë për gratë (dhe bebet)
- Kujdes shëndetësor i veçantë për të burgosurit e sëmurë mendor
- Stafit mjekësor

### Aksesi tek kujdesi shëndetësor

#### Standartet

“Mjeku duhet të vizitojë dhe ekzaminojë çdo të burgosur menjëherë pas hyrjes së tij në burg dhe më pas nëse është e nevojshme, me qëllim për të zbuluar sëmundjet fizike ose mendore dhe për të marrë të gjitha masat e nevojshme; veçimin e të burgosurve që dyshohen të kenë infeksione ose sëmundje ngjitëse; identifikimin e difekteve fizike ose mendore që mund të pengojnë rehabilitimin, dhe përcaktimin e aftësisë fizike për punë, të çdo të burgosuri.” *SMR, Rregulli 24*

“Një ekzaminim i përshtatshëm mjekësor duhet ti ofrohet çdo të paraburgosuri ose të burgosuri sa më shpejtë të jetë e mundur pas futjes së tij në vëndin e paraburgimit ose burgimit, dhe më pas kujdesi dhe trajtimi mjekësor duhet të sigurohet kurdoherë që është e nevojshme. Ky kujdes dhe trajtim duhet të sigurohet pa pagesë.” *BPP, Parimi 24*

“Kur futen në burg, të gjithë të burgosurit duhet të vizitohen pa vonesë, nga një anëtar i shërbimit të kujdesit shëndetësor të institucionit. Në raportet e tij CPT ka rekomanduar që çdo i burgosur i ardhur rishtaz duhet të intervistohet sic duhet dhe në se është e nevojshme të ekzaminohet fizikisht nga një doctor sa më shpejtë të jetë e mundur pas futjes në burg. Duhet shtuar se në disa shtete, vizita mjekësore në momentin e hyrjes në burg realizohet nga një infermier plotësisht e kualifikuar, e cila raporton tek një doctor. Trajtimi i rastit nga ky i fundit mund të konsiderohet si një përdorim më eficient i burimeve në dispozicion.

Është gjithashtu e dëshirueshme që një fletpalosje ose broshurë tju shpërndahet të burgosurve në momentin e mbërritje në burg, për ti informuar ata për ekzistencën dhe funksionimin e shërbimit të kujdesit ndaj shëndetit dhe për ti kujtuar për masat themelore të higjenes.” *CPT, GR3, § 33*

1 Të burgosurit e sëmurë që kanë nevojë për trajtim të specializuar duhet të transferohen në institucione të specializuara ose në spitale civile. Kur në institucion ka ambiente spitalore, pajisjet, mobiljet dhe furnizimet farmaceutike duhet të jenë të përshtatshme për trajtimin dhe kujdesin mjekësor të të burgosurve të sëmurë dhe duhet të ketë një staf të përbërë nga nëpunës të trajnuar sic duhet.

2 Shërbimet e një dentisti të kualifikuar duhet të jenë në dispozicion të çdo të burgosuri.” *SMR, Rregulli 22*

1. Mjeku duhet të kujdeset për shëndetin mendor dhe fizik të të burgosurve dhe duhet të vizitojë

çdo ditë të gjithë të burgosurit e sëmure, ata që ankohen për një sëmundje dhe çdo të burgosur që i tërheq vëmendjen në mënyrë të veçantë. *SMR, Rregulli*

“Nëpunësit e zbatimit të ligjit duhet të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit të personave nën mbikëqyrjen e tyre dhe në vecanti ata duhet të ndërmarrin veprime të menjëhershme për të siguruar kujdes mjekësor kurdoherë që nevojitet.” *Kodi i sjelljes për nëpunësit e zbatimit të ligjit, neni 6.*

“Ndërkohë që janë nën mbikëqyrje, të burgosurit duhet të jenë në gjëndje të kenë akses tek një doctor në çdo kohë, pavarësisht regjimit të burgimit (për sa i përket aksesit tek një doctor për të burgosurit që mbahen në izolim, shiko paragrafin 56 të Raportit të Dytë të Përgjithshëm të CPT-s: CPT/Inf (92) 3). Shërbimi I kujdesit ndaj shëndetit duhet të jetë I organizuar në mënyrë të tillë që kërkesat për tu konsultuar me një doctor të plotësohen pa vonesë.

Të burgosurit duhet të jenë në gjëndje të kërkojnë shërbimin e kujdesit shëndetësor në mënyrë konfidenciale, për shembull, nëpërmjet një mesazhi të mbyllur në një zarf. Për më tepër, nëpunësit e burgut nuk duhet të shfaqin publikisht kërkesat për tu konsultuar me një doktor.” *CPT, GR3, § 34*

Shiko gjithashtu *ACPR, A-4 dhe IDRC PDL, neni 25.*

### **Komente**

Mekanizmi vizitues duhet të ketë informacionin e nevojshëm për të krahasuar kudesin shëndetësor në burg dhe jashtë tij. Cilësia e kujdesit ndaj shëndetit që sigurohet për personat e privuar nga liria e tyre duhet të jetë e njëjtë me atë që është e disponueshme jashtë sistemit penal (parimi i ekuivalencës).

Të burgosurit e ardhur rishtaz duhet të vizitohen nga një doctor ose infermiere e kualifikuar menjëherë pas mbërritjes. Kjo mënyrë i mundëson stafit mjekësor të identifikojë sëmundje paraekzistuese si dhe dëmtimet që mund ti jenë shkaktuar të burgosurit gjatë qëndrimit në një vend tjetër burgimi. Ky process është gjithashtu i rëndësishëm pasi i mbron të burgosurit dhe stafin nga sëmundjet e transmetueshme.

Aksesi tek mjeku duhet ti sigurohet të gjithë të burgosurve pa vonesa të panevojshme (në qoftë se nuk është një emergjencë, brenda një dite). Kushte sipas të cilave të burgosurit ekzaminohen duhet të respektojnë dinjitetin e tyre. Konsultimet mjekësore duhet të zhvillohen privatisht ose minimalisht të mos dëgjohen nga stafi i burgut ose të burgosurit e tjerë. Stafi i burgut duhet të sigurojë akses tek mjeku pa qënë e nevojshme që i burgosuri të japi arsyet pse kërkon konsultim me mjekun.

Të burgosurit që kanë nevojë për trajtim të specializuar duhet të kenë akses ndaj këtij trajtimi, qoft ky nëpërmjet konsultimit me një specialist brenda vëndit të burgimit ose nëpërmjet transferimit tek një mjek. Çdo vënd burgimi ka nevojë për masa të vecanta për evakuimin emergjent për në spital.

Mohimi I aksesit ndaj trajtimit mjekësor mund të përbëjë keqtrajtim..

Të burgosurit nuk duhet të paguajnë për shërbimet e kujdesit shëndetësor.

Në se grupi vizitues nuk përfshin në përbërjen e tij një mjek të kualifikuar, anëtarët e grupit duhet të kujdesen të kërkojnë informacion të përgjithshëm për gjëndje shëndetësore të personave të privuar nga liria e tyre; sëmundjet më të shpeshta, identifikimin e sëmundjeve të transmetueshme dhe ngjitëse, vdekjet. Ata duhet gjithashtu të ekzaminojnë sistemin e aksesit tek kujdesi mjekësor.

### **Pika referimi**

- Cilat janë sëmundjet më të përhapura?
- A ka burgu një strategji për trajtimin e tyre ?
- A është burgu i përfshirë në strategjitë mbarë shtetërore për trajtimin e Tuberkulozit, Sidës dhe sëmundjeve të tjera të përhapura?
- Ku zhvillohen konsultime dhe në çfarë kushtesh ?
- Me sa lehtësi mund të ketë akses tek shërbimet mjekësore personat e privuar nga liria e tyre (Sa kohë presin ata për një takim me doktorin, me një specialist të jashtë)?
- me kërkesën e tyre: cila është procedura? –nëpërmjet stafit mjekësor: sa shpesh i vizitojnë ata insitucionin? – nëpërmjet personelit mbikëqyrës: cila është procedura?



- A është personeli mjekësor në detyrë ditë edhe natë?
- A ka ndonjë procedurë për evakuimin për emergjenca mjekësore, gjatë ditës/natës?
- Si organizohet aksesit tek psikologu?
- A ka ndonjë ankesë për praktika diskriminuuese në lidhje me sigurimin e aksesit tek mjeku ose trajtimi mjekësor?

## Mjekimi

- Sa e përshtatshme është magazinimi i mjekimeve?
- Si porositen ilaçet?
- Si kontrollohet administrimi i stokut?

## Stafi mjekësor

### Standartet

“1. Mjeku duhet të kujdeset për shëndetin mendor dhe fizik të të burgosurve dhe duhet të vizitojë çdo ditë të gjithë të burgosurit e sëmurë, ata që ankohen për një sëmundje dhe çdo të burgosur që i tërheq vëmendjen në mënyrë të vecantë.

2. Mjeku duhet të raportojë tek drejtori kurdoherë që ai konsideron se shëndeti fizik ose mendor i një të burgosuri është ose do të dëmtohet nga vazhdimësia e burgimit ose nga ndonjë kusht tjetër i burgut.” *SMR, Rregulli 25*

“1. Në çdo institucion duhet të ketë të paktën një mjek të kualifikuar i cili të ketë disa njohuri për psikiatrinë. Shërbimi mjekësor duhet të organizohet sipas mënyrës që administrohet kujdesi ndaj shëndetit në komunitet ose shtet. Këto shërbime duhet të përfshijnë shërbimet e një psikiatri për diagnostikimin dhe në rastet e duhura, trajtimin e gjëndjeve mendore jonormale.

2. Të burgosurit e sëmurë të cilët kanë nevojë për një trajtim të specializuar duhet të transferohen tek një institucion i specializuar ose tek një spital civil. Në rastet kur ambientet spitaloer sigurohen brenda institucionit, pajisjet, mobiljet dhe furnizimet farmaceutike duhet të jenë të përshtatshme për kujdesin dhe trajtimin mjekësor të të burgosurve të sëmurë dhe duhet të ketë një staf të përbërë nga nëpunës të trajnuar.” *SMR, Rregulli 22*

“Shërbimet e kujdesit ndaj shëndetit në një burg duhet të të paktën të sigurojnë konsultime të rregullta me pacientët dhe trajtim emergjent të tyre. Shërbimet e një dentisti të kualifikuar duhet të jenë të disponueshme për çdo të burgosur. Për më tepër, mjekët e burgjeve duhet të jenë në gjëndje të thërrasin për shërbime të specializuara.

Për sa i përket trajtimeve emergjente, një doktor duhet të jetë gjithmonë në gadishmëri. Për më tepër, dikush që është kompetent për të dhënë ndihmën e parë duhet të jetë gjithmonë present në ambientet e burgut, e preferueshme është që të jetë dikush me kualifikime të njohura infermierie.

Trajtimi i pacientëve duhet të jetë i mbikëqyrur, kur është e përshtatshme, nga stafi i kujdesit ndaj shëndetit; në shumë raste nuk është e mjaftueshme që shërbimet ndaj shëndetit varen nga iniciativa e të burgosurve.” *CPT, GR3, § 35*

“Është në kundërshtim me etikën mjekësore që personeli I kujdesit ndaj shëndetit, në vecanti mjekët:

(b) Të konfirmojë ose të marrin pjesë në konfirmimin se është e përshtatshme për një të burgosur ose të paraburgosur një formë trajtimi ose ndëshkimi që në fakt mund të ndikojë dukshëm në shëndetin e tij mendor ose fizik dhe që nuk është në përputhje me instrumentat ndërkombëtar përkatës ose të marri pjesë në një farë mënyre në kryerjen e këtij trajtimi ose ndëshkimi I cili nuk është në përputhje me instrumentat ndërkombëtar përkatës.” *Parimet e etikës mjekësore të Kombeve të Bashkuara në lidhje me rolin e personelit mjekësor, vecanërisht të mjekët, në mbrojtjen e të burgosurve dhe të paraburgosurve kundër torturës dhe trajtimi apo ndëshkimi mizor, johuman ose degradues, parimi 4.*

“Stafi i kujdesit ndaj shëndetit në çdo burg, është potencialisht në rrezik. Detyra e tyre për tu kujdesur për pacientët (të burgosurit e sëmurë) mund të bëri në konflikt me konsideratat e

administratës dhe sigurisë së burgut. Kjo mund të sjelli lindjen e pyetjeve dhe zgjedhjeve të vështira etike. Në mënyrë që të garantohet pavarësia e tyre në çështjet e kujdesit ndaj shëndetit, CPT e konsideron të rëndësishme që ky personel duhet të jetë në një linjë sa më të ngushtë me nivelin e kujdesit shëndetësor që sigurohet në komunitet.” *CPT, GR3, § 71*

Shiko gjithashtu *SMR, Rregullat 23-25 dhe IDRCPL, neni 29*.

### **Komente**

Gjatë ekzaminimit të kushteve të kujdesit shëndetësor në vendin e burgimit, mekanizmat vizitues duhet ti kushtojnë vëmendje të vecantë rolit të stafit mjekësor dhe autonomisë së tyre në marrjen e vendimeve mjekësore. Ata zakonisht kanë detyrat e mëposhtme:

- Të sigurojnë që kushtet e përgjithshme të burgimit favorizojnë ambientin e shëndetshëm duke raportuar tek autoritetet përkatëse në lidhje me impaktin e mundshëm që mund të kenë ndaj shëndetit trajtimet dhe kushtet e burgut.;
- Të zbulojnë sëmundjet e transmetueshme dhe të sugjerojnë masat që duhen marrë për të shmangur transmetimin e mëtejshëm;
- Të sigurojnë akses për të burgosurit ndaj konsultimeve dhe trajtimeve individuale;
- Të referojë rastet individuale tek specialistët. Këto detyrat të shumëfishta tregojnë se doktori në burg është njëkohësisht doctor personal për të burgosurit dhe një këshilltar për administratën e burgut. Kjo mund të çojë në një konflikt interesi. Roli i këshilltarit për administratën duhet të kufizohet vetëm në evidentimin e mënyrave për përmirësimin e kushteve shëndetësore në përgjithësi dhe vecanti për individ të caktuar. Në asnjë rrethanë nuk duhet që doktorit ose infermieres ti kërkohet të marrë pjesë në administrimin e ndëshkimeve. Kjo është në kundërshtim me etikën mjekësore dhe interpretimin e SMR-s19. Në marrjen e vendimeve mjekësore, stafi mjekësor duhet të jetë i pavarur nga autoritetet e burgut. Kjo mund të arrihet nëse ata janë të integruar në sistemin e përgjithshëm shëndetësor të shtetit dhe nuk janë të varur nga autoritetit I burgut.

Stafi mjekësor është i detyruar të respektojë kodin e konfidencialitetit.

Kompetencat e stafit mjekësor, pavarësia e tyre dhe etika profesionale dhe cilësia e kujdesit që sigurohet mund të vlerësohen vetëm nga specialistët e shëndetit. Është pra e këshillueshme që organet vizituese të përfshijnë në përbërjen e tyre ose të kenë akses tek mjekë të kualifikuar.

19 Shiko për këtë çështje për shembull PRI, Si ti bësh standartet të funksionojnë, f.80, § 39ff.

### **Pika referimi**

- Si është përbërja e grupit mjekësor (numri I doktorëve, infermiereve, psikologëve, psikiatrëve, të tjerëve) ?
- A kanë ata kualifikimet profesionale të duhura ?
- Sa janë ata të integruar në shërbimin publik shëndetësor, githashtu në lidhje me aksesin tek ushqimi, shërbimet, informimi dhe trajnimi ?
- A janë orët e tyre të punës të përshtatshme për nevojat e burgut ?
- Cilat janë detyrat e tyre ?

## **Kujdes I vecantë shëndetësor për gratë dhe bebet**

### **Standartet**

“(…) Për sa kohë bëhet fjalë për gratë e privuara nga liria e tyre, respektim i parimit të ekuivalencës për sa i përket kujdesit shëndetësor, kërkon që kujdesi ndaj shëndetit të sigurohet nga mjekë dhe infermiere të cilët kanë trajnim të vecantë për çështjet shëndetësore të grave, përfshirë gjinekologjinë. Gjithashtu kujdesi parandalues ndaj shëndetit me rëndësi të vecantë për gratë, si për shembull kongrolli i gjirit dhe kanceri i qafës së mitrës, që është i disponueshëm jashtë burgut, duhet ti sigurohet edhe grave të privuara nga liria.” *CPT, GR 10, §32*

“1. Në burgjet e grave duhet të ketë akomodime të vecanta për kujdesin dhe trajtimin e nevojshëm para-lindjes dhe pas-lindjes. Kurdoherë që është më praktike për fëmijët të lindin në një spital jashtë burgut, duhet të merren masat për të siguruar një gjë të tillë. Nëse një fëmijë lind në burg, ky fakt nuk duhet të përmendet në certifikatën e lindjes.

2. Kur fëmijët e sapo lindur lejohen të rrinë në institucion me nënat e tyre, duhet të merren masat për të siguruar një ambient fëmijësh të asistuar nga persona të kualifikuar, ku fëmijët të mund të mbahen kur ata nuk janë nën kujdesin e nënave të tyre.” *SMR, Rregulli 23*

“Është qartë që bebet nuk duhet të lindin në burg, dhe praktika e zakonshme që përkrah Këshilli i Europës duket se është që në momentin e përshtatshëm, gratë shtatëzënë të transferohen në spitalet jashtë burgut. Megjithatë, ndonjëherë, CPT haset me shëmbuj të grave shtatëzënë të lidhura ose të shtrënguara pas një krevati ose ndonjë mobiljeje tjetër, gjatë ekzaminimeve gjinekologjike ose lindjeve. Një veprim i tillë është plotësisht i papranueshëm dhe mund të kualifikohet si trajtim johuman dhe degradues.” *CPT, GR 10, §27.*

Shiko gjithashtu *ACPR, B-2b), c), d) dhe e) dhe IDRCPLD, neni 20.*

### **Komente**

Mekanizmat vizitues duhet të jenë të ndërgjegjshëm se burgjet janë shpesh të keqpërshtatura ndaj nevojave të vecanta të grave dhe kjo situatë ndikon në shëndetin e tyre mendor dhe fizik. Për më tepër, gratë mund të kenë qënë abuzuar , përfshirë seksualisht, përpara burgimit. Në shumë shtetet gratë mbeten vulnerabël edhe pas burgimit.

Kujdesi gjinekologjik duhet të garantohet. Nevojat e shtatëzanisë dhe amësisë duhet të trajtohen vecanërisht.

### **Pika referimi**

- A ka ndonjë gjinekolog në përbërjen e stafit mjekësor dhe cilat janë orët e punës së gjinekologut?
- Cilat janë kushtet e aksesit tek gjinekologu ?
- A trajtohen nevojat e veçanta të grave shtatëzënë?
- A trajtohen nevojat e veçanta të nënave me fëmijë?
- Ku lindin gratë?
- Kur fëmijët e vegjël jetëojnë me nënat e burgosura, a ka akses tek një mjek peditër?
- A kanë gratë të njëjtin standart kujdesi shëndetësor si dhe burrat?

## **Kujdes i veçantë shëndetësor për të burgosurit e sëmurë mendor**

### **Standartet**

“1. Personat e cmendur nuk duhet të mbahen në burgje si dhe duhet të merren masat për largimin e tyre sa më shpejtë të jetë e mundur, drejt institucioneve për të sëmurët mendorë.

1 Të burgosurit që vuajnë nga sëmundje të tjera mendore ose anomalitë duhet të mbikëqyren dhe trajtohen në institucione të specializuara nga mjekët.

2 Gjatë qëndrimit të tyre në burg, këta të burgosur duhet të vendosen nën mbikëqyrjen e vecantë të mjekut.

3 Shërbimi mjekësor ose psikiatrik në institucionet ndëshkimore duhet të sigurojë trajtim psikiatrik për të gjithë të burgosurit e tjerë që kanë nevojë për një trajtim të tillë” *SMR, Rregulli 82*

“Të burgosurit që vuajnë nga shqetësime mendore serioze duhet të mbahen dhe të trajtohen në një ambient spitalor i cili është i pajisur në mënyrë e duhur dhe ka stafin e duhur të trajnuar. Vendimi për të lejuar aksesin e një të burgosuri në një spital public duhet të merret nga një psikiatër, me autorizimin e autoritetit kompetent.” *R(98)7, para. 55.*

“Nga pikëpamja etike, është shtuar se është e përshtatshme për të burgosurit e sëmurë mendor të shtrohen në një spital jashtë sistemit të burgut, në institucione që I përkasin shërbimit publik ndaj shëndetit. Nga ana tjetër, mund të argumentohet se krijimi i ambienteve psikiatrike brenda sistemit të

burgut mundëson që kujdesi ndaj të sëmurëve të sigurohet në kushte maksimale sigurie dhe aktiviteti i shërbimeve mjekësore dhe sociale brenda sistemit të shtohet.” CPT GR3, § 43.

Shiko gjithashtu ACPR, B-5-b), c) dhe d) dhe IDRCPLD, neni 17.

### **Komente**

Përqindja e të burgosurve që vuajnë nga shqetësimet mendore është zakonisht më e lartë sesa në popullsinë e përgjithshme, për këtë arsye mekanizmat vizitues duhet të jenë në gjëndje të monitorojnë se në çfarë mase të burgosurit që vuajnë nga sëmundje mendore marrin kujdesin dhe trajtimin e duhur.

Kur është e nevojshme, kujdesi duhet të sigurohet brenda një ambienti të përshtatshëm. Shumica e standarteve ndërkombëtare bazohen në besimin se spitalet psikiatrike janë vendet më të mira për sigurimin e trajtimiy të specializuar dhe për rrjedhojë rekomandojnë transferimin e të burgosurve me sëmundje serioze mendore tek spitalet psikiatrike.

Nga ana tjetër, sic është argumentuar nga CPT në Raportin e saj të Tretë të Përgjithshëm, mund të ketë një avantazh në krijimin e ambienteve të specializuara psikiatrike brenda sistemit të burgut. CPT shpreson se kjo mund të rrisi nivelin e profesionalizmit në trajtimin e të burgosurve me sëmundje dhe shqetësime mendore.

Në mënyrë që të mund të gjykohet nëse shërbimet psikiatrike në vendin e burgimit janë të mjaftueshme, grupi vizitues duhet të ketë në përbërjen e tij, mbase edhe sipas rastit, një psikiatër shumë të kualifikuar. Nëse një specialist I tillë nuk është I disponueshëm, organi vizitues mund të konstatojë se çfarë politike ekziston për kujdesin ndaj shëndetit mendor dhe nëse kjo politikë është menduar mirë duke u bashkërenduar me shërbimet e kujdesit ndaj shëndetit, jashtë burgut. .

Një çështje e tjetër është ajo e personave të mbyllur në spitale psikiatrike me urdhër të detyruar. Disa mekanizma vizitues si CPT, ose mekanizmat sipas OPCAT, mund të përfshijnë në mandatin e tyre monitorimin e kushteve sipas të cilave personat mbahen në spitale psikiatrike. Kjo çështje nuk trajtohet në këtë manual por këtu mund të gjeni referencat e literaturës së përshtatshme për këtë temë.

### **Pika referimi:**

- A ka të burgosur që kanë hyrë në institucion gjatë 12 muajve të fundit, që të jenë diagnostikuar me sëmundje ose shqetësime mendore?
- Në rastet e këtyre diagnostikimeve, çfarë i ka ndodhur të burgosurve (për shembull, janë transferuar tek një spital psikiatrik jashtë burgut, i janë dorëzuar një seksioni të vecantë brenda institucionit, nuk janë marrë masa) ?
- Kush është përgjegjës për trajtimin e këtyre të burgosurve (psikiatri, mjeku i përgjithshëm) ?
- Sa psikiatrist punojnë në institucion dhe sa shpesh janë ata prezent aty ?
- Çfarë trajtimi kanë të burgosurit e sëmurë mendor (mjekim, aktivitetet rehabilituese, etj) ?

### **Për lexime të mëtejshme**

PRI, *Si ti bësh standartet të funksionojnë*, Londër 2001. (Seksioni IV Shëndeti fizik dhe mendor I të burgosurve, f.69 deri 98.

Andrew Coyle, *Afrimi I të drejtave të njeriut me administratën e burgut*, 2003. (Të burgosurit dhe kujdesi ndaj shëndetit, f.49 –58)

PRI, *Si ti bësh standartet të funksionojnë*, Londër 2001. (Seksioni V-Kontaktet e të burgosurve me botën e jashtme, f. 101-115; Seksioni VI – Programet për të burgosurit, f.17-149)

UN HCHR, *Të drejtat e njeriut dhe burgjet*, Gjenevë 2003. (Seksioni 4: Kujdeis ndaj shëndetit të të burgosurve, f.46-63).

### **Standarte specifike**

Raporti i Tretë i Përgjithshëm i CPT-s, *Shërbimet e kujdesit ndaj shëndetit në burgje*, CPT/Inf(93)12§ 30-77.

Raporti i Dhjetë i Përgjithshëm i CPT-s, *Gratë e privuara nga liria e tyre*, CPT/Inf(2000)13, §26-33)

Raporti i Tetë i Përgjithshëm i CPT-s, Futja e pavullnetshme në institucionet psikiatrike, CPT/Inf (98)12, §25-58)

Këshilli Ndërkombëtar për shërbimet mjekësore në burg, *Betimi i Athinës për mjekët e burgut*, 1979. [www.icpms.interfree.it/atheus](http://www.icpms.interfree.it/atheus)

Parimet e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e personave të sëmurë mendor, 1991.

## 6. PERSONELI

Stafi përgjegjës për të burgosurit nuk duhet të anashkalohej nga mekanizmat vizitues gjatë procesit të monitorimit të kushteve të burgimit, pasi janë ata që vendosin në shumicën e rasteve për mënyrën sesi të burgosurit të trajtohen. Celësi për një burg human ndodhet në cilësinë e marrëdhënies midis stafit dhe të burgosurve.

Faktorët e mëposhtme luajnë rol në përcaktimin e cilësisë së stafit:

- Organizimi (numri i stafit, numri i grave pjesë e stafit, raporti i stafit me të burgosurit, orët dhe kushtet e punës)
- Përzgjedhja dhe trajnimi bazë
- Aftësitë profesionale dhe sjellja
- Kushtet e shërbimit dhe statusi
- Specializimi
- Përdorimi i forcës
- Qëndrimi ndaj gjinive dhe kulturave të ndryshme
- Drejtori
- Stafi mund të grupohet sipas kategorive të mëposhtme:
- Menaxhimi
- Mbikëqyrja e brëndshme
- Mbikëqyrja e jashtme/ siguria (jo gjithmonë në varësinë e drejtëpërdrejtë të drejtuesit të bugut)
- Stafi mjekësor
- Stafi social (ata që kanë përgjegjësinë për jetën e përditshme të një grupi të caktuar të burgosurish)
- Stafi transportues
- Stafi trajnues (arsimimi, aktivitetet, puna)
- Stafi furnizues

Shtrirja e mandatit të organit vizitues për të monitoruar shqetësimet e stafit varjon. Megjithatë është e rëndësishme për anëtarët e grupit që të flasin me stafin. Kushtet e burgimit të të burgosurve janë gjithashtu kushtet e punës së stafit dhe pikëpamja e tyre në lidhje me funksionimin e institucionit dhe përmirësimet që ata i konsiderojnë të nevojshme, janë të rëndësishme.

### Personeli

- Çështje të përgjithshme
- Trajnimi i stafit të burgut.

### Çështje të përgjithshme

#### Standartet

“1. Administrata e burgut duhet të përzgjedhi me kujdes të gjitha nivelet e personelit, pasi është integriteti, humaniteti, kapaciteti i tyre profesional dhe përshtatshmëria e tyre personale për punë, nga e cila varet administrimi i përshatshëm i institucionit.

1 Administrata e burgut duhet të mundohet të mbajë gjallë dhe të ngulitur në mendje si të publikut ashtu dhe të personelit të burgut, bindjen se kjo punë është një shërbim civil i një rëndësie të madhe dhe për këtë qëllim duhet të përdoren të gjitha mjetet e informimit të publikut.

2 Personeli duhet të caktohet me kohë të plotë si nëpunësit profesionist të burgut dhe të ketë

statusin e shërbimit civil. Rrogat duhet të jenë të përshtatshme për të tërhequr dhe mbajtur në punë gratë dhe burrat e duhur; përfitimet e punësimit dhe kushtet e shërbimit duhet të jenë të favorshme duke pasur parasysh vështirësinë e natyrës së punës. për sa I përket.” *SMR, Rregulli 46* (shiko gjithashtu *Rregulli 54*.)

“Duke patur parasysh rëndësinë themelore që ka stafi I burgut në menaxhimin e përshtatshëm të institucionit dhe ndjekjen e objektivave të tij organizative dhe të trajtimit, administrata e burgut duhet ti japë prioritet të lartë plotësimit të rregullave në lidhje me personelin.” *EPR, Rregulli 51*

“(…) Stafi me përbërje gjinore të përzier është një masë mbrojtëse kundër keqtrajtimit në vendet e burgimit. Prezenca e stafit të përbërë prej meshkuj dhe femra mund të ketë një efekt të dobishëm për sa I përket karakterit të ruajtjes dhe krijimit të një shkalle normalitetit në burg.” *CPT, GR10, § 23*

“Baza për një sistem burgu human është gjithmonë rekrutimi dhe trajnimi I duhur I stafit të burgut I cili duhet të dijë të përshtasi sjelljen e duhur në marrëdhënie me të burgosurit dhe I cili duhet ta konsiderojë punën e si profesion më shumë sesa si thjesht punë. Ndërtimi I marrëdhënieve positive me të burgosurit duhet të njihet si një element bazë e këtij profesioni.

Me keqardhje, CPT shpesh konstaton se marrëdhëniet ndërmjet stafit dhe të burgosurve janë të një natyre formale dhe distante, me stafin që merr një qëndrim që I vë në regjim të burgosurit dhe që e shikon komunikimin me ata si një aspekt të padobishëm të punës së tyre. Praktikrat vijuese që janë hasur shpesh nga CPT janë tregues të një trajtimi të tillë: detyrimi I të burgosurve të qëndrojnë me fytyrë nga muri ndërkohë që presin që stafi I burgut të merret me ta ose që vizitorët të kalojnë; detyrimi I të burgosurve të qëndrojnë me kokat poshtë dhe me duart e kapura nga pas kurrit kur lëvizin nëpër institucion; mbajtja e shkopave të gomës në mënyrë të dukshme dhe provocative, nga stafi ruajtës. Këto praktika janë të panevojshme nga pikëpamja e sigurisë dhe nuk bëjnë asgjë për të promovuar marrëdhënien e mirë midis stafit dhe të burgosurve.

Profesionalizmi I vërtetë I stafit të burgut kërkon që ata të jenë në gjëndje të merren me të burgosurit në një mënyrë të përshtatshme dhe humane ndërkohë që I kushtojnë vëmendje sigurisë dhe rendit. Në këtë drejtim, administrata e burgut duhet të inkurajojë stafin të ketë një sens të arsyeshëm besimi dhe pritshmërie se të burgosurit dëshirojnë të sillen në mënyrën e duhur. Zhvillimi I një marrëdhënie konstruktive dhe positive midis stafit dhe të burgosurve jo vetëm që do uli rrezikun e keqtrajtimit por gjithashtu do të rrisi kontrollin dhe sigurinë. Një marrëdhënie e tillë mund ta bëjë punën e stafit të burgut më shpërbljese.

Sigurimi I marrëdhënieve positive midis stafit dhe të burgosurve varet edhe nga numri I përshtatshëm i stafit që është prezent në një kohë të caktuar në çdo vend të burgimit dhe në ambientet e përdorura nga të burgosurit për aktivitete. Delegacionet e CPT shpesh konstatojnë se kjo nuk është e vërtetë. Një sasi e ulët e stafit në përgjithësi dhe/ ose sisteme specifike të pjesëmarrjes së stafit të cilat pakësojnë mundësitë e kontaktit të drejtëpërdrejtë me të burgosurit, me siguri që do të pengojnë zhvillimin pozitiv të marrëdhënieve staf-të burgosur dhe do të krijojnë një ambient të pasigurt si për stafin ashtu dhe për të burgosurit.

Duhet patur gjithashtu parasysh që, kur numri I stafit nuk është I përshtatshëm, sasi e madhe pune jashtë orarit do të jetë e nevojshme për të mbajtur një nivelë bazë të sigurisë dhe mbajtjes së regjimit në institucion.” *CPT, GR 11, § 26*

Shiko gjithashtu *IDRCPDL, neni 7 para 1*.

### **Të rinjtë**

“Personeli duhet të jetë I kualifikuar dhe të përfshijë një numër të mjaftueshëm specialishtësh si mësues, instructor profesionesh, avokat, punonjës social, psikiatër dhe psikolog. Këta dhe specialistë të tjerë duhet të punësohen në mënyrë të përhershme.(…)” *RPJDL, Rregulli 81.1*

“Administrata duhet të përzgjedhi dhe rekrutojëme kujdes personelin e çdo niveli dhe lloji, pasi është integriteti, humaniteti, aftësia dhe kapaciteti i tyre profesional për tu marrë me të rinjtë, si dhe përshtatshmëria e tyre personale për të punuar, nga e cila varet administrimi i përshtatshëm i institucionit.” *RPJDL, Rregulli 82.3*

## **Komente**

Mekanizmat vizitues duhet ti kushtojnë vëmendje të vecantë sjelljes së stafit pasi roli që ata kanë është thelbësor në krijimin e klimës së përgjithshme në vendin e burgimit. Kjo është arsyeja pse është vecanërisht e rëndësishme që stafi të rekrutohet bazuar në kritere të qarta, sipas aftësive dhetributeve personale. Stafi duhet të jetë i mjaftueshëm në numër për t'ju përgjigjur nevojave për siguri fizike dhe për kontakt human me të burgosurit. Balanca midis burrave dhe grave në përbërjen e stafit duhet të reflektojë atë që është në shoqëri në përgjithësi.

Kushtet e shërbimit dhe statusi i stafit ndikojnë direkt në qëndrimin e tyre ndaj të burgosurve. Pagesa, orët e punës, kariera dhe shanset për ndryshimim e detyrave dhe ngritjes në përgjegjësi janë fusha të rëndësishme për t'i kushtuar vëmendje.

Për mbrojtjen e të burgosurve, stafi i burgut duhet të jetë i disiplinuar, me një strukturë të qartë raportimi. Megjithatë, nuk ka asnjë arsye operative për shërbimin e një burgu që të ketë strukturë ushtarake, me rangj ushtarake.

Sjellja e stafit lidhur me të burgosurit varet nga udhëzimet formale apo informale që ata marrin. Stafi ndikohet nga qëndrimi dhe sjellja hierarkisë së vetë, nga deklaratimet e politikanëve dhe nga qëndrimi i shokëve të tyre qytetarë ndaj të burgosurve. Ndikimi i drejtorit është me rëndësi të veçantë në çdo vend burgimi.

Skuadra vizituese duhet të vëzhgojë me kujdes cilësinë e marrëdhënies midis stafit dhe të burgosurve që shprehet në përzgjedhjen e gjuhës, tonin e zërit, gjuhën e turpit sikurs dhe në reagimin e tyre në situatë të veçanta.

## **Pika reference**

Skuadra vizituese duhet të ketë informacionet e mëposhtme:

- numrin e stafit që ka direkt kontakt me të burgosurit dhe në ç'proporcion janë;
- kriteri i rekrutimit-niveli arsimor dhe profile personal;
- trajnimet bazeë dhe trajnimet në vijim;
- paga mesatare;
- numri i stafit gra dhe niveli drejtues;
- si i drejtohet stafi të burgosurve dhe të burgosurit stafit;
- kontakti midis stafit dhe të burgosurve;
- qëndrimi i stafit ndaj të burgosurve, ndaj superiorëve dhe ndaj punës së tyre;
- aksesueshmëria e drejtorit tek të burgosurit
- shpeshësia e vizitav të drejtorit në të gjitha pjesët e vendeve të burgimit

## **TRAJNIMI I PERSONELIT**

### **Standartet**

“1. Personeli duhet të ketë standartin e duhur arsimor dhe inteligjent.

Përpara se të marrin këtë detyrë, personelit i duhet bërë një kurs trajnimi mbi detyrat e tyre të përgjithshme dhe specifike dhe t'ju kërkohet të kalojnë në testet teorike dhe praktike.

Pas marrjes së detyrës dhe gjatë karrierës së tyre, personeli duhet të ruajë dhe të përmirësojë njohuritë e veta dhe kapacitetin profesional duke ndjekur kurse të trajnuese në-shërbim që duhet të organizohen në intervale të rregullt.” *SMR, rregulli 47*

“Personeli shtrëngues, personeli mjeksor, punonjësit e policisë dhe çdo person tjetër i përfshirë në kujdestarinë apo trajtimin e çdo individi të arrestuar, të paraburgosur apo të burgosur duhet të ketë instruksionet dhe trajnimet e duhura.” *GC 20, para. 10*

“Në përfundim, CPT dëshiron të theksojë rëndësinë e madhe që i bashkëngjitet trajnimit të personelit zbatues të ligjit( i cili duhet të përfshijë arsimimin dhe çështjet e të drejtave të njeriut-gjithashtu Nenin 10 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të tjera Mizore, çnjerëzore dhe Degraduese). Nuk ka asnjë garanci më të mirë ndaj keqtrajtimit të personave të privuar nga liria e tyre sesa një punonjës policie apo i burgut i trajnuar siç

duhet. Oficerët e kualifikuar do të ishin në gjendje të kryenin me sukses detyrat e tyre pa u mbështetur tek keqtrajtimet dhe do të përballonin prezencën e mbrojtës themelore të të drejtave të paraburgosurve dhe të burgosurve.” *CPT, GR 2, § 59*

“Në këtë kontekst, CPT beson se zotësia për komunikime ndërpersonale duhet të jetë një faktor kryesor në procesin e rekrutimit të personelit ligj-zbatues dhe gjatë trajnimit i duhet vënë theksi i duhur zhvillimit të aftësive komunikuese ndërpersonale, bazuar në respektimin e dinjitetit njerëzor. Posedimi i aftësive të tillë do të mundësonte shpesh një punonjës policie apo të burgut të neutralizojë një situatë e cila mund të kthehet ndryshe në dhunë dhe për më tepër do të çonte në uljen e tensioneve dhe rritjen e cilësisë së jetës në vendqëndrimet policore apo burgje, në të mirën e të gjithëve.” *CPT, GR 2, § 60 shiko gjithashtu IDRCPDL. neni. 7 paragraf 2.*

## **Të rinjtë**

“Personeli duhet të ketë një trajnim të tillë që t’i mundësojë ata të kryejnë përgjegjësitë e tyre në mënyrë efektive e në veçanti trajnimin për psikologjinë e fëmijës, për mirëqenien e fëmijës, standartet ndërkombëtare dhe normat për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve duke përfshirë këtu edhe rregullat prezente. Personeli duhet të ruajë dhe përmirësojë njohuritë e veta dhe kapacitetin profesional duke ndjekur kurset e trajnimeve në-shërbim që duhet të organizohen në intervale të përshtatshme gjatë gjithë karrierës së tyre.” *RPJDL, Rregulli 85*

## **Komente**

Mekanizmat vizitues duhet të dinë që stafi i kualifikuar me një nivel të mirë trajnimi krijon bazat e një sistemi penal human dhe duhet të informohen për trajnimet e mundësuar dhe përshtatshmërinë e tyre. Trajnimi duhet të theksojë vlerat etike bazë që kërkohen për të punuar me qenie të tjera njerëzore në mënyrë humane dhe vetëm atëherë të fokusohet në aftësitë e domosdoshme teknike (si siguria dhe përdorimi i forcës). Trajnimi duhet të përfshijë fusha të tillë si komunikimi ndërpersonale, parandalimi i çrregullimeve, menaxhimi pa dhunë i konflikteve dhe menaxhimi i stresit.

Mundësia për vazhdimësinë e trajnimit duhet t’i sigurohet të gjithë stafit, pavarësisht nga gjinia, mosha apo rangu, pa asnjë diskriminim.

Stafi duhet të ketë akses për mbikqyrje psikologjike, mbështetje sidomos pas incidenteve të dhunshme.

## **Pika reference**

Cilat janë kriteret aktuale të rekrutimit?

- çfarë trajnimesh bazë bëjnë të rekrutuarit e rinj (lloji, gjatësia, fusha e subjektit)? Cilat janë mundësitë për vazhdimësinë e trajnimit? A përdoren ato?
- A i është bërë trajnim i veçantë stafit që punon me kategoritë e veçanta si psh. të rinjtë?
- A i mbulon trajnimi i stafit ankesat, inspektimet dhe monitorimet (përfshirë monitorimet e jashtëme nga mekanizmat vizitues)?

## **Lexim i mëtejshëm**

PRI, T’i bëjmë standartet të funksionojnë, Londër 2001 (Seksioni VII- Staf i burgut fq.151-166)

Andreë Coyle, *Një Përfaqje e të drejtave të Njeriut për Menaxhimin e Burgjeve*, 2003 (Stafi I burgut dhe administrata e burgut, fq.13-30).

UN HCHR, *Te Drejtat e Njeriut dhe Burgjet*, Gjenevë 2003. (Seksioni 12, Administrata e burgjeve dhe stafi i burgut, fq.162-171)



## 7. BURGOSJA NGA POLICIA

Disa mekanizma vizitues do të mandatohen të mbulojnë të gjitha vendet e burgimit ose vetëm burgimin nga policia. Vetëm ata, mandati i të cilëve mbulon vetëm monitorimin e llojeve të tjera të mbajtjes në ruajtje, mund të marrin ankesa se ka patur torturë dhe keqtrajtim gjatë veprimeve procedurale për mbajtje në ruajtje nga policia. Kjo mund të jetë hera e parë që të paraburgosurit bëjnë ankesat e tyre, pasi ata shpesh kanë frikë të ankohen derisa janë laguar nga burgimi i policisë. Ankesa të këtij lloji duhet sigurisht të pasqyrohen në veprimtarinë dhe raportet e të gjithë mekanizmave vizitues pavarësisht nga mandate i tyre specific. Kur ka një organ të veçantë përgjegjës për monitorimin e vendeve të burgimit nga policia apo të veprimtarisë së policisë në përgjithësi, mekanizmat vizitues duhet të konsiderojnë lidhjen me këto organe.

Vizitat që kryhen në stacionet e policisë janë ndryshe nga vizitat në burgje. Kontakti me botën e jashtme është zakonisht veçanërisht i kufizuar; prandaj, të paraburgosurit mund të ndjehen më vulnerabël për të folur me delegacionin. Kushtet materiale të paraburgimit përbëjnë një tjetër diferencim pasi ato nuk janë parashikuar për afat të gjatë dhe për rrjedhojë janë me shume elementare. Ruajtja, për të burgosurit, përfshirë edhe procedurën e ruajtjes, merr një rëndësi të veçantë dhe mekanizmat vizitues duhet të sigurojnë që të jenë të mirë përparë për procedurat që do të ndjekin.

Organi vizitues duhet të jetë i mirë informuar mbi ligjin vendor që drejton gjatësinë e burgimit nga policia, si dhe mbi rolin e gjykatësit që autorizon vazhdimësinë e burgimit. Privimi i lirisë nga policia duhet të ketë gjatësi të shkurtër. Pas një periudhe të shkurtër (zakonisht midis 24 deri 72 orë) personi i burgosur nga policia duhet ose të lirohet ose të çohet përpara gjykatësit (personalisht) për të marrë një vendim mbi lirimin apo burgimin e tij të mëtejshëm.

Në disa raste, megjithatë, këto limite nuk respektohen dhe /ose gjykatësit mund të japin vendimin e tyre pa e parë të burgosurin. Ndodh më shpesh në këto orë, menjëherë pas arrestit, që rreziku i keqtrajtimit të jetë më i madh. Për rrjedhojë, seksioni: TRAJTIM/Torturë dhe keqtrajtim është veçanërisht i përshtatshëm për këtë lloj burgimi.

### GARANCITË THEMELORE

#### Standartet

“Mbrojtja e të burgosurit kërkon gjithashtu që t’i jepet akses i rregullt dhe i mnjehershëm mjekëve dhe avokatëve de nën vëzhgimin e duhur sikurse e kërkon investigimi edhe anëtarëve të familjes“. *GC 20, para 11 in fine*

“CPT-ja i atashon rëndësi të veçantë tre të drejtave për personat e burgosur nga policia: e drejta e personit të përfshirë, për të njoftuar faktin e burgimit të tij tek një palë e tretë sipas zgjedhjes së tij ( një anëtar i familjes, shok apo konsultues), e drejta për të patur një avokat dhe e drejta të kërkojë ekzaminim mjekësor nga një mjek i zgjedhur nga ai vetë ( përveç ekzaminimit mjekësor të kryer nga një mjek i thirrur nga autoritetet e policisë). Në opinionin e CPT-së këto janë tre garancitë themelore përkundrejt keqtrajtimit të personit të burgosur, që duhet të zbatohen që në fillim të privimit të lirisë pavarësisht se si përshkruhet sipas sistemin ligjor përkatës ( i ndaluar, i arrestuar etj.) *CPT, GR2, § 36*

“CPT-ja thekson në mënyrë të përsëritur se, sipas eksperiencës së saj, periudha që ndjek menjëherë privimin e lirisë është kur rreziku për kanosje dhe keq- trajtim është më i madh. Për rrjedhojë, mundësia e personit nën mbikqyrjen e policisë për akses tek avokati gjatë asaj periudhe, përbën një mbrojtje themelore ndaj keqtrajtimit. Ekzistenca e kësaj mundësie do të kishte efekt zhbërës mbi personat që kanë ndërmend të keqtrajtojnë të burgosurit; për më tepër një avokat do të ndërmerre veprimet e duhura nëse një keqtrajtim do të ndodhte. CPT-ja pranon se me qëllim që të mbrohen interesat legjitime të investigimit të policisë, do të ishte veçanërisht e rëndësishme të vonohej për një periudhë të caktuar aksesit i personit të burgosur për një avokat të zgjedhur prej tij. Megjithatë, kjo nuk do të rezultonte në mohimin total të së drejtës së aksesit për një avokat gjatë periudhës në fjalë. Në raste të tillë, duhet të rrgullohet aksesit për një avokat tjetër të pavarur”.

E drejta e aksesit për një avokat duhet të përfshijë edhe të drejtën e bisedimit me të në privatësi. Personi duhet gjithashtu, në parim, të ketë të drejtën të mbajë avokatin e tij pranë gjatë marrjes në pyetje nga policia. Natyrisht, kjo nuk do ta pengonte policinë të pyesë personin e burgosur mbi çështje urgjente edhe në mungesë të avokatit (i cili mund të mos jetë menjëherë i disponueshëm), dhe nuk e përjashton zëvendësimin e avokatit i cili pengon realizimin siç duhet të marrjes në pyetje.

CPT-ja ka theksuar gjithashtu se nga e drejta e aksesit për avokat duhet të përfitojnë jo vetëm të dyshuarit penal por gjithashtu çdokush që ndodhet nën detyrimin ligjor për të ndjekur- apo qëndruar- në polici p.sh. si “dëshmitar”.

Për më tepër, që e drejta e aksesit për avokat të jetë plotësisht efektive në praktikë, duhet të bëhet dispozita e duhur për personat që nuk janë në pozitë të paguajnë avokatin.” *CPT GR 12, § 41*

“Personat që janë nën mbikqyrje të policisë duhet ta kenë të njohur zyrtarisht të drejtën e aksesit për doktor. Me fjalë të tjera, mjeku duhet gjithmone të thërritet pa vonesë nëse personi kërkon ekzaminim mjekësor; oficerët e policisë nuk duhet të kërkojnë të filtrojnë këtë kërkesë. Për më tepër, e drejta e aksesit për mjekun duhet të përfshijë të drejtën e personit nën mbikqyrje të policisë për tu ekzaminuar, nëse personi në fjalë kështu dëshiron, nga një mjek i përzgjedhur nga vetë ai ( përveç ndonjë ekzaminimi mjekësor të kryer nga një mjek i thirrur nga policia).

Të gjitha ekzaminimet mjekësore të personit nën mbikqyrjen e policisë duhet të kryhen jashtë dëgjimit të forcave shtrënguese të ligjit dhe nëse doktori kërkon në raste të veçanta, edhe jashtë shikimit të tyre.

Është gjithashtu e rëndësishme që personat e liruar nga mbikqyrja e policisë pa dalë përpara gjykatës, kanë të drejtë të kërkojnë direkt një ekzaminim /certifikatë mjekësore nga një mjek ligjor i njohur.” *CPT GR 12, §42*

“E drejta e një personi të burgosur për të njoftuar faktin e burgimit të tij/saj tek një palë e tretë, duhet në parim të garantohet që në fillim të mbikqyrjes policore. Sigurisht, CPT-ja pranon se ushtrimi i kësaj të drejte mund të duhet të bëhet subjekt për përjashtime të caktuara, me qëllim mbrojtjen e interesave legjitime të investigimit të policisë. Megjithatë, përjashtime të tillë duhet të përcaktohen qartë dhe të limitohen në kohë në mënyrë strikte dhe mbështetja tek ato duhet të shoqërohet me garancitë e duhura (psh. Çdo vonesë e njoftimit të mbikqyrjes nga policia të regjistrohet me shkrim bashkë me arsyen dhe të kërkohet aprovimi i një oficeri policie senior që nuk është i lidhur me rastin apo një prokurori).” *CPT GR12, § 43*

“Personat e privuar nga liria e tyre nga policia, kanë të drejtë të njoftojnë privimin e tyre nga liria tek një palë e tretë e zgjedhur prej tyre, të kenë akses për asistencë ligjore dhe të kenë ekzaminimin mjekësor nga një doktor i zgjedhur prej tyre, kurdoherë që është e mundur.” *Kodi European për Etken e policisë, 2001, neni 57*

Shiko gjithashtu *ACPR, A-17-b) dhe B-1 h) dhe g), dhe IDRCPLD., neni. 36 para. 1.*

## **Të Rinjtë**

Shiko *IDRCPLD, art. 36 para. 4.*

## **Komente**

Rreziku i abuzimit me pushtetin nga ata që janë përgjegjës për kujdesin dhe mbikqyrjen e të burgosurve është më i madh gjatë orëve që ndjekin menjëherë arrestin e që të burgosurit janë shumë vulnerable. Prandaj është e rëndësishme që pushteti i policisë për të burgosur personat përkohësisht, të shoqërohet nga garancitë e duhura. CPT-ja ka identifikuar garancitë e mëposhtme si të një rëndësie të veçantë, që nga fillimi i privimit të lirisë:

- Informimi I një personi të tretë;
- Aksesi për një avokat;
- Aksesi për një mjek.

Mekanizmat vizitues duhet të bëjnë pyetjet e mëposhtme:

## Pika reference

- A ka mundur i burgosuri të informojë familjen e tij/saj apo një person të tretë?
- A ka patur ai/ajo kontakt me një avokat ?
- Është parë ai/ajo nga një mjek?
- A është respektuar maksimumi i kohëzgjatjes së mbikqyrjes ligjore?
- A është çuar i burgosuri përpara gjykatës personalisht?
- A ka bërë i burgosuri ndonjë ankesë formale për torturë dhe çfarë përgjigje ka marrë?
- A ka ndarje të burrave dhe grave? Minorëve dhe të rriturit ?
- A ka mbrojtje nga personat e tjerë të privuar nga liria që mund të përbëjnë kërcënim për të burgosurin ?
- A janë identifikuar oficerët përgjegjës që do të punojnë me të rinjtë dhe gratë?

## REGJISTRAT

### Standartet

“CPT-ja konsideron se garancitë themelore për personat nën mbikqyrjen e policisë duhet të forcohen (dhe puna e policëve do të lehtësohet) nëse regjistrimi i një mbikqyrje të vetme apo gjithëpërfshirës do të ekzistonte për çdo person të burgosur, ku duhet të jenë regjistruar të gjitha aspektet e mbikqyrjes së tij si dhe veprimet e kryera lidhur me të (kur i është privuar liria dhe arsyet për atë masë; kur i janë treguar të drejtat; shenjat e plagëve, sëmundje mendore etj.kur ka kontaktuar me njerëzit e afërt/konsulentin apo avokatin dhe kur është vizituar prej tyre;kur i është ofruar ushqimi; kur është marrë në pyetje; kur është transferuar apo liruar etj.). Për çështje të ndryshme (psh. për artikuj në posedimet e personit, fakti që i janë treguar të drejtat apo që t’i kërkojë ato apo që i janë hequr ato) firma e të burgosurit duhet të merret dhe, nëse është e nevojshme të shpjegohet mungesa e firmës. Për më tepër avokati i të burgosurit duhet të ketë akses tek regjistrimet e tillë të mbikqyrjes. “CPT, GR 2, § 40

### Komente

Regjistrimi përbënë një garanci të rëndësishme pasi ai lë një gjurmë të shkruar të të gjithë informacionit të rëndësishëm që ka lidhje me trajtimin e personave dhe procedurën e ndjekur. Ka disa lloje informacioni që duhen regjistruar dhe pjesët e këtij informacioni gjenden në regjistra të ndryshëm. Mekanizmat vizitues duhet të njihen me regjistrat dhe të jenë në gjëndje të identifikojnë rastet kur dokumentat nuk janë plotësuar sic duhet. Informacioni kyc përfshinë emrin e të burgosurit, arsyet e burgimit, kohën e burgimit, marrjen në pyetje, transferimin dhe përcjelljen e informacionit tek të tretët. Është e rëndësishme që të hetohet nëse personi ka pasur mundësi të apelojë kundër burgimit ndërkohë që ka qenë nën mbikëqyrje, dhe nëse/në çfarë mënyre ky informacion është regjistruar.

### Pika referimi

- A është informacioni i mëposhtëm i regjistruar: kur është arrestuar; kur është marrë në pyetje; kur është transferuar ose liruar; kur është informuar një person i tretë; kur dhe si është informuar personi rreth të drejtave të tij; kur është vizituar nga një doktor, avokat, një person i tretë; sigurimi i ushqimit; çfarë ushqimi është siguruar dhe kur ?
- A është i regjistruar informacioni në mënyrë sistematike dhe rigoroze ?
- A tregojnë të dhënat e regjistruara se është respektuar kohëzgjatja maksimale e burgimit?
- A është regjistruar ndonjë dëmtim fizik ose pretendim për torturë ose keqtrajtim?

## Marrja në pyetje

### Standartet

“1. Kohëzgjatja e çdo marrje në pyetje të një të paraburgosuri ose të burgosuri dhe të intervaleve midis marrjeve në pyetje si dhe identiteti i nënpunësve që drejtojnë procesin dhe të personave të tjerë prezent, duhet të regjistrohet dhe të vërtetohet në një mënyrë të parashikuar nga ligji.

2. Një person i paraburgosur ose i burgosur, ose avokati I tij kur parashikohet nga ligji, duhet të kenë akses tek informacioni i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij parimi.” *BPP, Parimi 23*

“Për sa i përket procesit të marrjes në pyetje, CPT konsideron se duhet të ekzistojnë rregulla dhe udhëzime të qarta në lidhje me mënyrën sesi intervistimet nga policia duhet të kryhen. Ato duhet të trajtojnë ndër të tjera edhe çështjet e mëposhtme: kohëzgjatjen e lejueshme të marrjes në pyetje, intervalet midis intervistave dhe pauzat gjatë një interviste; vendet ku intervistat lejohen të kryhen; nëse të burgosurit mund ti kërkohet të qëndrojnë në këmbë ndërkohë që merret në pyetje; marrjen në pyetje të personave që janë nën efektin e drogës, alkolit, etj. Duhet gjithashtu të regjistrohet sistematikisht koha kur intervistat fillojnë dhe mbarojnë, kërkesat e bëra nga të burgosurit gjatë intervistave dhe nga personat prezent gjatë çdo interviste.

CPT shton se përdorimi I regjistrimeve elektronike gjatë intervistimeve nga policia përbënë një garanci të dobishme kundër keqtrajtimit të të burgosurve (si dhe sjell avantazhe të rëndësishme për policinë).” *T, GR2, §39*

“Regjistrimet elektronike (audio dhe/ose vidjo) të intervistimeve nga policia përbëjnë një garanci të rëndësishme shtesë kundër keqtrajtimit të të burgosurve. CPT është e kënaqur të theksojë se prezantimi i një sistemi të till është duke u konsideruar në një numër shtetes në rritje. Një metodë e till mund të sigurojë regjistrime të plota dhe autentike të procesit të intervistimit, duke lehtësuar në këtë mënyrë hetimin ndaj një pretendimi për keqtrajtim. Kjo gjë është në interes si të personit që është keqtrajtuar nga policia ashtu dhe të nënpunësve të policisë që përballen me pretendime të pabazuara për përfshirjen e tyre në keqtrajtime fizike ose presione psikologjike. Regjistrimet elektronike të intervistimeve nga policia gjithashtu ulin mundësitë që paditësit të mohojnë më vonë deklaratimet e bëra.” *CPT, GR12, § 36*

“Marrja në pyetje e të dyshuarve për një krim është një detyrë specialisti e cila kërkon trajnim specifik nëse duhet të bëhet në mënyrë të kënaqshme. Së pari dhe më e rëndësishmja, qëllimi preciz i marrjes në pyetje duhet të jetë shumë i qartë: qëllimi duhet të jetë përftimi i informacionit të saktë dhe të besueshëm në mënyrë që të zbulohet e vërteta në lidhje me çështjet nën hetim, dhe jo të merret një rrëfim nga dikush që prezumohet fajtor në sytë e nënpunësve që kryejnë intervistën. Për më tepër, përveç trajnimit të duhur, besnikëria e nënpunësve të zbatimit të ligjit ndaj qëllimit të sipërpërmendur do të lehtësojë shumë nga hartimi i një kodi sjelljeje për marrjen në pyetje të të dyshuarve për një krim.” *CPT, GR12, §34*

“ Duhet të theksohet se rishikimi sistematik I rregullave të marrjes në pyetje, instruksioneve, metodave dhe praktikave si dhe kushteve për mbikëqyrjen dhe trajtimin e personave të arrestuar, paraburgosur ose të burgosur, është një mënyrë efektive për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit.” *GC 20, para. 11*

“Për të garantuar mbrojtjen efektive të personave të burgosur (...) vëndi dhe koha e marrjeve në pyetje duhet të regjistrohet, sëbashku me emrat e të gjithë personave prezent dhe ky informacion duhet të jetë gjithashtu i disponueshëm për qëllimet e procedimit gjyqësor ose administrative.” *GC 20 para.11.*

“Për ndjekjen e duhur dhe integritetin e intervistimeve nga policia duhet të dalin udhëzime, të cilat të parashikojnë në vecanti që intervistimi të jetë i drejtë dhe gjatë tij personat që intervistohen të marrin dijeni për arsyet e intervistimit si dhe për çdo informacion tjetër të rëndësishëm. Intervistimet e policisë duhet të regjistrohen sistematikisht.” *Kodi European I Etikës së Policisë, § 50*

## **Komente**

Marrja në pyetje përbënë në vecanti një moment kritik kur i burgosuri është vecanërisht i ndjeshëm ndaj keqtrajtimit ose torturës. Në sistemet e hetimeve kriminale ku theksi vendoset tek rrëfimi më shumë sesa tek mbledhja e saktë e provave, rreziku që policët të përdorin keqtrajtimin ose torturën është shumë i lartë. Ky rrezik rritet atëhere kur rritja në detyrë e policëve bazohet në numrin e të burgosurve të dënuar.

Kur takohet me të burgosurit që janë marrë në pyetje ose janë në procesin e marrjes në pyetje, skuadra vizituese duhet të jetë në dijeni se po vepron në një situatë jonormale. Anëtarët duhet të jenë

të ndjeshëm ndaj gjendjes emocionale të të burgosurit dhe ndaj sigurisë së tij. Është veçanërisht e rëndësishme të arrihet një ekuilibër midis dëshirës së skuadrës për të mbledhur informacion dhe nevojës apo frikës së të burgosurit.

Kur një i burgosur nga policia dëshiron të deklarojë tek mekanizmi vizitues një abuzim fizik apo verbal (në dijeni të plotë për rrezikun që atij/asaj i kanoset), vizitorët nuk duhet të harrojnë të mbledhin informacion “neutral” mbi marrjen në pyetje që mund të jetë ndihmuese në mbështetje (apo në mosprovim) të çdo deklarimi siç është koha, gjatësia dhe vendodhja e marrjes në pyetje si dhe emrat apo pamja e jashtme e atyre prezent.

### **Pika reference**

- A deklaroi personi ndonjë dhunë fizike?
- Gjatë arrestit? Gjatë marrjes në pyetje?
- A ka vuajtur personi apo është duke vuajtur dhunë psikologjike: abuzim, kërcënim?
- Cilat ishin rrethanat e marrjes në pyetje?
- A përmendet në regjistër emri i personit që ka kryer marrjen në pyetje, kohëzgjatja e marrjes në pyetje, pauzat? (shiko gjithashtu Kapitullin IV, trajtimi/tortura dhe keqtrajtimi)

### **INFORMACION**

#### **Standartet**

“Kushdo që është i arrestuar duhet të informohet në kohën e arrestimit të tij, për arsyen e arrestimit dhe duhet të informohet menjëherë për çdo akuzë kundër tij.” *BPP, Parimi 10*

“Çdo person duhet, në momentin e arrestimit të tij dhe në fillimin e burgimit apo dënimit, apo menjëherë pas kësaj, t’i sigurohet nga personi përgjegjës për arrestimin, burgimin apo dënimin, respektivisht informacioni dhe shpjegimi i të drejtave të tij dhe se si të përfitojë ai nga këto të drejta.” *BPP, Parimi 13*

“Të drejtat e personave të privuar nga liria e tyre do të kishin pak vlerë nëse personat në fjalë nuk janë në dijeni të ekzistencës së tyre. Për rrjedhojë, është imperative që personat e marrë në mbikqyrje nga policia të informohen qartë e pa vonesë për të drejtat e tyre dhe në gjuhën që ata kuptojnë. Në mënyrë që të sigurohemi se kjo gjë është bërë, një formular që përcakton këto të drejta në mënyrë të drejtë përdrejtë duhet t’i jepet sistematikisht personave të burgosur nga policia, që në fillim të mbikqyrjes së tyre. Më tej, personave në fjalë duhet t’ju kërkohet të firmosin një deklaratë ku vërtetohet se ata janë informuar për të drejtat e tyre.” *CPT, GRI2, § 44*

“Policia, për aq sa i lejon ligji vendas, informon menjëherë personat e privuar nga liria e tyre për arsyet e privimit të lirisë dhe për çdo akuzë kundër tyre dhe gjithashtu, pa vonesë i informon ata për procedurën që aplikohet në rastin e tyre.” *Kodi Europian mbi Etikën e Policisë § 55*

#### **Komente**

Mekanizmat vizitues duhet të dinë çfarë informacioni duhet të marrë secili person i arrestuar dhe të monitorojë nëse ata e kanë marrë atë. Te burgosurit duhet të informohen për arsyen e arrestimit të tyre. Ata kanë gjithashtu të drejtë të informohen për të drejtat e tyre (psh. të kontaktojnë një person të tretë, avokatin etj). Ky informacion duhet të transmetohet në një gjuhë të kuptueshme. Kjo duhet të bëhet me shkrim duke përdorur formularin dhe nëse personi është analfabet të bëhet gojarisht.

### **Pika reference**

- A është informuar personi menjëherë për arsyen e arrestimit të tij/saj?
- A është informuar personi për të drejtat e tij/saj? Me gojë? Me shkrim?
- Në një gjuhë që ai/ajo kupton/ me përkthyes?
- Si janë trajtuar të burgosurit vulnerabël?

## KUSHTET MATERIALE

### Standartet

“Të gjitha qelitë e policisë duhet të jenë të pastërta dhe me madhësi të arsyeshme për numrin e personave që ato akomodojnë si dhe të kenë ndriçim të përshtatshëm (dmth të mjaftueshëm për të lexuar, përfshirë kohën e gjumit); preferohet që qelitë të kenë ndriçim natyral. Më tej, qelitë duhet të kenë pajisje për të pushuar (psh.nje karrige apo stol të fiksuar), dhe personat që janë të detyruar të kalojnë natën nën mbikqyrje duhet t’ju sigurohet një dyshek dhe batanije të pastërta. Personi nën mbikqyrje të policisë duhet të ketë akses për përdorimin si duhet të tualetit në kushte të përshtatshme dhe t’i ofrohen mjetet e duhura për tu larë.Duhet të kenë akses për ujë të pijshëm dhe t’ju jepet ushqimi në kohën e duhur, përfshirë të paktën një vakt të plotë çdo ditë (dmth dicka më të konsiderueshme se sa një sanduiç). Personat që mbahen nën mbikqyrjen e policisë për 24 orë apo më shumë duhet, për aq sa është e mundur, t’ju ofrohet gjimnastika në ajër të pastër çdo dite.” *CPT, GR12, § 47*

“Se cila është madhësia e arsyeshme për një qeli (ose çdo lloj tjetër akomodimi të të parburgosurve/ burgosurve) është një pyetje e vështirë. Kur bëhet një vlerësim I till duhet të merren parasysh disa faktorë. Megjithatë, delegacionet e CPT-s ndjenë se kishte nevojë për një direktivë për këtë çështje. Kriteri që vijon (i cili konsiderohet si nivel i dëshirueshëm sesa si standart minimal) aktualisht përdoret kur vlerësohen qelitë e policisë për përdorim individual për qëndrimet që tejkalojnë disa orë: 7m2 sipërfaqe, 2 metra ose më shumë midis mureve, 2.5 metra ndërmjet tavanit dhe dyshemesë.” *CPT, GR 2, §43*

“Policia duhet të kujdeset për sigurinë, shëndetin, higjienën, sigurinë dhe ushqimin e përshtatshëm të personave nën mbikëqyrjen e tyre. Qelitë e policisë duhet të jenë të një madhësie të arsyeshme, të kenë ndriçim dhe ajrosje të përshtatshëm dhe të jenë të pajisura me pajisjet e duhura për të pushuar”. *Kodi European mbi Etikën e Policisë, neni 56*

### Komente

Paraburgimi nën mbikëqyrjen e policisë supozohet të jetë i shkurtër në kohë, për rrjedhojë kushtet materiale do të jenë vetëm ato bazë. Megjithatë qelitë e policisë duhet të kenë dritë dhe ajrosje natyrale dhe temperaturë të përshtatshme për klimën dhe stinën. Nëse dikush duhet të kalojë një natë në qeli, ajo duhet të pajisjet me dyshekë e batanije. Aksesit tek tualeti duhet të sigurohet pa vonesë. Megjithatë, mekanizmi vizitues duhet të jetë i ndërgjegjshëm se këto ambiente përdoren nganjëherë për periudha më të gjata kohe, për të cilat ato janë shpesh të papërshtatshme.

Sa më e vogël të jetë qelia aq më pak kohë mund të shpenzohet aty. CPT përdor kriterin që vijon, për të vlerësuar qelitë individuale të policisë që përdoren për të mbajtur personat për më shumë se disa orë: sipërfaqja 7 m2, (me 2 metra ose më shumë midis mureve dhe 2.5metra ndërmjet tavanit dhe dyshemesë).

### Pika referimi

- Cila është madhësia e qelisë, kapaciteti i saj dhe numri aktual i personave që mbahen në të ? A është qelia e mbipopulluar?
- A kanë akses qelitë ndaj dritës natyrale?
- A është temperatura në qeli e përshtatshme për stinën?
- A kanë qelitë karrige dhe dyshekë?
- A i kanë siguruar personit ushqim? Ushqim të ngrohtë?
- A ka personi akses ndaj ujit të pijshëm?
- Cilat janë kushtet e aksesit në tualet?

### Lexime të mëtejshme

AI, *Të luftosh torturën*, Londër 2003. (Kapitulli 4 Garancitë gjatë arrestimit, f. 89-109)

### Standarte specifike

Raporti I dytë I përgjithshëm mbi aktivitetin e CPT, *Arrestimi nga policia*, CPT/Inf 92) 3, § 36- 41

# Anekse

LISTA

SHËMBULL I SHËNIMEVE TË BRENDSHME MBI VIZITËN      PROTOKOLLI OPSIONAL I KONVETËS SË  
KOMBEVE TË BASHKUARA KUNDËR TORTURËS      LISTË STANDARTESH TË RËNDËSISHME  
LEXIME SHITESË      ADRESA TË DOBISHME

## Aneksi 1

### Lista

#### Trajtimi

- Pretendime për torturë dhe keqtrajtim
- Përdorimi I forcës ose formave të tjera të shtrëngimit
- Përdorimi I izolimit

#### Masat mbrojtëse

##### Informimi i të burgosurve

- Informimi menjëherë pas mbërritjes
- Mundësia për të informuar një person të tretë
- Akses i ndaj rregullave dhe procedurave të brendshme

##### Procedura dhe sanksionet disiplinore

- Përshkrim i shkurtër i procedurës
- Përbërja e autoritetit disiplinor
- Mundësia për të apeluar,
- Llojet e ndëshkimeve dhe shpeshësia (proporcionaliteti)
- Ekzaminimi nga doktori pas arrestit
- Statistikat e sanksioneve sipas llojeve dhe arsyeve
- Qelitë disiplinore

##### Ankesat dhe procedurat e inspektimit

- Ekzistenca e ankesave dhe procedurat e inspektimit
- Pavarësia e procedurës
- Akses i ndaj procedurës (e akses i thjeshtë dhe efektiv?)

##### Veçimi i kategorive të të burgosurve

##### Regjistrat

#### Kushtet materiale

- Kapaciteti dhe mbushja e institucionit (në kohën e vizitës)
- Numri i të burgosurve sipas kategorive
- % e shtetasve të huaj
- Ndarja sipas gjinisë dhe moshës

## **Qelitë**

- Përmasat dhe kapacitetit / numri mesatar për qeli
- Kushtet materiale: ndricimi, ajrosja, mobilimi, ambientet sanitare
- Kushtet e higjenës

## **Ushqimi**

- Vaktet (cilësi, sasi, shumëllojshmëria, shpeshtësia)
- Regjime të vecanta dietike (për arsye mjekësore, kulturore ose fetare)

## **Higjena personale**

- Dushet (numri, pastërtia, kushtet e funksionimit, shpeshtësia për të burgosurit që punojnë, për të tjerët)
- Ambientet sanitare (Brenda qelive, jashtë tyre, aksesit, pastërtia)
- Shtrojet (cilësia, pastërtia, shpeshtësia e ndërrimit)
- Mundësia për të larë rrobat

## **Regjimi dhe aktivitetet**

### **Administrimi i kohës**

- Koha ditore që shpenzohet në qeli,
- Koha ditore që shpenzohet për ushtrime,
- Koha ditore që shpenzohet për punë,
- Koha ditore që shpenzohet jashta qelisë,
- Koha javore që shpenzohet për sporte,
- Koha që shpenzohet për aktivitete të tjera.

### **Aktivitetet që ofrohen**

- Puna: aksesit ndaj punës ; lloji i punës; % e të burgosurve që punojnë; detyrimi për të punuar; shpërblimi; sigurimet shoqërore; përshkrimi i ambienteve të punës
- Arsimimi: Aksesit ndaj studimeve, llojet e studimeve që ofrohen (fillore, shkolla e mesme, studime profesionale ose universitare), shpeshtësia e kurseve, organizatorët e kurseve, stafi mësimdhënës, % e të burgosurve që studiojnë, përshkrimi i klasave ku zhvillohet mësimi.
- Argëtimi: llojet e aktiviteteve argëtuese, aksesit, përshkrimi i hapësirave për argëtim dhe ambienteve sportive ; libraria
- Aktivitetet fetare: përfaqësuesit fetar (besimet që prezantohen, kushtet e aksesit; shpeshtësia dhe kohëzgjatja e vizitave); shërbesat fetare (aksesit, ambientet); mundësia për ndjekur praktikant fetare si larja dhe dieta.

### **Kontaktet me botën e jashtme**

- Vizitat: aksesit, shpeshtësia, kushtet për të patur vizita, kohëzgjatja, dhe rregullsia e vizitave, vizitat nga të afërmit/fëmijët/bashkëshortët, përshkrimi i ambienteve të vizitave
- Korrespondenca dhe pakot : shpeshtësia, censurimi
- Bisedat telefonike: shpeshtësia, kushtet, shtetasit e huaj

## **Shërbimet mjekësore**

### **Aksesit ndaj kujdesit shëndetësor**

- Ekzaminimi mjekësor menjëherë pas hyrjes në institucion
- Procedurat e aksesit ndaj kujdesit mjekësor
- Infermiera: numri i shtretërve, pajisjet, mjekimet
- Numri i të burgosurve nën trajtim



### **Stafi mjekësor**

Numri dhe disponueshmëria e doktorëve, infermiereve, psikiatërve dhe psikologëve, dhe personelit tjetër.

### **Stafi i burgut**

- Numri i anëtarëve të stafit (sipas kategorive)
- Marrëdhënia midis rojeve dhe të burgosurve; marrëdhënia midis administratës dhe të burgosurve
- Trajnimi i stafit

## **Aneksi 2: Shëmbull i shënimeve të brendshme mbi vizitën**

### **Informacion i përgjithshëm rreth institucionit**

- Emri i institucionit
- Lloji i institucionit
- Adresa

### **Autoritetet nga të cilat varet institucioni**

- Emri i personit përgjegjës për vendin
- Emri i zëvendësimit ose zëvendësimit

### **Informacion i përgjithshëm rreth vizitës**

- Data e vizitës
- Lloji dhe/ose objektivi i vizitës
- Data e vizitës së mëparshme
- Emrat e anëtarëve të grupit vizitues

## **INFORMACION MBI INSTITUCIONIN**

### **Kapaciteti i institucionit**

- Kapaciteti administrativ
- Kapaciteti mesatar
- Numri i personave të privuar nga liria e tyre në ditën e parë të vizitës (sipas kategorive/ seksit/ kombësisë)
- Përqindja e të burgosurve të huaj
- Ori gjina e të burgosurve të huaj
- Ndarja sipas seksit
- Të burgosurit e mitur
- Të burgosurit e vjetër

### **Struktura e institucionit**

- Përshkrimi i ndërtesës (numri i ndërtesave, vjetërsia, gjëndja, mirëmbajtja, kushtet e sigurisë);
- Përshkrimi i qelive dhe ambienteve të përbashkëta

### **Informacion mbi vizitën**

#### **Biseda në fillim të vizitës – çështjet e diskutuara**

#### **Aspektet e burgimit dhe rekomandimet**

- Sipas personave të privuar nga liria e tyre

- Sipas drejtorit dhe personelit;
- Sipas fakteve të vërejtura nga grupi vizitues.

#### **Biseda në fund të vizitës**

- Çështjet e diskutuara ;
- Përgjigjet e marra.

#### **Veprimet që duhen ndërmarrë**

- Afat shkurtra ;
- Afat mesme

#### **Kontaktet që duhen vendosur**

#### **Shpeshësia e vizitave**

#### **Pikat që duhen verifikuar gjatë vizitës së ardhshme**

### **Aneksi 3:**

## **Protokolli Opsional i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës**

#### **Parathënia**

*Shtetet Anëtare të këtij Protokollit,*

*Duke riafirmuar se tortura dhe trajtimi ose ndëshkimi mizor, johuman ose degradues janë të ndaluara dhe përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut,*

*Të bindura se ka nevojë për masa të mëtejshme për të arritur qëllimet e Konventës kundër Torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit mizor, johuman ose degradues (si më poshtë Konventa) dhe për të forcuar mbrojtjen e personave të privuar nga liria e tyre nga tortura dhe trajtimi ose ndëshkimi mizor, johuman ose degradues,*

*Duke patur parasysh se nenet 2 dhe 16 të Konventës detyrojnë çdo shtet anëtar të marri masa efektive për parandalimin e akteve të torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit mizor, johuman ose degradues në çdo territory brenda juridiksionit të tij.*

*Duke patur parasysh se Shtetet kanë përgjegjësinë kryesore për zbatimin e këtyre neneve, se forcimi i mbrojtjes së njerëzve të privuar nga liria e tyre dhe respektimi i të drejtave të njeriut është një përgjegjësi e përbashkët dhe organet ndërkombëtare të zbatimit plotësojnë dhe forcojnë masat kombëtare,*

*Duke patur parasysh se parandalimi efektiv i torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit mizor, johuman ose degradues kërkon edukim dhe kombinim të masave të ndryshme ligjore, administrative, gjyqësore dhe të natyrave të tjera,*

*Duke patur parasysh se Konferenca Botërore mbi të Drejtat e Njeriut deklaroi se përpjekjet për të rrëzuar torturën duhet si fillim dhe gjithmonë të përqëndrohen mbi parandalimin dhe të kërkojnë adoptimin e një Protokollit Opsional të Konventës, me qëllimin për të vendosur një system parandalues vizitash ndaj vëndeve të burgimit,*

*Duke qenë të bindura se mbrojtja e personave të privuar nga liria e tyre nga tortura dhe trajtimi ose ndëshkimi mizor, johuman ose degradues mund të forcohet nëpërmjet mjeteve jo-gjyqësore të një natyre parandaluese, bazuar në kryerjen e vizitave të rregullta në vëndet e burgimi,*

*Kanë rënë dakortë për sa vijon:*

## **Pjesa I – Parime të përgjithshme**

### **Neni 1**

Objektivi i këtij Protokoll është të vendosi një sistem vizitash të rregullta që kryen nga organe të pavarura kombëtare ose ndërkombëtare në vendet ku personat janë të privuar nga liria e tyre, në mënyrë që të parandalohet tortura dhe trajtimi ose ndëshkimi mizor, johuman ose degradues.

### **Neni 2**

1 Duhet të krijohet një Nënkomitet për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Mizor, Johuman ose Degradues (si më poshtë Nënkomiteti për Parandalim) i varur nga Komiteti kundër Torturës, i cili të kryejë funksionet e përcaktuara në këtë Protokoll.

2 Nënkomiteti për Parandalim duhet të kryejë punën e tij Brenda kuadrit të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe duhet të udhëhiqet nga qëllimet dhe parimet e përcaktuara aty si dhe nga normat e Kombeve të Bashkuara në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria e tyre.

3 Gjithashtu, Nënkomiteti për Parandalim duhet të udhëhiqet nga parimi i konfidencialitetit, paanshmërisë, jo-përzgjedhjes, universalitetit dhe objektivitetit.

4 Nënkomitetit për Parandalim dhe Shtetet Anëtare duhet të bashkëpunojnë për zbatimin e këtij Protokoll.

### **Neni 3**

Çdo Shtet Anëtar duhet të krijojë, të caktojë ose të mbajë në nivel vëndi një ose disa organe vizituese për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit mizor, johuman ose degradues (si më poshtë mekanizmat kombëtar parandalues).

### **Neni 4**

1 Çdo Shtet Anëtar duhet të lejojë kryerjen e vizitave në përputhje me këtë Protokoll, nga mekanizmat e referuar në nenin 2 dhe 3, në çdo vend nën juridiksionin dhe kontrollin e tij, ku personat janë ose mund të jenë të privuar nga liria e tyre bazuar në një urdhër të një autoriteti publik ose me iniciativën, pëlqimin ose dijeninë e tij (si më poshtë vëndet e burgimit). Këto vizita duhet të kryhen me qëllim forcimin e mbrojtjes së personave të privuar nga liria nga tortura dhe trajtimi ose ndëshkimi mizor, johuman ose degradues

2 Për qëllimet e këtij Protokoll, privimi i lirisë nënkupton çdo formë paraburgimi ose burgimit ose vendosjen e personit nën mbikëqyrje publike ose private duke bërë që ky person të mos lejohet të largohet sipas dëshirës, bazuar në urdhrin e çdo autoriteti gjyqësor, administrativ ose të një natyre tjetër.

## **Pjesa II –Nënkomiteti për Parandalim**

### **Neni 5**

1 Nënkomiteti për Parandalim do të përbëhet nga 10 anëtarë. Pas ratifikimit të pesëdhjetë të aksesit në këtë Protokoll, numri i anëtarëve të këtij Nënkomiteti për Parandalim do të rritet në 25

2 Anëtarët e Nënkomitetit për Parandalim do të përzgjidhen ndërmjet personave me karakter moral të lartë, me eksperiencë profesionale të provuar në fushën e administrimit të drejtësisë, në vecanti ligjit penal, burgut ose administratës së policisë, ose në fusha të ndryshme që kanë lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria.

3 Në përbërjen e Nënkomitetit për Parandalim duhet të merret në konsideratë shpërndarja gjeografike dhe përfaqësimi i formave të ndryshme të civilizimit dhe sistemeve ligjore të Shteteve Anëtare.

4 Në këtë përbërje duhet të merret në konsideratë përfaqësimi i balancuar i gjinive bazuar në parimin e barazisë dhe jodiskriminimit.

5 Dy anëtar të Nënkomitetit për Parandalim nuk mund të jenë shtetas të të njëjtit shtet.

6 Anëtarët e Nënkomitetit për Parandalim duhet të shërbejnë në kapacitetin e tyre individual, duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm dhe duhet të jenë në dispozicion të Nënkomitetit për Parandalim për të shërbyer atij në mënyrë eficiente.

## **Neni 6**

1 Çdo Shtet Anëtar mund të caktojë, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, deri në dy kandidatë që posedojnë kualifikimet dhe plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenin 5, si dhe duhet të sigurojnë informacion të detajuar për kualifikimet e kandidatëve: .

- (a) Kandidatët duhet të jenë shtetas të një prej Shteteve anëtare të këtij Protokollit;
- (b) Të paktën njëri prej dy kandidatëve duhet të jetë shtetas i Shtetit Anëtar propozues ;
- (c) Jo më shumë se dy shtetas të një Shteti anëtar mund të propozohen;

(d) Përpara se një Shtet Anëtar të propozojë një shtetas të një Shteti Tjetër Anëtar, ai duhet të marrë miratimin e këtij Shteti Anëtar;

2 Të paktën pesë muaj përpara datës së takimit të Shteteve Anëtare për zhvillimin e zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara duhet ti drejtojë një letër Shteteve Anëtare për ti ftuar ato të paraqesin kandidaturat e tyre brenda 3 muajve. Sekretari i Përgjithshëm duhet të paraqesi një listë, në rend alfabetik, të të gjithë kandidatëve të propozuar duke treguar Shtetet Anëtare përkatëse që i kanë nominuar ata.

## **Neni 7**

1. Anëtarët e Nënkomitetit për Parandalim duhet të përzgjidhen sipas mënyrës së mëposhtme:

(a) Konsideratë primare duhet ti jepet përmbushjes së kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 5 të këtij Protokollit;

(b) Zgjedhjet fillestare duhet të mbahen jo më vonë se gjashtë muaj nga hyrja në fuqi e këtij Protokollit;

(c) Shtetet Anëtare duhet të zgjedhin anëtarët e Nënkomitetit për Parandalim me votim të fshehtë;

(d) Zgjedhjet për anëtarët e Nënkomitetit për Parandalim duhet të zhvillohen një herë në dy vjetë në mbledhjet e thirrura nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Nëse në mbledhje, për të cilat quorumi i nevojshëm është dy të tretat e shteteve anëtare, personat e zgjedhur si anëtar të Nënkomitetit për Parandalim do të jenë ata që kanë marrë numrin më të madh të votave dhe shumicën absolute të votave të përfaqësuesve të Shteteve Anëtare që janë prezent dhe kanë të drejtë vote.

2. Nëse gjatë procesit të zgjedhjeve dy anëtar të një Shteti Anëtar janë kualifikuar për të qenë anëtar të Nënkomitetit për Parandalim, kandidati që ka marrë numrin më të madh të votave do të bëhet praktikisht anëtar i Nënkomitetit për Parandalim. Kur ata kanë marrë të njëjtin numër votash, do të aplikohet procedura e mëposhtme:

(a) Kur vetëm njëri është shtetas i Shtetit Anëtar që i ka nominuar, ai do të bëhet anëtar i Nënkomitetit për Parandalim;

(b) Kur të dy kandidatët janë shtetas të Shtetit Anëtar që i ka nominuar, do të zhvillohet një votim i vecantë i fshehtë për të përcaktuar se cili do të bëhet anëtar;

(c) Nëse asnjëri prej kandidatëve të nominuar nga një Shtet Anëtar nuk është shtetas i këtij shteti, do të zhvillohet një votim i vecantë i fshehtë për të përcaktuar se cili do të bëhet anëtar.

## **Neni 8**

Nëse një anëtar i Nënkomitetit për Parandalim vdes ose jep doreheqjen, ose për çfarë do lloj arsye nuk mund të kryej më detyrën e tij, Shteti Anëtar që e propozoi për anëtar duhet të propozojë një tjetër person i cili duhet të ketë kualifikimet dhe të plotësojë kriteret e përcaktuara në nenin 5, duke patur parasysh nevojën për një balancë midis fushave të ndryshme të kompetencës, i cili do shërbejë deri në mbledhjen e ardhshme të Shteteve Anëtare, me kusht që të miratohet nga shumica e Shteteve Anëtare. Miratimi do të konsiderohet i dhënë nëse gjysma ose një pjesë më e madhe e shteteve anëtare përgjigjet negativisht brenda 6 javëve pasi është informuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara për propozimin e bërë.

## **Neni 9**

Anëtarët e Nënkomitetit për Parandalim duhet të zgjidhen për një periudhë katër vjecare. Ata kanë të drejtën e rizgjedhjes vetëm një herë. Mandati i gjysmës së anëtarëve të përzgjedhur në zgjedhjet e para do të mbarojë në fund të dy vjetëve; menjëherë pas zgjedhjeve të para emrat e anëtarëve do të

zgjidhen me short nga kryetari i mbledhjes për të cilin bëhet referim në nenin 7, paragrafi 1 (d).

#### **Neni 10**

- 1 Nënkomiteti për Parandalim duhet të zgjedhi nënpunësit e vet për një periudhë dy vjecare. Ata mund të rizgjidhen.
2. Nënkomiteti për Parand duhet ti vendosi vetë rregullat procedurale. Këto rregulla duhet të parashikojnë se:
  - (a) Gjysma e anëtarëve plus një përbëjnë quorum-in;
  - (b) Vendimet e Nënkomitetit për Parandalim do të merren me shumicë votash të anëtarëve prezent;
  - (c) Nënkomiteti për Parandalim duhet të mbledhet në dhoma.
3. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara duhet të thërrasi mbledhjen e parë të Nënkomitetit për Parandalim. Pas mbledhjes së parë, Nënkomiteti për Parandalim duhet të mbledhet aq herë sa është parashikuar në rregullat e tij procedurale. Nënkomiteti për Parandalim dhe Komiteti kundër Torturës duhet të zhvillojnë seancat e tyre njëkohësisht të paktën një herë në vit.

### **Pjesa III – Mandati i Nënkomitetit për Parandalim**

#### **Neni 11**

Nënkomiteti për Parandalim duhet:

- (a) Të vizitojë vëndet e referuara në nenin 4 dhe ti bëjë rekomandime Shteteve Aëntare në lidhje me mbrojtjen e personave të privuar nga liria e tyre, ndaj torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit mizor, johuman ose degradues;
- (b) Për sa i përket mekanizmave kombëtar parandalues:
  - (i) Të këshillojë dhe asistojë Shtetet Anëtare, kur është e nevojshme, në institucionet e tyre;
  - (ii) Të mbajë kontakte të drejtëpërdrejta dhe nëse është e nevojshme, konfidenciale, me mekanizmat parandalues kombëtar dhe ti ofrojë atyre trajnim dhe asistencë teknike me qëllim forcimin e kapaciteteve të tyre;
  - (iii) Ti këshillojë dhe asistojë ata në vlerësimin e nevojave dhe mënyrave të nevojshme për forcimin e mbrojtjes së personave të privuar nga liria e tyre, kundër torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit mizor, johuman ose degradues;
  - (iv) Ti bëjë rekomandime dhe vërejtje Shteteve Anëtare me qëllim forcimin e kapacitetit dhe mandatit të mekanizmave parandalues kombëtar për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit mizor, johuman ose degradues;
- (c) Të bashkëpunojë për parandalimin e torturës në përgjithësi, me organet dhe mekanizmat përkatëse të Kombeve të Bashkuara si dhe me institucionet ose organizatat ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare që punojnë për forcimin e mbrojtjes së të gjithë personave nga tortura dhe trajtimi ose ndëshkimi mizor, johuman ose degradues.

#### **Neni 12**

Në mënyrë që ti mundësojnë Nënkomitetit për Parandalim të jetë në përputhje me mandatin sic është parashikuar në nenin 11, Shtetet Anëtare marrin përsipër:

- (a) Të presin Nënkomitetin për Parandalim në territorin e tyre dhe ti japin atij akses ndaj vëndeve të burgimit sic është parashikuar në nenin 4 të këtij protokollit;
- (b) Ti sigurojnë gjithë informacionin që Nënkomiteti për Parandalim mund të kërkojë për të vlerësuar nevojat dhe masat që duhet të adoptohen për të forcuar mbrojtjen e personave të privuar nga liria e tyre kundër torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit mizor, johuman ose degradues;
- (c) Të inkurajojë dhe lehtësojë kontaktet midis Nënkomitetit për Parandalim dhe Mekanizmave kombëtar parandalues;
- (d) Të ekzaminojë rekomandimet e Nënkomitetit për Parandalim dhe të hyjë në dialog me të për masat e mundshme të zbatimit.

### **Neni 13**

- 1 Nënkomitetit për Parandalim duhet të krijojë një program vizitash të rregullta në Shtetet Anëtare në mënyrë që të përmbushi mandatin e tij sic është përcaktuar në nenin 11.
- 2 Pas konsultimeve, Nënkomiteti për Parandalim duhet të njoftojë Shtetet Anëtare për programin e tij në mënyrë që ata të mund të bëjnë pa vonëse arranzhimet praktike për kryerjen e vizitave.
- 3 Vizitat duhet të kryhen nga të paktën dy anëtar të Nënkomitetit për Parandalim. Këta anëtar mund të shoqërohen nga ekspert me eksperiencë profesionale të njohur dhe njohuri në fushat që mbulohen nga ky Protokoll, të cilët do të përzgjidhen nga një listë ekspertësh, bazuar në propozimet e bëra nga Shtetet Anëtare, nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe nga Qendra e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit Ndërkombëtar. Në përgatitjen e listës, Shtetet Anëtare duhet të propozojnë jo më shumë se 5 ekspert kombëtar. Shteti Anëtar i interesuar mund të kundërshtojë përfshirjen e një eksperti specifik në vizitën që do të kryet në vendin e tij, në këtë rast Nënkomiteti për Parandalim duhet të propozojë një ekspert tjetër.
- 4 Nëse Nënkomiteti për Parandalim e konsideron të përshtatshme, mund të propozojë një vizitë të shkurtër pas vizitës së rregullt.

### **Neni 14**

1. Në mënyrë që të mundësohet që Nënkomiteti për Parandalim të përmbushi mandatin e tij, Shtetet Anëtare të këtij Protokollit pranojnë t'i japin atij:
  - (a) Akses të pakufizuar për gjithë informacionin që ka lidhje me numrin e personave të privuar nga liria e tyre në vendin e burgimit, siç është përcaktuar në nenin 4, si dhe me numrin e vendeve të burgimit dhe vendodhjen e tyre;
  - (b) Akses të pakufizuar për gjithë informacionin që ka lidhje me trajtimin e këtyre personave si dhe kushtet e tyre të burgimit;
  - (c) Në varësi të paragrafit 2 të mëposhtëm, akses të pakufizuar për të gjitha vendet e burgimit dhe ambientet e tyre;
  - (d) Mundësinë për të kryer intervista private me personat e privuar nga liria, pa dëshmitarë, personalisht ose nëpërmjet një përkthyesi, nëse konsiderohet e nevojshme, si dhe me çdo person që Nënkomiteti për Parandalim mendon se mund të sigurojë informacion të rëndësishëm;
  - (e) Lirinë për të zgjedhur vendet që dëshirojnë të vizitojnë dhe personat që dëshirojnë të intervistojnë

Kundërshtimi i një vizite në një vend burgimi të veçantë, mund të bëhet vetëm për arsye urgjente apo detyruese të mbrojtjes kombëtare, sigurisë publike, fatkeqësitë natyrore apo çrregullime serioze në vendin që do të vizitohet, gjë që pengon përkohësisht kryerjen e një vizite të tillë. Ekzistenca e një gjëndje të deklaruar emergjence si e tillë nuk do të quhej nga Shteti Anëtar si arsye për të kundërshtuar vizitën.

### **Neni 15**

Asnjë autoritet ose zyrtar nuk duhet të urdhërojë, të aplikojë, të lejojë, ose të tolerojë ndonjë sanksion kundër ndonjë personi ose organizate për arsye se ai i ka komunikuar Nënkomiteti për Parandalim ose përfaqësuesve të tij ndonjë informacion, të vërtetë ose fals, dhe asnjë person apo organizatë e tillë nuk duhet të paragjykohej në asnjë mënyrë.

### **Neni 16**

- 1 Nënkomiteti për Parandalim duhet të komunikojë në konfidencë Shteteve Anëtare rekomandimet dhe vërejtjet e tij dhe nëse është e nevojshme edhe mekanizmave kombëtarë parandalues.
- 2 Nënkomiteti për Parandalim duhet të publikojë raportin e tij së bashku me çdo koment të Shtetit Anëtar të interesuar, kurdoherë që i këkohet nga Shteti Anëtar. Nëse Shteti Anëtar e bënë publike një pjesë të raportit, Nënkomitetit për Parandalim mund të publikojë të gjithë raportin ose një pjesë të tij. Megjithatë asnjë e dhënë personale nuk duhet të publikohet pa miratimin e shprehur të personave të interesuar.
- 3 Nënkomiteti për Parandalim duhet të paraqesë një raport vjetor publik mbi aktivitetin e tij tek Komiteti kundër Torturës.

4 Nëse Shteti Anëtar refuzon të bashkëpunojë me Nënkomitetin për Parandalim sipas neneve 12 dhe 14, ose të ndarmarri hapa për përmirësimin e situatës sipas rekomandimeve të Nënkomitetit për Parandalim, Komiteti kundër Torturës mund, me kërkesë të Nënkomitetit për Parandalim, të vendosi me shumicë të anëtarëve të saj, pasi Shteti Anëtar të ketë pasur mundësinë të bëjë të njohur pikëpamjen e tij, të bëjë një deklaratë publike mbi çështjet ose të publikojë raportin e Nënkomitetit për Parandalim.

## **Pjesa IV – Mekanizmat kombëtar parandalues**

### **Neni 17**

Çdo Shtet Anëtar duhet të mbajë, përcaktojë, krijojë, të paktën brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij Protokollit ose nga ratifikimi I tij, një ose disa mekanizma kombëtar parandalues të pavarur për parandalimin e torturës në nivel vëndi. Mekanizmat e krijuar nga njësi të decentralizuara mund të përcaktohen si mekanizma kombëtar parandalues për qëllimet e këtij Protokollit nëse ato janë në përputhje me dispozitat e tij.

### **Neni 18**

1 Shtetet Anëtare duhet të garantojnë pavarësinë funksionale të mekanizmave kombëtar parandalues si dhe pavaërësinë e personelit të tyre.

2 Shtete Anëtare duhet të ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar që ekspertët e mekanizmit kombëtar parandalues kanë aftësitë dhe njohuritë profesionale të kërkuara. Ata duhet të përpiqen për një balancë gjinore dhe përfaqësimin e përshtatshëm të grupeve etnike dhe minoritare në vend.

3 Shtetet Anëtare pranojnë të vënë në dispozicion burimet e nevojshme për funksionimin e mekanizmave kombëtar parandalues.

4 Shtetet Anëtare duhet të konsiderojnë sic duhet parimet që kanë lidhje me statusin e institucioneve kombëtare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave njerëzore, kur krijojnë mekanizma kombëtar parandalues.

### **Neni 19**

Mekanizmat kombëtar parandalues duhet tu jepet minimalisht pushtet për:

(a) Të ekzaminuar rregullisht trajtimin e personave të privuar nga liria e tyre, që ndodhen në vendin e burgimit, sic është përcaktuar në nenin 4, me qëllim forcimin e mbrojtjes së tyre kundër nga tortura dhe trajtimi ose ndëshkimi mizor, johuman ose degradues.

(b) Të bërë rekomandime autoriteteve përkatëse me qëllim përmirësimin e trajtimit dhe të kushteve të personave të privuar nga liria e tyre dhe për të parandaluar torturën dhe trajtimin ose ndëshkimin mizor, johuman ose degradues, duke marrë në konsideratë normat përkatëse të Kombeve të Bashkuara;

(c) Të paraqitur propozime dhe vërejtje në lidhje me legjislacionin ekzistues dhe atë draft.

### **Neni 20**

Në mënyrë që të mundësohen mekanizmat kombëtar parandalues të përmbushin madantin e tyre, Shtete Anëtare të këtij Protokollit pranojnë ti japin atyre:

(a) Akses për të gjithë informacionin që ka të bëjë me numrin e personave të privuar nga liria e tyre, që gjenden në vëndet e burgimit sic është përcaktuar në nenin 4, si dhe numrin e vëndeve të burgimit dhe vendodhjen e tyre;

(b) Akses ndaj çdo informacioni që ka të bëjë me trajtimin e personave të privuar nga liria si dhe me kushtet e burgimit;

(c) Akses në çdo vend burgimi dhe ambientet e tij;

(d) Mundësinë për të kryer intervista private me personat e privuar nga liria, pa dëshmitarë, personalisht ose nëpërmjet një përkthyesi, nëse konsiderohet e nevojshme, si dhe me çdo person që mekanizmi kombëtar parandalues mendon se mund ti sigurojë informacion të rëndësishëm;

(e) Lirinë për të zgjedhur vëndet që dëshirojnë të vizitojnë dhe personat që duan të intervistojnë;

(f) Të drejtën për të patur kontakte me Nënkomitetin për Parandalim, ti dërgojnë atij informacione dhe të takohen me të.

#### **Neni 21**

1 Asnjë autoritet ose zyrtar nuk duhet të urdhërojë, të aplikojë, të lejojë, ose të tolerojë ndonjë sanksion kundër ndonjë personi ose organizate për arsye se I ka komunikuar mekanizmit kombëtar parandalues ndonjë informacion të vërtetë ose fals, dhe asnjë person apo organizatë e tillë nuk duhet të paragjykohej në asnjë mënyrë.

2 Informacioni konfidencial I mbledhur nga mekanizmi kombëtar parandalues duhet të jetë I privilegjuar. Asnjë e dhënë personale nuk duhet të publikohet pa pëlqimin e shprehur të personit të interesuar.

#### **Neni 22**

Autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar përkatës duhet të ekzaminonjë rekomandimet e mekanizmit kombëtar parandalues dhe të hyjnë në dialog me të për masat e mundshme për zbatimin e tyre.

#### **Neni 23**

Shtetet Anëtare të këtij Protokollit pranojnë të publikojnë dhe shpërndajnë raportet vjetore të mekanizmave kombëtar parandalues.

### **Pjesa V -Deklarimi**

#### **Neni 24**

1. Me ratifikimin, Shtetet Anëtare mund të bëjnë deklarata që shtyjnë zbatimin e detyrimeve të tyre sipas pjesës së III ose të IV të këtij protokollit.

2. Kjo shtyrje duhet të jetë e për një periudhë maksimale prej 3 vjetësh. Pas konsultimit me Nënkomitetin për Parandalim, Komiteti kundër Torturës mund të shtyjë akoma më shumë këtë periudhë për dy vjetë të tjera.

### **Pjesa VI – Dispozita financiare**

#### **Neni 25**

1 Shpenzimet që bëhen nga Nënkomiteti për Parandalim gjatë zbatimit të këtij Protokollit duhet të përballohen nga Kombet e Bashkuara.

2 Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara duhet të sigurojë stafin dhe lehtësitë e nevojshëm për kryerjen efektive të funksioneve të Nënkomitetit për Parandalim sipas këtij Protokollit.

#### **Neni 26**

1 Një fond i vecantë duhet të krijohet në përputhje me procedurat përkatëse të Asamblesë së Përgjithshme, i cili do administrohet në përputhje me rregulloret dhe rregullat financiare të Kombeve të Bashkuara, për të ndihmuar financimin e zbatimit të rekomandimeve të Nënkomitetit për Parandalim pas një vizite në një Shtet Anëtar, si dhe të programeve arsimore të mekanizmave kombëtar parandalues.

2 Fondi i veçantë mund të financohet nëpërmjet kontributeve vullnetare të organizatave qeveritare, ndërqeveritare dhe joqeveritare si dhe entiteteve publike ose private.

### **Pjesa VII – Dispozita përfundimtare**

#### **Neni 27**

1 Ky Protokoll është i hapur për tu firmosur nga çdo Shtet që ka nënshkruar Konventën.

2 Ky Protokoll është objekt ratifikimi nga çdo Shtet që ka ratifikuar ose ka miratuar Konventën. Instrumentat e ratifikimit duhet të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

3 Ky Protokoll është i hapur për çdo Shtet që ka ratifikuar ose miratuar Konventën.



4 Hyrja në këtë Protokoll merr efekt nga momenti i depozitimit të instrumentave të hyrjes pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

5 Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara duhet të informojë të gjitha Shtetet që kanë nënshkruar këtë Protokoll ose kanë hyrë në të të depozitojnë çdo instrument ratifikimi ose hyrjeje.

#### **Neni 28**

1 Ky Protokoll hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të instrumentit të njëzetë të ratifikimit ose hyrjes.

2 Për çdo Shtet që ratifikon këtë Protokoll ose hyn në të pas depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të instrumentit të njëzetë të ratifikimit ose hyrjes, ky Protokoll hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit ose hyrjes.

#### **Neni 29**

Dispozitat e këtij Protokollit shtrihen në të gjitha pjesët e Shteteve ferale pa kufizime ose përjashtime.

#### **Neni 30**

Asnjë rezervë nuk mund ti bëhet këtij Protokollit

#### **Neni 31**

Dispozitat e protokollit aktual nuk i prekin detyrimet e Shteteve Anëtare që burojnë nga marrëveshje të tjera rajonale të cilat vendosin një sistem vizitash në vendet e burgimit. Nënkomiteti për Parandalim dhe organet e krijuara bazuar në marrëveshjet rajonale duhet të inkurajohen të konsultohen dhe bashkëpunojnë me qëllim shmangien e duplikimeve dhe promovimit efektiv të objektivave të këtij Protokollit.

#### **Neni 32**

Dispozitat e këtij Protokollit nuk prekin detyrimet e Shteteve Anëtare ndaj 4 Konventave të Gjenevës të 12 Gushtit 1949 dhe Protokollit Shtesë të 8 Qershorit 1977, dhe as mundësinë e mundshme të çdo Shteti Anëtar për të autorizuar Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq për të vizituar vendet e burgimit në situatat që nuk mbulohen nga ligji ndërkombëtar humanitar.

#### **Neni 33**

1 Çdo Shtet Anëtar mund të denoncojë Protokollin aktual në çdo kohe nëpërmjet një njoftimi me shkrim të adresuar tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili menjëherë pas kësaj informon Shtetet e tjera Anëtare për Protokollin aktual dhe Konventën. Denoncimi hyn në veprim një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.

2 Një denoncim i tillë nuk ka efektin e lirimit të Shtetit Anëtar nga detyrimet e tij sipas Protokollit aktual, lidhur me ndonjë veprim apo situatë që mund të ndodhë përpara datës në të cilën denoncimi hyn në veprim, apo me veprimet që Nënkomiteti për Parandalim ka vendosur apo mund të vendosë të bëjë lidhur me Shtetin Anëtar në fjalë, dhe në asnjë mënyrë nuk do të paragjykonte denoncimi vlerësimin në vijim të ndonjë çështjeje nën vlerësim nga Nënkomiteti për Parandalim përpara datës në të cilën denoncimi hyn në veprim.

3 Në vijim të datës në të cilën denoncimi i Shtetit Anëtar hyn në veprim, Nënkomiteti për Parandalim nuk fillon vlerësimin e asnjë çështjeje lidhur me atë Shtet.

#### **Neni 34**

1 Çdo Shtet Anëtar i Protokollit aktual mund të propozojë ndonjë amendament dhe ta paraqesë ato tek Sekretari Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm do t'ja komunikojë këtë amendament të propozuar Shteteve Anëtare të Protokollit aktual me kërkesën që ta njoftojnë atë nëse janë dakort për një konferencë të Shteteve Anëtare, për të vlerësuar dhe votuar propozimin. Në rast se brenda katër muajsh nga data e një komunikimi të tillë janë dakort të paktën një e treta e

Shteteve Anëtare, atëhere Sekretari i Përgjithshëm mbledh konferencën nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara. Çdo amendament i miratuar nga shumica prej dy të tretave të Shteteve Anëtare prezente dhe që votojnë në konferencë do t'ju parashtrahet, nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara të gjithë Shteteve Anëtare për praninë.

2 Çdo amendament i miratuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni do të hyjë në fuqi kur të jetë pranuar nga shumica prej dy të tretat e Shteteve Anëtare të Protokollit aktual, në përputhje me proceset e tyre përkatëse kushtetuese.

3 Kur amendamentet hyjnë në fuqi, ato do të jenë detyruese për ato Shtete Anëtare që i kanë pranuar ato. Shtetet e tjera Anëtare do të jenë ende të detyruara ndaj dispozitave të Protokollit aktual dhe ndaj çdo amendamenti të mëparshëm që ata e kanë pranuar.

### **Neni 35**

Anëtarëve të Nënkomiteti për Parandalim dhe të mekanizmave kombëtar parandalues do t'ju akordohen privilegje dhe imunitete të tilla që janë të nevojshme për ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre. Anëtarëve të Nënkomiteti për Parandalim do t'ju akordohen privilegje dhe imunitete të përcaktuara në seksionin 22 të Konventës mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Kombeve të Bashkuara të 13 shkurtit 1946, në varësi të dispozitës të seksionit 23 të asaj Konvente.

### **Neni 36**

Kur vizitohet një Shtet Anëtar, anëtarët e Nënkomiteti për Parandalim, pa asnjë paragjykim të dispozitave dhe qëllimeve të Protokollit aktual apo privilegjeve dhe imuniteteve që ata mund të gëzojnë, do të:

- (a) Respektojë ligjet dhe rregulloret e Shtetit që vizitohet
- (b) Frenojë çdo veprim apo aktivitet të papajtueshëm më natyrën e paanëshme dhe ndërkombëtare të detyrave të tyre.

### **Neni 37**

1 Protokollin aktual, në të cilin tekstet Arabe, Kineze, Angleze, Franceze, Ruse dhe Spanjolle janë njësoj autentike, do të depozitohet tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

2 Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të transmetojë kopjet e çertifikuara të Protokollit aktual tek të gjitha Shtetet.

## Anex 4

### Lista e Standarteve Përkatëse

#### 1. KOMBET E BASHKUARA (KB)

##### 1.1. Konventat e KB-së dhe Organizmat e Traktateve

Gjenden tek : [www.unhchr.ch](http://www.unhchr.ch) ⇒ Treaties and Treaty monitoring bodies

Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, 1966 Organi i Traktatit:  
Komiteti për të Drejtat e Njeriut

Konventa kundër Torturës dhe formave të tjera të trajtimeve apo Ndëshkimeve Mizore,  
Çnjerëzore dhe Degraduese, 1984 Organi i Traktatit: Komiteti kundër Torturës

Protokolli Opsional i Konventës kundër Torturës dhe formave të tjera të Trajtimeve apo  
Ndëshkimeve Mizore, Çnjerëzore dhe Degraduese, 2002 Informacioni shtesë gjendet tek [www.apt.ch](http://www.apt.ch)  
⇒ UN & Legal ⇒ Information on the Optional Protocol

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve, 1989 Organizmi i Traktatit: Komiteti për të Drejtat e  
Fëmijëve

Konventa e Vjenës mbi marrëdhëniet Konsullore, 1967, gjendet tek [www1.umn.edu/humanrts](http://www1.umn.edu/humanrts)

##### 1.2. Dokumentat Jo-detyruese të Kombeve të Bashkuara

gjenden tek : [www.unhchr.ch](http://www.unhchr.ch) ⇒ Treaties

Trungu i Parimeve për Mbrojtjen e të Gjithë Personave të çdo Forme Burgimi apo Dënimi me  
Burg, miratuar me rezoltë të Asamblesë së Përgjithshme të KB 43/173, më 9 dhjetor 1988

Parimet Bazë për Trajtimin e të Burgosurve, miratuar me rezoltë të Asamblesë së  
Përgjithshme të KB 45/111, më 14 dhjetor 1990

Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve të Privuar nga Liria e tyre,  
miratuar me rezoltë të Asamblesë së Përgjithshme të KB 45/113 më 14 dhjetor 1990

Rregullat Standarte Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të  
Rinjët (“rregullat e Pekinit”), miratuar me rezoltë të Asamblesë së Përgjithshme të KB 40/33, më 29  
nëntor 1985

Rregullat Standarte Minimale për Trajtimin e të Burgosurve, të miratuara nga ECOSOC me  
rezolutën 633 C (XXIV) të 31 korrikut 1957 dhe 2076 (LXII) të 13 majit 1977

Parimet e Etikës Mjekësore lidhur me Rolin e Personelit Shëndetësor, veçanërisht Mjekët, në  
mbrojtje të të Dënuarve dhe të Burgosurve kundër Torturës dhe Formave të tjera të Trajtimeve apo  
Ndëshkimeve Mizore, Çnjerëzore dhe Degraduese, miratuar me rezoltë të Asamblesë së  
Përgjithshme të KB 37/194 më 18 dhjetor 1982

Parimet Bazë për Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Forcat Shtrënguese të Ligjit,  
miratuar në kongresin e Tetë të Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimi i  
Shkelësve të Ligjit Havana, Cuba, 27 gusht deri 7 shtator 1990

Kodi i sjelljes për forcat shtrënguese të kligjit, miratuar me rezoltë të Asamblesë së  
Përgjithshme të KB 34/169 më 17 dhjetor 1979

Parimet e KB për mbrojtjen e personave me sëmundje mendore dhe përmirësimi i kujdesit të  
Shëndetit Mendor, miratuar me rezoltë të Asamblesë së Përgjithshme të KB 46/119 më 17 dhjetor  
1991

Direktivat e rishikuara të Komisionerit të Lartë të KB mbi kriteret dhe standartet e aplikuara  
lidhur me burgimin e azil kwrkuesve, 1999, gjendet tek [www.unhcr.ch](http://www.unhcr.ch)

■ Deklarata mbi kerkimet e trupave të të burgosurve, miratuar nga Asambleja e 45të e Mjeksisë  
Botërore, Budapest, Hungari, tetor 1993. Gjendet tek [www.wma.net/e/policy/b5.htm](http://www.wma.net/e/policy/b5.htm)

Rregullat Standarte Minimale për Masat Jo-mbikqyrëse (rregullat e Tokios), miratuar me  
rezoltë të Asamblesë së Përgjithshme të KB 45/110 më 14 dhjetor 1990

## 2. UNIONI AFRIKAN

- Karta Afrikane mbi të Drejtat Njeriut dhe të Popullit, miratuar nga organizata e Unitetit Afrikan, më 27 qershor 1981

gjendet tek [www.africa-union.org](http://www.africa-union.org) ⇒ Official Documents ⇒ Treaties, Conventions & Protocols

- Draft Karta Afrikane mbi të Drejtat e të Burgosurve, miratuar në Konferencën e Pestë të Afrikës Qendrore, Lindore dhe Jugore.

Kryetarët e Shërbimeve Korrektuese, Windhoek Namibia, më 4 deri 7 shtator 2001, diskutuar në Konferencën Pan-Afrikan mbi Reformën Penale dhe të Burgjeve në Afrikë, Ouagadougou nga 18 deri 20 shtator 2002,

Informacion shtesë i disponueshëm tek [www.penalreform.org](http://www.penalreform.org)

Direktivat dhe Masat për Ndalimin dhe Parandalimin e Torturës, të Trajtimeve apo Ndëshkimeve Mizore, Çnjerëzore dhe Degraduese në Afrikë (direktivat e Robben Island), 2001, gjenden tek [www.apr.ch](http://www.apr.ch) ⇒ Africa

Deklarata e Kampala mbi Kushtet e Burgut në Afrikë, prodhuar nga një Konferencë Afrikane mbi kushtet e burgjeve, 1996.

Gjendet tek [www.penalreform.org/english/pana\\_declarationkampala.htm](http://www.penalreform.org/english/pana_declarationkampala.htm)

## 3. ORGANIZATAT E SHTETEVE AMERIKANE

gjenden tek: [www.cidh.oas.org](http://www.cidh.oas.org) ⇒ Basic Documents

Konventa Amerikane mbi të Drejtat e Njeriut (Pakti San Jose), miratuar nga Konferenca Ndër-Amerikane e Specializuar për të Drejtat e Njeriut e Organizatës së Shteteve Amerikane, San José, Costa Rica, 22 nëntor 1969

Deklarata Amerikane mbi të Drejtat dhe Deryrat e Njeriut, miratuar nga Konferenca e Nëntë Ndërkombëtare e Shteteve Amerikane, 2 maj 1948

Konventa Ndër-Amerikane për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Torturës, Cartagena de Indias, Colombia, 9 dhjetor 1985

Draft deklarata Ndër-Amerikane mbi të Drejtat dhe Kujdesin e Personave të Privuar nga Liria, sponsorizuar nga qeveria e Costa Rikës dhe përgatitur nga Reforma Penale Ndërkombëtare në 2001, duke patur parasysh paraqitjen e Organizatës së Shteteve Amerikane në Asamblenë e Përgjithshme.

Gjendet tek [www.penalreform.org](http://www.penalreform.org)

## 4. KËSHILLI I EUROPËS

### 4.1. Konventat e Këshillit të Europës

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, ETS No. 005, 1950, gjendet tek [www.coe.int](http://www.coe.int) ⇒ Human Rights

Konventa Europiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të tjera çnjerëzore dhe degraduese, ETS No. 126, 1987, gjendet tek [www.cpt.coe.int](http://www.cpt.coe.int) ⇒ Documents ⇒ Reference Documents

Të gjitha standartet e CPT-së mund të gjenden tek [www.cpt.coe.com](http://www.cpt.coe.com)

### 4.2. Dokumentat Jo-detyruese të Këshillit të Europës

gjenden tek [www.coe.int](http://www.coe.int) ⇒ Committee of Ministers ⇒ Advanced Search (prezanto datën dhe referencën)

Rekomandimi R(87)3, Rregullat e Burgut European, miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës më 12 shkurt 1987, referenca: Rec(87)3

Rekomandimi R(89)12 mbi Edukimin në Burg, miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës më 13 tetor 1989, referenca: Rec(89)12

Rekomandimi R(98)7 lidhur me aspektin etik dhe organizativ të kujdesit për shëndetin në burg, miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës më 8 prill 1998, referenca: Rec(98)7

Rekomandimi R(80)11 lidhur me mbikqyrjen në pritje të gjyqimit, miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës më 27 qershor 1980, referenca: Rec(80)11

Rekomandimi R(82) 16 për lejet e burgut, miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës më 24 shtator 1982, referenca: Rec(82)16

Rekomandimi R(82)17 lidhur me mbikqyrjen dhe trajtimin e të burgosurve të rrezikshëm, miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës më 24 shtator 1982, referenca: Rec(82)17

Rekomandimi R (84)12 lidhur me të burgosurit e huaj, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 21 qershor 1984, referenca: Rec(84)12

Rekomandimi R(89)14 lidhur me çeshtjet etike të infeksionit HIV në kujdesin shëndetësor dhe mjedisin shoqëror, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 24 tetor 1989, referenca: Rec(89)14

Rekomandimi R(92)16 mbi rregullat europiane për sanksionet e komunitetit dhe masat, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 19 tetor 1992, referenca: Rec(92)16

Rekomandimi R(93)6 lidhur me burgun dhe aspektet e kriminologjise mbi kontrollin e sëmundjeve të transmetueshme përfshirë AIDS dhe problemet shëndetsore të lidhura me të në burg, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 18 tetor 1993, referenca: Rec(93)6

Rekomandimi R(98)7 lidhur me aspektin etik dhe organizativ të kujdesit për shëndetin në burg, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 8 prill 1998, referenca: Rec(98)7

Rekomandimi R(98)8 lidhur me aspektin etik dhe organizativ të kujdesit për shëndetin në burg, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 8 prill 1998, referenca: Rec(98)8

Rekomandimi R(99)22 lidhur me mbipopullimin e burgut dhe inflacionin e popullsisë në burg, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 30 shtator 1999, referenca: Rec(99)22

Rekomandimi Rec(2001)10 mbi Kodin European të Etikës së Policisë, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 19 shtator 2001; referenca Rec(2001)10

## Anex 5

### Lexime Shtesë

#### 1. MBI MONITORIMIN E VENDEVE TË BURGIMIT

APT/OSCE-ODHIR, *Monitorimi I vendeve të burgimit: një guidë praktike për OJQ-të*, Gjeneva, dhjetor 2002, [www.apr.ch](http://www.apr.ch) në anglisht dhe rusisht.

Reforma penale Ndërkombëtare, *Monitorimi i kushteve të burgut në Europë: Raporti i një Europiani, Seminar i zhvilluar në Marly-le-Roi, France, Paris, 1997.*

#### 2. MBI OPCAT-in

APT, *Protokolli Opsional i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve apo ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore, degraduese, të Kombeve të Bashkuara: Një Manual për Parandalimin*, Gjeneva, 2004, gjendet në anglisht (në vijim edhe në frengjisht, spanjisht dhe portugalisht).

APT, *Implementimi i Protokolli Opsional të Konventës kundër Torturës të Kombeve të Bashkuara. Ngritja e Mekanizmave Kombëtarë Parandalues*, Gjeneva, Prill 2003, gjendet tek [www.apr.ch](http://www.apr.ch) në anglisht, frengjisht, spanjisht dhe rusisht.

#### 3. MBI TORTURËN

Camille Giffard, *Libërth Raportues i Torturës, Si të dokumentojmë dhe të reagojmë ndaj deklaramëve të torturës brenda sistemit ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut*, Qendra për të Drejtat e Njeriut, Universiteti Essex, 2000. gjendet në gjuhën arabe, angleze franceze, spanjolle dhe ruse.

Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, *Protokolli i Stambollit, Manuali mbi investigimin efektiv dhe dokumentimin e torturës dhe trajtimeve apo ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore dhe degraduese*, Vëllimi i Trajnimit Profesional no. 8, Neë York, Gjeneva, 2001.

Amnesty International, *Lufta Kundër Torturës: manual Veprimi*, Londër 2003, gjendet tek [www.amnesty.org](http://www.amnesty.org), në anglisht.

OSCE/ODIHR, *Parandalimi i Torturës – një libër për stafin në terren të OSBE-s.*, Varshavë 1999, gjendet tek [www.osce.org](http://www.osce.org) në anglisht dhe rusisht.

#### 4. MBI IMPLEMENTIMIN E STANDARTEVE NË BURGJE

Andrew Coyle, *Një Përjasje e të Drejtave të Njeriut për Menaxhimin e Burgjeve. Libër për stafin e burgut. Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Burgut*, 2003, gjendet tek [www.prisonstudies.org](http://www.prisonstudies.org), në gjuhën arabe, portugeze-braziliane, kineze, angleze, ruse, spanjolle dhe turke.

Reforma Penale Ndërkombëtare, *T'i bëjmë standartet të funksionojnë, një libër ndërkombëtar mbi praktikën e mira të burgut*. Londër, 2001, gjendet në gjuhën angleze, franceze, ruse dhe spanjolle, për tu shkarkuar tek [www.penalreform.org](http://www.penalreform.org)

Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, *Të Drejtat e Njeriut dhe Burgjet- Një manual për trajnimin e Punonjësve të Burgjeve mbi të Drejtat e Njeriut*, Vëllimi i Trajnimit Profesional no.9, Gjeneva, 2003

Nigel S. Rodley, *trajtimi i të burgosurve sipas të drejtës ndërkombëtare*, Botimi i Dytë, Oksford 1999

Vivien Stern, *Një mëkat kundrejt së ardhmes- Burgimi në botë*. Librat Pinguin, 1998

Peter Sutton, (ed.), *Edukimi Elementar në Burgje: Raporti Final, botim i përbashkët i Kombeve të Bashkuara dhe Institutit të Edukimit të UNESCO(UIE), versioni anglisht është pa pagesë tek UIE, versioni në gjuhën franceze dhe spanjolle gjendet tek UIE Website:*

<http://www.unesco.org/education/uie/online/prifr/prifr.pdf> Others

## **5. MBI MONITORIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË PËRGGJITHËSI**

Fondacioni për të Drejtat e Njeriut të Helsinkit, *Monitorimi i të Drejtave të Njeriut*, Varshavë 2001.  
Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara,  
*Vëllimi i Trajnimit Profesional no.7, Manuali i Monitorimit të të Drejtave të Njeriut*, New York,  
Gjeneva, 2001

## **6. MBI ORGANIZMAT QË VIZITOJNË VENDET E BURGIMIT**

APT, *Vizitimi i vendeve të burgimit: Praktika dhe Mësime të mësuara nga institucionet vendore të përzgjedhura. Raporti i Seminarit*, Gjeneva, 2004.

APT, *Impakti i Vizitave të Jashtme në Stacionet e Policisë mbi Parandalimin e Torturës dhe Keqtrajtimit, Studim*, Gjenevë, 1999.

APT, *Procedurat e Veprimeve Standarte të Mekanizmave Ndërkombëtare që Kryejnë Vizita në vendet e burgimit, Raporti i Seminarit*, Gjenevë, 1997.

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, *Privimi nga Liria*, Gjenevë 2002.

Malcolm D. Evans dhe Morgan Rod, *Parandalimi i Torturës, Një studim Konventës Europiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin apo Ndëshkimit çnjerëzor dhe Degradues*, Oksford, 1998.

Rod Morgan dhe Malcolm D. Evans, *Lufta kundër Torturës në Europë*, Botim i Këshillit të Europës, 2001.

Vëllimet e APT *mbi Parandalimin e Torturës në Europë* (në frengjisht dhe anglisht)

Broshure n°3 – Barbara Bernath, *Historia, mandati dhe kompozimi i CPT-së*, Gjeneva, dhjetor 1999.

Brochure n°4 – Ursula Kriebaum, *CPT Modus Operandi*, Gjeneva, Maj 2002.

APT/Këshilli i Europës, *Një vizitë nga CPT- Për çfarë është e gjithë kjo? 15 pyetje dhe përgjigje për policinë*, Maj 1999.

# Anex 6

## Adresa të Dobishme

### 1. ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

#### **Secretariati i Commonwealth**

Human Rights Unit Marlborough House, Pall Mall, London SW1Y 5HX, United Kingdom Tel: +44 207 747 6500 – Fax: +44 207 930 0827 Website [www.thecommonwealth.org](http://www.thecommonwealth.org)

#### **Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq**

19 Avenue de la Paix, 1202 Geneva, Switzerland Tel: +41 (0)22 734 60 01 - Fax: +41 (0)22 733 20 57 E-mail: [webmaster.gva@icrc.org](mailto:webmaster.gva@icrc.org) Website: [www.icrc.org](http://www.icrc.org)

#### **Unioni Ndër-Parlamentar**

5 chemin du Pommier, Case postale 330 CH – 1218 Grand-Saconnex, Geneva, Switzerland Tel: +41 (0)22 919 4150 – Fax: +41 (0)22 919 4160 E-mail: [postbox@mail.ipu.org](mailto:postbox@mail.ipu.org) Website: [www.ipu.org](http://www.ipu.org)

#### **Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut**

Palais Wilson, 52 Rue de Pâquis, 1201 Geneva, Switzerland Tel: +41 (0)22 917 9000 - Fax: +41 (0)22 917 9012 E-mail: [infodesk@ohchr.org](mailto:infodesk@ohchr.org) Website: [www.ohchr.org](http://www.ohchr.org)

#### **Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët**

P.O Box 2500, CH-1211 Geneva 2 Dépôt, Switzerland Tel: +41 (0)22 739 8111 - Fax: +41 (0)22 731 9546 Website: [www.unhcr.org](http://www.unhcr.org)

#### **Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin**

Vienna International Centre Wagramer Strasse 5 -P.O. Box 500, A-1400 Vienna, Austria Tel: +43 1 260 600 – Fax: +43 1 260 60 58 66 E-mail: [unodc@unodc.org](mailto:unodc@unodc.org) Website: [www.unodc.org](http://www.unodc.org)

### 2. ORGANIZATAT RAJONALE

#### **EUROPA**

##### **Këshilli i Europës**

Avenue de l'Europe F-67075 Strasbourg, Cedex, France Tel: +33 3 88 41 20 00 / 33 -Fax:+33 3 88 41 27 30 / 45 Website: [www.coe.int](http://www.coe.int)

##### **Komiteti European për Parandalimin e Torturës (CPT)**

Human Rights Building - Council of Europe F-67075 Strasbourg Cedex, France Tel: +33 3 88 41 39 39 - Fax: +33 3 88 41 27 72 E-mail: [cptdoc@coe.int](mailto:cptdoc@coe.int) Website: [www.cpt.coe.int](http://www.cpt.coe.int)

##### **Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut**

Council of Europe 67075 Strasbourg Cedex, France Tel: +33 (0)3 88 41 20 18 - Fax: +33 (0)3 88 41 27 30 Website: [www.echr.coe.int](http://www.echr.coe.int)

##### **Instituti European për Parandalimin dhe Kontrollimin e Krimin, bashkuar me Kombet e Bashkuara ë ë (HEUNI)**

P.O. Box 444, Pitkäsillanranta 3 A 00531 Helsinki, Finland Tel: +358 (0)10 366 5280 - Fax: +358 (0)10 366 5290 E-mail : [heuni@om.fi](mailto:heuni@om.fi) Website: [www.heuni.fi](http://www.heuni.fi)

##### **Parlamenti European**

Allée du Printemps - Boîte Postale 1024/F F-67070 Strasbourg Cedex, France Tel: +33 3 88 17 40 01 -Fax: +33 3 88 1 / +33 3 88 25 65 01 E-mail: [civis@europarl.eu.int](mailto:civis@europarl.eu.int) Website: [www.europarl.eu.int](http://www.europarl.eu.int) (You can also consult the addresses in Brussels and Luxembourg)

##### **Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR)**

Organization for Security and Cooperation in Europe (OSCE) Aleje Ujazdowskie 19, 00557 Warsaw, Poland Tel: +48 22 520 06 00 - Fax: +48 22 520 06 05 E-mail: [office@odhir.pl](mailto:office@odhir.pl) Website: [www.osce.org/odhir](http://www.osce.org/odhir)

#### **AFRIKA**

##### **Komisioni Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe të Popullit**

90 Kairaba Avenue, P.O. Box 673, Banjul, The Gambia Tel: +220 392 962 - Fax: +220 390 764 E-mail: [achpr@achpr.org](mailto:achpr@achpr.org) Website: [www.achpr.org](http://www.achpr.org)



**Unioni Afrikan (i njohur dikur si Organizata e Unitetit Afrikan)**

P.O. Box 3243, Addis Ababa, Ethiopia Tel: +251 11 551 77 00 - Fax: +251 11 551 78 44 E-mail:

[webmaster@africa-union.org](mailto:webmaster@africa-union.org) Website: [www.africa-union.org](http://www.africa-union.org)

**Instituti i Kombeve të Bashkuara Afrikane për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Shkelësve të Ligjit**

P.O. Box 10590, Kampala, Uganda Tel: +256 41 22 11 19 - Fax: +256 41 22 26 23 E-mail: [unafri@unafri.or.ug](mailto:unafri@unafri.or.ug)

Website: [www.unafri.or.ug](http://www.unafri.or.ug)

**AMERICAS****Komisioni Ndër-Amerikan për të Drejtat e Njeriut**

Organization of American States (OAS) 1889 F Street, N.W., Washington D.C. 2006,

USA Tel: +1 202 458-6002 - Fax: +1 202 458-3992 Website [www.cidh.org](http://www.cidh.org)

**Instituti i Kombeve të Bashkuara Latine për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Shkelësve të Ligjit (ILANUD)**

P.O. Box 10071-1000, San José, Costa Rica Tel: +506 257 5826 - Fax: +506 233 7175 e-mail:

[ilanud@ilanud.or.cr](mailto:ilanud@ilanud.or.cr) home page: <http://www.ilanud.or.cr>

**AZIA****Instituti i Kombeve të Bashkuara të Azisë dhe Lindjes së Largët për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Shkelësve të Ligjit (UNAFEI)**

1-26 Harumi-cho, Fuchu-shi, Tokyo 183-0057, Japan Tel: +81 42 333 7021 - Fax: +81 42 333 7024 E-mail :

[unafei@moj.go.jp](mailto:unafei@moj.go.jp) Website: [www.unafei.or.jp](http://www.unafei.or.jp)

**3. ORGANIZATAT JO-QEVERITARE****OJQ-të NDËRKOMBËTARE****Amnesty International ( Sekretariati Ndërkombëtar)**

1 Easton Street, London WC1X 0DW, Mbretëria e Bashkuar Tel: +44 207 413 55 00 -Fax: +44 207 956 11 57

E-mail: [amnestyis@amnesty.org](mailto:amnestyis@amnesty.org) Website: [www.amnesty.org](http://www.amnesty.org)

**Shoqata për Parandalimin e Torturës (APT)**

10 Route de Ferney, P.O. Box 2267, 1211 Geneva 2, Switzerland Tel: +41 22 919 21 70 - Fax: +41 22 919 21 80

E-mail: [apt@apt.ch](mailto:apt@apt.ch) Website: [www.apt.ch](http://www.apt.ch)

**Human Rights Watch (HRW)**

350 Fifth Avenue, 34th floor New York, NY 10118-3299 USA Tel: +1 212 290 4700 - Fax: +1 212 736 1300

E-mail: [hrwny@hrw.org](mailto:hrwny@hrw.org) Website: [www.hrw.org](http://www.hrw.org)

**Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Burgjeve (ICPS)**

King's College London, School of Law, 3rd Floor 26-29 Drury Lane, London WC2B 5RL, United Kingdom

Tel: +44 (0) 207 848 1922 - Fax: +44 (0) 207 848 1901 E-mail: [icps@kcl.ac.uk](mailto:icps@kcl.ac.uk) Website: [www.prisonstudies.org](http://www.prisonstudies.org)

**Komisioni Ndërkombëtar i Juristëve (ICJ)**

P.O. Box 91, 33, rue des Bains 1211 Geneva 8, Switzerland Tel: +41 22 979 3800 - Fax: +41 22 979 3801

E-mail: [info@icj.org](mailto:info@icj.org) Website: [www.icj.org](http://www.icj.org)

**Federata Ndërkombëtare e Veprimit Kristian për Zhdukjen e Torturës (FIACAT)**

27 Rue de Maubeuge, 75009 Paris, France Tel: +33 1 42 80 01 60 - Fax: +33 1 42 80 20 89 E-mail:

[fiacat@fiacat.org](mailto:fiacat@fiacat.org) Website: [www.fiacat.org](http://www.fiacat.org) (Please refer to the addresses of other ACATs in the world)

**Federata Ndërkombëtare e Lidhjes për të Drejtat e Njeriut (FIDH)**

17 Passage de la Main d'Or, 75011 Paris, France Tel: +33 1 43 55 25 18 -Fax: +33 1 43 55 18 80 E-mail:

[fidh@fidh.org](mailto:fidh@fidh.org) Website: [www.fidh.org](http://www.fidh.org)

**Këshilli Ndërkombëtare i Rehabilitimit të Viktimave të Torturës**

Borgergade 13 – P.O Box 9049 - DK-1022 Copenhagen K - Denmark Tel: +45 33 76 06 00

Fax: +45 33 76 05 00 E-mail: [irct@irct.org](mailto:irct@irct.org) Website: [www.irct.org](http://www.irct.org)

**Shërbimi Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut**

1 rue de Varembe, P.O. Box 16, 1211 Geneva 20, Switzerland Tel: +41 (0)22 733 51 23 - Fax:

+41 (0)22 733 08 26 Website: [www.ishr.ch](http://www.ishr.ch)

**Organizata Botërore kundër Torturës (OMCT—SOS Torture)**

8, rue du Vieux-Billard, P.O. Box 21, 1211 Geneva 8, Switzerland Tel: +41 (0)22 809 49 39

Fax: +41 (0)22 809 49 29 E-mail : [omct@omct.org](mailto:omct@omct.org) Website: [www.omct.org](http://www.omct.org)

**Reforma Penale Ndërkombëtare (London office)**

Unit 450, The Bon Marche Centre 241 - 251 Ferndale Road, London, SW9 8BJ, United Kingdom Tel: +44 (0)20

7924 9575 - Fax: +44 (0) 20 7924 9697 E-mail: [headofsecretariat@penalreform.org](mailto:headofsecretariat@penalreform.org) Website:

[www.penalreform.org](http://www.penalreform.org)

**The Redress Trust**

3rd Floor, 87 Vauxhall Walk - London SE11 5HJ – United Kingdom Tel: +44 (0)20 7793 1777 -Fax: +44 (0)20

7793 1719 E-mail: [redresstrust@gn.apc.org](mailto:redresstrust@gn.apc.org) Site Internet: [www.redress.org](http://www.redress.org)

**OJQ-të RAJONALE****Qendra Afrikane për Demokraci dhe Studimin e të Drejtave të Njeriut**

P. O. Box 2728, Serekunda, Zoe Tembo Building, Kerr Sereign, The Gambia Tel: +220 4462340/1/2 -Fax:

(220)4462338/9 E-mail: [acdhrs@acdhrs.org](mailto:acdhrs@acdhrs.org)/ [edir@acdhrs.org](mailto:edir@acdhrs.org) Website: [www.acdhrs.org](http://www.acdhrs.org)

**Rrjeti Aziatiko-Paqësor për të Drejtat e Njeriut**

B – 6/6 Safdarjung Enclave Extension, 110029 New Delhi, India Tel: +91 11 26 192 717 / 26 192 706 -Fax: +91

11 26 191 120 E-mail: [secretariat@aphrn.org](mailto:secretariat@aphrn.org) Site Internet: [www.aphrn.org](http://www.aphrn.org)

**Qendra Ndër-Amerikane për Drejtësi dhe të Drejtën Ndërkombëtare(CEJIL)**

CEJIL Washington 1630 Connecticut Ave., NW - Suite 401 - Washington D.C. 20009 – 1053, USA Tel: +202

319 3000 -Fax: +202 319-3019 E-mail: [washington@cejil.org](mailto:washington@cejil.org) Website: [www.cejil.org](http://www.cejil.org)

**Instituti Ndër-Amerikan për të Drejtat e Njeriut (IIDH)**

P.O. Box 10081-1000 San José, Costa Rica Tel: +506 234 0404 - Fax: +506 234 0955

E-mail: [instituto@iidh.ed.cr](mailto:instituto@iidh.ed.cr) Website: [www.iidh.ed.cr](http://www.iidh.ed.cr)

**Federata Ndërkombëtare e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut**

Wickenburggasse 14/7, 1080 Vienna, Austria Tel: +43 1 408 88 22 - Fax: +43 1 408 88 22/50 E-mail:

[office@ihf-hr.org](mailto:office@ihf-hr.org) Website: [www.ihf-hr.org](http://www.ihf-hr.org)